RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË

NË
INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Tiranë, gusht 2025

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4**
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve	5-11
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	11-14
II	**HYRJA**	**15**
1	Objektivat dhe qëllimi	15
2	Identifikimi i çështjes	15
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15
4	Përgjegjësitë e audituesve	16
5	Kriteret e vlerësimit	16
6	Standardet e auditimit	16
7	Metodat e auditimit	17
8	Dokumentimi i auditimit	18
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**19**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	19
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	20
2.1	Auditimi mbi përputhshmërinë me kuadrin ligjor në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	20-28
2.2	Auditimin e zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, respektimin e strukturave organike të miratuara dhe krahasimin me gjendjen faktike, si dhe respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve	28-33
2.3	Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare	33-43
2.4 2.4.1-2.4.18	Mbi zbatimin e legjislacionit per realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve	44-122
2.5	Mbi Vlerësimin e Funksionimit të Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	122-125
2.6 2.6.1-2.6.8	Të tjera, mbi aktivitetin e ISUV, si institucion përgjegjës për gjurmimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe shpendëve, si dhe çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit	125-142
IV	**REKOMANDIMIE**	**143-159**
V	**ANEKSE**	**160-186**

Lista e shkurtimeve

ACCREDIA	Agjenci Kombëtare Akreditimi në Itali
AK	Autoritet Kontraktor
AKMBV	Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes së Bimëve dhe Veterinarisë
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
EU-RL	Laboratorë Evropianë të Referencës
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
LIMS	Sistem i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
PKKZBR	Plani Kombëtar i Kontrollit Zyrtar me Bazë Risku.
PMB	Produktet e Mbrojtjes së Bimëve
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
TVA	Tatim mbi Vlerën e Shtuar (Belgjikë)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZPK	Zyrën e Pranimit të Kampioneve

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

a. Përshkrim i shkurtër i auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 58/1 prot., datë 21.01.2025 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 22.01.2025 deri 05.05.2025, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2024.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij;

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është një institucion publik, i specializuar në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit veterinar dhe kontrollit të produkteve me origjinë shtazore dhe bimore. ISUV luan një rol thelbësor në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit dhe në garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian. ISUV është akreditуar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, i cili përcakton kërkesat për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit. Akreditimi përbën një proces të rëndësishëm që siguron njohjen zyrtare të kompetencës teknike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara nga ISUV.

Në funksion të misionit të tij, për forcimin e sigurisë ushqimore dhe veterinare, ISUV realizon një gamë të gjerë analizash laboratorike të akredituara.

Aktualisht, në total, kryhen 1,909 analiza të akredituara, të cilat janë të ndara sipas departamenteve dhe sektorëve përkatës të tyre. ISUV ka gjithsej 41 laboratorë (përfshirë 3 laboratorë që kryejnë vetëm shërbime të brendshme: Lab. Metrologjisë, Preparatori Speciale, Vivarium), nga të cilët 19 Laborator kanë teste të akredituara në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, pra rreth 50% e laboratorëve (pa përfshirë 3 laboratorët për shërbime të brendshme) janë të pa akredituar. Procesi i akreditimit të ISUV, sipas standardit ISO/IEC 17025 ka nisur në vitin 2011, me mbikëqyrje nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).

Në vitin 2012, ISUV mori akreditim nga ACCREDIA (Italia), për të siguruar njohje ndërkombëtare, pasi DPA nuk ishte ende pjesë e EA-MLA.[1] Nga viti 2016, ISUV mban vetëm akreditimin e DPA, pasi kjo e fundit u bë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare të njohjes reciproke (EA-MLA dhe ILAC-MRA[2]). Instituti kryen diagnozat veterinare dhe testimin e profilaksisë së shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve epizootike, ilaçeve veterinare dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjithshme, është përgjegjës për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, ujërave e molusqeve bivale.

ISUV është përgjegjës për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik.

c. *Qëllimi i auditimit*

Objekti i auditimit përfshin dy komponentë kryesorë: Auditimin Financiar dhe Auditimin e Përputhshmërisë.

Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejt në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.

Ndërsa në Auditimin e Përputhshmërisë, synimi është të vlerësohet shkalla në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kodet e sjelljes dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Përmes këtyre dy komponentëve, auditimi synon të ofrojë një vlerësim të gjithanshëm mbi saktësinë e raportimit financiar, përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt.

[1] European co-operation for Accreditation-Multilateral Agreement

[2] International Laboratory Accreditation Cooperation-Mutual Recognition Arrangement

d. *Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave*.

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[3]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

e. *Numri i gjetjeve dhe Rekomandimeve*.

Grupi i auditimit ka konstatuar 22 gjetje dhe ka dhënë 24 rekomandime, 16 masa organizative, 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike dhe 2 masa shpërblim dëmi.

f. *Paraqitja e gjetjeve kryesore*.

1. Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit konstatohet se:

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se ISUV nuk ka hartuar planin strategjik dhe planet e veprimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues", pika 4, germa "a".

-Nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) , i cili duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e marra duhen të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b" dhe nenin 27, Manualin e MFK-së, pika 2.2.6, si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*".

- Nuk ka rregullore të brendshme, veprim ky në kundërshtim me Manualin e MFK-së, pika 3.3

-Nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, siç parashikohet në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, pika 2, neni 21 "Menaxhimi i Riskut", si dhe në udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*", pika 3.2.1

- Nuk është hartuar regjistri i riskut në nivel institucional sikurse parashikohet në nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, dhe nuk është përgatitur regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky i parashikuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 11.

- Nuk ka miratuar gjurmën e auditit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit, siç përcaktohet në pikat nr. 2 dhe 3, të nenit 16, "*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit*", dhe në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.

2. Nga auditimi konstatohet se ISUV, është një institucion i akreditуar sipas standardit ISO 17025:2017ISUV dhe deri në fund të vitit 2024, ky laborator reference për sigurinë ushqimore dhe veterinare në total është i akreditуar për kryerjen e 1,909 analizave, të cilat janë të ndara sipas departamenteve dhe sektorëve

- Procesi i akreditimit të ISUV, sipas standardit ISO/IEC 17025 ka nisur në vitin 2011, me mbikëqyrje nga DPA.

[3] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- Në vitin 2012, ISUV mori akreditim nga ACCREDIA agjenci kombëtare akreditimi në Itali, për të siguruar njohje ndërkombëtare, pasi DPA në këtë periudhë nuk ishte pjesë e EA-MLA.[4]
- Duke filluar nga viti 2016 e në vazhdim, ISUV mban vetëm akreditimin nga DPA, pasi kjo e fundit u bë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare të njohjes reciproke (EA-MLA dhe ILAC-MRA[5]).
-Referuar të dhënave të tabelës nr.1., mbi numrin e analizave të akredituara që kryhen deri në fund të vitit 2024 në ISUV, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr.2, shpërndarja e përcaktimeve "Akredituar" për secilin departament:
- ISUV ka gjithsej 41 laboratorë (përfshirë 3 laboratorë që kryejnë vetëm shërbime të brendshme: Lab. Metrologjisë, Preparatori Speciale, Vivarium), nga të cilët 19 Laborator kanë teste të akredituara në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, pra rreth 50% e laboratorëve (pa përfshirë 3 laboratorët për shërbime të brendshme) janë të pa akredituar.
- Pjesa dërrmuese e analizave të akredituara, përkatësisht 1,778 ose 93.1% e totalit, janë të përqendruara në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve.
- Ndërkohë, që departamente të tjera me funksione kyçe për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve, si Departamenti i Mikrobiologjisë dhe Monitorimit të Ujërave (4.7%), Departamenti i Monitorimit të Mbetjeve (1.1%) dhe Departamenti i Shëndetit të Kafshëve (1.1%), përfaqësojnë një përqindje minimale të analizave të akredituara.
- Sektori i kontrollit të barnave veterinare dhe sektori i diagnostikimit të dëmtuesve të bimëve, nuk kanë asnjë përcaktim/test analitik të akreditуar.
3. Nga auditimi mbi administrimin e kiteve, reagentëve dhe materialeve laboratorike, u konstatohet se:
- Për periudhën e auditimit, ISUV është furnizuar me "Kite" përmes kontratave me një vlerë totale prej 19,987,243 lekë. (siç pasqyrohet në tabelën nr.9, aneksi 2.6.5.)

Sasia totale e këtyre kiteve për periudhën 2022-2024 është shpërndarë e gjitha nga magazina qendrore drejt departamenteve direkt pasi është marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim, pra nëse i referohemi vetëm artikujve "kite dhe reagent" i gjithë furnizimi i kontraktuar nga ISUV, nuk ka qëndruar asnjë ditë në magazinën qendrore, por ka kaluar në laboratorët e departamenteve të ISUV.
- Përdorimi i artikujve, kryesisht kite dhe reagentë, pasi janë transferuar nga magazina në laboratorë, nuk administrohet dhe nuk dokumentohen në përputhje me ndonjë procedurë të miratuar nga drejtuesit e ISUV, sipas së cilës çdo artikull i përdorur duhet të dokumentohet përmes një fletë kërkese të paraqitur nga përdoruesi dhe të miratuar nga drejtuesi i laboratorit/departamentit/sektorit përkatës.
- Mungon një sistem formal për monitorimin e datave të skadencës gjatë kohës së qëndrimit të këtyre artikujve në laboratorët përkatës sipas departamenteve respektive.

Strukturat përgjegjëse në ISUV nuk kanë hartuar dhe miratuar ndonjë akt administrativ për këtë qëllim.
- Për artikujt kite dhe reagentë, mungon një sistem informatik për sinjalizimin në prag të skadencës, që do të lejonte përdorimin në kohë ose transferimin e tyre në laboratorë të tjerë shtetërorë që kanë nevojë për përdorimin e tyre.

Në mungesë të një sistemi të informatizuar (module shtesë të LIMS), administrimi i këtyre produkteve bëhet në mënyrë manuale dhe jo të standardizuar, duke pamundësuar kontrollin sasior dhe cilësor të tyre, duke rritur rrezikun që produktet të skadojnë gjatë kohës që qëndrojnë në laborator, edhe nëse në momentin e dorëzimit ato përputhen me kriteret e vlefshmërisë.
- Gjatë hartimit të PBA-së për nevojat e institucionit, kryesisht për materialet si kite, reagentë, standarde dhe terrene, për periudhën objekt auditimi, drejtuesit e ISUV nuk kanë ngritur një komision të posaçëm për konsolidimin e kërkesave sipas departamenteve dhe sektorëve përbërës të institucionit.

[4] European co-operation for Accreditation-Multilateral Agreement
[5] International Laboratory Accreditation Cooperation-Mutual Recognition Arrangement

Si pasojë, nuk është ndjekur një metodologji e qartë për parashikimin e nevojave, bazuar në gjendjen e stokut, qarkullimin e viteve të fundit (2–3 vite) dhe objektivat e akreditimit për rritjen e analizave dhe përcaktimeve analitike të akreditura.

- Gjatë proceseve laboratorike, krijohen mbetje laboratorike nga përdorimi i kiteve dhe reagentëve, nga ku konstatohet se këto mbetje nuk regjistrohen në regjistra të veçantë apo në sisteme informatike. Mbetjet laboratorike të krijuara nuk ruhen në ambiente të dedikuara, por vendosen në vende të improvizuara nga përdoruesit në laborator.
- Magazina qendrore nuk plotëson kushtet teknike për ruajtjen e materialeve që kërkojnë zinxhir në të ftohtë, për shkak të mungesës së investimeve në frigoriferë specifikë të përshtatshëm për këtë qëllim., etj.

4. Kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike, bazuar në nenin 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, hartohen nga specialisti i fushës dhe në çdo rast *duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht*. Nga auditimi i procedurave të prokurimit mbi kufirin e ulët monetar dhe mbi kufirin e lartë monetar, u konstatua se:

a. Pavarësisht se Titullari i AK ka ngritur komisionin e posaçëm për hartimin e specifikimeve teknike, sa i përket procedurave të prokurimit:

1. "*Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes"* viti 2022,
2. *"Blerje enë dhe materiale laboratorike"* viti 2023,
3. "*Blerje Standarde dhe materiale reference*" viti 2023,

4-5."*Shërbim, servis kalibrimi*" për vitit 2023-2024,

6."*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" vitin 2024,

7. *"Blerje Kite"* viti 2024,
8. *"Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve";*

Këto komisione nuk janë angazhuar në hartimin e specifikimeve teknike, por i kanë marrë drejtpërdrejt nga përgjegjësit e departamenteve.

Në procedurat e prokurimit "*Shërbim, servis kalibrimi*" për vitit 2023-2024, "*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" për vitin 2024, nuk është përfshirë një specialist fushe inxhinier elektronik, teknik laboratori, pavarësisht se objektet e prokurimit përfshinin specifikime të detajuara teknike të pajisjeve laboratorike dhe të nevojave teknike për servis.

b. Komisioni i posaçëm i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, në asnjë rast në procedurat e prokurimit të audituara, nuk ka argumentuar specifikimet teknike të artikujve të kërkuar. Mos argumentimi i specifikimeve teknike, përveç faktit se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, që nga studimi i tregut, ofertimi nga OE dhe marrja në dorëzim e mallit/ shërbimit të kërkuar, duke mos garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike, njëherazi nuk nxit pjesëmarrjen e OE-ve në procedurat e prokurimit dhe kufizon ndjeshëm konkurrencën ndërmjet tyre.

c. Specifikimet teknike, sa i përket procedurave të prokurimit me objekt "*Shërbim servis kalibrimi*" për vitet 2023-2024, "*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" për vitin 2024, "*Pajisje për fuqizimin e laboratorëve në ISUV*" për vitin 2023, "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve*" për vitin 2024, nuk janë hartuar nga specialistë të fushës, duke mos garantuar se të gjithë elementët e përfshirë në specifikimet teknike, në sasinë e kërkuar, janë të nevojshme për përmbushjen e objektit të kontratës, duke mos garantuar përdorimin me ekonomicitet të fondeve publike.

ç. Në procedurat e prokurimit me objekt "*Shërbim servis kalibrimi*" për vitet 2023 dhe 2024, pavarësisht se ndarja në Lot-e është bërë nisur nga kompania prodhuese e pajisjeve, në lot-in I dhe lot-in II janë përfshirë pajisje të firmave prodhuese të ndryshme dhe artikuj të tjerë, të cilat nuk kanë lidhje me kompaninë prodhuese përkatëse ("Agilent", "Thermofisher"). Përfshirja e tyre e paargumentuar në një procedurë që nuk ka konkurrencë, pasi janë operatorë specifikë që disponojnë autorizimin e prodhuesit, ndikon drejtpërdrejt në fondin limit të përllogaritur e në vlerën totale të kontratës, duke mos garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficencë.

d. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sa i përket procedurës së prokurimit me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve*" për vitin 2024, nuk janë hartuar nga specialistë të fushës. Kjo ka sjellë që të vendosen kritere për kualifikim, të paargumentuara, që nuk lidhen me objektin e

kontratës dhe që nuk janë në proporcion me objektin e kontratës. Gjithashtu, Njësia e prokurimit ka kërkuar që OE të disponojë Leje mjedisore të Tipit A, pa specifikuar kategorinë e mbetjeve objekt i prokurimit. Kjo ka sjellë që KVO të neglizhojë në kryerjen e verifikimeve të nevojshme mbi kategoritë e mbetjeve që BOE ofertues ishte i licencuar, duke u mjaftuar me Lejen mjedisore të Tipit A të paraqitur, rrjedhimisht duke kualifikuar një ofertues që nuk plotësonte kriteret e nevojshme për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi.

5. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike*", për vitin 2024, Titullari i AK nuk ka përfshirë specialist të fushës (inxhinier mjedisi ose ekuivalent) në komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011. Komisioni i marrjes në dorëzim ka konfirmuar marrjen në dorëzim të shërbimit, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur si Dokumentet e transportit për mbetje të rrezikshme dhe Dokumenti i dorëzimit për mbetje të rrezikshme nuk përcaktojnë saktë përshkrimin e mbetjes dhe kodin sipas katalogut të mbetjeve, duke përfshirë të gjitha mbetjet e asgjësuara në kodin 15 01 10*, që i referohet *mbetjeve të ambalazhit* që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme, por jo vetë mbetjeve që mbaheshin në këto ambalazhe. Sipas pikës 8 të VKM-së nr. 798, datë 29.09.2010 "*Për administrimin e mbetjeve spitalore*", çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve deri tek asgjësimi i tyre.

-<u>*Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt*</u> "*Shërbim, servis kalibrimi*", ndarë në 3 lot-e, për vitet 2022 – 2024, janë konstatuar parregullsitë, si më poshtë:

-Titullari i AK nuk ka përfshirë specialist të fushës (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent) në komisionin e marrjes në dorëzim, si dhe nuk ka përfshirë personin me përgjegjësi materiale (magazinierin), pavarësisht se kontratat e lot-it 1 (për të treja vitet) dhe në kontratat e lot-it 3 (për vitin 2023, 2024) kanë qenë kontrata mikse, ku përpos marrjes së shërbimit të servisit, janë marrë në dorëzim edhe pjesë këmbimi dhe pjesë për operimin e pajisjeve (pra jo pjesë që ndërrohen direkt me marrjen e shërbimit), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011. Kjo ka sjellë rrjedhimisht që nuk është kryer verifikimi fizik i sasisë së tyre nga magazinieri, për t'u bërë hyrje në magazinë, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011.

-Pavarësisht se në dokumentet e tenderit është kërkuar që OE të paraqesin vërtetime që kanë inxhinierë të trajnuar dhe të C.tifikuar nga kompanitë prodhuese për të kryer shërbimin e servisit, Komisionet e marrjes në dorëzim nuk kanë kryer verifikimet e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratave. Kjo ka sjellë që, shërbimi për lot-in I dhe lot-in II të jetë kryer nga persona të ndryshëm nga stafi i paraqitur dhe i pranuar në ofertën fituese, për të cilët ISUV nuk administron dokumentacion nëse janë ose jo të trajnuar dhe të C.tifikuar nga kompanitë prodhuese për ofrimin e këtij shërbimi.

-Pavarësisht se është kërkuar ndër të tjera kalibrimi i pajisjeve në secilin prej lot-eve, komisioni i marrjes në dorëzim ka konfirmuar marrjen e shërbimit pa administruar certifikatat e kalibrimit, si dokument vërtetues për kalibrimin e pajisjeve, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të DPA-së me Kod DA-IN-0011 "Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi".

-<u>*Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt*</u>

1. "*Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes*" viti 2022
2. "*Blerje enë dhe materiale laboratorike*" viti 2023
3. "*Blerje enë dhe materiale laboratorike*" viti 2023
4. "*Blerje Standarde dhe materiale reference*" viti 2023
5. "*Blerje Kite*" viti 2024
6. "*Blerje kite për nevoja të ISUV*" viti 2022 (procedurë e kryer nga MBZHR, zbatuar nga ISUV),
7. *"Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve"*

u konstatua se komisionet e marrjes në dorëzim kanë përcaktuar dokumentuar në procesverbal vetëm verifikimin sasior të artikujve të marrë në dorëzim, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit, për të mundësuar gjurmën e auditimit mbi marrjen në dorëzim të

artikujve në përputhje me kontratën, DST, si dhe ofertën fituese.
6. ISUV, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, gjeneron mbetje të rrezikshme dhe/ose mbetje jo të rrezikshme si dhe ushtron veprimtari të tilla si grumbullimi, ruajtja, trajtimi dhe asgjësimi i këtyre mbetjeve. Këto veprimtari përfshihen ndër ato që, sipas përcaktimeve ligjore kërkojnë pajisjen me leje mjedisore Tipi A/B, në varësi të kategorisë së mbetjeve, kapacitetit dhe llojit të procesit të trajtimit. Nga auditimi rezulton se ISUV nuk është i pajisur me leje mjedisore për ushtrimin e këtyre aktiviteteve si: grumbullim/ ruajtje apo trajtim/asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dh/ose jo të rrezikshme, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar.
7. Procedura e prokurimit me objekt "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes". Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr., 105 prot, datë 17.02.2023 dhe afati për shërbimin është 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës ose deri me datë 18.04.2023.
Me procesverbal datë 03.05.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i parë dhe mallrat janë mare në dorëzim 15 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,063,735 lekë me TVSh.
Me procesverbal datë 10.05.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i dytë dhe mallrat janë mare në dorëzim 22 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,480,945 lekë me TVSh.
Me procesverbal datë 02.06.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i tretë dhe mallrat janë mare në dorëzim 45 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,429,920 lekë me TVSh.
Me procesverbal datë 09.08.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i katër dhe i fundit dhe mallrat janë mare në dorëzim 122 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 3,346,608 lekë me TVSh.
Në total penaliteti është 1,063,735 lekë + 1,480,945 lekë + 1,429,920 lekë + 3,346,608 lekë = **7,321,208** lekë me TVSh.
8. Për periudhën objekt auditimi u konstatua se është ekzekutuar vendimi gjyqësor për një ish-punonjës, në vlerën totale prej **6,906,437 lekë.**
Vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga ISUV, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë, duke paguar tarifa përmbarimore në vlerën totale prej **512,820 lekë**.
Vendimet gjyqësore përbëjnë një shpenzim të pajustifikuar dhe në mospërputhje me parimet e *eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit*, duke shkaktuar kosto shtesë për buxhetin e ISUV-it, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej **6,906,437 lekë**. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, konkretisht, nenin 130, "Rregullat e njoftimit shkresor të akteve", i cili përcakton se "Në rastin e personave juridikë publikë, njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve"; nenin 451/a, ku thuhet se "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët" dhe nenin 510/a, "Titujt ekzekutivë".
9. Nga auditimi i praktikës së kryerjes së analizave jashtë vendit për ato që nuk mund të realizohen në ISUV, lidhur me pagesat e kryera ndaj laboratorit C. Group (Belgjikë), u konstatua se:
Laboratori C. Group (Belgjikë), për periudhën 2022–2024, në faturat e shërbimit të kryera për llogari të ISUV ka përfshirë vlerën e TVSH-së (21%), ndërkohë që për të njëjtën periudhë, laboratori tjetër i kontraktuar, W. (Holandë), nuk ka përfshirë vlerën e TVSH-së në faturat e shërbimit kundrejt ISUV.
- Në marrëveshjen tip të bashkëpunimit të ISUV me laboratorin C. Group (Belgjikë), nuk është përcaktuar qartë nëse përfshihet apo jo TVSH-ja (21%).
- Grupit të auditimit të KLSH, krahas dokumentacionit të kërkuar në lidhje me pagesat e kryera nga ISUV për laboratorin C. Group, iu vunë në dispozicion edhe fatura për periudha para auditimit, ku konstatohet se në këto raste nuk është përfshirë TVSH-ja. Kjo tregon se laboratori C. Group në këto raste ka respektuar parashikimet e nenit 21, pika 2 të Kodit të TVSH-së së shtetit Belg, për parimin "Reverse Charge". Një prej faturave me TVSH zero paraqitet në aneksin 2.6.6, ku gjithashtu është vendosur NIPT i ISUV, fakt që tregon se laboratori është i informuar se subjekti ISUV është person i klasifikuar tatueshëm.
- Të gjitha faturat e C. Group, për periudhën 2022-2024, ku është përfshirë TVSH-ja, dhe ato ku TVSH është zero, janë firmosur nga Dr. N. G., drejtori i laboratorit të analizave të C. Group.

- Për periudhën objekt auditimi, shpenzimet totale lidhur me pagesat për analizat dhe shërbimet mbështetëse arrijnë afërsisht në 1,880,000 euro, duke përfshirë edhe shpenzimet e tjera të pasqyruara në tabelën nr. 11. Nga këto rezulton një shpenzim mesatar vjetor prej rreth 627,000 euro për kryerjen e analizave me nënkontraktim për llogari të ISUV.
- Procesi i përzgjedhjes së laboratorëve për kryerjen e analizave, në zbatim të PKKZBR, të cilat realizohen në një nga vendet e BE-së, është kryer pa urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës për ushqimin, në kundërshtim me nenin 44, pika 4 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" (i ndryshuar), si dhe me nenin 121 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).
- Gjithashtu, propozimet për përzgjedhjen e laboratorëve referentë në vendet e BE-së, të bëra nga strukturat përgjegjëse pranë ISUV-it, nuk janë mbështetur në një studim të mirëfilltë për laboratorët e akreditуar, duke rritur riskun financiar të marrjes së të njëjtit shërbim me kosto më të lartë.
-Nga ana e zyrës së financës nuk janë evidentuar parregullsi lidhur me faturat e lëshuara nga kompania C. Group me seli në Belgjikë, ku është përfshirë TVSH-ja në masën 21%.
-Pas konfirmimit nga nëpunësi zbatues në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur pranë zyrës së financës, është përgatitur urdhërshpenzimi për kryerjen e pagesës së shërbimeve të përfituara jashtë vendit, duke lejuar kështu ekzekutimin e faturave të dërguara nga laboratori C. Group, pavarësisht përfshirjes së vlerës së TVSH-së.
Për periudhën objekt auditimi, përfshirja e TVSH-së në faturat e C. Group ka rezultuar në një kosto shtesë prej 297,774.27 euro, ose **32,576,505 lekë**, shumë e cila nga KLSH konsiderohet si përdorim i fondeve buxhetore pa ekonomicitet.

h. Paraqitja e Rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa Rekomandime si vijon:
1. Titullari i ISUV, në bashkëpunim me strukturave përgjegjëse në ISUV, duhet të ndërmarrë masa konkrete për krijimin dhe funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), duke:
-Hartuar dhe miratuar planin strategjik afatmesëm me objektiva të matshme dhe të arritshme.
-Ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
-Bashkëpunuar me MBZHR për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme.
-Hartuar strategjinë dhe regjistrat e riskut në nivel departamentesh/drejtori/sektor, dhe të ndërtojë mekanizma për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e riskut.
-Miratuar procedurat e kontrollit të brendshëm dhe dokumentin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore.
2. Drejtori i Përgjithshëm i ISUV, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), duhet të marrë masa për rritjen e numrit të analizave të akredituara në sektorët ku niveli i akreditimit rezulton i ulët, duke pasur parasysh se mungesa e akreditimit në këta sektorë ka sjellë rritje të ndjeshme të shpenzimeve të ISUV, për shkak të nevojës për realizimin e analizave pranë laboratorëve referentë të sigurisë ushqimore dhe veterinare të Bashkimit Europian.
Në këtë kuadër, duhet të hartohet dhe të zbatohet një plan veprimi konkret, afatshkurtër dhe i matshëm, për zgjerimin e fushës së akreditimit në sektorët prioritarë, duke garantuar mbështetjen teknike, financiare dhe njerëzore të nevojshme, në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025 dhe objektivat strategjikë të politikave kombëtare për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen veterinare.
3. Drejtori i Përgjithshëm i ISUV duhet të marrë masa për përmirësimin dhe standardizimin e administrimit të kiteve, reagentëve dhe materialeve të tjera laboratorike në të gjitha hallkat e përdorimit të tyre, duke:
- Hartuar akte administrative për përdorimin, dokumentimin dhe kontrollin e çdo artikulli laboratorik (kit, reagent, etj.);
- Informatizuar monitorimin e afateve të skadencës dhe gjendjes së stokut, përmes zgjerimit të platformës LIMS me module shtesë për administrimin e inventarit;
- Ngritur një komision Ad Hoc për analizimin e kërkesave të departamenteve dhe sektorëve dhe konsolidimin e tyre në kuadër të hartimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, bazuar në gjendjen aktuale

të stokut, qarkullimin e materialeve gjatë 2–3 viteve të fundit dhe objektivat e akreditimit për zgjerimin e analizave të akredituara;
- Përmirësuar dhe plotësuar kushtet e ruajtjes në magazinën qendrore për materialet që kërkojnë zinxhir të ftohtë, përmes investimeve në pajisje frigoriferike të përshtatshme

4. Autoriteti kontraktor, në vijimësi, duhet të hartojë dhe argumentojë kërkesat e veçanta për kualifikim/ specifikimet teknike dhe kriterin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë të tillë që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mosdiskriminim dhe konkurrencë, njëherazi duke garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë.

5. Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/ shërbimeve/ punëve, të ngritura nga Titullari i Institucionit, të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuar në ftesën për ofertë, kontratës së lidhur dhe ofertës së pranuar të OE, si dhe të administrojnë të gjithë dokumentacionin shoqërues të nevojshëm, me qëllim evidentimin dhe mundësimin e gjurmës së auditimit mbi realizimin e furnizimit me mallra, shërbime e punë sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar, me qëllim garantimin e përdorimit të fondeve publike me eficiencë dhe efektivitet.

6. Drejtori i Përgjithshëm i ISUV të marrë masa për fillimin e procedurave për pajisjen me lejet mjedisore përkatëse për të gjitha proceset/ aktivitetet që ISUV kryen lidhur me grumbullimin, trajtimin, asgjësimin e mbetjeve, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve/publikut, si dhe të sigurohet që çdo aktivitet kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve si dhe me standardet mjedisore.

Titullari i ISUV të marrë masa për planifikimin dhe kryerjen e procedurave të prokurimit publik lidhur me largimin dhe asgjësimin e mbetjeve që grumbullohen/ ruhen në ambientet e ISUV, duke kërkuar personel të specializuar, si dhe duke mbajtur në vëmendje kategorizimin e saktë të mbetjeve, për të eliminuar risqet mjedisore që mund të sjellë përzgjedhja e një operatori që nuk është i licencuar/ i pajisur me leje mjedisore për kategoritë specifike të mbetjeve.

7. Autoriteti Kontraktor ISUV, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **7,321,208 lekë** nga OE "K." shpk si kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të mallrave**.**

8.Nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare të merren masa për analizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën prej **6,906,437 lekë**.

Vendimet gjyqësore kanë rezultuar në pagesa që nuk përputhen me parimet e efiçiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin e ISUV-it. Për këtë arsye, është e rëndësishme të ndërmerren hapa për parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara.

9. Nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare duhet të marrë masa për analizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në shumën prej **32,576,505 lekë**.

Përfshirja dhe pagesa e vlerës së TVSH-së në faturat për llogari të laboratorit C. Group nuk përputhen me këto parime, duke sjellë një kosto shtesë për buxhetin e ISUV-it. Për këtë arsye, është e nevojshme të ndërmerren hapa për parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara.

I.1. Opinioni i auditimit.

Opinion i auditimit financiar

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të ISUV, për vitin ushtrimor 2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të subjektit Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë

evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar**.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen "Përgjegjësitë e Audituesit" për auditimin e pasqyrave financiare.

Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura.

Për këto arsye, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 21,349 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një "**Opinioni të Kualifikuar**"[6] të auditimit

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2024, paraqiten si më poshtë:

- Për periudhën objekt auditimi, nuk është realizuar procesi i inventarizimit, veprime të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar

-ISUV ka klasifikuar TVSH-në e projekteve IPA, si një aktiv të caktuar, ndonëse nuk ka dokumentacion mbështetës për të verifikuar origjinën e kësaj vlere, investimit të cilit i korrespondon dhe nëse ky investim është kryer për llogari të ISUV apo një institucion tjetër, në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022.

-Nga auditimi i llogarive vjetore rezultoi se, në vitin 2024, vlera e llogarisë 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata" është pakësuar me 23,979,396 lekë për shkak të amortizimit në masën 15%, një trajtim i pasaktë kontabël, pasi llogaria 28 nuk i nënshtrohet procesit të amortizimit.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të ISUV-të

Strukturat menaxheriale të ISUV janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Opinion mbi Përputhshmërinë

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit të ISUV. Ky auditim është realizuar në përputhje me Ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren për Procedurat e Auditimit, Manualin për Auditimin e Përputhshmërisë, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik – ISSAI 4000.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencën audituese dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, është konstatuar se, në aktivitetin e ISUV janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin". Këto devijime, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë me karakter material, por jo të përhapura, dhe si të tilla justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për Opinionin

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona si audites janë të përshkruara në detaje në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e përputhshmërisë".

[6] Opinion i modifikuar/ kualifikuar: Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura"

Ne jemi të pavarur nga ISUV, sipas përcaktimeve të ISSAI 10 – Deklarata e Meksikës për Pavarësinë e SAI-t dhe ISSAI 30 – Kodi i Etikës, dhe kemi respektuar të gjitha kërkesat etike për auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Kodin e Etikës së KLSH.
Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.
Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:
Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatuan:
- Parregullsi në hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike në të gjitha procedurat e prokurimit publik të audituara për blerje pajisje dhe/ ose me objekt "Shërbim, servis kalibrimi", për vitet periudhë auditimi, duke ndikuar në kufizimin e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik;
- Përfshirje e zërave jo në lidhje me objektin e kontratave, në procedurat e prokurimit me objekt "Shërbim servis kalibrimi", ndarë në 3 lot-e, për vitet periudhë auditimi, që kanë ndikuar në rritjen e volumit të zërave e njëkohësisht në rritjen e fondit limit dhe vlerës së kontratës, duke mos garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë;
- Parregullsi në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve", për vitin 2024, duke kualifikuar dhe shpallur fitues BOE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit; si dhe në procedurën "Blerje enë dhe materiale laboratorike", duke skualifikuar OE me ofertë ekonomike më të ulët;
- Parregullsi në zbatimin e kontratave, sa i përket kontratave me objekt "Shërbim, servis kalibrimi", për vitet periudhë auditimi, ku u konstatua se shërbimi i servisit për lot-in I dhe lot-in II është kryer nga kontraktuesi me stafi të pa trajnuar dhe të Certifikuar nga kompania prodhuese, si dhe nga ana e ISUV nuk janë administruar Certifikatat e kalibrimit për pajisjet e kërkuara, duke mos garantuar përdorimin e fondeve publike me efektivitet;
- Parregullsi në zbatimin e kontratave, "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes" viti 2022, "Blerje enë dhe materiale laboratorike" viti 2023, "Blerje enë dhe materiale laboratorike" viti 2023, "Blerje Standarde dhe materiale reference" viti 2023, "Blerje Kite" viti 2024, "Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve", "Blerje kite për nevoja të ISUV" viti 2022, komisionet e marrjes në dorëzim nuk kanë përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit.
- Në 2 procedura prokurimi, u konstatua dëm ekonomik në buxhetit e ISUV-it në vlerën **7,465,208 lekë**, për mos realizim të kushteve të kontratës nga kontraktuesi.
-Gjatë periudhës së auditimit 2022–2024, ISUV ka ushtruar veprimtari që kërkojnë pajisje me leje mjedisore përkatëse, të tilla si grumbullimi, ruajtja dhe asgjësimi i mbetjeve. Këto veprimtari janë kryer pa disponuar lejen mjedisore të nevojshme, duke rrezikuar mospërputhjen me standardet mjedisore në fuqi dhe duke krijuar mundësi për cenimin e sigurisë në punë dhe shëndetit të punonjësve.
Për periudhën objekt auditimi, përfshirja e TVSH-së në faturat e C. G. me seli në Belgjikë, ka rezultuar me në një kosto shtesë për shërbimet e kryera nga ISUV në shumën 297,774.27 euro, ose **32,576,505 lekë**, shumë e cila nga KLSH konsiderohet si përdorim i fondeve buxhetore pa ekonomicitet.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 58/1 prot., datë 21.01.2025 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 22.01.2025 deri 05.05.2025, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2024, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. L., përgjegjës grupi
2. A. Z.,
3. D. P.,
4. J. P.,
5. A. Xh.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit*:*

Objekti i auditimit përfshin dy komponentë kryesorë: Auditimin Financiar dhe Auditimin e Përputhshmërisë.

Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejt në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.

Ndërsa në Auditimin e Përputhshmërisë, synimi është të vlerësohet shkalla në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kodet e sjelljes dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Përmes këtyre dy komponentëve, auditimi synon të ofrojë një vlerësim të gjithanshëm mbi saktësinë e raportimit financiar, përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti i Auditimit ka për qëllim të vlerësojë përmbushjen e rolit të ISUV si laborator reference në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinare, si dhe të përgjegjësive që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi. Auditimi synon të evidentojë masat e marra për përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë ushqimore, në përputhje me strategjitë përkatëse dhe direktivat e Bashkimit Europian, si dhe për zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve analitike, veçanërisht në drejtim të analizave të akredituara për produkte me origjinë shtazore. Gjithashtu, raporti adreson aspektet financiare, duke vlerësuar saktësinë, rregullshmërinë dhe dokumentimin e transaksioneve kontabël, si dhe regjistrimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat përgjegjëse të ISUV, përfshirë drejtuesin e institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe drejtuesin e zyrës së financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, mbajnë përgjegjësi për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në sektorin publik. Ata gjithashtu janë përgjegjës për sigurimin e funksionimit efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar si dhe akteve të tjera në fuqi.

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë një opinion dhe të nxjerrë konkluzione mbi çështjet që janë objekt i auditimit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të

Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), të hartuara nga INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë parimet etike dhe të planifikojnë e realizojnë auditimin me qëllim sigurimin e një niveli të arsyeshëm besueshmërie.
Nëpërmjet auditimit të kryer, grupi i auditimit i KLSH-së synon të formulojë një opinion profesional mbi aspektet që vlerësohen, përfshirë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, si dhe me parimet e ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
- Nëse janë respektuar parimet e përgjithshme të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe rregullat e sjelljes së zyrtarëve publikë;
- Nëse janë zbatuar kërkesat ligjore dhe normative në fuqi, si Ligji i Buxhetit, legjislacioni financiar, tatimor;
- Nëse janë adresuar shkeljet e evidentuara në auditimet e mëparshme ndaj institucionit të audituar;
- Nëse janë marrë në konsideratë interesat dhe pritshmëritë e publikut, përfshirë çështje të ngritura nga media, ankesa apo sinjalizime;
- Nëse janë respektuar kërkesat ligjore në fusha specifike që përbëjnë prioritet auditimi për periudhën përkatëse.

Në përputhje me kërkesat e ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, audituesit kanë zbatuar konceptin e materialitetit gjatë planifikimit dhe zhvillimit të auditimit. Procesi auditues ka përfshirë procedura për mbledhjen e evidencave lidhur me praktikat administrative dhe financiare, si dhe me shifrat e paraqitura në Pasqyrat Financiare. Zgjedhja e procedurave është bazuar në gjykimin profesional të audituesve, duke përfshirë vlerësimin e risqeve të gabimeve materiale, qofshin ato të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.
Në kuadër të vlerësimit të riskut, audituesit kanë analizuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në ISUV, me qëllim përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
Ligjet përkatëse "Për buxhetin vjetor" dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje
Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar
Ligji Nr.10465, datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
Ligji Nr.9308, datë 4.11.2004 "Për Shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar"
Ligji Nr.9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar
Ligji Nr.9362, datë 24.3.2005 "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve", i ndryshuar
Ligji Nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar
VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël"
VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve..."
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
VKM nr. 732, datë 16.11.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë"
VKM nr. 366, datë 16.06.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027"
VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil"
VKM nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar
Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar;
UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar
Urdhëri nr. 10, datë 26.01.2023 i Kryeministrit, "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së ISUV-së", i ndryshuar

Urdhri i Kryeministrit nr. 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë."
Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël", i ndryshuar

6. Standardet e auditimit:

ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik",
ISSAI 2000-2899 "Udhëzues të Auditimit Financiar";
ISSAI 2300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare";
NTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik" si dhe INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm";
ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë", si dhe ISSAI 4200 "Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë";
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodat e auditimit:

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[7]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale

[7] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër. - Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre. - Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm.

8. Dokumentimi i auditimit:

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, audituesit përgatitën dokumentacionin përkatës të auditimit, të mjaftueshëm për të mundësuar kuptimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të kryera, në përputhje me standardet përkatëse si dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Në vijim të këtyre procedurave dhe bazuar në evidencat e mbledhura, u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar, u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili përbën bazën për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik.

Rezultatet e procedurave të zbatuara, evidencat e mbledhura dhe çështjet e tjera me rëndësi të identifikuara gjatë procesit të auditimit janë reflektuar në përfundimet përkatëse, të cilat janë nxjerrë përmes gjykimit dhe skepticizmit profesional të ushtruar nga audituesit.

Dokumentacioni i përgatitur është i përshtatshëm dhe thelbësor për të mbështetur opinionet dhe raportet e audituesve, si dhe ka shërbyer si burim kryesor informacioni për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është një institucion publik, i specializuar në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit veterinar dhe kontrollit të produkteve me origjinë shtazore dhe bimore.

ISUV luan një rol thelbësor në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit dhe në garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian.

ISUV është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, i cili përcakton kërkesat për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit.

Akreditimi përbën një proces të rëndësishëm që siguron njohjen zyrtare të kompetencës teknike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara nga ISUV

Në funksion të misionit të tij, për forcimin e sigurisë ushqimore dhe veterinare, ISUV realizon një gamë të gjerë analizash laboratorike të akredituara.

Aktualisht, në total, kryhen 1,909 analiza të akredituara, të cilat janë të ndara sipas departamenteve dhe sektorëve përkatës të tyre.

ISUV ka gjithsej 41 laboratorë (përfshirë 3 laboratorë që kryejnë vetëm shërbime të brendshme: Lab. Metrologjisë, Preparatori Speciale, Vivarium), nga të cilët 19 Laborator kanë teste të akredituara në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, pra rreth 50% e laboratorëve (pa përfshirë 3 laboratorët për shërbime të brendshme) janë të pa akredituar.

- Procesi i akreditimit të ISUV, sipas standardit ISO/IEC 17025 ka nisur në vitin 2011, me mbikëqyrje nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).
- Në vitin 2012, ISUV mori akreditim nga ACCREDIA (Italia), për të siguruar njohje ndërkombëtare, pasi DPA nuk ishte ende pjesë e EA-MLA.[8]
- Nga viti 2016, ISUV mban vetëm akreditimin e DPA, pasi kjo e fundit u bë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare të njohjes reciproke (EA-MLA dhe ILAC-MRA[9]).

Instituti kryen diagnozat veterinare dhe testimin e profilaksisë së shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve epizootike, ilaçeve veterinare dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjithshme, është përgjegjës për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, ujërave e molusqeve bivale.

ISUV është përgjegjës gjithashtu për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik.

Detyrat kryesore të institucionit janë:

- Kryerja e analizave laboratorike, në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit dhe survejancës së situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, zoonozave dhe mbetjeve toksike;
- Kontrolli i mbetjeve të substancave me efekt anabolik dhe të paautorizuara, i biopreparateve dhe barnave veterinare në kafshët e gjalla dhe produktet e tyre;
- Kryerja e analizave laboratorike për vendosjen e diagnozës së sëmundjeve infektive tek kafshët;
- Prodhimi i biopreparateve veterinare, si vaksina, antigjenë, alergjenë dhe materiale diagnostikuese (si antigjenë dhe serume hiperimune), për përdorim në diagnostikimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive dhe zoonozave, në mbështetje të kërkesës së autoritetit kompetent;
- Kontrolli mikrobiologjik, kimik dhe toksikologjik i produkteve ushqimore me origjinë shtazore, i nënprodukteve me origjinë shtazore, si dhe i ushqimeve për kafshë, të cilat prodhohen në, importohen për në, ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë;
- Kualifikimi i specialistëve dhe teknikëve të laboratorëve veterinarë;
- Bashkërendimi i studimeve kërkimore dhe shkencore për zbatimin e metodave të reja diagnostikuese për sëmundjet e kafshëve.

[8] European co-operation for Accreditation-Multilateral Agreement

[9] International Laboratory Accreditation Cooperation-Mutual Recognition Arrangement

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditimi mbi përputhshmërinë me kuadrin ligjor në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Buxheti i vitit 2022 - Përgatitja e PBA 2023 – 2025

Hartimi i planifikimit të programit afatmesëm 2023 – 2024 dhe Projektbuxheti i vitit 2022 ka kaluar përgjatë fazave të parashikuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në kuadër të hartimit të PBA – së 2023 – 2025 dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", të ndryshuar, udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025" dhe VKM nr.130, datë 02.03.2022 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025".

Struktura përgjegjëse e ISUV, me shkresën nr. 265/1 prot., datë 02.042022 ka dërguar në MBZHR fazën e parë të PBA 2023 – 2025 dhe me shkresën nr. 265/3 datë 08.08.2022 ISUV ka fazën e dytë të PBA 2023 – 2025, e cila është paraqitur në tabelën Nr.1, aneksi 1:

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR, me shkresën nr. 508, datë 24.01.2022 ka përcjelle në ISUV, detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për periudhën 2022 - 2024, sipas artikujve kryesorë të strukturës buxhetore, detajuar në Tabelën nr.1:

Tabela nr.1. Detajimi i Buxhetit të vitit 2022 *Në mijë lekë*

Kod. Ins	Inst.	Prog.	Llog.	Kod Proj.	Buxheti	Emërtimi
1005111	ISUV	04220	600	90502AD	85,000	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	601	90502AD	14,500	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	602	90502AD	140,000	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	34,000	Rikonstruksion I ISUV
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	50,000	Fuqizimi I laboratorëve diagnostic të shëndetit të kafshëve dhe rritja e kapacitetit analitik të tyre (inkubator për izolimin M. turbeculosis)
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	32,820	Implementim i planit kombëtar të monitorimit të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	29,366	Ngritje dhe funksionim I laboratorit të mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve (blerje paisjesh)
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	3,000	Pajisje lab. Kontrolli për sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore
Totali					**388,686**	

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

- Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", me shkresën nr. 245/4 prot., datë 21.02.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR, është dërguar në ISUV detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022.

Fondi i veçantë i miratuar për ISUV është në vlerën 500 mijë lekë për llogarinë 6060000 "Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)".

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022

- Me shkresën nr. 2258/4 prot., datë 19.05.2022 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerë 12,250 mijë lekë dhe pakësimin e fondit në llogarinë 601 me vlerën 3,770 mijë lekë dhe në llogarinë 602 me vlerën 630 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.072022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" të ndryshuar, është pakësuar me 17,000 mijë lekë fondi për llogarinë 231.
- Me shkresën nr. 5110/1, datë 14.10.2022 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 600 me vlerën 161 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5753/2, datë 14.11.2022 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerën 24,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5818/6, datë 05.12.2022 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 600 me vlerën 395 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" të ndryshuar është pakësuar me 95,442 mijë lekë fondi për llogarinë 231, me 700 lekë fondi për llogarinë 600 dhe me 500 mijë lekë fondi për llogarinë 602. Gjithashtu është shtuar me 5,447 mijë lekë fondi për llogarinë 231 (Rikonstruksion I ISUV).
- Me shkresën nr. 6271/1, datë 21.12.2022 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 6 mijë lekë.
- Me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 është miratuar shtesa prej 900 mijë lekë për llogarinë 606.

Buxheti përfundimtar duke reflektuar dhe ndryshimet buxhetore të ndodhura gjatë vitit paraqitet në tabelën nr.2, Aneksin nr.1

Buxheti total për vitin 2022 për ISUV është në shumën 307,140 mijë lekë

Realizimi i buxhetit për vitin 2022

Për vitin 2022 realizimi i programeve buxhetore paraqitet në tabelën nr. 2.

Tabela nr.2 Realizimi i zërave buxhetor të vitit 2022. *Në mijë lekë*

Art.	Emërtimi	Buxheti	Ndryshime	Plani	Fakti	Diferenca	Realizim
600	Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli	85,000	-3,215	81,785	81,785	0	100%
601	Kontribute të sig. shoqërore nga punëdhënësi	14,500	-1,130	13,370	13,336	34	99.75%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	140,000	28,400	168,400	167,806	594	99.65%
606	Transferta për buxhetet familjare	500	894	1,394	1,391	3	99.78%
231	Rikonstruksion I ISUV	34,000	5,447	39,447	39,447	0	100.00%
231	Fuqizimi I laboratorëve diagnostik të shëndetit të kafshëve dhe rritja e kapacitetit analitik të tyre (incubator për izolimin M. turbeculosis)	50,000	-50,000	0	0	0	0.00%
231	Implementim i planit kombëtar të monitorimit të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes	32,820	-32,820	0	0	0	0.00%
231	Ngritje dhe funksionim I laboratorit të mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve (blerje pajisjesh)	29,366	-26,622	2,744	2,744	0	100%
231	Pajisje lab. Kontrolli për sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore	3,000	-3,000	0	0	0	0.00%
	Total	**389,186**	**-82,046**	**307,140**	**306,509**	**631**	**99.79%**

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se nuk ka në asnjë program tejkalim të realizimit të fondeve të programuara.

Në total realizimi i buxhetit 2022 është 99.79 % të fondeve buxhetore të alokuara.

ISUV realizon të ardhura në përputhje me ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" neni 37, pika 2 dhe neni 44, pika 2.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar në tabelën e mëposhtme paraqitet niveli i realizimit të të ardhurave të vitit 2022, të ardhura të cilat derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit, pasqyrohen në tabelën nr.3.

Tabela nr.3. Të ardhurat për vitin 2022. *Në mijë lekë*

PROGRAMI					
Llogaria	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi
7111005	Të ardhura nga shitja dhe veprimtaria e drejtpërdrejtë	10,302	10,461	159	102%
	Totali	**10,302**	**10,461**	**159**	**102%**

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti i vitit 2023 - Përgatitja e PBA 2024 – 2026

Hartimi i planifikimit të programit afatmesëm 2024 – 2026 dhe projektbuxhetit të vitit 2023 ka kaluar përgjatë fazave të parashikuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në kuadër të hartimit të PBA – së 2024 – 2026 dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", të ndryshuar, të udhëzimit nr.5, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026" dhe VKM nr.195, datë 05.04.2022 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026", ISUV", struktura përgjegjëse e ISUV, me shkresën nr. 205/1 prot. datë 07.04.2023 ka dërguar në MBZHR fazën e parë të PBA 2024 – 2026, dhe me shkresën nr. 480/1 datë 28.07.2023 ISUV ka dërguar në MBZHR përgatitjen për fazën e dytë të PBA 2024 – 2026, paraqitur në Aneksin nr.1, tabela nr.4.

Në krahasim me vitin 2022 parashikimi i të ardhurave për vitin 2023 është përgjysmuar, për shkak se në përputhje me udhëzimin nr. 19, dt. 22.11.2022, pika 2, ISUV nuk do të aplikojë më tarifa për analizat e kërkuara nga institucionet e varësisë së MBZHR.

Heqja e tarifave të aplikueshme mes institucioneve te varësisë, solli reduktimin e parashikimit të të ardhurave dytësore, dhe në këto kushte ISUV do të ofrojë shërbim vetëm për subjektet private që kërkojnë analiza për qëllime eksporti.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR, me shkresën nr. 289, datë 16.01.2023 ka përcjelle në ISUV, detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për periudhën 2023 - 2025, sipas artikujve kryesorë të strukturës buxhetore, detajuar në tabelën nr.4, si vijon:

Tabela nr.4. Detajimi i Buxhetit të vitit 2023 *Në mijë lekë*

Kodi Ins.	Inst.	Prog.	Llog.	Kod Proj.	Buxheti	Emërtimi Projektit
1005111	ISUV	04220	600	90502AD	110,000	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	601	90502AD	19,300	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	602	90502AD	100,000	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	50,000	Fuqizimi I laboratorëve diagnostic të shëndetit të kafshëve dhe rritja e kapacitetit analitik të tyre (incubator për izolimin M. turbeculosis)
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	32,820	Implementim i planit kombëtar të monitorimit të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes
1005111	ISUV	04220	231	90502AD	29,366	Ngritje dhe funksionim I laboratorit të mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve (blerje paisjesh)
Totali					**341,486**	

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Në zbatim të Ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", dhe shkresës të MFE nr. 2027/1 prot., dt. 14.02.2023 për miratimin e fondit të veçantë për vitin 2023, MBZHR me shkresën nr. 347/1 prot., datë 22.02.2023 ka dërguar në ISUV detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023. Fondi i veçantë i miratuar për ISUV është në vlerën 500 mijë lekë për llogarinë 6060000 "Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)".

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2023

- Me shkresën nr. 1601/8 prot., datë 27.06.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerën 10,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 3871/2 prot., datë 26.07.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 600 me vlerën 3,800 mijë lekë dhe për llogarinë 601 me vlerën 100 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5578/1 prot., datë 26.10.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi rialokimin e fondeve ndërmjet projekteve në llogarinë 231.
- Me shkresën nr. 5236/1 prot., datë 26.10.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 100 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5826/2 prot., datë 05.11.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerë 11,500 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", është pakësuar me 300 mijë lekë fondi për llogarinë 601.
- Me shkresën nr. 5891/1 prot., datë 21.11.2023 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 30 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", është pakësuar me 60,000 mijë lekë fondi për llogarinë 231.
- Me VKM nr. 834, datë 28.12.2023 është miratuar shtesa prej 1,124 mijë lekë për llogarinë 600.

Buxheti përfundimtar duke reflektuar dhe ndryshimet buxhetore të ndodhura gjatë vitit paraqitet në aneksin nr.1, Tabela nr.4.

Buxheti total për vitin 2023 për ISUV është në shumën 358,080 mijë lekë

Realizimi i buxhetit për vitin 2023

Për vitin 2023 realizimi i programeve buxhetore paraqitet në tabelën nr. 5.

Tabela nr.5 Realizimi i zërave buxhetor të vitit 2023. *Në mijë lekë*

Art.	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Realz.
600	Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli	114,924	114,707	-217	99,8%
601	Kontribute të sig. shoqërore nga punëdhënësi	19,100	18,684	-416	99.20%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	171,500	170,158	-1,342	99%
606	Transferta për buxhetet familjare	370	309	-61	83,5%
231	Blerje Pajisje Laboratorike	17,729	17,729	0	100%
231	Blerje pajisje kafshëve	21,540	21,540	0	100.00%
231	Blerje pajisje laboratorike	388	388	0	100%
231	Rikonstruksion Godina 6-kateshe	1,229	1,207	-22	98,2%
231	Arredim zyra, salla konferencave	7,950	7,800	-150	98,1%
231	Blerje pajisje kompjuterike	2,144	2,092	-52	97,6%
231	Furnizim vendosje grila	1,206	1,192	-14	98,8%
	Total	**358,080**	**355,806**	**-2,274**	**99.30%**

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se nuk ka në asnjë program tejkalim të realizimit të fondeve të programuara. Në total realizimi vjetor është 99.3 % e fondeve të alokuara.

Gjatë vitit 2023 ISUV ka kryer mirëmbajtjen e 1,367 testeve laboratorike dhe ka zgjeruar akreditimin me 8 metoda të reja për 264 parametra analitike duke e rritur kështu numrin e akreditimeve me 1631 parametra dhe teste analitike. Në fushën e sigurisë ushqimore është zgjeruar lista e kontrollit të mbetjeve-pesticide në produktet me origjine bimore, si dhe ka përfunduar akreditimi për të gjithë parametrat analitik të cilët analizohen për kontrollin e freskisë së peshkut.

Në fushën e shëndetit të kafshëve është rritur me 6 numri i testimeve për pesë sëmundje.
Në fushat ku laboratorët e ISUV ushtrojnë aktivitetin e tyre analitik gjatë vitit 2023 janë realizuar:
Në fushën e Shëndetit të Kafshëve :
- Programi i Kontrollit të Brucelozës në gjedhin për Qumësht në nivel ferme dhe individual (Realizuar 6724 kampione në nivel ferme dhe 1264 në nivel individual)
Plani i Monitorimit postvaksinal të Brucelozës Rev 1 në të imta /remont. (Realizuar 1685 kampione)
- Plani i Monitorimit të vaksinës kundër Tërbimit në dhelprën e kuqe. (në mbyllje të proces realizimi 170 kampione)
- Plani i Monitorimit të Aftës epizotike për të ruajtur statusin "free" të vendit mbi këtë sëmundje-INDICIO (Realizuar 350 kampione)
- Plani i Monitorimit të Gjuhës Blu/INDICIO (në mbyllje të procesit të realizimit 294)
- Plani i Monitorimit të Aviane Influencës në shpendë. (Realizuar 910 kampione)
- Plani i Mbikëqyrjes së Afrikan Swine Fever (nuk kanë ardhur kampione të dyshuara)
- Kontrollet zyrtare lidhur me Programet e kontrollit të Zoonozave Anthrax (50 kampione, TBC (2 Kampione) (Realizuar)
- Kontrollet Zyrtare lidhur me Anisakis Spp në peshk (realizuar 7 kampione)
- Kontrollet zyrtare si dhe autokontrollet për përcaktimin e shkaktarit të ngordhshmërisë apo uljes së prodhimit në kafshë bujqësore, shpendë si dhe akuakulturë (realizuar 1339 kampione)

Në fushën e Sigurisë Ushqimore:
- Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me Origjinë Shtazore dhe Ushqimet për Kafshë (Ardhur 1557 kampione, kryer 1286 dhe 2150 analiza të kryera)
- Planet e kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivale të gjalla, (Ardhur 8 kampione, kryer 8)
- Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit nr. Prot 2236 dt. 08.03.2019 (Ardhur 71 kampione, dhe 70 analiza të kryera)
- Planit me bazë risku të AKU-së, për disa kontaminant (Ardhur 167 kampione dhe 105 analiza të kryera)
- Autokontroll dhe eksport (3 kampione realizuar për metalet e rënda)
- Kontrolli i barnave veterinare (PMV) me qëllim regjistrimin (173 PMV dhe 500 analiza)
- Plani Kombëtar i Molusqeve (837 kampione realizuar)
- Plani me bazë risku i AKU dhe kontrollet zyrtare për tregues mikrobiologjike, freskose së peshkut dhe tregues cilësor (1711 kampione realizuar)
- Autokontroll /Eksport (662 kampione realizuar).

Në fushën Mbrojtjes dhe Shëndetit të Bimëve.
- Plani Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve në produktet dhe nënproduktet me origjinë Bimore (1,110 kampione të realizuar)
- Plani Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve në produktet dhe nënproduktet me origjinë Bimore në fermë (178 kampione realizuar)
- Plani Kombëtar të Monitorimit të dëmtuesve në bimë (173 kampione të realizuar)
- Planit me Bazë Risku të AKU-së, kontrolleve zyrtare dhe kontrolleve për eksport në produkte dhe nënproduktet ushqimore me origjinë bimore si dhe kontrollin e produkteve që përdoren në bimë;
- Analizimi i Nitrateve (27 kampione realizuar)
- Analizimi i PMB-ve (49 kampione realizuar)
- Kontrollet zyrtare (30 kampione realizuar)
- Vlerësimi i 41 dosjeve të PMB-ve –Realizuar.
ISUV realizon të ardhura në përputhje me ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" neni 37, pika 2 dhe neni 44, pika 2.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar niveli i realizimit të të ardhurave të vitit 2023, të ardhura të cilat derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit, pasqyrohen në tabelën nr.6.

Tabela nr.6. Të ardhurat për vitin 2022. *Në mijë lekë*

PROGRAMI					
Llogaria	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi
7111005	Të ardhura nga shitja dhe veprimtaria e drejtpërdrejtë	5,650	3,771	-1,879	66,7%
	Totali	5,650	3,771	-1,879	66,7%

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti i vitit 2024 - Përgatitja e PBA 2025 – 2027

Hartimi i planifikimit të programit afatmesëm 2025 – 2027 dhe projektbuxhetit të vitit 2024 ka kaluar përgjatë fazave të parashikuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në kuadër të hartimit të PBA – së 2025 – 2027 dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", të ndryshuar, të udhëzimit nr.4, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" dhe VKM nr.184, datë 27.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 - 2027", struktura përgjegjëse e ISUV, me shkresën nr. 240/1 prot. datë 29.03.2024 ka dërguar në MBZHR përgatitjen për fazën e parë të PBA 2025 – 2027 dhe me shkresën nr. 585/1 datë 07.08.2024 ISUV ka dërguar në MBZHR përgatitjen për fazën e dytë të PBA 2025 – 2027, paraqitur në tabelën Nr.5, aneksi nr.1.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR, me shkresën nr. 663, datë 25.01.2024 dhe shkresën nr. 2149/1 prot., datë 29.03.2024, ka përcjelle në ISUV, detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për periudhën 2024 - 2026, sipas artikujve kryesorë të strukturës buxhetore, detajuar si vijon:

Tabela nr.7. Detajimi i Buxhetit të vitit 2024 *Në mijë lekë*

Kodi Ins	Inst.	Prog.	Llog.	Kodi Proj.	Buxheti	Emërtimi Projektit
1005111	ISUV	04220	6000000	90502AD	117,159	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	6010000	90502AD	19,500	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	6020000	90502AD	160,000	Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)
1005111	ISUV	04220	2310000	M050437	30,000	Përmirësim dhe zgjerim I infrastrukturës laboratorike dhe shtrim i linjave të gazit për Departamentin e Mbrojtjes dhe Shëndetit të bimëve
1005111	ISUV	04220	2310000	M050437	55,409	Fuqizim i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e saj analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh
Totali					**382,068**	

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", MBZHR me shkresën nr. 1483/1 prot., datë 04.03.2024 ka dërguar në ISUV detajimi i fondit të veçantë për vitin 2024.

Fondi i veçantë i miratuar për ISUV është në vlerën 500 mijë lekë për llogarinë 6060000 "Analiza të kryera të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale (realizuar nga ISUV)".

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2024

- Me shkresën nr. 2937/1 prot., datë 14.05.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerën 50 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 2353/3 prot., datë 23.05.2025 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerën 5,400 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 3277/1 prot., datë 23.05.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi rialokimin e fondeve ndërmjet projekteve në llogarinë 231.
- Me shkresën nr. 5060/3 prot., datë 05.08.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtimin e fondit për llogarinë 602 me vlerë 11,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5489/1 prot., datë 26.08.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 600 me vlerë 24,000 mijë lekë dhe për llogarinë 601 me vlerë 3,850 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 5951/1 prot., datë 23.09.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 30 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", është pakësuar me 4,550 mijë lekë fondi për llogarinë 231.
- Me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", është shtuar me 47,500 mijë lekë fondi për llogarinë 602.
- Me shkresën nr. 6503/1 prot., datë 17.10.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 130 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 4159/11 prot., datë 24.10.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerë 6,750 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 7185/1 prot., datë 06.11.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 600 me vlerë 4,000 mijë lekë dhe për llogarinë 601 me vlerë 800 mijë lekë
- Me shkresën nr. 7891/1 prot., datë 06.12.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi rialokimin e fondeve ndërmjet projekteve në llogarinë 231.
- Me shkresën nr. 8014/1 prot., datë 19.12.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi pakësimin e fondit për llogarinë 606 me vlerë 113 mijë lekë
- Me shkresën nr. 8071/1 prot., datë 20.12.2024 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 me vlerë 37,200 mijë lekë
- Me shkresën nr. 221/1 prot., datë 17.01.2025 të MBZHR është njoftuar ISUV mbi shtesën e fondit për llogarinë 606 me vlerë 705 mijë lekë
- Me Aktin Normativ nr.5, datë 18.12.2024, është pakësuar me 24,45 mijë lekë fondi për llogarinë 231, projekti "Përmirësim dhe zgjerim i infrastrukturës laboratorike dhe shtrimi i linjave të gazit për Departamentin e Mbrojtjes dhe Shëndetit të Bimëve"; dhe është shtuar me 25,920 mijë lekë fondi për llogarinë 231, Projekti "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në të tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh.

Buxheti përfundimtar duke reflektuar dhe ndryshimet buxhetore të ndodhura gjatë vitit paraqitet në Tabelën nr.6, Aneksin nr.1.

<u>Buxheti total për vitin 2024 për ISUV është në shumën 510,791 mijë lekë</u>

Për vitin 2024 realizimi i programeve buxhetore paraqitet në tabelën nr. 8.

Tabela nr.8 Realizimi i zërave buxhetor të vitit 2024. *Në mijë lekë*

Art.	Emërtimi	Buxheti	Ndrysh.	Plani	Fakt	Dif.	Realiz.
600	Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli	117,150	20,000	137,150	135,765	-1,385	99%
601	Kontribute të sig. shoqërore nga punëdhënësi	19,500	3,050	22,550	22,277	-273	99%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	160,000	107,850	267,850	255,878	-11,972	96%
606	Transferta për buxhetet familjare	500	412	912	862	-50	95%
231	Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës laboratorike dhe shtrimi i linjave të gazit për Departamentin e Mbrojtjes dhe Shëndetit të Bimëve	30,000	-10,485	19,515	0	-19,515	0%

231	Fuqizimi I laboratorëve diagnostic të shëndetit të kafshëve dhe rritja e kapacitetit analitik të tyre (incubator për izolimin M. turbeculosis)	55,409	25,920	81,329	81,329	0	100%
231	Implementim i planit kombëtar të monitorimit të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes	0	980	980	980	0	100%
	Total	**382,559**	**147,727**	**510,791**	**497,091**	**-13,700**	**97%**

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se nuk ka në asnjë program tejkalim të realizimit të fondeve të programuara.

<u>Në total realizimi i buxhetit 2024 është 97% të fondeve buxhetore të alokuara.</u>

ISUV gjatë vitit 2024 ka kryer mirëmbajtjen e 1631 testeve laboratorike dhe ka zgjeruar akreditimin me 278 parametra analitike. Në fushën e sigurisë ushqimore është zgjeruar lista e kontrollit të mbetjeve në produktet me origjinë shtazore dhe bimore për të cilat vendi ynë është listuar për të eksportuar si fenikolet, nitrofuranet, tetraciklinat në vezë, metalet e rënda në veshkë, si dhe mbetjet e pesticideve në bimët medicinale. Gjithashtu ka përfunduar dhe akreditimin për parametrat analitik të cilët analizohen për vajin e ullirit. Konkretisht në fushat ku laboratorët e ISUV ushtrojnë aktivitetin e tyre analitik gjatë vitit 2024 janë realizuar:

-Në fushën e Shëndetit të Kafshëve gjatë viti 2024 janë realizuar në total 11,704 kampione, 11735 analiza.

- Në fushën e Sigurisë Ushqimore:

Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Kafshët e Gjalla dhe Produktet me Origjinë Shtazore (Ardhur 1450 kampione, kryer 1450 dhe 2050 analiza)

Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit nr. Prot 2236 dt. 08.03.2019 (Ardhur 29 kampione, kryer 29 dhe 32 analiza).

Planit me bazë rrisku të AKU-së, për disa kontaminant (Ardhur 214 kampione, kryer 214 dhe 275 analiza). Autokontroll dhe eksport (14 kampione realizuar për metalet e rënda)

Kontrolli i barnave veterinare (PMV) me qëllim regjistrimi (89 PMV dhe 430 analiza)

Plani Kombëtar i Molusqeve (Ardhur 950 kampione, realizuar 873 kampione)

Plani me bazë risku i AKU dhe kontrollet zyrtare për tregues mikrobiologjike , freskose së peshkut dhe tregues cilësor (Ardhur 613 kampione dhe analizuar 613 kampione)

Autokontroll /Eksport (Ardhur 403 kampione dhe analizuar 403 kampione).

-Në fushën Mbrojtjes dhe Shëndetit të Bimëve.

Plani Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve te pesticideve në produktet me origjinë Bimore (1095 kampione dhe 328500 analiza, realizuar)

Plani Kombëtar të Monitorimit të dëmtuesve në bimë (390 kampione dhe 390 analiza realizuar)

-Planit me Bazë Risku të AKU-së, kontrolleve zyrtare dhe kontrolleve për eksport në produkte dhe nënproduktet ushqimore me origjinë bimore si dhe kontrollin e produkteve që përdoren në bimë;

a) Analizimi i Nitrateve (23 kampione realizuar- 23 analiza)

b) Analizimi i PMB-ve (28 kampione realizuar)

c) Kontrollet zyrtare -indicio (102 kampione ; 30600 analiza realizuar)

d) Vlerësimi i 50 dosjeve të PMB-ve –Realizuar.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar niveli i realizimit të të ardhurave të vitit 2024, të ardhura të cilat derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit, pasqyrohen në tabelën nr.9.

Tabela nr.9. Të ardhurat për vitin 2024. *Në mijë lekë*

llogaria	emërtimi	plan	fakt	diferenca	real.në %
7111005	të ardhura nga shitja dhe veprimtaria e drejtpërdrejtë	5,650	3,471	-2,179	43,7%
	Totali	**5,650**	**3,471**	**-2,179**	**43,7%**

Burimi: ISUV, përpunoi Grupi i Auditimit

Nga auditimi konstatohet se:
Për vitin 2022, 2023 dhe 2024, Titullari i institucionit nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe mungon dokumentacioni i aktivitetit të tij për periudhën objekt auditimi.
Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.
Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b" dhe nenin 27, Manualin e MFK-së, pika 2.2.6, si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".
- Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-ve të hartuara gjatë periudhës së auditimit, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit. Mosveprimet e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit si përgjegjës për realizimin e detyrave teknike si dhe zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore janë në kundërshtim me pikën 2.6 të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm". Bazuar në pikën 2.5 të Udhëzimit përcaktohet se: "Nëpunësi i autorizuar në cilësinë e Drejtuesit të programit është përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore, si dhe ka përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik, duke marrë pjesë në çdo diskutim si dhe vendim-marrjet përkatëse që kanë ndikim mbi programin e tyre.
- ISUV nuk ka hartuar raportet periodike të monitorimit me qëllimin vlerësimin e ecurisë së realizimit të buxhetit vjetor, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 9, dt.20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kapitulli VI "Raportet e monitorimit".
- Gjatë periudhës 2022 – 2024 u konstatua një numër i lartë i rishikimeve buxhetore, konkretisht në vitin 2024 janë kryer 16 ndryshime buxhetore; në vitin 2023 janë kryer 9 ndryshime buxhetore dhe për vitin 2022 gjithashtu 9 ndryshime. Po ashtu konstatohet një nivel i ulët i realizimit të investimeve të parashikuara dhe i të ardhurave. Këto tregojnë për një planifikim fillestar të pasaktë, si dhe për një mungesë të monitorimit dhe kontrollit efektiv gjatë zbatimit të buxhetit.
Me veprimet apo mosveprimet brenda periudhës së ushtrimit të detyrës së titullarit të institucionit të ISUV, duke mos siguruar dhe ngritur një sistem efektiv për hartimin e kërkesave buxhetore dhe monitorimin e ecurisë së realizimit të buxhetit vjetor, ngarkohen me përgjegjësi: z. A. R., z. P. A., z. I. A dhe znj. J. B., dhe përgjegjësi i sektorit të financës znj. D. Sh.në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.2. Auditimin e zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, respektimin e strukturave organike të miratuara dhe krahasimin me gjendjen faktike, si dhe respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve"

ISUV është Qendër Kombëtare Reference Laboratorike si dhe bashkëpunon me institute, qendra kërkimore shkencore, ente ndërkombëtare dhe qendra reference. Vlerësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore është përqendruar në aktivitetet që pasqyrojnë fokusin funksional, të mbare vajtur dhe të konsoliduar të kësaj fushe, në identifikimin e indikatorëve thelbësore që shtojnë vlerë në funksionin e Burimeve Njerëzore, pjesë të kësaj strukture, e konkretisht:
- Strategjia e Burimeve Njerëzore/menaxhimi i ndryshimit të strukturës, duke e rimodeluar atë në një formë më të qëndrueshme sipas Urdhrit nr. 126, datë 23.10.2020, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV", është një nga ndryshimet më të rëndësishme e cila ka hyrë në fuqi në janar 2021;
- Urdhri nr., 10, datë 26.10.2023 "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Siguresë Ushqimore dhe veterinarisë"
- Urdhri nr., 156, datë 05.10.2023 një ndryshim në urdhrin nr. 10, datë 26.01.2023 të Kryeministrit mbi "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe veterinarisë"

- ISUV-i, deri në dhjetor 2022 ka qenë strukturë administrative e MBZHR sipas VKM nr. 515, datë 19.7.2006 "Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore-Shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", pika 8, VKM e cila është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të VKM nr. 732 datë 16.11.2022 'Për organizimin dhe funksionimin e ISUV".

Nga muaj janar 2023 e në vijim struktura nuk ka pësuar ndryshime.

Në lidhje me strukturën e re, hyrë në fuqi në janar 2023, numri i punonjësve në total është 99 veta.
Struktura aktuale e ISUV nuk ka pësuar ndryshime në përbërje dhe numër departamentesh por ka pasur ndryshime në kategorinë e pagës ndaj punonjësve.
ISUV është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin për shërbimin civil, në zbatim të lidhjes nr. 1 të VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

Marrëdhëniet e punës rregullohen:

- *Për nëpunësit civil* me legjislacionin për shërbimin civil, aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij, si dhe ligje specifike, që rregullojnë raportet e sjelljes së punëmarrësve nëpunës civilë.
- *Për punonjësit e aktivitetit ndihmës,* legjislacionin bazë është Kodi i Punës, aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, kontratat individuale të punës.

Nga auditimi konstatohet se:

Gjatë periudhës objekt auditimi, ISUV nuk ka miratuar rregullore të brendshme në përputhje me strukturën dhe organikën aktuale, në të cilën të përcaktohen në mënyrë të detajuar detyrat funksionale të çdo Departamenti, Drejtorie, Sektori dhe të punonjësve të institucionit. Edhe pse instituti ka hartuar një draft të rregullores së brendshme, MBZhR nuk e ka miratuar atë, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Neni 20, pika c, kërkon në mënyrë eksplicite përcaktimin e strukturës organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta për të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Struktura organizative e ISUV

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është i organizuar në strukturat e mëposhtme:

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, e cila përfshin:
- Sektorin e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Arkivës/Protokollit;
- Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë, Pranimit të Kampioneve dhe Vivariumit, i cili përfshin:
- Sektorin e Menaxhimit të Cilësisë;
- Sektorin e Pranimit të Kampioneve dhe Vivariumit.

Departamenti i Shëndetit të Kafshëve, i cili përfshin:
- Sektorin e Diagnozës në Kafshë dhe Shpendë;
- Sektorin e Patologjisë dhe Tërbimit;
- Sektorin e Serologjisë.

Departamenti i Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë, i cili përfshin:
- Sektorin e Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve;
- Sektorin e Produkteve të Peshkut dhe Monitorimit të Molusqeve;
- Sektorin e Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimeve.

Departamenti i Monitorimit të Mbetjeve, Kontrollit të Barnave Veterinare dhe Toksikologjisë, i cili përfshin:
- Sektorin e Mbetjeve Veterinare dhe Kontaminantëve;
- Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare.

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, i cili përfshin:
- Sektorin e Diagnostikimit të Dëmtuesve;
- Sektorin e Analizave të PMB-së dhe Monitorimit të Mbetjeve në Bimë.

Sektori i Financës funksionon si një njësi më vete në strukturën organizative të institucionit.

Kuadri ligjor i marrëdhënieve të punës

- Rregullimi i marrëdhënieve të punës është bërë në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe me dispozitat e Kodit të Punës dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij.
- Punonjësit që bëjnë pjesë në shërbimin civil janë të konfirmuar me statusin e nëpunësit civil.
- Me punonjësit mbështetës janë lidhur kontrata individuale pune në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës, të cilat janë përfshirë në dosjet e tyre personale.
- ISUV nisur nga rëndësia që ka si Institut i vetëm i referencës në Shqipëri dhe ngarkesa në realizimin e objektivave të lëna dhe nga BE, ka paraqitur në DAP për mendim përshkrimet e punës, të cilat janë realizuar në bashkëpunim me DAP.

Sipas viteve të periudhës objekt auditimi, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme:

Struktura plan fakt

Viti 2022	**Fakt**	**Plan**	**vakant**	**shërbim civil**	**kod pune(lab. Mbështetës)**
Janar	88	99	11	53	35
Dhjetor	90	99	9	57	35
viti 2023					
Janar	88	99	9	57	33
Dhjetor	97	99	2	62	35
viti 2024					
Janar	97	99	2	63	33
Dhjetor	97	99	2	63	34

Largimet

Viti	**2022**	**2023**	**2024**
Punonjës te larguar Total	10	11	6
Dorëheqje	6	5	3
Transferim i përhershëm	1	0	
Zgjidhje e kontratës nga punëdhënësi	2	2	1
Pension pleqërie	0	3	1
Urdhër Lirimi	1	1	1

Grupi i auditimit konstatoi se:

Për periudhën objekt auditimi 10 punonjës mbështetës janë punësuar pa iu nënshtruar më parë procesit të rekrutimit, në kundërshtim me VKM nr. 176 datë 29.03.2006 ‘’Për botimin e buletinit e njoftimeve publike’’ pika 3 germa VI... ku botohen të gjitha njoftimet publike (Lista si me poshtë)

Nr.	**Emër, Mbiemër**	**Pozicioni i punës**	**Kategoria**	**Dt. Emërimi ISUV**
1	D. B.	Nëpunës Informacioni	II	03/08/2023
2	T. B.	Shofer	III	09/05/2022
3	V. P.	Punonjës Pastrimi	I	01/11/2023
4	E. B.	Laborant	VI	21.8.2023
5	R. D.	Laborant	VI	09/10/2023
6	E. K.	Laborant	VI	03/08/2023
7	A. K.	Laborant	VI	04/04/2023
8	L. Z.	Specialist (Kërkimi Teknologjik)	IV-1	02/11/2023
9	D. M.	Laborante zevendesuese leje lindje	VI	15/05/2024
10	S. H.	Sekretare	VII	18/07/2023

Këshilltarët e jashtëm

Për periudhën 2023-2024 pranë ISUVI-it janë punësuar në total 13 këshilltar të jashtëm të cilët nuk janë paguar nga fondi i pagave por janë paguar si shërbim në llogarinë 602.

Tabela nr.10 Këshilltarët e jashtëm

NR	Emër Mbiemër	Nr. urdhri	Dt. e fill. te efektit fin.	Vlera bruto	Dt. e mbarimit e efektit fin.	Pagesa neto	Viti i likuidimit
1	E. Gj.	96 DT 14.07.2023	14.07.2023	110,000	13.10.2023	280,500	2023
2	A. T.	98 DT 08.08.2023	08.08.2023	60,000	15.11.2023	229,500	2023
	A. T.	134 DT 16.11.2023	16.11.2023	90,000	04.02.2024	459,000	2024
	A. T.	7 DT 05.02.2024	05.02.2024	70,000	11.07.2024		
3	I. T.	101 DT 11.08.2023	11.08.2023	50,000	13.10.2023	85,000	2023
4	K. S.	111 DT 15.9.2023	15.09.2023	70,000	13.10.2023	59,500	2023
5	Xh. K.	135 DT 16.11.2023	16.11.2023	90,000	04.02.2024	76,500	2023
	Xh. K.	8 DT 05.02.2024	05.02.2024	70,000	31.10.2024	651,795	
6	S. D.	136 DT 16.11.2023	16.11.2023	90,000	04.02.2024	76,500	2023
	S. D.	6 DT 05.02.2024	05.02.2024	70,000	31.10.2024	651,795	
7	O. G.	210 DT 20.12.2023	20.12.2023	60,000	31.10.2024	530,864	2024
8	G. C.	5 DT 05.02.2024	05.02.2024	60,000	31.10.2024	452,045	2024
9	R. S.	55 DT 12.07.2024	12.07.2024	70,000	31.10.2024	216,364	2024
10	E. Dh.	131 DT 05.12.2024	05.12.2024	70,000	Vazhdon 2025	-	Pagesa 2025
11	J. Gj.	140 DT 23.12.2024	24.12.2024	60,000	Vazhdon 2025	-	Pagesa 2025
12	V. A.	141 DT 23.12.2024	24.12.2024	60,000	Vazhdon 2025	-	Pagesa 2025
13	B. D.	142 DT 23.12.2024	24.12.2024	60,000	Vazhdon 2025	-	Pagesa 2025
	Totali					**3,769,363**	

Nga auditimi konstatohet se:

Sipas Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", kreu III, pika 2, germa "ç", citohet:

"Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, (mund të caktojnë pagë) në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj."

Gjatë periudhës 2023–2024 janë lidhur gjithsej 17 kontrata me këshilltarë të jashtëm. Numri i kontratave tejkalon numrin e këshilltarëve të përfshirë, pasi disa prej tyre janë angazhuar më shumë se një herë, përmes rinovimit ose lidhjes së kontratave të njëpasnjëshme.

Nga auditimi rezulton se, ISUV në vitin 2023, ka lidhur 8 kontrata me këshilltarë të jashtëm, ndërsa në vitin 2024 ka lidhur 9 kontrata, përfshirë kontratat e reja dhe ato të rinovuara nga viti paraardhës. Në total, për vitet 2023 dhe 2024, rezultojnë të lidhura 17 kontrata në vlerën totale prej 3,769,363 lekësh për 13 këshilltar të jashtëm.

Përzgjedhja dhe kontraktimi i tyre nga strukturat përgjegjëse të ISUV nuk është realizuar nëpërmjet procedurës së prokurimit për shërbime konsulence, duke vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", konkretisht:

Neni 1, pika 2, ku përcaktohet: "Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike."

Neni 3, pika 2, ku përcaktohet: "Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën."

Neni 7, që përcakton përjashtimet e veçanta nga procedurat e prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara mbajnë përgjegjësi:

Titullari i institucionit z. I. A, për periudhën 12.07.2023 – 31.10.2024; znj. J. B.në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm për periudhën 01.11.2024 – 31.12.2024 dhe znj. D. Sh.në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për sa është trajtuar më sipër në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nga përfaqësues të ISUV-it, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Sa më sipër sqarojmë se; Bazuar në Kreu III pika 2 germa (ç) të Vendimit Nr. 325 datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" citohet se: "Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj." Dispozita e mësipërme ka natyrë autorizuese dhe kufizuese njëkohësisht e cila e lejon Titullarin e një institucioni qendror nën varësinë e ekzekutivit të emërojë dhe paguajë këshilltarë të jashtëm, por vetëm deri në kufirin maksimal të përcaktuar nga ligji (110,000 lekë/muaj).
Vlen të theksojmë se në kuadër të kësaj dispozite këshilltarët nuk janë nëpunës civilë ose punonjës të përhershëm të administratës, por ekspertë apo profesionistë të jashtëm që punojnë me kontratë të posaçme si subjekte që veprojnë në bazë të së drejtës që vet ligji jua ka njohur. Përsa i takon pjesës sepse nuk është zhvilluar një procedurë prokurimi konsulencë ose shërbimi për punësimin e 13-këshilltarëve të jashtëm sqarojmë se këshilltarët e jashtëm mund të angazhohen pa tender, por me kontratë të dokumentuar dhe justifikim ligjor e financiar, si shtojcë e një urdhri institucional bazuar kjo dhe në Kodin Civil dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore për zbatim të tij.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumente shtesë vërtetues për pasoje observacioni nuk merret në konsideratë.

Administrimi i Dosjeve të Personelit.
Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 883, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022-31.12.2024 është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Vlerësimi i fundit periodik është ai i periudhës qershor - dhjetor të vitit 2024.
U audituan gjithsej 15 dosje personale të punonjësve të ISUV-së, nga të cilët:
-10 dosje personale të nëpunësve të rekrutuar sipas Ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil", i ndryshuar;*
-3 dosje personale të punonjësve mbështetës, të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- 2 dosje personale të punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë/ditë), të punësuar sipas VKM Nr. 39, datë 24.01.2024, "Për caktimin e numrit te punonjësve me kontrate te përkohshme".

Nga auditimi i dosjeve të personelit mbështetës të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; konstatohet se:
Në kontratat individuale të punës të lidhura ndërmjet nëpunësve dhe ISUV nuk janë të përcaktuara procedurat e dhënia e masave disiplinore si dhe klasifikimi i tyre veprime në kundërshtim me sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", neni 21 pika 3.
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. B. C..

Fondi Veçantë
Nga auditimi, në lidhje me destinacionin e përdorimit të fondit të veçantë, në respektim të përcaktimeve të VKM nr. 929, datë 17.11.2010, i ndryshuar, u konstatuan shpenzimet e mëposhtme:

Nr	Vitet	Ndihma për pension pleqërie	Ndihmë për fatkeqësi ose vdekje	Ndihma për rast sëmundje	Ndihma për shpenzim financiar	Totali në lekë i realizuar
1	2022	91,220			1,300,000	1,391,220
2	2023	248,500	30,000	30,000		308,500
3	2024	51,938		105,000	705,000	861,938
Totali		**391,658**	**30,000**	**135,000**	**2,005,000**	**2,561,658**

Burimi: Sektori i financës në ISUV

Proceset Gjyqësore

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, janë planifikuar fonde për artikullin buxhetor 602/74 "Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna", si më poshtë:

Shpenzimet Gjyqësore

Viti	**Plan**	**Fakt**
2022	500,000	0
2023	1,000,000	**800,000**
2024	6,106,437	**6,106,437**
TOTAL	**7,606,437**	**6,906,437**

Detyrimi i paguar, i ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbarimore, për gjithë periudhën e auditimit, paraqitet në tabelë si dhe në listat bashkëlidhur.

Viti	**Përshkrimi**	**Vendimi nr , datë**	**Vl. Lik. Baz. në v. gjyqësore**	**Vl. e lik. për shër. Përmb.**	**TOTALI (në lekë)**
2022	Pagesë për vendime gjyqësore.(1 punonjës)	Autorizim 5810/6 dt 30.12.2022 Vendim 00-2022-1129 dt 13.05.2022	0.00	0	**0**
2023	Pagesë për vendime gjyqësore.(1 punonjës)	Autorizim 5810/6 dt 30.12.2022 Vendim 00-2022-1129 dt 13.05.2022	800,000	0	**800,000**
2024	Pagesë për vendime gjyqësore.(1 punonjës)	Autorizim 5810/6 dt 30.12.2022 Vendim 00-2022-1129 dt 13.05.2022	5,593,617	512820	**6,106,437**

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2024, është në proces gjyqësor një çështje me objekt marrëdhëniet e punës.

- Çështja gjyqësore e znj. A. M. është në shqyrtim pranë gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm. Gjithashtu, për periudhën objekt auditimi u konstatua se është ekzekutuar vendimi gjyqësor për punonjësen znj. S. H., në vlerën totale prej 6,906,437 lekësh.

Vendimi nr. 00-2022-1129 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur si më poshtë:

- Detyrimin e palës së paditur ISUV të sistemojë paditësen znj. S. H. në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori.
- Detyrimin e palës së paditur ISUV, t'i paguajë paditëses znj. S. H. pagën nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ditën e ekzekutimit.

ISUV, si dhe Departamenti i Administratës Publike, kanë shkëmbyer korrespondenca mbi rikthimin e znj. S. H. në pozicionin e punës së mëparshëm dhe në prill të vitit 2023 ajo është rikthyer përsëri në pozicionin e saj të mëparshëm, duke ekzekutuar një nga pikat e vendimit të Kolegjit.

Vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga ISUV, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë, duke paguar tarifa përmbarimore në vlerën totale prej 512,820 lekë.

Vendimet gjyqësore përbëjnë një shpenzim të pajustifikuar dhe në mospërputhje me parimet e eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, duke shkaktuar kosto shtesë për buxhetin e ISUV-it, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej 6,906,437 lekë.
Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, konkretisht, nenin 130, "Rregullat e njoftimit shkresor të akteve", i cili përcakton se:
"Në rastin e personave juridikë publikë, njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve"; nenin 451/a, ku thuhet se "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët" dhe nenin 510/a, "Titujt ekzekutivë".

Për sa është trajtuar më sipër në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nga përfaqësues të ISUV-it, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Me shkresën nr. 4784 prot., datë 10.10.2022, nga zyra përmbarimore "Strati" shpk, jemi bërë me dije ne dhe Departamenti i Administratës Publike në lidhje me "Rifillimin e Ekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Lartë të datës 13.05.2022".
Në diapozitivin e shkresës përmbarimore Urdhërohet:
1. Rifillimin e Ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendimin Nr. 649 Vendimi, datë 12.05.2025 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Tiranë, ndryshuar me Vendimin Nr. 5106 (86-2017-5429) datë 05.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
Nisur nga fakti që për shkresat e cituara më sipër nuk patëm një reagim nga palët përkatëse me shkresën nr. 907 prot., datë 10.11.2022, jemi drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me "Kërkesën për dhënie autorizimi për rastet e praktikave për gjyqëfituesit dhe buxhetet për zbatimin e vendimit gjyqësor nr. 00-2022-1129, të Gjykatës së Lartë dhe njoftim mbi gjithë hapat e ndjekura nga ana jonë", praktik e cila ishte domosdoshmëri për arsye të faktit që jemi një institucion tërësisht buxhetor me fonde dhe buxhete të përcaktuara nga autoriteti ynë qendror nga ku dhe kemi varësi nga MBZHR. Për ta përmbyllur argumentimin tonë dhe për të shpjeguar përpjekjen e ISUV dhe mos neglizhencën në zbatimin e vendimit të gjykatës në datë 15.11.2022 me shkresën me nr. 907/1 prot., jemi drejtuar MBZHR dhe DAP me "Sqarim dhe kërkesë për zgjidhje të përbashkët". Pra ISUV në asnjë moment nuk ka anashkaluar detyrimet që legjislacioni ka parashikuar dhe ka zbatuar vendimin e gjykatës sipas fazave të cituara më sipër, brenda kompetencave të veta Institucionale.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumente shtesë vërtetues prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

2.3 Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare viti 2024
Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.
Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të ISUV: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore nga struktura përgjegjëse e ISUV në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Degën e Thesarit me shkresën nr.279 prot., datë 21.03.2025 konfirmuar nga dega e thesarit. Pra bilanci kontabël i vitit 2024 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave. Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formatit nr.1; Pasqyrën e performancës financiare sipas formatit nr.2; Pasqyrën e flukseve monetare sipas formatit nr.3; Pasqyrën e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto sipas formatit nr.4; Pyetësorin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.5 dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën e Investimeve dhe Burimet e financimit sipas formantit nr.6, Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Afatgjata (Kosto Historike) sipas formatit nr.7/a Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlerë Neto) sipas formatit 7/b; si dhe Pasqyrën mbi numrin e

punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.8. Bashkangjitur gjendet dhe relacioni shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 rezultoi:
(Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.)
Gjendja e llogarive aktive për vitin 2024, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2024-2023), janë të paraqitura në Aneksin nr.2, Tabela nr.1.

Zëri Aktive (lekë)
Shuma e aktivit të pasqyrës financiare pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese, kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij. Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivit të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2024, rezulton se totali i aktivit me 31.12.2024 paraqitet me vlerën 1,123,988,227 lekë dhe se, "Aktivet e Qëndrueshme", zënë 89% të vlerës totale të aktivit ndërsa, Aktivet Qarkulluese zënë 11% të vlerës totale. Aktivet e Qëndrueshme në krahasim me vitin 2023, janë rritur në vlerën 15,804,329 lekë ndërsa, Aktivet Qarkulluese janë pakësuar me vlerën 10,179,320 lekë.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 148,573 lekë;
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 106,414,701 lekë;
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 14,437,048 lekë.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre", përbëhet nga:
Gjendja e llogarisë nr.520 "Disponibilitete në Thesar", e cila sipas pasqyrës se pozicionit financiar F1 të vitit 2024 në mbyllje paraqitet në shumën prej 148,573 lekë dhe rakordon me rubrikën VI "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" të formatit F3 "Pasqyra e flukseve monetare". Vlera e pasqyruar në llogarinë 520 përfaqëson garancinë në masën 5% të mbajtur në vitin 2020 për projektin me kod 18AJ303 për kompaninë P.. UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49, parashikon se Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV nuk disponon akt rakordim të llogarisë 520, në kundërshtim me pikën 50 e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, ku citohet se... Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet).

Klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues", me vlerën 106,414,701 lekë.
Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 11,184,630 lekë nga viti i shkuar 2023. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së materialeve" në Pasqyrën e performancës.
Në përbërje të klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", janë:

- Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 45,922,579 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 980,733lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2024.
- Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 59,351,314 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 10,203,897 lekë.
- Llogaria 34 “Produkte” me vlerë 1,410,808 lekë, e pandryshuar nga viti i shkuar, detajuar si më poshtë vijon:

Llogaria kontabilitetit	Përshkrimi I llogarisë	Njësia	Sasia	Vlera Kontabilitetit
N00036	mbajtëse refrigjerantesh	Cope	2	60
N00060	robot tenxhere	Cope	1	600
N00088	kroxhola platini n 151 18.4521 gr	Cope	1	4,138
A00005	Sterilizator	cope	152	30,400
A00008	Dare kastrimi	cope	3	5,400
A00009	Katgut	cope	148	37,500
A00011	Ganxha hunde	cope	227	11,350
A00012	Mbajtëse gjilpërash	cope	106	106,000
A00014	Maja bisturie	cope	21700	151,900
A00018	Shiringa	cope	388	13,580
A00019	hapëse plagësh	cope	490	73,500
A00020	Hapëse kanalit gjirit	cope	340	17,000
A00027	KATGUT	cope	1740	348,000
A00028	Pinca për fiksim age	cope	377	226,200
A00041	Emuskulator	cope	132	132,000
C00051	RB 51-VAKSINE	doze	1620	14,580
C00081/1	Vaksine Murtaje (Pestivac x 5 ds)	shishe	1200	235,800
B02016/3	Aparat telefoni, KX T053 CID	cope	1	2,800
	Totali			**1,410,808**

Nga auditimi mbi procedurën e inventarizimit të vitit 2024 konstatohet se:
ISUV disponon kartelat e punonjësve për materialet dhe mallrat në ngarkim të stafit. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion, grupi i auditimit konstatoi se për periudhën objekt auditimi, nuk është realizuar procesi i inventarizimit, veprime të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” përbëhet nga:
Llogaria 468 “Debitorë të Ndryshëm”, në vlerë 727,073, e pandryshuar nga viti i kaluar, ku përfshihen kryesisht detyrime të ish – punonjësve ndaj institucionit, e detajuar si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Detyrimi i të tretëve	Viti i krijimit	Vl. fillestare e detyrimit	Likuiduar deri 31.12.2024	Detyrimi i mbetur
1	A. M.	280,463	2015	280,463	0	280,463
2	S. Z.	60,000	2014	60,000	0	60,000
3	V. M.	215,800	2014	215,800	0	215,800
4	B. Sh.	170,810	2018	170,810	0	170,810
	Totali					727,073

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV mban në llogarinë 468 detyrime që ish-punonjësit kanë ndaj institucionit, të cilat datojnë që nga viti 2014. Gjatë kësaj periudhe, ISUV nuk ka ndërmarrë masa ligjore apo administrative për të arkëtuar këto të drejta nga debitorët, në kundërshtim me germat "g" dhe "gj", të nenit 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 13,709,975 lekë shtuar nga viti rritur me 1,005,310 lekë, kjo llogari përfshin pagat e personelit dhe kontributet të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2024.

Aktive Afatgjata.

AAGJ përbëhen nga aktivet afatgjata jomateriale, aktivet afatgjata materiale dhe investimeve të cilat paraqiten në vlerën 1,002,987,905 lekë dhe përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë llogaritë si më poshtë:

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, në shumën 58,482,549 lekë
Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në shumën 246,361,628 lekë
Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në shumën 450,059,341lekë
Llogaria 215 “Mjete transporti” në shumën 4,917,105lekë
Llogaria 217 “Kafshë pune prodhimi” në shumën 174,058 lekë
Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në shumën 18,570,995 lekë
Llogaria 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” në shumën 135,883,244 lekë
Llogaria 230 “Për Aktive Afatgjata jo materiale” në shumën 7,209,985 lekë
Llogaria 231 “Për Aktive Afatgjata materiale” në shumën 81,329,000 lekë

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024 me vlerë totale prej 914,448,920 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 66,505,156 lekë përbëhet nga:

a) Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, në vlerë 58,482,549 lekë, shtuar nga viti i kaluar me 58,482,549 lekë, detajuar si më poshtë vijon:

Llog kontab.	Përshkrimi I llogarisë	Vlera Kontabël.
210001	Toke are Rrashbull	7,319,489
210002	Toke are Rrashbull	7,543,000
210003	Toke are Rrashbull	5,955,000
210004	Zyra e Institutit te mbrojtjes se Bimeve sere me nebulizim	29,473,560
210005	Laboratori I Mbrojtes se Bimeve sere me nebulizim	2,476,500
210006	Sera e vjetër, baza e seres së Holandezit, Baza e seres së italianit, Stacioni meteorologjik	5,715,000
	Totali	**58,482,549**

Pasuritë e mësipërme janë përftuar në vijim të urdhrit nr. 17, dt. 04.05.2020, të MBZHR dhe Rektorit të Universitetit Bujqësor, “Për transferimin kapital të aseteve”. ISUV disponon certitifikatë pronësie për katër pasuri, ndërsa për dy prej tyre nuk është pajisur ende me titullin e pronësisë.

Për sa është trajtuar më sipër në Projekt Raportin e Auditimit nr.506 prot., datë 20.06.2025, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nga përfaqësues të ISUV-it, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur, observacioni për këtë pikë konsiston, citojmë: Sqarojmë se serat me nebulizer dhe sera e vjetër nuk përbëjnë ndërtesa apo objekte me karakter të përhershëm ndërtimor, por janë struktura të përkohshme ose të lehta, të ngritura mbi tokë, të cilat disponojnë certifikatat përkatëse të pronësisë (bashkëngjitur dokumente).
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit të KLSH pas njohjes me dokumentacionin e ri dhe vërtetues, pranon dhe merr në konsideratë observacioni duke e reflektuar në materialin e auditimit.

b) Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 246,361,628 lekë, pakësuar nga viti i kaluar me vlerën 12,966,401 lekë për shkak të amortizimit të aplikuar në masën 5%, detajuar në Aneksin nr.2, tabela nr.2.

c) Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 450,059,341 lekë, pakësuar me vlerën 23,687,334 lekë, për shkak të amortizimit të aplikuar në masën 5%.
d) Llogaria 215 “Mjete transporti”, paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 4,917,105 lekë, pakësuar me vlerën 1,229,276 lekë për shkak të amortizimit të aplikuar në masën 20% në përputhje me UMF Nr.8, datë 09.03.2018. Llogaria “Mjete transporti” paraqitet e detajuar si më poshtë vijon:

Kartela	Përshkrimi	Viti	Njësi	Sasi	Çmim	Vlefta	Nor. amortiz	Amortizim 2024	Amortizim Akum	Vlera e mbetur 2024
b03705	automjet benz vito frigoriferik transp vaksina	2012	copë	1	11,122,848	11,122,848	20%	512,524	9,072,753	2,050,095
b03706/2	hyndai santa fe	2015	copë	1	3,429,468	3,429,468	20%	174,184	2,732,732	696,736
b06260	ford kuga	2015	copë	1	5,000,000	5,000,000	20%	390,349	3,438,605	1,561,395
b01760	ford everest	2021	copë	1	2,054,750	2,054,750	20%	144,216	1,477,884	576,866
d01562	autoveture	2004	copë	1	22,380	22,380	20%	4,401	4,774	17,606
b01078	motociklete tip jaëa 350	1990	copë	1	5,457	5,457	20%	237	4,509	948
b01299	motociklete piagio	1995	copë	1	77,500	77,500	20%	3,365	64,041	13,459
totali					**21,712,403**	**21,712,403**		**1,229,276**	**16,795,298**	**4,917,105**

e) Llogaria 217 “Kafshë pune prodhimi” në vlerë 174,058 lekë, e pandryshuar nga viti i kaluar

Kartela	Përshkrimi	Viti i hyrjes	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta	Amortizim I akumuluar	Vlera e mbetur 2024
D01031	kavie minj	2020	copë	250	456	114,000	0	114,000
B04041	lepuj laboratorik	2020	copë	10	4,500	45,000	0	45,000
B04117	gjel	2020	copë	1	3,500	3,500	0	3,500
B01381	dash	2020	copë	1	11,558	11,558	0	11,558
Totali						174,058	-	174,058

f) Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 18,570,995 lekë dhe krahasuar me vitin paraardhës është pakësuar me shumën 4,642,749 lekë, ku ndikim ka amortizimi i aplikuar në masën 20%.

Nga auditimi konstatohet se:
Në llogaritë kontabël 214 ("Aktive të tjera afatgjata materiale") dhe 218 ("Aktive të tjera afatgjata jomateriale") rezultojnë të mbartura aktive të blera që prej vitit 1996. Nga analiza e të dhënave kontabël rezulton se vlera e mbetur kontabël e këtyre aktiveve është më e vogël se 10% e vlerës fillestare të tyre. Koha e largët e regjistrimit fillestar të këtyre aktiveve dhe vlera e ulët me të cilën ato figurojnë të regjistruara mbart risk në lidhje me gjendjen funksionale dhe vlefshmërinë e tyre ekonomike. Kjo situatë është në kundërshtim me Paragrafin 74 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, i cili parashikon që çdo njësi publike duhet të kontrollojë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerën reale të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale përmes procesit të inventarizimit dhe dokumentacionit mbështetës.
g)Llogaria 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” në vlerë 135,883,244 lekë, e pakësuar me vlerën 23,979,396 nga viti i kaluar. Në këtë llogari është përfshirë vlera e TVSH së projekteve IPA të viteve 2012 dhe 2013.
- ISUV ka debituar në llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata”, TVSH – në e projekteve IPA të viteve 2012 dhe 2013, në vlerën 125,883,224 lekë. Sipas UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, seksioni 2.1 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2", pika "f", llogaria 28 debitohet vetëm në rastet kur një institucion i transferon një aktiv një institucioni tjetër të varësisë ose institucioneve të tjera. Derisa aktivi të jetë në përdorim nga institucioni përfitues, ai regjistrohet si një caktim, ku llogaria 28 shërben si një llogari kalimtare për caktime ndërinstitucionale. ISUV ka klasifikuar TVSH-në e projekteve IPA si një aktiv të caktuar, ndonëse nuk ka dokumentacion mbështetës për të

verifikuar origjinën e kësaj vlere, investimit të cilit i korrespondon dhe nëse ky investim është kryer për llogari të ISUV apo një institucion tjetër, në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022.
- Në vitin 2024, vlera e llogarisë 28 është pakësuar me 23,979,396 lekë për shkak të amortizimit në masën 15%, një trajtim i pasaktë kontabël, pasi llogaria 28 nuk i nënshtrohet procesit të amortizimit. Sipas përcaktimeve të UMFE nr. 5, llogaria 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata" nuk duhet të përfshijë amortizim, pasi ajo funksionon si një llogari kalimtare për transferime ndërinstitucionale të aktiveve. Veprimet e mësipërme tregojnë për një pasqyrim të gabuar të vlerës së aktiveve dhe pasaktësi në hartimin e pasqyrave financiare.
- ISUV disponon regjistër aktivesh i cili nevojitet të plotësohet me disa elemente sikundër parashikohet në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 30 ku citohet se "Formati i regjistrit te aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia".
Llogaria 4 "Investime" me vlerë totale prej 88,538,985 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 82,309,485 lekë përbëhet nga:
Llogaria 230 "Për Aktive Afatgjata jo materiale" në vlerë 7,209,985 lekë, e shtuar me 980,485 nga viti i kaluar. Në këtë llogari përfshihet teprica e grandeve kapitale të mbartura ndër vite në vlerën 6,229,500 lekë dhe projekti për investimin që do të kryhet për rikonstruksionin e objektit në vlerë 980,485 lekë.
Llogaria 231 "Për Aktive Afatgjata materiale" në vlerë 81,329,000 lekë, shtuar nga viti i kaluar me 81,329,000 lekë, ku përfshihet investimi në proces për projektin me kod 24AD701 për blerje të pajisjeve laboratorike.

Pasivi
Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2024, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2024-2023), janë të paraqitura në Aneksin nr.2, tabela nr.3.
Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e ISUV në datën 31.12.2024 kundrejt furnitorëve, punonjësve për pagat e muajit Dhjetor 2024, tatimeve për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorëve të ndryshëm etj., të analizuara si më poshtë:
- Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit", në vlerën 9,382,490 lekë përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2024 të cilat likuidohen në muajin Janar 2025.
- Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa" në vlerën 1,097,150 lekë, shtuar nga viti i kaluar me 105,811 lekë dhe përfaqëson detyrimin për Tatimin në burim të muajit Dhjetor 2024, i cili likuidohet në muajin Janar 2025.
- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 2,829,933 lekë përfaqëson detyrimin për sigurimet shoqërore për muajin Dhjetor 2024 të cilat likuidohen në muajin Janar 2025.
- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 400,402 lekë përfaqëson detyrimin për sigurimet shëndetësore për muajin Dhjetor 2024 të cilat likuidohen në muajin Janar 2025.
- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 148,573 lekë përfaqëson garancinë në masën 5% të mbajtur ndaj kompanisë "P." në vitin 2020, në kuadër të projektit me kod 18AJ303.

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV nuk disponon akt rakordim të llogarisë 466, në kundërshtim me pikën 50 e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, ku citohet se... Tepricat e llogarisë 520

“Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato 37 të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet).
-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në vlerën 727,073, e pandryshuar nga viti i shkuar. Kjo llogari rakordon me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, ku përfshihen kryesisht detyrime të ish – punonjësve ndaj institucionit, e detajuar si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Detyrim të tretëve	Viti krijimit	Vlera fillestare	Lik 31.12.2024	Detyrimi i mbetur
1	A. M.	280,463	2015	280,463	0	280,463
2	S. Z.	60,000	2014	60,000	0	60,000
3	V. M.	215,800	2014	215,800	0	215,800
4	B. Sh.	170,810	2018	170,810	0	170,810
	Totali					**727,073**

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV mban në llogarinë 4341 detyrime që ish-punonjësit kanë ndaj institucionit, të cilat datojnë që nga viti 2014. Gjatë kësaj periudhe, ISUV nuk ka ndërmarrë masa ligjore apo administrative për të arkëtuar këto të drejta nga debitorët, në kundërshtim me germat "g" dhe "gj", të nenit 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

-Llogaritë 101“Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”, në vlerën 896,165,007 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivit të bilancit.
-Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën -11,184,630 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit të cilat do të trashëgohen në vitin 2024. Kjo tepricë debitore përfaqëson rezultatin nga funksionimi që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në ushtrimet e mëpasshme.
-Llogaria 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në shumën 218,192,729lekë përfaqëson përdoret për të evidentuar tepricën e grandeve kapitale të brendshme, të cilat janë fonde të siguruara nga burime të brendshme (buxheti i shtetit) për financimin e projekteve me natyrë kapitale. Llogaria 105 përbëhet nga:

Llogaria	Përshkrimi I llogarisë	Vlera
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	135,883,244
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	980,485
231	Për Aktive Afatgjata materiale	81,329,000
	TOTALI	218,192,729

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV ka debituar në llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata”, TVSH – në e projekteve IPA të viteve 2012 dhe 2013, në vlerën 125,883,224 lekë. Sipas UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, seksioni 2.1 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2", pika "f", llogaria 28 debitohet vetëm në rastet kur një institucion i transferon një aktiv një institucioni tjetër të varësisë ose institucioneve të tjera. Derisa aktivi të jetë në përdorim nga institucioni përfitues, ai regjistrohet si një caktim, ku llogaria 28 shërben si një llogari kalimtare për caktime ndërinstitucionale. ISUV ka klasifikuar TVSH-në e projekteve IPA si një aktiv të caktuar, ndonëse nuk ka dokumentacion mbështetës për të verifikuar origjinën e kësaj vlere, investimit të cilit i korrespondon dhe nëse ky investim është kryer për llogari të ISUV apo një institucion tjetër, në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022. Klasifikimi i gabuar i TVSH-së së projekteve IPA në llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” ka implikime edhe për llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, duke rritur artificialisht vlerën e kësaj llogarie.

-Llogaria 106 “Teprica e grandeve kapitale te huaja” përfaqëson investimet nga organizatat e huaja dhe rakordon me llogarinë 230 Investime për Aktive Afatgjata Materiale.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)
Mbi të ardhurat:
Klasa 7 të ardhurat e ushtrimit paraqiten në Aneksin nr.2, tabela nr.4. Në këtë pasqyrë të ardhurat paraqiten në shumën 415,786,677 lekë, ky total është i rakorduar me “Shpenzime të shfrytëzimit” dhe “Llogaritë Debitore”. Të ardhurat e ISUV janë të karakterit “Grande korrente të brendshme” me vlerë 415,786,677 lekë. Këto të ardhura përfaqësohen nga:
- Llogaria 7200 “Nga buxheti për NjQPQ” për vlerën 402,076,702 lekë, shtuar nga viti shtuar me 107,126,448 lekë, përfaqëson financimin me grande nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit.
- Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga Buxheti” me vlerë prej 13,709,975 lekë, shtuar gjatë këtij viti me 1,005,310 lekë dhe përfaqëson të drejta e njësisë në marrëdhënie me shtetin. Rakorduar me kundërpartinë, llogarinë 4342 “Operacione me shtetin”.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).
Konkretisht për vitin 2024 paraqiten si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi	Vlera (në lekë)
i	Të ardhurat (Grupi A, pasqyra F2)	415,786,677
ii	Shpenzimet (Grupi B, kolona 74 e pasqyrës F2)	426,971,307
iii	Rezultati i ushtrimit (llogaria 85)	-11,184,630
	Totali (ii + iii)	**415,786,677**

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2024 me shkresën pa nr. prot., datë 31.01.2025, nënshkruar nga specialist i financës znj. D. Sh., i ngarkuari me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm znj. J. B., Specialiste e degës së të ardhurave znj. Almira Basha. Të ardhurat nga veprimtaria e ISUV, krijohen nga pagesat e kryera nga subjektet privatë për analizat e llojit “autokontroll”, në përputhje me ligjin nr.10465, datë 29.09.2011“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” neni 37, pika 2 dhe neni 44, pika 2.
Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.6.2006 “Mbi të ardhurat në institucionet buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.
Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit 2024 janë 3,740,990 lekë, nga të cilat janë derdhur në buxhet 3,740,990 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 0 lekë.

Kod. Ins	Klasa	Përshkrimi	Mujore	Progresive	Pjesëm. e ISUV	Rritje e Autoriz	Derdhur në Buxhet	Të trashëg. për Vitin pasardhës
1005111	7111005	Analiza Kimike dhe biologjike	330,836	3,453,000			3,453,000	0
1005111	7111099	Analiza Kimike dhe biologjike	0	500			500	0
1005111	7111021	Analiza Kimike dhe biologjike	0	1,000			1,000	
1005111	71113099	Analiza Kimike dhe biologjike	12,190	16,490			16,490	
		T O T A L I	343,026	3,470,990			3,470,990	0

Burimi: ISUV

Mbi shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2024. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj Dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2024 në bilancin kontabël, dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2023.

Në pasqyrën e shpenzimeve të periudhës ushtrimore, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 11,184,630 lekë, të ndara sipas zërave si:

-Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në shumën prej 136,629,695 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe te përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatim Taksave.

-Llogaria 601 "Kontribute të Sigurimeve" në shumën prej 22,416,954 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve.

-Llogaria 602 "Blerje mallra e shërbime" në shumën prej 255,878,090 lekë, përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve e cila përbëhet nga:

Llogaria 6020 "Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme" për 20,152,667 lekë cila paraqet shpenzimet që institucionet ka kryer për shërbime utilitare dhe blerje materiale të përgjithshme gjatë vitit 2024.

Në këtë llogari gjejmë të kontabilizuara si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i Shpenzimit	Total Vlera në lekë
1	Shpenzime Uji	757,272
2	Energjia Elektrike	16,215,662
3	Posta	39,975
4	Numri Jeshil (AKEP)	25,000
5	Blerje Standarde ISO	76,362
6	Servis Kamera Isuv	118,800
7	Sigurimi I shëndetit ne pune	555,000
8	sigurimi I ndërtesës	987,000
9	blerje bateri UPS	65,600
10	blerje toner	360,000
11	blerje materiale pastrimi	745,800
12	Blerje materiale elektrike	108,396
13	Fikse zjarri	97,800
	Total	20,152,667

Llogaria 6021 "Materiale dhe shërbime speciale" për 93,330,575 lekë përbëhet nga shpenzime të kryera për blerjet e detajuara më poshtë:

Nr.	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
1	Blerje Gaz Instrumental	5,146,560
2	Blerje Akull I thate	1,001,082
3	Blerje ene laboratorike	3,339,252
4	Shërbim servis kalibrim	41,493,600
5	Blerje reagent	12,134,904
6	Blerje teste Proficense	794,536
7	Blerje Standarde	1,019,448
8	Blerje Kite	8,885,971
9	Blerje terrene dhe suplemente	2,591,664
10	Blerje baze materiale laboratorike dëmtuesit e bimëve	1,441,063
11	Shërbimi mirëmbajtje aparatura bertini	1,186,800
12	Riparimi i tarracës se DSHK dhe riparimi I serologjigje	3,396,101
13	Grumbullim transportim mbetjes laboratorike	10,851,654
14	Blerje Ushqim për kafshët	47,940
	Total	93,330,575

Llogaria 6022 "Shërbime nga të tretë" për 124,091,433 lekë e detajuar si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
1	Analiza konfermatore	102,250,438
2	Roje private	16,435,097
3	Shërbim këshilltare Ligjor	2,961,863
4	Tarifa Akreditimi	382,000
5	Transport analiza konfermatore	1,958,235
6	mirëmbajtje programi financa 5	103,800
	Total	124,091,433

Llogaria 6023 "Shpenzime transporti" në shumën 1,364,728lekë përbëhet nga shpenzime për karburant, bileta avioni, dhe taksat e detyrueshme për automjetet në pronësi të subjektit, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
1	Taksa mjete ISUV	151,273
2	blerje karburanti	1,104,500
3	Bileta Avioni	108,955
	Total	1,364,728

Llogaria 6024 "Shpenzime udhëtimi" në shumën 163,112 lekë përfshin shpenzimet për dietat jashtë vendit. Llogaria 6025 "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" në shumën 4,451,200lekë përfaqëson shpenzime për shërbime mirëmbajtje si më poshtë vijon:

Nr	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
1	Mirëmbajtje ashensori	922,000
2	Shërbimi interneti	540,000
3	Shërbim Mirëmbajtje Cillera DshK	1,052,400
4	Mirëmbajtje materiale frigoriferike	880,800
5	Kontrolli I mjeteve matëse	1,056,000
	Total	4,451,200

Llogaria 6027 "Shpenzime për detyrime për kompensime legale" në shumën 6,106,437 lekë përfaqësojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për një ish – punonjës në vlerën 5,593,617 lekë. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga ISUV, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat duke paguar tarifa përmbarimore, në vlerë totale prej 512,820 lekë. Llogaria 6029 "Shpenzime të tjera operative" ne shumën 6,217,938lekë, e detajuar si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
1	Tatim ne burim	582,683
2	taksa bashkie	2,726,118
3	oponence teknike	104,945
4	Vlerësim Qëndrueshmërie Objekti	600,000
5	OBP kryerje procedure prokurimi	2,204,192
	Total	6,217,938

Llogaria 6061 "Transferta të paguara nga Inst. tjera e Org. Pusht. Vendor" në shumën prej 861,938 lekë përfaqëson:

Nr.	Përshkrimi I Shpenzimit	Total Vlera e paguar ne lek
6060005	Shpërblim për dalje ne pension	51,938
6060021	Shpërblim për arsye Mjekësorë	105,000

6061003	Shpërblim për Ndihme Financiare	705,000
	Total	861,938

-Llogaria (63) "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën 11,184,630 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 "transferim për ndryshim gjendje inventari" në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.
Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 janë si në Aneksin nr.2, tabela nr.5.
Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me Akt Rakordimin e shpenzimeve me thesarin pa nr. prot., datë 31.01.2025, ku u konstatuan diferencat si më poshtë vijon:

LLog	Shpenzimet e ushtrimit	PF	Rak. Me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	415,081,677	387,535,126	27,546,551
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	136,629,695	135,746,716	882,979
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	22,416,954	22,276,623	140,331
602	Mallra dhe shërbime te tjera	255,878,090	228,649,849	27,228,241
606	Transferta për buxh. familjare e individë	861,938	861,938	0

-Diferenca prej 882,979 lekë në llogarinë 600 "Paga, shpërblime e të tjera personeli", përfaqëson diferencën ndërmjet pagave të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në Janar 2024 me pagat e muajit Dhjetor 2024, të cilat paguhen në Janar 2025.
-Diferenca prej 140,331lekë në llogarinë 601 "Kontribute sigurim shoqëror dhe shëndetësor", përfaqëson diferencën ndërmjet sigurimeve të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në Janar 2024 me sigurimet e muajit Dhjetor 2024, të cilat paguhen në Janar 2025.
-Diferenca prej 27,228,241 lekë në llogarinë 602 "Mallra dhe shërbime të tjera", janë detyrime për mallra dhe shërbime të muajit Dhjetor 2024, të cilat paguhen në Janar 2025.
Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2024:
-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 1 "Pasqyra e pozicionit"
-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 1,123,988,227 lekë në vitin 2024;
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të Formatit nr. 2 "Pasqyra e performancës"
Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 415,786,677 lekë (426,971,307+ (-11,184,630)). Pra totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 2), në shumën 415,786,677 lekë;
- Llogaria 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr.2, për -11,184,630 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 "Gjendja e inventarit" në aktivin e bilancit.
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 3 "Pasqyra e cash flow" kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto" kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 1,109,402,606 lekë.
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.5 "Shënimet shpjeguese", japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);
informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë, etj.);
informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
informacion në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.
Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë
Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.
-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.6 "Investimet dhe Burimet e financimit". Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për ISUV është 135,883,244
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje për sa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)", jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pikësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.
Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin për 914,448,920 lekë (Kosto Historike 1,477,779,317 lekë – AA 563,330,397 lekë)
Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.8 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave", siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjate vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.
Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.
Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarive.

Me veprimet apo mosveprimet brenda periudhës së ushtrimit të detyrës së titullarit të institucionit të ISUV, duke mos siguruar dhe ngritur një sistem efektiv të raportimit financiar, ngarkohen me përgjegjësi z. A. R., z. P. A., z. I. A dhe znj. J. B., dhe njëkohësisht nëpunësi zbatues znj. D. Sh. në cilësinë e Pergjegjëses së Financës.

2.4. Mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2024, nga ISUV, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve publike, janë kryer gjithsej 83 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 509,375,515 lekë dhe vlerë të kontratave të lidhura në shumën 398,813,116 lekë pa TVSh, me diference nga fondi limit në shumën 110,562,399 leke pa TVSH.

Sipas llojit të procedurave dhe natyrës, procedurat e prokurimit të realizuar pasqyrohen më poshtë:

Viti	Lloji i Procedurës	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kont. (pa TVSH)	Dif.
2022	Procedurë e hapur	3	80,771,000	49,712,433	31,058,567
2022	Procedurë e hapur e thjeshtuar	3	5,878,153	4,726,910	1,151,243
2022	Blerje e vogël	14	10,336,693.00	8,622,235.00	1,714,458
Shuma 1		**20**	**96,985,846**	**63,061,578**	**33,924,268**
2023	Procedurë e hapur	4	82,693,904	52,152,600	30,541,304
2023	Procedurë e hapur e thjeshtuar	4	14,781,162	13,877,349	903,813
2023	Procedurë e hapur ndërkombëtare	1	40,589,000	17,950,000	22,639,000
2023	Blerje e vogël	23	14,304,710	13,630,109	674,601
Shuma 2		**32**	**152,368,776**	**97,610,058**	**54,758,718**
2024	Procedurë e hapur	2	49,843,920	39,731,176	10,112,744
2024	Procedurë e hapur e thjeshtuar	6	31,125,488	27,439,269	3,686,219
2024	Procedurë e hapur ndërk.	1	162,819,000	157,780,000	5,039,000
2024	Blerje e vogël	22	16,232,485	13,191,035.00	3,041,450
Shuma 3		**31**	**260,020,893**	**238,141,480**	**21,879,413**
Total		**83**	**509,375,515**	**398,813,116**	**110,562,399**

Grupi i auditimit të KLSH, ka audituar 18 procedura prokurimi për periudhën objekt auditimi, me fond limit në total prej 426,841,848 lekësh dhe vlerë të kontratave të realizuara prej 305,328,588 lekësh, pa TVSH.

Procedurat e përzgjedhura për auditim, paraqitur në tabelën më poshtë.

Viti	nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Proc. Prok.	Vlera e kont. pa tvsh	OE fitues
2022	1	Implementimi i planit kombëtar te molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes	27,300,500	Open Local	14,774,100	K.
	2	Blerje pajisje për ngritjen dhe funksionimin e laboratorëve te mbrojtjes dhe shendetit te bimëve	23,500,500	Open Local	11,483,333	M.
	3	Shërbim, riparim servis kalibrimi	29,970,000	Open Local	23,455,000	P., G., K.
	4	Sherbim, riparim krematoriumi	800,000	Small Value	780,000	H.-G. C.
	5	Blerje kite emergjence	1,000,000	Small Value	740,000	K.
2023	6	Blerje ene laboratorike	20,696,138	E Hapur	10,300,000	K.
	7	Blerje standarte dhe materiale reference	10,657,826	E Hapur	5,964,600	A.
	8	Mobilim, arredim dhe venie ne funksion te salles se koferencave dhe zyrave te administrates	6,625,000	E hapur e Thjeshtuar	6,500,000	R.

	9	Sherbim, riparim, blerje pjese kembimi per aparaturat	35,339,090	E Hapur	26,438,000	P.
	10	Blerje pajisje per fuqezimin e laboratoreve diagnostik te shendetit te kafsheve dhe rritja e kapacitetit analitik te tyre	40,589,000	E Hapur mbi kufirin e larte monetar	17,950,000	P.
	11	Sherbim, servis krematoriumi	958,000	Blerje vogel	917,000	C.
2024	12	Fuqezimi i kapaciteteve laboratorike te ISUV ne te tre fushat ku ushtron aktivitettin e vet analitik, siguri ushqimore, shendet kafshesh dhe bimesh	162,819,000	Open INT	131,483,333	B. Albania
	13	Sherbim, riparim servis kalibrimi	38,677,020	Open Local	31,356,000	P.
	14	Grumbullim, transportim dhe asgjesim mbetjesh laboratorike	9,047,682	Open Simple	9,043,045	G. C.
	15	Blerje kite	11,166,900	Open Local	8,375,176	K.
	16	Blerje baze materiale laboratorike per demtuesit e bimeve	5,695,192	Open Simple	3,900,000	G.
	17	Sherbim, riparim, servis kalibrimi per aparaturat Bertin	1,000,000	Small Value	989,000	I.
	18	Kontrolli i mjeteve matese	1,000,000	Small Value	880,000	A.
Total	**18**		**426,841,848**		**305,328,588**	

Në vijim, paraqiten në mënyrë të detajuar procedurat e përzgjedhura për auditim, së bashku me gjetjet e konstatuara gjatë procesit të auditimit.
Përzgjedhja e këtyre procedurave është bërë mbi bazën e vlerësimit të riskut, vlerës së kontratës, rëndësisë së objektit të prokurimit për funksionimin e institucionit, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me pajtueshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Për secilën procedurë të auditimit janë shqyrtuar dokumentet përkatëse, përputhshmëria me kuadrin ligjor të zbatueshëm në fushën e prokurimeve publike, planifikimi dhe afatet, zbatimi i procedurës së prokurimit sipas llojit të saj, respektimi i kritereve të vlerësimit, zbatimi kontratës si dhe mënyra e administrimit dhe arkivimit të dokumentacionit.
Gjetjet janë paraqitur në mënyrë analitike për secilën procedurë të audituar dhe përfshijnë vlerësime mbi aspektet e pajtueshmërisë ligjore, menaxhimit të riskut, dhe përdorimit të fondeve publike në mënyrë efikase dhe transparente.

2.4.1. Procedura e prokurimit "Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve"

1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Proçedurë e hapur, e thjeshtuar, REF-16539-08-19-2024 Urdher prokurimi nr. 292/9 prot., date 14.08.2024	2.Hartimi i specifikimeve teknike dhe fondit limit: Urdhër Nr. 176/1, datë 27.02.2024 J. B., V. V., M. K., E. M., D. Sh.	**3**. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 292/9 prot, datë 14.08.2024 A. I. B. Q. U. R.	**4**. Komisioni i Vlerësimit Ofertave. Urdhri nr. 292/10 prot, datë 14.08.2024 F. H. S. B. S. Dh.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,695,192 lekë	**6**. Oferta fituese (pa TVSh) OE G. 3,900,000 lekë		7. Dif. me fondin limit 1,795,192 (pa TVSh)

8/1 Data e publikimit të tenderit: 20.08.2024 Data e pranimit te ofertave: 30.08.2024 ora 12:00	**9**. Burimi Financimit Fondet e Buxheti i Shtetit	**12**. OE a) Pjesëmarrës në tender 3 OE; 1. OE G.. 2. OE K. 3. OE M. b.Skualifikur: 1 OE M.
8/2 Kohëzgjatja e kontratës 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.	**11.** Ankimim: Jo	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit		
13. Lidhja e kontratës: Kontrata me G. me Nr. 292/18 Prot., datë 23.09.2024	**14**.Zbatimi i kontratës: Me urdhër nr. 292/19 prot, datë 15.10.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës: S. K., M. L., Sh. R., Zh. H., L. Z.	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e Fondit Limit

Me urdhrin e brendshëm nr. 176/1 prot., datë 27.02.2024, të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. I. A, është ngritur Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe për përllogaritjen e fondit limit, i përbërë nga znj. J. B., znj. M. K., znj. E. M., znj. V. V. dhe znj. D. Sh., për disa procedura prokurimi të planifikuara për t'u zhvilluar gjatë vitit 2024, përfshirë edhe procedurën me objekt: "Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve".

Në pikën 4 të urdhrit të sipërcituar është përcaktuar:

"Pasi ofertat janë paraqitur nga operatori ekonomik te njësia e prokurimit, kjo e fundit ia përcjell me një memo Komisionit për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjen e fondit limit."

Nëpërmjet memo-s së datës 07.03.2024, të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme (znj. B. C.) dhe përgjegjëses së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë/Protokollit (znj. A. I.), drejtuar Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, është paraqitur bashkëlidhur tabela përkatëse për këtë objekt auditimi, ku pasqyrohet vetëm vlera totale e ofertave nga operatorët ekonomikë: "K.", në shumën 25.667.300 lekë pa TVSH, dhe "I." sh.p.k., në shumën 22.120.135 lekë pa TVSH.

Nga Auditimi konstatohet se:

Komisioni i sipërcituar, nëpërmjet procesverbalit (pa nr. prot.), datë 13.03.2024, ka përcaktuar fondin limit në shumën 5.695.192 lekë pa TVSH.

Në këtë dokument nuk janë pasqyruar sasia dhe specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për secilin artikull, por thjesht është përcaktuar një shumë totale, pa përfshirë metodologjinë e përdorur për përllogaritjen e fondit limit.

Gjithashtu, rezulton se ofertat e pretenduara, të dërguara nëpërmjet postës elektronike, por pa listën e artikujve përkatëse të bashkëlidhura, të cilat janë përfshirë në dosjen e prokurimit për këtë objekt auditimi, nuk i përkasin kësaj procedure, por i referohen një procedure tjetër prokurimi me objekt: "Blerje reagentësh". Njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit bazuar në specifikime teknike, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se:

Neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës "vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme".

Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:

- Titullari i AK I. A për parregullsitë e konstatuara në veprimet e strukturave të ISUV në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në nenin 21, pika 5 të LPP, i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të RPP
- J. B., V. V., E. M., M. K., D. Sh., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit, duke mos garantuar ndjekjen e një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet;
- A. I., për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Me Urdhrin nr. 292/10 Prot., datë 14.08.2024, Titullari i Autoritetit Kontraktor z. I. A ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), i cili përbëhej nga znj. F. H. Kryetare e Komisionit, znj. S. B.– Anëtare dhe znj. S. Dh.– Anëtare.

-Me procesverbal pa nr prot, datë 30.08.2024 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku morën pjesë 3 OE si më poshtë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera e Ofertës pa TVSH	Kualifikohet/S'kualifikohet
1.	O.E "G." sh.p.k	3,900,000	Kualifikohet
2.	O.E "K." sh.p.k	4,271,194	Kualifikohet
3.	O.E "M." sh.p.k	4,541,568	Skualifikohet

Me proces-verbal Nr. 3 pa nr. Prot., datë 09.09.2024, O.E "G." shpk është shpallur fituese si oferta më e ulët, në shumën 3,900,000 lekë pa TVSh.

O.E "M." shpk është skualifikuar pasi nuk plotëson kriteret ligjore të kërkuara nga AK në DST: AK ISUV, për plotësimin e kriterit për kapacitetin ekonomik dhe financiar, ka kërkuar:

Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve 2021, 2022, 2023 të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivit dhe pasivit. (me firmë dhe vulë nga ky institucion).

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se, mungon bilanci i vitit 2023.

-Në ofertën teknike mungon "Nr. i faqes ku ndodhet produkti, C.tifikimet përkatëse për produktet. Emërtimi i katalogut të artikullit/ produktit "

-Nuk deklarohet" Origjina e mallit"

-Kapaciteti teknik është specifikuar se: Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (mos markimi me ngjyrë të ndezur do të jetë kusht skualifikimi). Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se, ky OE nuk ka markuar specifikimet dhe artikujt.

Raporti përfundimtar nga anëtarët e KVO është hartuar me Nr. 292/15 Prot., datë 17.09.2024.

Me shkresë Nr. 292/12 Prot., datë 12.09.2024 është marrë në dorëzim nga protokolli i ISUV dokumentacioni i shkruar i OE G..

Nga auditimi konstatohet se:

OE "G." shpk, nuk ka dorëzuar vërtetim për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqëror por ka dorëzuar vetëm vërtetimin për pagimin e taksave dhe tatimeve në dokumentacionin e dorëzuar me shkresën nr. 292/12 Prot., datë 12.09.2024

Për sa me sipër KVO, nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DT siç janë Kriteret detyruese, *Veprim në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020,"Për prokurimin publik"Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 2 citon: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, Neni 92 Shqyrtimi i ofertave pika 3 citon: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika 2 germa dh citon: operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së dhe Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Për sa me lart, për veprimet apo mos veprimet mbi zbatimin e LPP dhe aktet nënligjore në fushën e prokurimeve publike ngarkohen me përgjegjësi: F. H., S. B.dhe S. Dh.në cilësinë e anëtarëve të KVO.

-Lidhja e kontratës.
Kontrata midis AK dhe OE "G." shpk, është me Nr. 292/18 Prot.,datë 23.09.2024 dhe afati për shërbimin është 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Me shkresë nr. 292/20 prot datë 15.10.2024 është hartuar plani i zbatimit të kontratës.
-Zbatimi i kontratës.
Me urdhrin Nr. 292/19 prot, datë 15.10.2024, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përbërë nga: S. K., M. L., Sh. R., Zh. H.dhe L. Z.

Nga auditimi konstatohet se:
1. Komisioni i marrjes në dorëzim, në zbatim të kontratës dhe planit të zbatimit të saj, përmes procesverbalit pa nr. prot., datë 30.10.2024, ka konstatuar se artikulli me nr. rendor 144 në ofertën e kontraktuesit "G.", me përshkrimin "Antigjen RB për Brucelozë" dhe me specifikimin teknik "Antigjen për testin e aglutinimit të shpejtë", paketim 10 ml për sasinë 5 shishe, është dorëzuar në paketim 5 ml dhe në sasi 5 shishe, sipas aktit të dorëzimit të datës 23.09.2024. Ky akt është nënshkruar nga A. I. dhe A. D., persona të paautorizuar për marrjen në dorëzim, në kundërshtim me urdhrin nr. 292/19 prot., datë 15.10.2024 të Titullarit të AK ISUV.
Nga sa më sipër, rezulton se ky artikull është marrë në dorëzim nga persona të paautorizuar rreth 37 ditë përpara se të verifikohej dhe të merrej zyrtarisht në dorëzim nga komisioni përkatës, i ngritur në zbatim të urdhrit të titullarit të institucionit.
Në lidhje me këtë konstatim të komisionit të marrjes në dorëzim dhe kolaudimit, i pasqyruar në procesverbalin e datës 30.10.2024, për plotësimin e sasisë së munguar prej 25 ml të "Antigjenit për testin e aglutinimit të shpejtë", kontraktuesi ka dorëzuar, më datë 06.11.2024, reagentin "Antigjen për testin e aglutinimit të shpejtë" me paketim 10 ml në sasinë 3 shishe, duke përmbushur kështu sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor sipas specifikimeve në Dokumentet e Tenderit.
Sasia totale për "Antigjenin për testin e aglutinimit të shpejtë", në paketim 10 ml, në total 5 copë (50 ml), është regjistruar në magazinë me fletëhyrjen nr. 85, datë 06.11.2024.
Për sa është konstatuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. A. I. dhe znj. A. D., të cilat kanë marrë në dorëzim pa u bërë hyrje në magazine një pjesë të mallit të dorëzuar nga kontraktuesi, sipas akt-dorëzimit të datës 23.09.2024, duke vepruar në mospërputhje me urdhrin e brendshëm nr. 292/19 prot., datë 15.10.2024.
Me urdhrin e shpenzimeve nr. 367, datë 23.12.2024, është kryer pagesa për kontraktuesin "G." në shumën 30,000 lekë, sipas faturës tatimore nr. 328/2024, datë 31.10.2024.
2. Komisioni i marrjes në dorëzim, në zbatim të kontratës dhe planit të zbatimit të saj, përmes procesverbalit pa nr. prot., datë 20.11.2024, ka kryer verifikimin e 54 artikujve, të dorëzuar nga kontraktuesi "G.", sipas aktit të dorëzimit të po kësaj date.
Referuar procesverbalit të anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, konstatohet se 16 artikuj specifikë – me numër rendor 5, 7, 95, 97, 104, 106, 114, 116, 122, 124, 125, 127, 132, 134, 135 dhe 137 – pjesë e aktit të dorëzimit të kontraktuesit "G.", nuk janë pranuar, pasi nuk përmbushnin specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST). Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se edhe në aktin e dorëzimit të kontraktuesit "G." është bërë shënimi për mospranimin e këtyre 16 artikujve, për shkak të mospërputhjes me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, sipas DST., 38 artikujt e pranuar, që plotësonin kriteret teknike të AK, janë administruar nga AK ISU përmes fletëhyrjes nr. 91, datë 20.11.2024.
Me urdhrin e shpenzimeve nr. 367, datë 23.12.2024, është kryer pagesa vetëm për 38 artikujt e pranuar për kontraktuesin "G." në shumën 435,816 lekë, sipas faturës tatimore nr. 362/2024, datë 20.11.2024.
3. Komisioni i marrjes në dorëzim, në zbatim të kontratës dhe planit të zbatimit të saj, përmes procesverbalit pa nr. prot., datë 11.12.2024, ka kryer verifikimin e 34 artikujve, të dorëzuar nga kontraktuesi "G.", sipas aktit të dorëzimit të po kësaj date. Referuar procesverbalit të anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, konstatohet se 6 artikuj specifikë – me numër rendor 28, 95, 97,

104, 106 dhe 125 – pjesë e aktit të dorëzimit të kontraktuesit "G.", nuk janë pranuar, pasi nuk përmbushnin specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST).
Artikujt e kthyer, të pasqyruar në procesverbalin e datës 11.12.2024, përveç artikullit me nr. rendor 28, janë artikuj që janë kthyer për të njëjtën arsye, nga komisioni i marrjes në dorëzim, sipas procesverbalit të datës 20.11.2024.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se edhe në aktin e dorëzimit të kontraktuesit "G." është bërë shënimi për mospranimin e këtyre 6 artikujve, për shkak të mospërputhjes me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, sipas DST.28 artikujt e pranuar, që plotësonin kriteret teknike të AK, janë administruar nga AK ISU përmes fletëhyrjes nr. 96, datë 11.12.2024.Me urdhrin e shpenzimeve nr. 384, datë 26.12.2024, është kryer pagesa për kontraktuesin "G." në shumën 733,056 lekë, sipas faturës tatimore nr. 380/2024, datë 11.12.2024.
4. Komisioni i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të artikujve, lidhur me zbatimin e kontratës Nr. 292/18 Prot., datë 23.09.2024, në asnjë rast, në procesverbalet e mbajtura për sasitë pjesore të dorëzuara nga kontraktuesi "G." sh.p.k., nuk ka evidentuar datën e skadencës së produkteve apo afatin e përdorimit të tyre, siç është përcaktuar në Dokumentet e Tenderit[10], gjithashtu komisioni i marrjes në dorëzim ka përcaktuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit.
Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar, dhe se datat e skadencës dhe/ose afatet e përdorimit kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe ofertën e pranuar, sa i përket afateve të skadencës dhe origjinës së produkteve.
Anëtareët e komisionit të marrjes në dorëzim kanë vepruar në mospërputhje me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 dhe kontratën Nr. 292/18 Prot., datë 23.09.2024, nenin 4. Si dhe Rekomandimi i APP nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandimi mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit të zbatimit të kontratave të nënshkruara në përfundim të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime"
Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:
S. K., M. L., Sh. R., Zh. H. dhe L. Z. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Referuar Urdhrit të Shpenzimeve nr. 367, datë 23.12.2024, pagesa e kryer për kontraktuesin është në shumën 708,007 lekë, ndërsa sipas Urdhrit të Shpenzimeve nr. 384, datë 26.12.2024, është kryer pagesa në shumën 733,056 lekë. Në total, për kontraktuesin janë realizuar pagesa në vlerën 1,441,063 lekë, e cila përfaqëson 30% të vlerës së kontratës prej 4,680,000 lekësh, për furnizimet brenda afatit 12-mujor të kontratës deri më datë 23.09.2025.

2.4.2. Procedura e prokurimit "*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*" me objekt "*LOTI I – Inkubator për rritjen e Mykobacterieve*", me afat 90 ditë nga nënshkrimi i kontratës, nr. REF-67916-05-02-2023, me fond limit 18,000,000 lekë pa TVSH

Procedura e prokurimit "Loti I – Inkubator për rritjen e Mykobacterieve"		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 302 prot., 02.05.2023	3. **Përll. e FL dhe specif. Teknike** Urdhër nr. 261/1 prot., datë 14.04.2023 - J. B. - V. V. - E. M. - D. T. - D. Sh. **Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit** Urdhër nr. 1 prot., 02.05.2023	4. **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 302/3 prot., 10.05.2023 - A. V. - E. Sh. - B. Q.
2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"		

[10] Koha e përdorimit për kite dhe reagent në DST, nga ISUV kërkohet të jetë jo me pak se 2/3 e afatit të skadences

	- A. I. - A. D. - A. L.	
5. **Fondi Limit (pa TVSH)** 18,000,000 lekë	6. **Oferta fituese (pa TVSH)** 17,950,000 lekë	7. **Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 50,000 lekë (0.27%)
8. **Data e hapjes së tenderit** 03.05.2023	9. **Burimi i financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatorët Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE
11. **Ankimime** AK: - KPP: -		
12. **Lidhja e kontratës** (MK) Nr. 302/7 prot., 29.06.2023	13. **Vlera e kontratës** 21,540,000 lekë me TVSH	14. **Afati i kontratës në ditë** 90 ditë

Nëpërmjet shkresës së datës 05.01.2024, e paprotokolluar, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkiv Protokoll kanë dërguar kërkesën për përcaktimin e nevojave në lidhje me fuqizimin e kapaciteteve laboratorike të ISUV, drejtuar Përgjegjësit të Departamentit të Shëndetit të Kafshëve, Përgjegjësit të Departamentit të Shëndetit të Bimëve, Përgjegjësit të Departamentit të Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë. Nga korrespondenca elektronike e vënë në dispozicion, u konstatua se specifikimet teknike janë dërguar nga J. B. drejt personit përgjegjës për prokurimin A. I., për të iniciuar kontaktimin e operatorëve për studimin e tregut. Personi i angazhuar me studimin e tregut A. I. nuk rezulton të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit, pavarësisht se është zyrtar i përfshirë në procedurën e prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 13, pika 5, të RPP.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 261/1 prot., datë 14.04.2023, Titullari i AK P. A. ka ngritur Komisionin për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga J. B., V. V., E. M., D. T., D. Sh.. Ky komision nuk ka në përbërje specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalente). Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se "*pasi ofertat janë paraqitur nga OE te njësia e prokurimit, kjo e fundit ia përcjell me memo komisionit për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjen e fondit limit*".

Nëpërmjet memo-s nr. 261/2 prot., datë 21.04.2023, A. I. personi përgjegjës për prokurimin ka dërguar 1 ofertë të paraqitur sa i përket Lotit I – Inkubatori, drejtuar Komisionit të sipërcituar, të OE "P.", i paprotokolluar, me ofertë ekonomike 18,000,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet PV të datës 26.04.2023, Komisioni ka përllogaritur fondin limit, bazuar në ofertën e paraqitur nga OE "P.", në vlerën prej 18,000,000 lekë pa TVSH. PV është nënshkruar nga J. B., E. K., V. V., E. M. dhe D. Sh.. Përbërja e tij nuk është e njëjtë me komisionin e ngritur në Urdhrin nr. 261/1 prot., datë 14.04.2024. Ky komision nuk shprehet mbi specifikimet teknike të pajisjeve, pra këto specifikime teknike, pavarësisht se është ngritur komision i posaçëm për hartimin e tyre, nuk rezulton të jenë hartuar nga ky komision. Specifikimet teknike nuk rezulton të jenë argumentuar teknikisht. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.

Pavarësisht se janë zyrtarë të përfshirë në procedurën e prokurimit, anëtarët e komisionit dhe hartuesi i specifikimeve teknike (nëse nuk është pjesë e komisionit) nuk rezulton të ketë nënshkruar Deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenin 73, pika 4 të RPP.

Nëpërmjet veprimeve të mësipërme, njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës **vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme**.

Titullari i AK P. A. ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 302 prot., datë 02.05.2023, duke përcaktuar njësinë e prokurimit të përbërë nga A. I., A. L., A. D.. Njësia nuk ka në përbërje specialist të fushës. Njësia e prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin e fondit limit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, ku janë përcaktuar ndër të tjera kriteret për

kualifikim, si dhe specifikimet teknike të pajisjes inkubator (pa argumentuar specifikimet teknike edhe në këtë rast).
Në datën 02.05.2023, njësia e prokurimit ka ngarkuar DST dhe Procesverbalin e argumentimit të kritereve teknike në SPE dhe në datën 03.05.2023 është publikuar procedura e prokurimit në SPE. Sipas DST të ngarkuar në SPE, afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është data 07.06.2023, ora 12:00. Në datën 09.05.2023, njësia e prokurimit ka ngarkuar në SPE "*Shtojcën nr. 1 Ndryshim kriteresh pajisjet*" në gjuhën shqip dhe anglisht.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 302/3 prot., datë 10.05.2023, Titullari i AK P. A. ka krijuar KVO, të përbërë nga A. V., E. Sh., B. Q.. KVO nuk ka në përbërje specialist të fushës. Nëpërmjet PV të datës 07.06.2023 dhe PV nr. 3, datë 07.06.2023, të paprotokolluar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka dokumentuar hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave sa i përket Lot-it I, ku u konstatua, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Statusi
1	P.	17,950,000	Kualifikuar
2	A.	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar

Në përfundim të procedurës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk rezulton të ketë hartuar Raportin përmbledhës, për miratim nga titullari i AK, në kundërshtim me nenin 84 të RPP.
Ndërmjet AK dhe OE "P." është lidhur kontrata nr. 302/7 prot., datë 29.06.2023, me vlerë ekonomike 17,950,000 lekë pa TVSH ose 21,540,000 lekë me TVSH, me afat 90 ditë nga nënshkrimi i kontratës, si dhe plani i zbatimit të kontratës nr. 302/8 prot., datë 30.06.2023.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 104 prot., datë 10.08.2023, Titullari i AK I. A ka ngritur Komisionin për marrje në dorëzim të pajisjes, të përbërë nga J. B., A. T., V. K., Zh. H. Ky komision ka dokumentuar marrjen në dorëzim të inkubatorit nëpërmjet PV të datës 12.09.2023, duke administruar edhe dokumentacionin shoqërues të pajisjes, raport shërbimet dhe listë-verifikimet e instalimit të pajisjes.
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 187, datë 23.10.2023**, në vlerën totale prej **21,540,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 3668/2023, datë 11.09.2023, duke bashkëlidhur Situacionin e nënshkruar nga përfaqësues të OE dhe ISUV, me përshkrimin e artikujve të marrë në dorëzim, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia
1	Inkubator për rritjen e Mikobaktereve	1	Copë
2	Suplementet e rritjes që përmban Polymyxin B, Trimethoprim, Amphotericin B, Azlocillin, Nalidixic acid, 100 test	1	Kuti
3	Kit me reagent për dekontaminimin dhe procesimin/ tretjen e mostrave mykobakteriale 10x 150ml	1	Kuti
4	Tuba 7ml me terren të modifikuar Middlebrook 7H9 Broth bazë, 100 copë	1	Kuti
5	Testi i shpejtë për identifikimin e M. Tuberculosis, M. Bovis, M. Africanum dhe M. Microti, 25 teste	1	Kuti
6	Sistem optik, Real Time PCR	1	Copë

Në fletë-hyrjen në magazinë nr. 43, datë 11.09.2023, është pasqyruar artikulli "*Inkubator për rritjen e mykobakterieve*", me vlerë 21,540,000 lekë, por jo artikujt shoqërues të përcaktuar në specifikimet teknike, duke përfshirë por pa u kufizuar artikujt e marrë në dorëzim të listuara në Situacionin e hartuar nga OE, ku përfshihen kite/ reagente për konsum vjetor prej 1400 testesh në vit, terren i lëngshëm & tuba (deri në 1400 tuba), kit për suplemente me 1400 teste, deri në 250 teste të shpejta për identifikimin e M. Tuberculosis, M. Bovis, M. Africanum dhe M. Microti, kompjuter për kontrollin e aparaturës dhe softëare përkatës.

2.4.3. Procedura e prokurimit "E hapur mbi kufirin e lartë monetar" me objekt "*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh*", me afat 100 ditë nga nënshkrimi i kontratës, nr. REF-09362-06-13-2024, me fond limit 162,819,000 lekë pa TVSH.

Procedura e prokurimit "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh"		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 420/5 prot., 03.06.2024 2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	3. **Përllog.FL dhe specif. Teknike** Urdhër nr. 172/2 prot., datë 29.05.2024 - J. B. - E. Sh. - M. B. - D. Sh. **Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit** Urdhër nr. 420/5 prot., 03.06.2024 - A. I. - E. P. - S. H.	4. **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 420/6 prot., 03.06.2024 - E. K. - P. A. - E. P.
5. **Fondi Limit (pa TVSH)** 162,819,000 lekë	6. **Oferta fituese (pa TVSH)** 157,780,000 lekë	7. **Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 5,039,000 lekë (3.1%)
8. **Data e hapjes së tenderit** 13.06.2024	9. **Burimi i financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatorët Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 2 OE
11. **Ankimime** AK: PO KPP: PO		
12. **Lidhja e kontratës** (MK) Nr. 593/10 prot., 30.09.2024	13. **Vlera e kontratës** 10,851,653.50 lekë me TVSH	14. **Afati i kontratës në ditë** 100 ditë për pajisjet

Nëpërmjet shkresës së datës 05.01.2024, e paprotokolluar, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkiv/ Protokoll kanë dërguar kërkesën për përcaktimin e nevojave lidhur me fuqizimin e kapaciteteve laboratorike të ISUV, drejtuar Përgjegjësit të Departamentit të Shëndetit të Kafshëve J. B., të Shëndetit të Bimëve V. V. dhe të Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë E. K., duke cituar "*bazuar nevojave institucionale si dhe mosrealizimit të procedurave të planifikuara për vitin kalendarik 2023 (në pajisje laboratorike) ju lutemi na bëni me dije se cilat janë prioritetet tuaja për fuqizimin e laboratorëve në secilën fushë ku Departamentet Tuaja ushtrojnë aktivitetin e tyre*". Nisur nga fondi i akorduar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkiv/ Protokoll kanë dërguar kërkesën për prioritizimin në pajisje laboratorike dhe fushave në të cilat do të vijohet me prokurimin, drejtuar J. B., V. V., E. K.. Nëpërmjet shkresës së datës 15.04.2024, përgjegjësit e departamenteve kanë dërguar kthim përgjigje mbi sa më sipër, duke cituar se "*vendosëm që t'i jepet prioritet ngritjes së kapaciteteve laboratorike të sektorit të vlerësimit të cilësisë ushqimore, lidhur me analizimin e aditivëve ushqimor*".

Nga auditimi rezulton se materiali për hartimin e specifikimeve teknike është punuar nga E. K., S. H., E. Sh., përcjellë drejt personit përgjegjës për prokurimin A. I. nëpërmjet zv. Drejtorit të Përgjithshëm J. B., për të iniciuar kontaktimin e operatorëve për studimin e tregut. Personi i angazhuar me studimin e tregut A. I. nuk rezulton të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit, pavarësisht se është zyrtar i përfshirë në procedurën e prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 13, pika 5, të RPP.Në dosjen e prokurimit administrohen ofertat ekonomike të paraqitura për studimin e tregut, si më poshtë:

Nr.	OE	Praktika hyrëse	Oferta (lekë pa TVSH)
1	P.	pa praktikë hyrëse	168,555,500
2	B.	nr. 420 prot., datë 27.05.2024	165,995,500
3	A.	nr. 420/1 prot., datë 28.05.2024	172,186,000

Nëpërmjet Urdhrit nr. 172/2 prot., datë 29.05.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur *Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit*, të përbërë nga J. B., E. Sh., M. B., D. Sh.. Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se përllogaritja e fondit limit të kryhet

nëpërmjet testimit të tregut dhe ofertat janë marrë paraprakisht. Ky komision nuk ka në përbërje specialist fushe (teknik laboratori).
Ky komision ka hartuar relacionin me lëndë "*Përllogaritja për fondin limit*", duke cituar se "*për këtë zë kanë ardhur nga zyra e prokurimit 3 oferta...*", duke përcaktuar fondin limit prej 162,819,000 lekë pa TVSH. Kjo vlerë nuk korrespondon me mesataren aritmetike të 3 ofertave të marra nga studimi i tregut. Në PV e datës 04.06.2024 dhe në memo, Ky komision nuk shprehet mbi specifikimet teknike të pajisjeve, pra këto specifikime teknike, pavarësisht se është ngritur komision i posaçëm për hartimin e tyre, nuk rezulton të jenë hartuar nga ky komision. Specifikimet teknike nuk rezulton të jenë argumentuar teknikisht. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP. Pavarësisht se janë zyrtarë të përfshirë në procedurën e prokurimit, anëtarët e komisionit dhe hartuesi i specifikimeve teknike (nëse nuk është pjesë e komisionit) nuk rezulton të kenë nënshkruar Deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenin 73, pika 4 të RPP.
Nëpërmjet veprimeve të mësipërme, njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme.
Titullari i AK I. A ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 420/5 prot., datë 03.06.2024, ku kërkon kryerjen e procedurës së prokurimit sipas objektit, duke përcaktuar njësinë e prokurimit të përbërë nga A. I., E. P. dhe S. H., si dhe duke përcaktuar fondin limit prej 162,819,000 lekë pa TVSH. Njësia e prokurimit nuk ka në përbërje specialist të fushës. *Pavarësisht se shkresa mban datën 03.06.2024, nga ISUV bëhet me dije se është një lapsus dhe shkresa është gjeneruar në datën 04.06.2024. Nga verifikimi në Regjistrin e protokollit të ISUV, konstatohet se kjo shkresë është evidencuar me nr. 420/5 prot., datë 04.06.2024.*
Në datën 13.06.2024, njësia e prokurimit ka ngarkuar DST dhe Procesverbalin e argumentimit të kritereve teknike në SPE dhe në datën 14.06.2024 është publikuar procedura e prokurimit në SPE. Sipas DST të ngarkuar në SPE, afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është data 19.07.2024, ora 12:00.
Në datën 24.06.2024, OE "M." ka paraqitur ankesë mbi dokumentet e tenderit, me objekt modifikimin e tyre. Në datën 24.06.2024, OE "K." ka paraqitur ankesë mbi kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, me objekt modifikimin e tyre.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 420/6 prot., datë 26.06.2024, Titullari i AK ka pezulluar procedurën, duke krijuar Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, për trajtimin njëkohësisht të 2 ankesave të ardhura, të përbërë nga A. C., J. N., A. D.. Ky komision nuk ka në përbërje specialist të fushës, pavarësisht se objekti i ankesës lidhet me specifikimet teknike.
Në datën 26.06.2024, pas konstatimit se OE "M." nuk kishte paraqitur mandatin e pagesës bashkëlidhur, personi përgjegjës për prokurimin ka informuar mbi detyrimin për plotësimin e ankesës me dokumentin bankar, sipas përcaktimit në nenin 111, pika 2, të RPP dhe, më tej, në datën 01.07.2024, ka njoftuar OE mbi mospranimin e ankesës për arsye të pagesës së detyrueshme.
KShA mori në shqyrtim ankesën e OE "K." dhe ka hartuar PV e datës 05.07.2024, i paprotokolluar, 4 ditë në tejkalim të afatit 5-ditor të përcaktuar në nenin 100, pika 2, të RPP. Nga PV rezulton se ka pranuar pjesërisht ankesën, duke vënë në dijeni titullarin e AK. Titullari i AK ka përcjellë vendimin drejt KPP në datën 08.07.2024, dhe jo menjëherë pas vendimmarrjes së KShA. KPP ka marrë vendimin nr. 942/2024, nr. 1690/6 prot., datë 23.07.2024, për ankimin e subjektit "K." dhe ka vendosur të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e konkurrimit, me arsyen se OE është tërhequr nga ankesa e depozituar. KPP ka marrë vendimin nr. 953/2024, nr. 1683/8 prot., datë 24.07.2024, për ankimin e subjektit "M." dhe ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur, me arsyen e OE nuk ka kryer pagesën e detyrueshme. Pavarësisht se Vendimi i KPP ka përcaktuar se AK lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit dhe se ky vendim hyn në fuqi menjëherë, shtojca e modifikimit të DST është hedhur në sistem në datën 30.07.2024, 6 ditë me vonesë. Në shtojcë nuk është parashikuar shtyrja e afatit për zhvillimin e procedurës, por nga

informacioni administrativ në SPE rezulton se afati i fundit për pranimin e ofertave është caktuar data 13.08.2024, ora 12:00. Nëpërmjet Vendimit nr. 74, datë 25.07.2024, APP ka vendosur përjashtimin e OE "B. Albania" nga e drejta për të fituar kontrata publike për 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Me shkresën e APP-së nr. 5427/3 prot., datë 07.08.2024 "*Të dhëna mbi vendimin nr. 74, datë 25.07.2024*", është hequr OE "B. Albania" nga lista e OE të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, si pasojë e marrjes së masës së sigurimit të padisë, nëpërmjet vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nr. Regj. Them. 162 (3000004-06540-80-2024).
Nëpërmjet Urdhrit nr. 420/6 prot., datë 04.06.2024, Titullari i AK ka ngritur KVO, të përbërë nga E. K., P. A., E. P.. *Komisioni nuk ka në përbërje ekspert të fushës, në kundërshtim me nenin 75 të RPP*. *Nga auditimi ka rezultuar se ky urdhër/ kjo shkresë nuk është evidencuar në Regjistrin e protokollit, por me këtë nr. (420/6 prot.,) është evidencuar Njoftimi i pezullimit (i sipërcituar)*. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka rezultuar se anëtari i KVO E. K., përgjegjës i Departamentit të Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë, është përfshirë *de facto* në hartimin e specifikimeve teknike, përcjellë nëpërmjet e-mail, specifikime të cilat janë përdorur për studimin e tregut dhe përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 75, pika 4, të RPP, ku përcaktohet se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave *nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në rregullat e përcaktuara për anëtarët e KVO në nenin 75 të RPP*. Për sa më sipër, përderisa ishte angazhuar në hartimin e specifikimeve teknike, punonjësja E. K. nuk duhet të ishte përfshirë në procesin e shqyrtimin dhe vlerësimit të ofertave.
Nëpërmjet PV të datës 13.08.2024, i paprotokolluar, KVO ka dokumentuar hapjen e procedurës së prokurimit, dhe nëpërmjet PV nr. 3, datë 16.08/2024, i paprotokolluar, ka vlerësuar ofertat e OE pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta (lekë pa TVSH)**	**Statusi**
1	B.	157,780,000	Kualifikuar
2	P.	150,000,000	Skualifikuar
3	T.	Nuk ka paraqitur ofertë	Skualifikuar

Nëpërmjet PV nr. 3 të datës 16.08.2024, i paprotokolluar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka proceduar me skualifikimin e OE "P." SHPK, duke dokumentuar rast pas rasti mangësitë në dokumentacionin e paraqitur në ofertën ekonomike të lidhura me specifikimet teknike, si dhe OE "T.", pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentacion plotësues sipas kërkesave të AK, duke kualifikuar OE "B. Al." me ofertë ekonomike 157,780,000 lekë pa TVSH. Për vlerësimin e ofertave nuk rezulton të ketë patur ankimime. Titullari i AK I. A ka miratuar raportin përfundimtar të procedurës së prokurimit në datën 09.09.2024, i paprotokolluar.
Ndërmjet AK dhe OE "B. Al." është lidhur kontrata nr. 420/14 prot., datë 16.09.2024, me vlerë ekonomike 157,780,000 lekë pa TVSH ose 189,336,000 me TVSH, me afat 100 ditë nga nënshkrimi i kontratës për pajisjet laboratorike dhe 5 muaj për aplikimin e metodave nga momenti i instalimit dhe vënies në punë të pajisjeve.
AK dhe OE kanë nënshkruar planin e zbatimit të kontratës nr. 420/15 prot., datë 17.09.2024. Në Seksionin II përcaktohet se pagesa do të bëhet sipas buxhetit të parashikuar nga Autoriteti Kompetent: Buxheti 2024 – 55,409,000 lekë; Buxheti 2025 – 70,000,000 lekë; Buxheti 2026 – 70,000,000 lekë.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 125 prot., datë 26.11.2024, i ngarkuari me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm J. B. ka ngritur Komisionin e marrjes në dorëzim, të përbërë nga S. Dh., S. M., U. R.. Ky komision nuk ka në përbërje specialist të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011.
Komisioni ka hartuar PV e datës 27.11.2024, i paprotokolluar, nëpërmjet të cilit ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pajisjeve sipas specifikimeve teknike. Në dokumentacionin e marrjes në dorëzim gjithashtu administrohet Akt-dorëzimi i datës 27.11.2024, i nënshkruar nga përfaqësues i OE dhe anëtarët e Komisionit të marrjes në dorëzim, 12 procesverbale të instalimit, shërbimit teknik, trajnimit, mirëmbajtjes dhe validimit, të nënshkruara nga përfaqësues i OE dhe përfaqësues nga ISUV, si dhe 4 raport shërbime të lëshuara nga Shimadzu.

OE është likuiduar pjesërisht nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 403, datë 09.01.2025, në vlerën prej 81,329,000 lekë, bazuar në faturën elektronike 1413/2024, datë 27.11.2024, në vlerën prej 181,032,000 lekë. Deri në përfundim të fazës së terrenit në datën 05.05.2025, pavarësisht se nga OE është faturuar vlera e plotë, pranuar dhe marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim, nuk rezulton të jetë likuiduar pjesa e mbetur pa likuiduar nga vlera totale e kontratës.

2.4.4. Procedura e prokurimit me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike*", për vitin 2024, me nr. REF-18633-09-11-2024, me fond limit 9,047,682 lekë pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="3">Procedura e prokurimit "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik për vitin 2023"</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 593/5 prot., 14.08.2024</td><td rowspan="2">3. Përllogaritja e fondit limit dhe specif. Teknike
Urdhër nr. 593/2 prot., datë 05.08.2024
- J. B.
- M. L.
- E. M.
- M. K.
- D. Sh.
Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit
Urdhër nr. 593/5 prot., 14.08.2024
- A. I.
- S. M.
- E. P.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 593/6 prot., 14.08.2024
- E. Sh.
- A. C.
- B. Q.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Procedurë e hapur e thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)

9,047,682 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)

9,043,044.58 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
4,637.42 lekë (0.05%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
11.09.2024</td><td>9. Burimi i financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE
b) Skualifikuar: -</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK: - KPP: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e kontratës (MK)
Nr. 593/10 prot., 30.09.2024</td><td>13. Vlera e kontratës 10,851,653.50 lekë me TVSH</td><td>14. Afati i kontratës në ditë 5 ditë</td></tr>
</table>

Nëpërmjet shkresës nr. 298 prot., datë 08.04.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A i drejtohet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Mbrojtjes me kërkesën emergjente për asgjësim kimikatesh dhe mbetjesh laboratorike, duke cituar se këto kimikate janë të mbartura nga IKV dhe IKU që prej 30-40 vitesh, si dhe se nga rrezikshmëria që këto kimikate paraqesin duhet të asgjësohen nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, duke listuar gjithashtu komunikime të mëparshme me të njëjtën kërkesë me Ministritë respektive gjatë vitit 2019 dhe 2021. Nëpërmjet shkresës administruar në ISUV me nr. 298/1 prot., datë 17.05.2024, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes bën me dije se MM nuk ka asnjë kapacitet për asgjësimin e mbetjeve kimike pavarësisht burimit nga janë gjeneruar ato, si dhe nuk rezulton asnjë mundësi dhe hapësirë për marrjen dhe administrimin e këtyre mbetjeve pavarësisht sasisë dhe gjendjes së tyre.
Me anë të Urdhrit nr. 45, datë 16.04.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin për evidentimin e kimikateve dhe mbetjeve laboratorike jashtë përdorimit që ndodhen në ambientet e ISUV, të domosdoshme për asgjësim, duke përcaktuar se Komisioni duhet të përcaktojë edhe rrezikshmërinë shëndetësore që ato paraqesin, të përbërë nga E. M. (Përgjegjëse e Departamentit të Monitorimit të Mbetjeve, Kontrollit të Barnave Veterinare dhe Toksikologjisë), V. V. (Përgjegjëse e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve), E. B.(Përgjegjëse e Departamentit të Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë), Zh. H.(magaziniere Sektori i Financës). Nëpërmjet shkresës nr. 302 prot., datë 17.04.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV dërgon ftesën për ofertë drejt 2 OE "P. M." ShPK dhe "F. 2006" ShPK, duke cituar "*bashkëlidhur lista me zërat përkatës*", *por ky dokument nuk administrohet bashkëlidhur*, ndërkohë që evidentimi i kimikateve dhe mbetjeve laboratorike është përfunduar në datën 23.04.2024, si më poshtë: Komisioni i sipërcituar ka hartuar memon informuese të datës 23.04.2024 në lidhje me evidentimin dhe rrezikshmërinë shëndetësore që

paraqesin kimikatet dhe mbetjet laboratorike të depozituara në ambientet e ISUV, ku citohet se "*kategoritë e kimikateve që duhet të asgjësohen janë (i) Medikamente veterinare të ardhura për efekt të regjistrimit të medikamenteve veterinare për t'u analizuar, (ii) PMB-të e ardhura gjatë procesit të monitorimit për efekt të realizimit të planit me bazë risku të AKU, (iii) Reagent dhe kimikate të mbartura nga bashkimi apo shkrirja e institucioneve të ndryshëm si IKV, IKU, etj., të cilët janë shumë të hershëm dhe shumë të vjetër, (iv) Mbetje të gjeneruara nga laboratorët nga puna e përditshme e tyre. Këtu futen të gjitha mbetjet që gjenerohen nga analizat e ndryshme gjatë proceseve të ekstraktimit, nga instrumentat e ndryshëm të analizës si kromatografia e lëngët, etj. Këto reagentë paraqesin rrezikshmëri të shumëllojshme pasi janë lehtësisht të ndezshëm, korroziv, oksidues, eksplodues, si dhe toksik mutagjenik, toksik respiratorë dhe toksik riprodhues, apo dhe të rrezikshëm për mjedisin*", duke bashkëlidhur gjithashtu një listë me 1926 artikuj, ku përcaktohet emërtimi, data e skadencës dhe sasia. Nëpërmjet shkresës nr. 298/2 prot., datë 20.05.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të MBZhR kërkesën për alokim fondi për "Asgjësim Kimikatesh dhe Mbetje Laboratorike", duke cituar se "*nga një studim i bërë në treg, procedura për asgjësimin e tyre ka një kosto të përafërt në vlerën 11,500,000 lekë*". Në dokumentacionin bashkëlidhur administrohen listat që përcaktojnë kategoritë, artikujt dhe sasitë, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Lista e reagentëve stok në magazinë të ISUV (IKU)	36 artikuj, në sasitë totale prej 6,635 gram, 1,750 miligram, 21 litra, 20 kg dhe 5 ml
2	Lista e reagentëve stok në magazinë të ISUV	91 artikuj, në sasitë totale prej 1,068 kg, 2,633 litra, 326 gram
3	Kimikatet e skaduara për t'u asgjësuar – Sektori i cilësisë ushqimore	45 artikuj, 22.155 kg
4	Lista e PMB-ve për eliminim – Sektori PMBMM	84 artikuj
Mbetje laboratorike të gjeneruara gjatë procesit të punës ndër vite		
5	Mbetje laboratorike (tretës organikë, inorganikë, kripëra, etj.) të gjeneruar nga laboratorë të medikamenteve, pesticideve, metaleve të rënda dhe mykotoksinave	2,484 litër
6	Mbetje reagentë	37.5 litra
7	Mbetje kripëra dhe terrene	126.7 litra
8	Mbetje shumë të rrezikshme (kloroform, hekzan, etj.)	99.7 litra
9	Mbetje shumë të rrezikshme (brom, dansil klorid, mërkur, etj.)	8 kg

Nëpërmjet shkresës nr. 571 prot., datë 23.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV i dërgon MBZhR kërkesën për shtesë fondi, duke përfshirë vlerën prej 11,000,000 lekësh për procedurën e prokurimit me objekt asgjësimin e kimikateve dhe mbetjeve laboratorike. Nëpërmjet shkresës së administruar në ISUV me nr. 619 prot., datë 05.08.2024, Sekretari i Përgjithshëm i MBZhR ka dërguar shkresën "Mbi transferimin e fondit në shpenzimet korrente për vitin 2024", ku citohet se: "Referuar kërkesës së ISUV... gjeni tabelën e rialokimit të fondit në vlerë totale 11,000,000 lekë... për asgjësimin e kimikateve dhe mbetjeve laboratorike".

Studimi i tregut është iniciuar nga personi përgjegjës për prokurimin, A. I., pa dokument autorizues nga titullari, nëpërmjet e-maileve të datave 30.05.2024 dhe 07.06.2024, duke kërkuar dorëzimin e ofertave elektronike, bashkëlidhur me një dokument që citohet të jetë lista e mbetjeve objekt i procedurës së prokurimit. Në komunikim nuk specifikohet për llogari të cilëve operatorë ekonomikë është dërguar kërkesa për paraqitje ofertash për studimin e tregut.

Nëpërmjet e-mailit të datës 30.05.2024, drejtuar personit përgjegjës për prokurimet, A. I., dërguesi bën me dije se "F. 2006" është kompani që menaxhon mbetje jo të rrezikshme, ndaj është e pamundur të përgatitet një ofertë.

Personi i angazhuar me studimin e tregut, A. I., nuk rezulton të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit, pavarësisht se është zyrtare e përfshirë në procedurën e prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 13, pika 5, të Rregullores për Prokurimet Publike (RPP).

• OE "P. M." ka paraqitur ofertën financiare, të administruar në ISUV me nr. 593 prot., datë 26.07.2024, në vlerën prej 10,449,735 lekësh pa TVSH.

• OE "G. C." ka paraqitur ofertën financiare, të administruar në ISUV me nr. 593/1 prot., datë 26.07.2024, në vlerën prej 9,242,572 lekësh pa TVSH. Referuar ekstraktit historik në QKB, ky operator ekonomik rezulton të ketë në objektin e veprimtarisë së tij vetëm grumbullimin dhe transportimin, por jo asgjësimin e mbetjeve.

Nëpërmjet urdhrit nr. 593/2 prot., datë 05.08.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga: J. B., M. L., E. M., M. K., D. Sh.. Ky komision nuk ka në përbërje specialist të fushës (inxhinier mjedisi ose ekuivalent).

Nëpërmjet shkresës nr. 593/3 prot., datë 05.08.2024, B. Ç., A. I. dhe J. N. i dërgojnë Komisionit ofertat e administruara nga OE "P. M." dhe OE "G. C.", me qëllim përllogaritjen e fondit limit.

Nëpërmjet shkresës nr. 593/4 prot., datë 09.08.2024, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit ka paraqitur përllogaritjen e kryer bazuar në ofertat e marra, në vlerën prej 9,047,682 lekësh pa TVSH, vlerë e cila nuk përbën mesataren e dy ofertave të administruara, në mospërputhje me nenin 76, pika 1, germa **b**, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Gjithashtu, Komisioni ka hartuar listën e artikujve, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia
1	Mbetje solvent	387 shishe, 883.5 litra
2	Mbetje pesticide	106 shishe, 227.5 litra
3	Diklormetan, N-Hekzan, HCL 37%	7.5 litra
4	Kripëra	126,581.4 gramë
5	Reagente stok në ISUV (IKU)	36 artikuj, në sasitë totale prej 6,635 gram, 1,750 miligram, 21 litra, 20 kg dhe 5 ml
6	Kimikatet e skaduara për t'u asgjësuar – Sektori i cilësisë ushqimore	45 artikuj, 22.155 kg
7	Lista e PMB-ve për eliminim – Sektori PMBMM	84 artikuj
8	Lista e reagentëve stok në magazinë të ISUV	102 artikuj

Ofertat e përdorura për studimin e tregut janë marrë nga njësia e prokurimit përpara se Komisioni i posaçëm për hartimin e specifikimeve teknike të kishte konkluduar me këtë raport. Për sa më sipër, kjo nuk garanton se është ndjekur një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit *bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*.

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 593/5 prot., datë 14.08.2024, Titullari i AK I. A ka kërkuar përdorimin e fondit limit prej 9,047,682 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike*", duke krijuar Njësinë për hartimin e DST, të përbërë nga A. I., S. M., E. P.. Njësia e Prokurimit nuk ka në përbërje specialist të fushës (*inxhinier mjedisi ose ekuivalent*), në mospërputhje me nenin 74, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 593/6 prot., datë 14.08.2024, Titullari i AK ka ngritur KVO të përbërë nga E. Sh. (Kimist), A. C. (Biokimist), B. Q. (Kimi dhe teknologji ushqimore). KVO nuk ka në përbërje specialist të fushës (*inxhinier mjedisi ose ekuivalent*), në mospërputhje me nenin 75, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Njësia e prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, i paprotokolluar dhe pa datë. Në këtë procesverbal janë përcaktuar ndër të tjera Kriteret e veçanta të kualifikimit, si më poshtë:

Sa i përket **KVK nr. 2.3.2** – "*Leje mjedisi Tipi A (Kodi III.1.C), së bashku me Akt miratimin përkatës ose kontratë me një OE të licencuar për të njëjtin objekt prokurimi*", Njësia e prokurimit, nisur nga specifikat dhe rrezikshmëria e lartë e mbetjeve, duhet të kishte përcaktuar qartazi jo vetëm lejen mjedisore, por edhe kategorinë specifike të mbetjeve të cilat do të grumbullohen, transportohen dhe asgjësohen, objekt prokurimi, sipas Katalogut të Mbetjeve, miratuar me VKM nr. 402, datë 30.06.2021, për të cilën OE duhet të ishte i licencuar.

Sa i përket **KVK 2.3.3** – "*OE duhet të ketë leje Tipi A për trajtimin e ujërave të ndotura dhe impiantin përkatës ose kontratë me një OE të licencuar për të njëjtin objekt prokurimi*", ky kriter nuk është

argumentuar teknikisht, në mospërputhje me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe nuk është në proporcion me objektin e prokurimit në mospërputhje me nenin 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, pasi nuk kemi të bëjmë me ujëra të ndotura por me asgjësim të mbetjeve e më tej trajtim/ depozitim të produktit final që del nga procesi i trajtimit/ asgjësimit.
Sa i përket **KVK 2.3.5** – "*OE duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listëpagesa ose me kontratë shërbimi jo më pak se 10 punonjës*", duke argumentuar se "vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që OE të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit". Vendosja e kriterit prej minimalisht 10 punonjësish, pa përcaktuar profilin e nevojshëm për 8 prej tyre, si dhe pa detajuar punën që duhet të kryhet për të cilën është nevoja për minimalisht 10 punonjës, është i paargumentuar teknikisht, në mospërputhje me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 dhe Rekomandimin e APP nr. 7998 prot., datë 24.12.2021, ku përcaktohet se "*në rastin e kriterit të fuqisë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, AK duhet të hartojnë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore që nevojitet... dhe mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm*".
Vendosja e kritereve të paargumentuara teknikisht dhe jo në proporcion me objektin e prokurimit, në mospërputhje me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ndikon negativisht në nxitjen e konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në procedurat e prokurimit publik.
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka hartuar PV e datës 24.09.2024, i paprotokolluar, duke dokumentuar hapjen e procedurës së prokurimit, ku u konstatua se është paraqitur vetëm një operator ekonomik BOE "G. C." ShPK & "B. A." ShPK, me ofertë ekonomike 9,043,044.58 lekë pa TVSH.
Nëpërmjet PV nr. 3 të datës 25.09.2024, KVO ka dokumentuar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës, duke kualifikuar BOE "G. C." ShPK & "B. A." ShPK, me ofertë ekonomike 9,043,044.58 lekë pa TVSH.
BOE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në ISUV me nr. 593/8 prot., datë 27.09.2024.
Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE dhe i administruar fizikisht, u konstatua se, sa i përket Lejeve mjedisore, BOE ka paraqitur:

Nr.	Dokumenti	Koment
1	Licencë nr. LN-1648-12-2020, për subjektin "G. C.", Kodi III.2.B me emërtim përshkrues të veprimtarisë "*Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme*"	
2	Akt miratimi i lëshuar nga AKM, nr. 5268 prot., datë 16.08.2024. Në pikën 4 "Kushtet e licencës" janë përcaktuar kategoritë e mbetjeve për të cilat është licencuar për të kryer grumbullimin dhe transportimin, sipas VKM nr. 402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".	Sipas këtij Akt miratimi, nuk rezulton që subjekti të jetë i licencuar për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve sipas kategorisë 6 "*Mbetje të kimisë minerale*" dhe kategorisë 7 "*Mbetje nga proceset e kimisë organike*"
3	Leje nr. PN-0874-12-2021, për subjektin "B. A.", Kodi III.1.C, me emërtim përshkrues të veprimtarisë (*listuar vetëm kategoritë që lidhen me asgjësimin ose me mbetjet e rrezikshme*): "*Leje mjedisi Tipi A:* (i) *ID 5.3.e.* ***Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme*** *me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9); (ii) ID 5.4.b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve...; (iii) ID 5.10.a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart*"	
4	Akt miratimi i lëshuar nga AKM, nr. 3400/1 prot., datë 20.05.2024. Në Shtojcën 4.1 "Menaxhimi i mbetjeve", tabela 4.1.1 "*Asgjësimi/ trajtimi i mbetjeve të rrezikshme*" përcaktohen lloji i mbetjeve, trajtimi dhe metoda e asgjësimit për secilën prej tyre.	Sipas këtij Akt miratimi, nuk rezulton që subjekti të jetë i licencuar për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e mbetjeve sipas kategorisë 6 "*Mbetje të kimisë minerale*" dhe kategorisë 7 "*Mbetje nga proceset e kimisë organike*".

Për sa më sipër, duke qenë se asnjë prej OE pjesë të BOE nuk rezulton të jetë i licencuar për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e kategorisë specifike të mbetjeve, KVO duhet të kishte skualifikuar BOE "G. C." ShPK & "B. A." ShPK.
Titullari i AK I. A ka miratuar Raportin përfundimtar për procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike", datë 25.09.2024, i paprotokolluar.
Ndërmjet AK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjitshëm I. A, dhe BOE, përfaqësuar me autorizim nga S. B., është lidhur kontrata e shërbimit nr. 593/10 prot., datë 30.09.2024, me vlerë 9,043,044.58 lekë pa TVSH ose 10,851,653.50 lekë me TVSH, duke përcaktuar që zbatimi i kontratës duhet të fillojë nga data 01.10.2024 deri në datën 05.10.2024 (afati 5 ditë).
Nëpërmjet Urdhrit nr. 593/12 prot., datë 02.10.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin e përbërë nga E. M., M. L., E. B., Zh. H., H. M., duke cituar se "*Komisioni do të dorëzojë mbetjet bazuar në kontratën për procedurën me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike" dhe do të vlerësojë këtë shërbim*". Ky komision nuk ka në përbërje specialist të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011.
Në dosjen e procedurës së prokurimit administrohen, si më poshtë:

1. Dokumentat e transportit për mbetje të rrezikshme, si më poshtë:

Nr.	Nr. i dokumentit të transportit	Dorëzues	Transportues	Kodi i mbetjeve	Përshkrim	Sasia	Data e nisjes/ mbërritjes	Nënshkruar për ISUV
1	GTC022624343	ISUV	G. C., në emër të "B. A."	15 01 10*	*Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*	E papërcaktuar	02.10.2024	E. B., M. L., E. M.
2	GTC022624347	ISUV	G. C., në emër të "B. A."	15 01 10*	*Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*	E papërcaktuar	04.10.2024	E. B., M. L., E. M.
3	GTC022624358	ISUV	G. C., në emër të "B. A."	15 01 10*	*Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*	E papërcaktuar	11.10.2024	E. B., M. L., E. M., H. M., Zh. H.

2. Dokumenti i dorëzimit për mbetje të rrezikshme, nr. GTC022624346, krijues/dorëzues "ISUV", grumbullues "G. C.", me përshkrim mbetje "*Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*", me kod 15 01 10* sipas Katalogut të mbetjeve, data e nisjes dhe mbërritjes 04.10.2024. Në këtë dokument, kolonat "Sasia" dhe "Komponentët kimikë/ biologjikë të mbetjeve dhe përqendrimet e tyre" janë plotësuar "Sipas listës bashkëlidhur të Dokumentit të Dorëzimit të Mbetjeve".
Grupit të auditimit nuk u është vënë në dispozicion Dokumenti i dorëzimit për mbetje të rrezikshme, referuar transferimit të kryer me dokument transporti nr. GTC022624343, datë 02.10.2024 dhe nr. GTC022624358, datë 11.10.2024.
Në asnjë prej dokumenteve të mësipërm nuk rezulton të jetë përcaktuar saktë përshkrimi i mbetjes dhe kodi 6-shifror sipas Katalogut të mbetjeve, pasi kategorinë "*Mbetje ambalazhimi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*" përcaktohet mënyra e trajtimit "*Riambalazhim i mbetjeve me anë të operacioneve D14 (riambalazhim) përpara se t'i nënshtrohet operacioneve D1 dhe D5*", "*Ruajtje/ magazinim i mbetjeve me anë të operacioneve D15, në pritje të operacioneve D1 (Depozitimi nën dhé ose mbi dhé) dhe D5 (Lendfillet me projekte inxhinierike të posaçme (p.sh.*

vendosja në qeliza të veçanta, të renditura njëra pas tjetrës, të cilat mbulohen dhe izolohen nga njëra-tjetra dhe nga mjedisi etj.)", me metodë asgjësimi "*Depozitim i mbetjeve në lendfillin e mbetjeve industriale me anë të operacioneve D1 dhe D5*", ndërkohë që mbetjet objekt kontrate për grumbullim, transportim dhe asgjësim ishin mbetje të rrezikshme të kategorisë 06 "*Mbetje të kimisë minerale*" dhe 07 "*Mbetje nga proceset e kimisë organike*".
OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 285, datë 17.10.2024, në vlerën prej 10,851,654 lekë, bazuar në faturën elektronike nr. 861/2024, datë 07.10.2024 dhe PV të marrjes në dorëzim të datës 04.10.2024, i paprotokolluar, nga Komisioni i dorëzimit të mbetjeve (i panënshkruar nga M. L.), bashkëlidhur tabelat me mbetjet e dorëzuara. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, përkatësisht Dokumenti i transportit nr. GTC022624358, konstatohet se shërbimi i fundit është kryer në datën 11.10.2024, pra pasi Komisioni ka hartuar PV përmbledhës dhe pas faturimit nga ana e OE për shërbimin e kryer. Struktura përgjegjëse për financat nuk duhet të kishte proceduar me vijimin e likuidimit të kontratës, për sa kohë PV i marrjes në dorëzim nuk ishte nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, veprim në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, si dhe Kreut III, pika 4, gërma h, të Rekomandimit të APP-së nr. 5529/1 prot., datë 18.07.2023.

2.4.5. Zbatimi i Marrëveshjes kuadër nr. 880/4 prot., datë 20.12.2021 me objekt "Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparatura", për vitin 2022

ISUV ka lidhur Marrëveshje kuadër me të njëjtin nr. prot 880/4, datë 20.12.2021, me 3 OE të ndryshëm (jo në të njëjtin dokument), duke mos evidencuar me numër rendor të veçantë çdo dokument, në mospërputhje me nenin 19, pika 1, të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Në secilën prej 3 dokumentave të emërtuar "*Draft marrëveshje kuadër*" me nr. 990/4 prot., datë 20.12.2021, të lidhur veçmas me secilin prej OE, është përcaktuar rast pas rasti, si më poshtë:

Nr. Lot	OE	Nr. REF	Vlera (lekë pa TVSH)
I	P.	11668-11-16-2021	18,983,250
II	K.	11670-11-16-2021	1,841,000
III	G.	11672-11-16-2021	2,644,800

a. Zbatimi i kontratës me objekt Loti I "Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Agilent", nr. REF-11668-11-16-2021, për vitin 2022.

Ndërmjet AK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. R., dhe OE "P." ShPK, është lidhur kontrata për shërbim nr. 880/5 prot., datë 20.12.2021, me afat 365 ditë, në vlerën prej 18,983,250 lekë pa TVSH ose 22,776,000 lekë me TVSH, ku është përcaktuar lista me 14 zëra, me shërbimet përkatëse dhe sasinë e marrjes së secilit. Me të njëjtin numër protokolli janë evidencuar edhe 2 kontrata të tjera, përkatësisht (i) me OE "K." ShPK, me objekt Loti II "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Thermofisher*" dhe (ii) me OE "G." ShPK me objekt Loti III "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Shimadzu*", duke mos evidencuar me numër rendor të veçantë çdo dokument, në mospërputhje me nenin 19, pika 1, të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 25, nr. 259 prot., datë 25.02.2022, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim të shërbimit për pajisjet Agilent, të përbërë nga S. M., S. T., A. J.. Pavarësisht se kjo është kontratë e përzier, që ka si objekt prokurimin për *shërbime*, sa i përket shërbimit të servisit, validimit dhe/ ose kalibrimit sipas rastit, dhe *furnizime*, sa i përket pjesëve të këmbimit, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nuk ka përfshirë në Komisionin e marrjes në dorëzim punonjësin me përgjegjësi materiale (magazinierin), si dhe specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
OE është likuiduar në vlerën totale prej **22,776,000 lekë**, nëpërmjet, si më poshtë:

Nr.	Urdhër-shpenzimi		Vlera (lekë me TVSH)	Fatura elektronike		Vlera (lekë me TVSH)	Marrja në dorëzim	
	Nr.	Datë		Nr.	Datë		Komisioni	Data
1	285	25.11.2022	17,940,000	4203/2022	03.11.2022	10,762,956	S. T., S. M., A. J.	03.11.2022
				4205/2022	03.11.2022	7,177,044		
2	304	20.12.2022	4,836,000	4858/2022	16.12.2022	4,056,000	A. J., S. T., S. M.	16.12.2022
				4586/2022	16.12.2022	780,000		

Pavarësisht se nëpërmjet kësaj procedure AK është furnizuar dhe me pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, Komisioni i marrjes në dorëzim nuk shprehet mbi aspektin sasior dhe cilësor të artikujve përbërës të kërkuar në specifikimet teknike dhe të faturuar nga OE. Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.
Në dokumentacionin bashkëlidhur, vënë në dispozicion grupit të auditimit, administrohen, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Data	Lëshuar nga	Kryer/ nënshkruar nga
1	Raport i kualifikimit të Operacionit për instrumentin "*Elisa Reader*", modeli ELx808, nr. serial 1803175, me prodhues "Dialab"	18.01.2022	"P." ShPK	E. B.
2	Raport i kualifikimit të Operacionit për instrumentin "*Elisa Reader*", modeli ELx808, nr. serial 15072910, me prodhues "Dialab"	19.01.2022	"P." ShPK	E. B.
3	Raport i kualifikimit të Operacionit për instrumentin "*Elisa Reader*", modeli ELx808, nr. serial 1803175, me prodhues "Dialab"	16.08.2022	"P." ShPK	E. B.
4	Raport i kualifikimit të Operacionit për instrumentin "*Elisa Reader*", modeli ELx808, nr. serial 15072910, me prodhues "Dialab"	17.08.2022	"P." ShPK	E. B.
5	Raport Shërbimi për instrumentin "*Laboratory Water Purification System 78 MP*", modeli ËPE-RO-DI-15, nr. serial 20112524, me prodhues "M.R.C (Rachmanov – Bookstein) Ltd."	11.10.2022	"P." ShPK	Dokumentit i mungon faqja e fundit me nënshkrimin e inxhinierit që ka kryer procedurën.
6	Dokumenti (fotokopje në gjuhë angleze) "*MiSeq System*" për llojin e shërbimit "Kualifikim operacioni (OQ)" për instrumentin me nr. serial M05642	06.10.2022		Personeli i Ilumina Borislav Georgiev

Në KVK nr. 2.3 është kërkuar që inxhinierët që do të kryejnë servis-kalibrimin duhet të jenë të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve Agilent. Në ofertën e shpallur fituese, OE "P." ka paraqitur certifikata përfundimi për D. S., si (i) "*Trajnim për mbështetjen e shërbimeve të planifikuara për seritë 6400 TQ LC/MS – HË & SW*", e datës 30.06.2017, (ii) "*Trajnim për mbështetjen e riparimit për seritë 6400 TQ LC/MS – Zgjidhja e avancuar e problemeve*", e datës 07.07.2017, (iii) "*Riparimi fillestar dhe zgjidhja e problemeve*", e datës 24.05.2019, (iv) "*Paraqitja e harduerit*", e datës 19.10.2011, certifikuar nga kompania "Learning at Agilent". *Pavarësisht sa më sipër, të gjitha dokumentet si raporte kualifikimi të operacionit dhe raport shërbime, janë kryer dhe nënshkruar nga E. B., për të cilin nuk ka evidencë nëse është ose jo i trajnuar dhe Certifikuar nga kompania prodhuese për servis – kalibrimin e pajisjeve Agilent.*
Në asnjë nga dokumentat e sipërcituar, nuk vërtetohet se laboratorët kalibrues plotësojnë kërkesat e SSH ISO/IEC 17025, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*".

Grupit të auditimit nuk u janë vendosur në dispozicion *Certifikatat e pjesëve të këmbimit*, sikurse kërkuar në specifikimet teknike të secilit prej zërave.
Pavarësisht se në DST është kërkuar **kalibrimi** i 6 pajisjeve, në zërat respektivë 4, 6, 8, 9, 12, 14, Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar **Certifikatat e kalibrimit**, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi"*.
Në pikën 6.4.3 të dokumentit të DPA me Kod DA-IN-0011 përcaktohet se, kur laboratori përdor shërbime të një organizate të jashtme për të kalibruar pajisjet matëse dhe testuese, laboratori duhet të plotësojë kërkesat e SSH ISO/IEC 17025. Nëse shërbimet nuk ofrohen nga një laborator kalibrues i akreditуar, laboratori duhet të sigurojë që Certifikata e kalibrimit duhet të përmbajë informacionin dhe elementët e përcaktuar në pikën 6.4.4, kur përfshihen pa u kufizuar: titulli "*Certifikatë kalibrimi*", të dhënat e laboratorik ku janë kryer matjet, identifikimi unik i certifikatës së kalibrimit dhe në çdo faqe një element identifikues që kjo faqe është pjesë e Certifikatës, etj. Në pikën 6.8.2 përcaktohet se, kur pajisja është kalibruar ose kur materiali referues është Certifikuar nga një organizëm i tretë, laboratori duhet të sigurojë që materiali referues/ pajisja është e përshtatshme për qëllimin që do të përdoret, është e etiketuar dhe ka Certifikatën e cila tregon rezultatet e kalibrimit.
b. Zbatimi i kontratës me objekt Loti II "Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Thermofisher", nr. REF-11670-11-16-2021, për vitin 2022.
Ndërmjet AK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. R., dhe OE "K." ShPK, është lidhur kontrata për shërbim nr. 880/5 prot., datë 20.12.2021, me afat 365 ditë, në vlerën prej1,835,000 lekë pa TVSH ose 2,202,000 lekë me TVSH, ku është përcaktuar lista me 6 zëra, me shërbimet përkatëse dhe sasinë e marrjes së secilit. Me të njëjtin numër protokolli janë evidencuar edhe 2 kontrata të tjera, përkatësisht (i) me OE "P." ShPK, me objekt Loti I "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Agilent*" dhe (ii) me OE "G." ShPK me objekt Loti III "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Shimadzu*", duke mos evidencuar me numër rendor të veçantë çdo dokument, në mospërputhje me nenin 19, pika 1, të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 26, nr. 259 prot., datë 25.02.2022, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim të shërbimit për pajisjet Thermofisher, të përbërë nga S. Dh., E. Sh., E. Sh.. Komisioni nuk ka në përbërje specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
OE është likuiduar në vlerën totale prej 2,202,000 lekë, nëpërmjet, si më poshtë:

Nr.	Urdhër-shpenzimi		Vlera (lekë me TVSH)	Fatura elektronike		Vlera (lekë me TVSH)	Marrja në dorëzim	
	Nr.	Datë		Nr.	Datë		Komisioni	Data
1	155	06.07.2022	1,140,000	667/2022	28.04.2022	1,140,000	S. Dh., E. Sh., E. Sh.	28.04.2022
2	305	20.12.2022	792,000	1906/2022	13.12.2022	792,000	A. J., S. T., S. M.	13.12.2022
3	309	20.12.2022	270,000	1037/2022	05.07.2022	270,000	A. J., S. T. S. M.	05.07.2022

Komisioni i marrjes në dorëzim, sa i përket furnizimeve me nr. rendor 2 & 3 (më sipër) nuk është i njëjtë më Komisionin e ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nëpërmjet Urdhrit nr. 26, datë 25.02.2022.
Pavarësisht se në DST është kërkuar kalibrimi i artikujve "Real-time PCR" (në furnizimin e parë) dhe "aparat distilimi" (në furnizimin e tretë), Komisionet e marrjes në dorëzim nuk rezulton të kenë administruar certifikatat e kalibrimit, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të DPA-së me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi*", ndërkohë që ky dokument është administruar për 3 artikujt/ pajisjet në furnizimin e dytë.

c. Zbatimi i kontratës me objekt Loti II "Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Shimadzu", nr. REF-11672-11-16-2021, për vitin 2022.

Ndërmjet AK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. R., dhe OE "G." ShPK, është lidhur kontrata për shërbim nr. 880/5 prot., datë 20.12.2021, me afat 365 ditë, në vlerën prej 2,640,000 lekë pa TVSH ose 3,168,000 lekë me TVSH, ku është përcaktuar lista me 2 zëra, me shërbimet përkatëse dhe sasinë e marrjes së secilit. Me të njëjtin numër protokolli janë evidencuar edhe 2 kontrata të tjera, përkatësisht (i) me OE "Agilent" ShPK, me objekt Loti II "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Thermofisher*" dhe (ii) me OE "K." ShPK me objekt Loti III "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Shimadzu*", duke mos evidencuar me numër rendor të veçantë çdo dokument, në mospërputhje me nenin 19, pika 1, të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 24, nr. 257 prot., datë 25.02.2022, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim të shërbimit për pajisjet Shimadzu, të përbërë nga M. L., K. C., E. B.. Komisioni nuk ka në përbërje specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 69, datë 10.05.2022**, në vlerën prej **3,168,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 18/2022, datë 25.02.2022, ku janë faturuar shërbimet (i) "HPLC Shimadzu – Kalibrim-validim, Ndërrim pjesësh" dhe (ii) "HPLC-UV-Shimadzu – Kalibrim-validim, OQ, Ndërrim pjesësh".

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar **Certifikatat e kalibrimit**, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të DPA-së me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi*".

2.4.6. Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", për vitin 2024, me fond limit 38,677,020 lekë pa TVSH, e ndarë në 4 Lot-e, si më poshtë:

1. Loti I "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Agilent", me nr. REF-06411-05-24-2024, me fond limit 31,358,000 lekë pa TVSH;
2. Loti II "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Thermofisher", me nr. REF-06414-05-24-2024, me fond limit 1,690,000 lekë pa TVSH;
3. Loti III "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Shimadzu", me nr. REF-06416-05-24-2024, me fond limit 4,608,000 lekë pa TVSH;
4. Loti IV "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Bertin", me fond limit 1,021,020 lekë pa TVSH[11].

<table>
<tr><th colspan="3">Procedura e prokurimit "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", për vitin 2024</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 389/2 prot., 21.05.2024</td><td rowspan="2">3. Përllogaritja e fondit limit dhe specif. Teknike
Urdhër nr. 176/1 prot., datë 27.02.2024
- J. B.
- M. K.
- E. M.
- V. V.
- D. Sh.
Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit
Urdhër nr. 389/2 prot., 21.05.2023
- A. I.
- R. D.
- K. C.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 389/3 prot., 21.05.2024
- E. K.
- P. A.
- V. Sh.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Procedurë e hapur"</td></tr>
</table>

[11] Nuk është paraqitur asnjë ofertë ekonomike në këtë procedurë.

5. **Fondi Limit (pa TVSH)** L1 – 31,358,000 lekë L2 – 1,690,000 lekë L3 – 4,608,000 lekë	6. **Oferta fituese (pa TVSH)** L1 – 31,356,000 lekë L2 – 1,670,000 lekë L3 – 4,600,000 lekë	7. **Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** L1 – 2,000 lekë (0.01%) L2 – 20,000 lekë (0.1%) L3 – 8,000 lekë (0.01%)
8. **Data e hapjes së tenderit** 03.05.2023	9. **Burimi i financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatorët Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE
11. **Ankimime** AK: - KPP: -		
12. **Lidhja e kontratës** L1 – 389/7 prot., 04.07.2024 L2 – 389/14 prot., 09.07.2024 L3 – 389/11 prot., 05.07.2024	13. **Vlera e kontratës (lekë me TVSH)** L1 – 21,540,000 L2 – 2,004,000 L3 – 5,520,000	14. **Afati i kontratës në ditë** 365 ditë (12 muaj)

Nëpërmjet Urdhrit nr. 176/1 prot., datë 27.02.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit për 9 procedura prokurimi, ndër të tjera për procedurën me objekt "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi*", të përbërë nga J. B., V. V., E. M., M. K., D. Sh.. Komisioni nuk ka në përbërje specialist të fushës (teknik laboratori), për të evidentuar nevojat teknike për shërbimin e mirëmbajtjes/ riparimit të aparaturave.
Nga korrespondenca elektronike e vënë në dispozicion, rezulton se specifikimet teknike për shërbimet e kërkuara, pjesët e këmbimit dhe pjesët e nevojshme për operimin e pajisjeve përkatëse janë hartuar dhe dërguar drejt zv. Drejtorit të Përgjithshëm J. B.përkatësisht nga A. V., E. M., V. V., E. B.. Asnjë nga personat që kanë hartuar specifikimet teknike nuk është specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), për të vlerësuar nevojat teknike për shërbim/ riparim që kanë pajisjet.
Nga korrespondenca elektronike e vënë në dispozicion, zërat për servis kalibrimin me specifikimet teknike përkatëse janë dërguar nga zv. Drejtori i Përgjithshëm J. B. drejt personit përgjegjës për prokurimin A. I., për të iniciuar studimin e tregut. Personi i angazhuar me studimin e tregut A. I. nuk rezulton të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit, pavarësisht se është zyrtar i përfshirë në procedurën e prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 13, pika 5, të RPP.
Nëpërmjet shkresës nr. 389 prot., datë 13.05.2024, B. Ç. dhe A. I. kanë dërguar drejt Komisionit për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjes së fondit limit, shkresën ku citohet se "*Po ju dërgojmë ofertat e ardhura nga ana e OE... Ju lutem për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë prokurimi... Oferta 2024 "Shërbim, riparim, servis kalibrimi (për aparaturat Agilent)" nga OE "P." në vlerën 31,964,000 lekë pa TVSH... Duke qenë se kemi të bëjmë me kontrata me natyrë të vazhdueshme sugjerojmë të merren në konsideratë edhe kontratat e nënshkruara në vitin paraardhës*". Kjo shkresë mban datën 13.05.2024, përpara e-mail të dërguar nga OE (të cituar më sipër). *Nga verifikimi në regjistrin e protokollit, kjo shkresë nuk rezulton të jetë evidencuar në regjistër, pavarësisht se mban të dhënat identifikuese (nr. prot. dhe datë) dhe vulë*.
Nëpërmjet shkresës nr. 389/1 prot., datë 15.05.2024, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit ka hartuar relacionin, ku citohet se "*Lista e finalizuar përmban çmimet nga oferta për Lot P., ndërsa çmimet për lotet Thermofisher, Shimadzu dhe Bertin janë marrë nga kontrata e 2023, të ardhura nga zyra e prokurimit me memon e datës 11.03.2024*", duke përcaktuar zërat specifikë për secilin prej lot-eve, si dhe fondet limit për lot-et, si më poshtë:

Nr.	Lot	Fondi limit (lekë pa TVSH)
1	I	31,358,000
2	II	1,690,000
3	III	4,608,000

Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e procedurës së prokurimit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ISUV, nuk rezulton që për përcaktimin e fondit limit sa i përket Lot-eve II dhe III të jetë përdorur një nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të RPP, kjo pasi çmimet e kontratave të mëparshme nuk janë të njëjta me vlerën e përllogaritur të fondit limit (*vlerë më e ulët në krahasim*

me vitin e mëparshëm). Pavarësisht se për Lot-in II janë shtuar 3 zëra & pajisje (në krahasim me vitin e mëparshëm), ndërkohë që ka mbetur i njëjtë për Lot-in III në nr. zërash, por është shtuar 1 pajisje (në krahasim me vitin e mëparshëm), vlera e fondit limit është ulur, rrjedhimisht oferta e OE është ulur dhe kontrata shërbimi është marrë në dorëzim (sikurse cituar) sipas kërkesës së AK. Në relacionin nr. 389/1 prot., datë 15.05.2024, pavarësisht se objekti i Komisionit të posaçëm është hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit, nuk rezulton të jetë dokumentuar hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike, por vetëm përllogaritja e fondit limit sikurse trajtuar më sipër.

Studimi i tregut sa i përket Lot-it I (datë 04.04.2024) është kryer përpara relacionit përkatës nga Komisioni i posaçëm (datë 15.05.2024), rrjedhimisht, ky studim nuk është kryer bazuar në specifikimet teknike që supozohet të hartohen nga Komisioni i posaçëm i ngritur, por bazuar në specifikimet teknike të dërguara në planifikimin buxhetor nga drejtuesit e departamenteve, nëpërmjet e-mail-eve të listuara më sipër. Nëpërmjet veprimeve të mësipërme, struktura e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit, sa i përket lot-it I, nuk ka garantuar argumentimin e specifikimeve teknike dhe kryerjen e përllogaritjes së fondit limit bazuar në specifikime teknike, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës **vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme**.

1. Sa i përket Lot-it I, për secilin prej zërave, në kolonën "*Specifikimet teknike*" janë parashikuar jo vetëm veprime që lidhen me servisin (p.sh. servis i pompës, ndërrim i filtrave/ vajit, etj.), por edhe furnizim me artikuj (p.sh. kite mirëmbajtje, kite, inserte, shiringa, tapa, tuba, filtra membrane, etj.), të cilat janë në sasi më të mëdha se "një (1)" dhe nuk konsistojnë vetëm në pjesë këmbimi për servisin, por edhe në funksionimin dhe operimin e pajisjes në vijimësi. **Specifikimet teknike (përfshirë artikujt dhe sasitë përkatëse të kërkuara, të përfshira në kolonën "*Specifikimet teknike*", për secilën prej pajisjeve) nuk janë të argumentuara**, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP, aq më tepër duke marrë në konsideratë faktin që kjo procedurë kryhet çdo vit dhe këto artikuj (pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin në vijim të pajisjes) përfshihen në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur. Kërkesat nuk janë mbështetur në një relacion teknik për të argumentuar/ justifikuar nevojën për çdo element të shërbimit, pajisjet pjesë këmbimi, si dhe të gjithë artikujt që janë kërkuar, për secilin prej zërave, specifikime të cilat ndikojnë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike.

Pavarësisht se kjo është një procedurë e përvitshme që kryhet nga ISUV, nga auditimi konstatohet se në specifikimet teknike të përcaktuara, në ndryshim nga procedurat e mëparshme (procedura e vitit 2021-2022), nuk kërkohen më *Certifikatat e pjesëve të këmbimit dhe artikujve të furnizuar që shoqërojnë secilin prej zërave*, ndërkohë që në këtë procedurë, kjo kërkesë është përcaktuar vetëm në 2 prej 18 zërave nga Lot-i I dhe asnjë prej zërave nga Lot-i II dhe III.

Pavarësisht se shërbimi në Lot-in I kërkohet për pajisjet me prodhues "Agilent", duke kërkuar në DST që OE të ketë kontratë të lidhur me inxhinier të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve "Agilent", 4 nga zërat e përfshirë (për 6 pajisje në total) janë me prodhues të ndryshëm nga "Agilent", si "Dialab", "Biosan", "MRC", "SUEZ", si dhe janë përfshirë 2 zëra "Kapë sigurimi" dhe "Dollap për ruajtjen e kimikateve", të cilat nuk kanë lidhje me kompaninë "Agilent" dhe nuk argumentohet përfshirja në këtë procedurë (*në total 6 nga 17 zërat e parashikuar nuk lidhen me prodhuesin "Agilent"*). Nëpërmjet observacionit të paraqitur nga ISUV me shkresë administruar në KLSH nr. 58/3 prot., datë 13.05.2025, citohet se "*pajisjet e përfshira janë më të thjeshta dhe jo instrumentale dhe nuk janë të kompanisë specifike dhe nuk kërkohet të jenë të Certifikuar nga kompanitë prodhuese*", ndërkohë që nuk argumentohet përfshirja e 2 artikujve "kapë sigurimi" dhe "dollap për ruajtjen e kimikateve". Përfshirja e tyre në një procedurë ku kërkohet disponimi i autorizimit dhe dokumentacion tjetër si Certifikime trajnimi të prodhuesit "Agilent", procedurë e cila *a priori* nuk ka konkurrencë pasi këto disponohen vetëm nga 1 OE, rrit artificialisht volumet e shërbimeve/ pajisjeve të kërkuara në këtë procedurë prokurimi, duke mos garantuar

përdorimin me ekonomicitet të fondeve publike, pasi në këtë procedurë është vetëm 1 OE që angazhohet në fazën e studimit të tregut, duke përcaktuar në këtë mënyrë fondin limit, dhe po i njëjti OE i vetëm që oferton. Sikurse paraqitur edhe në tabelën më poshtë, fondi limit i parashikuar dhe vlera e kontraktuar për shërbimin lidhur me pajisjet "Agilent" ka patur një rritje me 165% në krahasim me kontratën e shërbimit të lidhur në vitin 2022.
Për marrjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve në Lot-in I në vitet periudhë auditimi është përllogaritur fondi limit dhe është kontraktuar vlera, si më poshtë:

Viti	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlera e kontratës (lekë pa TVSH)
2022	18,983,250	18,983,250
2023	26,439,090	26,438,000
2024	31,358,000	31,356,000
Totali	**76,780,340**	**76,777,250**

2. Sa i përket Lot-it II, në kolonën "Specifikime teknike" për 7 prej 9 zërave të përfshirë, citohet "*Mirëmbajtje e jashtëzakonshme (p.sh. pastrim objektivash dhe okularësh, qendërzimi i dritës, ndërrimi i llampës, etj*.). Në asnjë prej këtyre zërave nuk specifikohen shërbimet që do të kryhen, specifikime të cilat do të duhej të ishin të qarta për të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike.
Pavarësisht se shërbimi në Lot-in II kërkohet për pajisjet me prodhues "Thermofisher", duke kërkuar në DST që OE të ketë kontratë të lidhur me inxhinier të Certifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve "Thermofisher", zërat e përfshirë konsistojnë në pajisje me prodhues të ndryshëm, si "Velp Scientifica", "Carl Zeiss", "Optech", "Optica", "Applied Biosystems". Nga kërkimi në burime të hapura (faqja zyrtare e "Thermofisher[12]) rezulton se kompania "Applied Biosystems" është pjesë e portofolit të "Thermofisher", ndërkohë që kompanitë e tjera nuk kanë lidhje me prodhuesin "Thermofisher" dhe nuk argumentohet përfshirja në këtë procedurë. Nëpërmjet observacionit të paraqitur nga ISUV me shkresë administruar në KLSH nr. 58/3 prot., datë 13.05.2025, citohet se "*pajisjet e përfshira janë më të thjeshta dhe jo instrumentale dhe nuk janë të kompanisë specifike dhe nuk kërkohet të jenë të Certifikuar nga kompanitë prodhuese*". Përfshirja e tyre në një procedurë ku kërkohet disponimi i autorizimit dhe dokumentacion tjetër si Certifikime trajnimi të prodhuesit "Thermofisher", procedurë e cila *a priori* nuk ka konkurrencë pasi këto disponohen vetëm nga 1 OE, rrit artificialisht volumet e shërbimeve/ pajisjeve të kërkuara në këtë procedurë prokurimi, duke mos garantuar përdorimin me ekonomicitet të fondeve publike, pasi në këtë procedurë është vetëm 1 OE që angazhohet në fazën e studimit të tregut, duke përcaktuar në këtë mënyrë fondin limit, dhe po i njëjti OE i vetëm që oferton.
Për marrjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve "Thermofisher" në vitet periudhë auditimi është përllogaritur fondi limit dhe është kontraktuar vlera, si më poshtë:

Viti	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlera e kontratës (lekë pa TVSH)
2022	1,841,000	1,835,000
2023	2,340,000	2,229,000
2024	1,690,000	1,670,000
Totali	**5,871,000**	**5,734,000**

3. Sa i përket Lot-it III, për secilin prej zërave, në kolonën "*Specifikimet teknike*" janë parashikuar jo vetëm veprime që lidhen me servisin, por edhe furnizim me artikuj (p.sh. set shishe për solventët, kolona, llampa, kapilarë, filtra, etj.), ndër të tjerë edhe artikuj për operimin në vijimësi të pajisjes si viale material qelqi (1000 copë), tapa (2000 copë). Gjithashtu në pajisjet e përfshira në zërin 1 "HPLC-UV-Shimadzu" përfshihet dhe "*...të update software dhe të zëvendësohet kompjuteri i pajisjes...*", zë i cili është përsëritur dhe në vitin paraardhës (*marrja në dorëzim dokumentuar*

[12] https://www.thermofisher.com/al/en/home.html

nëpërmjet PV e Komisionit të marrjes në dorëzim të datës 15.09.2023). Specifikimet teknike (përfshirë artikujt dhe sasitë përkatëse të kërkuara, të përfshira në kolonën "*Specifikimet teknike*", për secilën prej pajisjeve) nuk janë të argumentuara, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP, aq më tepër duke marrë në konsideratë faktin që kjo procedurë kryhet çdo vit dhe këto artikuj (pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin në vijim të pajisjes) përfshihen në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur. Kërkesat nuk janë mbështetur në një relacion teknik për të argumentuar/ justifikuar nevojën për çdo element të shërbimit, pajisjet pjesë këmbimi, si dhe të gjithë artikujt që janë kërkuar, për secilin prej zërave, specifikime të cilat ndikojnë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike.
Për marrjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve "Shimadzu" në vitet periudhë auditimi është përllogaritur fondi limit dhe është kontraktuar vlera, si më poshtë:

Viti	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlera e kontratës (lekë pa TVSH)
2022	2,644,800	2,640,000
2023	5,670,000	5,640,000
2024	4,608,000	4,600,000
Totali	**12,922,800**	**12,880,000**

Pavarësisht se janë zyrtarë të përfshirë në procedurën e prokurimit, anëtarët e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit nuk rezulton të kenë nënshkruar Deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenin 73, pika 4 të RPP.
Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 389/2 prot., datë 21.05.2024, Titullari i AK I. A ka kërkuar përdorimin e fondit limit prej 38,677,020 lekë pa TVSH, për realizimin e procedurës me objekt "*Shërbim riparim, servis, kalibrimi*", duke ngritur Njësinë e prokurimit, të përbërë nga A. I., R. D., K. C.. Njësia e prokurimit nuk ka në përbërje specialist të fushës (teknik laboratori). Njësia e prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Njësia e prokurimit ka ngarkuar në SPE dokumentet e tenderit dhe PV e argumentimit të ST dhe KVK në datën 24.05.2024, ka publikuar procedurat e prokurimit (për secilin Lot) në datën 27.05.2024 dhe ka caktuar afatin e fundit për pranimin e ofertave datën 19.06.2024.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 389/3 prot., datë 21.05.2024, Titullari i AK ka ngritur Komisionin për Vlerësimin e Ofertave, të përbërë nga E. K., P. A., V. Sh.. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka rezultuar se anëtari i KVO E. K., përgjegjës i Departamentit të Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë, ka hartuar *de facto* specifikimet teknike, përcjellë nëpërmjet e-mail, specifikime të cilat janë përdorur për studimin e tregut dhe përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 75, pika 4, të RPP, ku përcaktohet se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në rregullat e përcaktuara për anëtarët e KVO në nenin 75 të RPP. Për sa më sipër, përderisa ishte angazhuar në hartimin e specifikimeve teknike, punonjësja E. K. nuk duhet të ishte përfshirë në procesin e shqyrtimin dhe vlerësimit të ofertave.
Nëpërmjet PV të datës 19.06.2024 dhe PV të datës 24.06.2024, të paprotokolluar, KVO ka dokumentuar hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, ku ka rezultuar, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Statusi
Lot I "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Agilent"			
1	P.	31,358,000	Kualifikuar
Lot II "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Thermofisher"			
1	K.	1,670,000	Kualifikuar
Lot III "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Shimadzu"			
1	G.	4,600,000	Kualifikuar
Lot IV "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Bertin"			
Nuk ka patur ofertë.			

Zbatimi i kontratës

I. Mbi pajisjet "Agilent"

Ndërmjet AK dhe OE "P." është lidhur Marrëveshja Kuadër nr. 389/6 prot., datë 04.07.2024 dhe kontrata nr. 389/7 prot., datë 04.07.2024, me vlerë 31,358,000 lekë pa TVSH ose 37,627,200 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 61, datë 08.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga U. R., S. B., S. Dh.. Ky komision ka hartuar procesverbalin e datës 25.11.2024, ku citohet "*PV i mbajtur sot më datë 25.11.2024... mbi marrjen në dorëzim të shërbimit të prokurimit...*", por në asnjë moment nuk shprehet nëse shërbimi dhe pjesët e këmbimit janë marrë në dorëzim sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar. Pavarësisht se kemi të bëjmë me kontratë miks-e, ku krahas shërbimit do të merren/ furnizohen një numër i konsiderueshëm artikujsh, si pjesë këmbimi dhe artikuj që shërbejnë për operimin në kohë të pajisjes, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nuk ka përfshirë në Komisionin e marrjes në dorëzim punonjësin me përgjegjësi materiale (magazinierin), si dhe specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

OE është likuiduar pjesërisht në vlerën totale prej **28,422,000 lekë**, si më poshtë:

Nr.	Urdhër-shpenzimi		Vlera (lekë me TVSH)	Fatura elektronike		Vlera (lekë me TVSH)	Marrja në dorëzim	
	Nr.	Datë		Nr.	Datë		Komisioni	Data
1	334	25.11.2024	22,515,600	4465/2024	21.11.2024	22,515,600	U. R., S. B., S. Dh.	25.11.2024
2	404	09.01.2025	5,906,400	4916/2024	30.12.2024	5,906,400	U. R., S. B., S. Dh.	30.12.2024

Marrja në dorëzim e artikujve të furnizuar, pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit nuk rezulton të ketë administruar *Certifikatat e pjesëve të këmbimit* sa i përket zërave përkatës në përcaktimin në DST, për pajisjet.

Në dokumentacionin për marrjen në dorëzim të shërbimit, bashkëlidhur Urdhër-shpenzimeve dhe/ ose vënë në dispozicion grupit të auditimit nga ISUV, administrohen, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Data	Lëshuar nga	Kryer/ nënshkruar nga
1	Raport i kualifikimit të Operacionit (fotokopje) për instrumentin "Elisa Reader", modeli ELx808, nr. serial 1803175, me prodhues "Dialab"	19.08.2024	"P." ShPK	E. B.
2	Raport i kualifikimit të Operacionit (fotokopje) për instrumentin "Elisa Reader", modeli ELx808, nr. serial 15072910, me prodhues "Dialab"	19.08.2024	"P." ShPK	E. B.
3	Raport shërbimi për pajisjen "Ultrapure Ëater Deionization Unit", modeli "Select Fusion 40", nr. serial 033714, me prodhues "SUEZ Ëater Purification Systems Ltd."	24.10.2024	"P." ShPK	E. B.
4	Certifikatë e kualifikimit të sistemit (për pajisjen GC-MS/MS)	07.11.2024		
5	Certifikatë e kualifikimit të sistemit (për pajisjen LC-MS/MS)	08.11.2024		
6	Raport i kualifikimit të Pajisjes (EQR) (fotokopje) "LC-OQ"	13.11.2024	Agilent CrossLab	
7	Raport i kualifikimit të Pajisjes (EQR) (fotokopje) "LC-OQ + LCMS-OQ"	18.11.2024	Agilent CrossLab	

8	Raporti i kualifikimit të Pajisjes (EQR) (fotokopje) "LC-OQ"	20.11.2024	Agilent CrossLab	
9	"Agilent Cary 60 UV-Vis System" Mirëmbajtje parandaluese (fotokopje)	21.11.2024	Agilent CrossLab	D. S.
10	Raporti i kualifikimit të Pajisjes (EQR) (fotokopje) "ICPMS"	09.12.2024	Agilent CrossLab	
11	Raporti i kualifikimit të Pajisjes (EQR) "AA-OQ" për pajisjen CVAAS (zëri nr. 6)	10.12.2024	Agilent CrossLab	
12	Raporti i kualifikimit të Pajisjes (EQR) "ICPMS-OQ" për pajisjen ICPMS (zëri nr. 5)	10.12.2024	Agilent CrossLab	

Në KVK nr. 2.3 është kërkuar që inxhinierët që do të kryejnë servis-kalibrimin duhet të jenë të Certifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve Agilent. Në ofertën e shpallur fituese, OE "P." ka paraqitur dokumentacionin për D. S.. *Pavarësisht sa më sipër, 3 nga raportet e paraqitura, si raporte kualifikimi të operacionit dhe raport shërbimi, janë kryer dhe nënshkruar nga E. B., për të cilin ISUV nuk kishte administruar evidencë të paraqitur nga OE nëse është ose jo i trajnuar dhe C.tifikuar nga kompania prodhuese për servis – kalibrimin e pajisjeve Agilent*.
Në asnjë nga dokumentet e sipërcituar, nuk vërtetohet se laboratorët kalibrues plotësojnë kërkesat e SSH ISO/IEC 17025, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*".
Pavarësisht se në DST është kërkuar kalibrimi i 7 prej pajisjeve (vetëm 5 prej të cilave janë marrë në dorëzim, MK nuk është realizuar ende plotësisht), marrja në dorëzim e shërbimit për të cilat është faturuar dhe konfirmuar nga Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit, sa i përket pajisjeve në zërat respektivë 5, 6, 8, 11, 12, Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar Certifikatat e kalibrimit, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi"*.

II. Mbi pajisjet "Thermofisher"
Ndërmjet AK dhe OE "K." është lidhur Marrëveshja Kuadër nr. 389/13 prot., datë 09.07.2024 dhe kontrata nr. 389/14 prot., datë 09.07.2024, me vlerë 1,670,000 lekë pa TVSH ose 2,004,000 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 62, datë 11.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga S. H., A. V., S. M.. Ky komision nuk ka në përbërje specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 20.11.2024, i paprotokolluar, ku citohet "*Komisioni verifikoi për të marrë në dorëzim aparaturat laboratorike... shërbimi ishte konform kërkesave tona dhe çdo pajisje u shoqërua me Certifikatën përkatëse të shërbimit*".

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 328, datë 20.11.2024**, në vlerën prej **2,004,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 1742/2024, datë 19.11.2024.
Në dokumentacionin për marrjen në dorëzim të shërbimit, bashkëlidhur Urdhër-shpenzimeve dhe/ose vënë në dispozicion grupit të auditimit nga ISUV, administrohen, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Data	Lëshuar nga	Nënshkruar nga
1	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Carl Zeiss", modeli "Axiovert 25 C", nr. serial 661161	29.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
2	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Carl Zeiss", modeli "Axiovert 25", nr. serial 668958	29.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
3	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Carl Zeiss", nr. serial 228167	29.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.

4	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Optech", modeli "Flexible", nr. serial 220337	30.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
5	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Optika", modeli "SZM-LED2", nr. serial 428278	30.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
6	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Carl Zeiss", modeli "Primo Star", nr. serial 3125001256	30.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
7	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Optika", modeli "B-383 PL", nr. serial 428430	30.07.2024	"K." ShPK	E. Q., D. L.
8	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Velp Scientifica", modeli "UDK 149", nr. serial 399623	12.09.2024	"K." ShPK	M. B.
9	Raport servisi për pajisjen me prodhues "Applied Biosystem", modeli "7500 Real-Time PCR", nr. serial 275003932. Bashkëlidhur raporti i inxhinierit, nga "Biosistemi grupa" i datës 23.10.2024, i nënshkruar nga Dejan Markovic	23.10.2024	"K." ShPK	E. Q.

Në KVK nr. 2.3 është kërkuar që inxhinierët që do të kryejnë servis-kalibrimin duhet të jenë të Certifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve Thermofisher.
Në ofertën e shpallur fituese, OE "K." ka paraqitur dokumentacionin për F. Z. dhe E. Z.. *Pavarësisht sa më sipër, të gjithë raportet e paraqitur të servisit janë kryer dhe nënshkruar nga E. Q., D. L., M. B., për të cilët ISUV nuk ka administruar evidencë të paraqitur nga OE nëse janë ose jo të trajnuar dhe Certifikuar nga kompania prodhuese për servis – kalibrimin e pajisjeve Thermofisher*.
Pavarësisht se në DST është kërkuar kalibrimi i artikullit "Real-time PCR", Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar certifikatën e kalibrimit, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi"*.

III. Mbi pajisjet "Shimadzu"

Ndërmjet AK dhe OE "G." është lidhur Marrëveshja Kuadër nr. 389/10 prot., datë 05.07.2024 dhe kontrata nr. 389/11 prot., datë 05.07.2024, me vlerë 4,600,000 lekë pa TVSH dhe 5,520,000 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 60, datë 09.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga M. L., S. T., B. N.. Ky komision ka hartuar procesverbalin e datës 20.11.2024, i paprotokolluar, ku citohet "*Komisioni verifikoi për të marrë në dorëzim të shërbim-riparimit... konfirmoi se shërbmi i marrë është konform*". Pavarësisht se kemi të bëjmë me kontratë mikse, ku krahas shërbimit do të merren/ furnizohen një numër i konsiderueshëm artikujsh, si pjesë këmbimi dhe artikuj që shërbejnë për operimin në kohë të pajisjes, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nuk ka përfshirë në Komisionin e marrjes në dorëzim punonjësin me përgjegjësi materiale (magazinierin), si dhe specialist fushe (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 293, datë 30.10.2024**, në vlerën prej **5,520,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 304/2024, datë 21.09.2024. Marrja në dorëzim e artikujve të furnizuar, pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

2.4.7. Procedura e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes", me fond limit **27,300,500 pa TVSH**

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Implementimi i planit kombëtar te molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes" viti 2022</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Proçedurë e hapur, : <u>REF-39435-08-22-2022</u></td><td>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:
Urdhri nr. 525 prot, datë 14.06.2022
J. B.
E. K.
S. K.
V. V.
D. T.
D. Sh.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 645/7 prot, datë 22.08.2022
A. I.
H. M.
E. P.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 645/8 prot, datë 22.08.2022
E. N.
M. B.
A. C.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
27,300,500 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
14,774,100 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
12,526,400 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Dt. Publ. 23.08.2022
8/2 Kohëzgjatja 60 ditë</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td>10. OE a) Pjesëmarrës 3 OE; 1. 3 OE të kualifikuar</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim
Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje Ankesës AK
Me shkresë nr. 743 prot, datë 06.09.2022</td><td>14. Përgjigje Ankesës nga KKP
Vendim, nr. 884/2022 datë 13.09.2022. Vendim nr. 965/2022 datë 04.10.2022. Vendim nr. 1011/2022. Vendim nr. 1072/2022.</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
nr. 105 prot, datë 17.02.2023.</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës: Me urdhër nr. 263 prot, datë 13.04.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.</td></tr>
</table>

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 525 prot, datë 14.06.2022, i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të ISUV z, P. A. ka ngritur *Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit*, të përbërë nga J. B., E. K., S. K.

V. V., D. T. dhe D. Sh.. Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se përllogaritja e fondit limit të kryhet nëpërmjet testimit të tregut dhe ofertat janë marrë paraprakisht.

Nëpërmjet shkresës pa nr prot, datë 16.06.2022, përgatitur nga Komisioni i posaçëm i ngritur për përllogaritjen e fondit limit, citohet se ofertat nuk janë marrë nga ky komision por janë përcjellë nga zyra e prokurimit. Në këtë memo, si dhe në PV e të njëjtës datë të Komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 525 prot, datë 14.06.2022, dokumentohet se ky komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke nxjerrë thjesht mesataren aritmetike e ofertave të dhëna nga Njësia e prokurimit, në vlerën prej 27,300,500 lekë pa TVSh.

Njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se:

- Në datën 01.07.2022, kur personi përgjegjës për prokurimin A. I. ka dërguar e-mail 7 kompanive, Njësia e posaçme ende nuk kishte hartuar memon me datë 16.08.2022, ku ka përcaktuar specifikimet teknike;
- Neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme.

Specifikimet teknike janë nuk janë të argumentuara, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.

Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:
- Titullari i AK z, P. A. për parregullsitë e konstatuara në veprimet e strukturave të ISUV në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në nenin 21, pika 5 të LPP, i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të RPP;
- J. B., E. K., S. K., V. V., D. T. dhe D. Sh., *në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit*, duke mos garantuar ndjekjen e një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit *bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*;
- A. I., për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit.

- Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 645/7 prot, datë 22.08.2022 është ngritur Njësia e prokurimit si më poshtë: A. I., H. M., E. P.
Me proces-verbal pa nr prot dhe pa datë, njësia e prokurimit ka hartuar dhe argumentuar specifiket teknike.
Në SPE datë 29.08.2022 është paraqitur ankesë nga OE "G." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Titullari i AK me shkresë nr. 710/2 prot, datë 02.09.2022 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbehet nga znj, E. N., znj, M. B. dhe znj, A. C..
KSHA me shkresë nr. 743 prot, datë 06.09.2022 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "G." shpk.
KPP ka mare vendim me nr. 884/2022 datë 13.09.2022 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
KPP ka mare vendim me nr. 965/2022 datë 04.10.2022 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të pranoj ankesat e paraqitur nga OE.
2. AK të kryej modifikim e DT ne përputhje me konstatimet e KPP…….
3. AK brenda 5 ditëve te veje ne dijeni KPP mbi zbatimin e këtij vendimi…..
Me shkresë nr. 743/7 prot, datë 11.10.2022 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 965/2022.
Me shkresë 73/8 prot. pranë AK datë 21.10.2022, **KPP** me vendim nr. 1011/2022 nuk ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.
Me shkresë nr. 743/9 prot, datë 26.10.2022 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 965/2022.
Me shkresë 404/2 prot pranë AK datë 29.06.2023, **KPP** me vendim nr. 1072/2022 ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Urdhri nr. nr. 645/8 prot, datë 22.08.2022, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga: znj, E. N., znj, M. B., znj, A. C..
Me procesverbal pa nr prot, datë 18.11.2022 u be hapja e oferta të dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjesë 6 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "K." shpk	14,774,100 lekë.	**Kualifikuar dhe shpallur fitues**
2	OE "G." shpk	16,999,000 lekë.	**Kualifikuar**
3	OE "M." shpk	22,972,980 lekë.	**Kualifikuar**

Në SPE AK i ka kërkuar OE K. dhe G. argumentim për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë pasi në ofertat e paraqitura janë anomalisht të ulëta. Me date 05.12.2022 oferta e shpallur fituese(paraprak) është OE "K." shpk pas argumentimit te ofertës së tij anomalisht të ulet si oferta me çmim me te ulet, me ofertën ekonomike në vlerën 14,774,100 lekë pa TVSh ose 17,728,920 Lekë me TVSh. Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 09.12.2022 është bërë vlerësimi i oferta ku është

shpallur fitues OE K. SHPK. Me shkresë nr.743/11 prot, datë 13.12.2022 janë marrë në dorëzim dokumentacioni i OE.
Raporti përmbledhës është hartuar pa nr. Prot., datë 21.12.2022.

Nga auditimi konstatohet se:
KVO nuk ka verifikuar dokumentacionit e dorëzuar nga OE, por ka përgatitur proces verbalin mbi vlerësim e oferta me datë 09.12.2022 duke shpallur fitues OE. *Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, citon: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet: Komisioni i vlerësimit të ofertave, znj. E. N., znj. M. B., znj. A. C. si dhe titullari i AK z. I. A.

-Lidhja e kontratës.
Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr. 105 prot, datë 17.02.2023.
Me shkresë pa nr prot datë 20.02.2023 është hartuar plani i zbatimit të kontratës dhe afati i saj është 60 dite nga nënshkrimi i saj.
Me shkresë nr. 105/1 prot datë 13.04.2023 OE K.i ka kërkuar shtyrjen e afatit te zbatimit të kontratës deri me datë 17.06.2023.
Me shkresë nr. 105/2 prot datë 14.04.2023 AK miratuar shtyrjen e afatit deri me datë 30.06.2023.

Nga auditimi konstatohet se:
AK nuk ka hartuar modifikimin e kontratës mbi shtyrjen e afatit të kohëzgjatjes së saj, i cili është deri me datë 30.06.2023, *në kundërshtim me kontratën e lidhur me nr. 105 prot, datë 17.02.2023 neni 1.2.3 Modifikimi citon: Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. neni 23 Modifikimi i kontratës, neni 24.1 zgjatja e afatit si dhe Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar neni 127 Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre.*
Gjithashtu numri i protokolli nr. 105/2, datë 14.04.2023, *"Kthim përgjigje shkresës…"* nuk është evidentuar në përputhje me rregullat dhe formatin standard të librit të protokollit, pasi është shtuar në fundin e faqes, në një hapësirë pa vijëzim, duke shënuar numrin e përditësuar. (*Bashkëngjitur foto përkatëse e librit të protokollit)*



-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 263 prot, datë 13.04.2023 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: znj. E. K., z. E. Sh. dhe z. R. M..

<u>*Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë:*</u>
- Me Proces verbal pa nr prot datë 03.05.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë ne tender janë në vlerën 900,000 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 613/2023, datë 27.04.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 58 datë 11.05.2023 në vlerën 900,000 lekë.

Me fletë hyrje nr. 15 datë 03.05.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 10.05.2023 komisioni shprehet se mallrat të përfshirë ne tender janë në vlerën 8,884,920 lekë.
Fatura tatimore e korrigjuar është paraqitur nga OE me nr. 699/2023 Prot., datë 10.05.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 57 datë 11.05.2023 në vlerën 8,884,920 lekë.
Me fletë hyrje nr. 16 datë 10.05.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 02.06.2023 komisioni shprehet se mallrat të përfshirë ne tender janë në vlerën 540,000 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 803/2023, datë 02.06.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 103 datë 10.07.2023 në vlerën 540,000 lekë.
Me fletë hyrje nr., 84 datë 11.12.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 09.08.2023, komisioni shprehet se është mbajtur me datën e sipër cituar për arsye te instalimit të kapave kimike, mbi marrjen ne dorëzim të mallrave te tenderit janë në vlerën 7,404,000 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr., 965, datë 29.06.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr., 245 datë 13.12.2023 në vlerën 7,404,000 lekë.
Me fletë hyrje nr., 38 datë 09.08.2023 është bërë hyrje në magazinë.
Në total në baze të kontratës se sipërcituar janë shpenzuar 17,728,920 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se komisioni i marrjes në dorëzim në procesverbalet e mbajtura ka përcaktuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese dhe origjinën e mallrave të furnizuar. Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar dhe a kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe ofertën e pranuar, sa i përket firmës prodhuese si dhe origjinës së produkteve.

Në kundërshtim me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, dhe Rekomandimi i APP me nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit te zbatimit te kontratave te nënshkruara ne përfundim te procedurave te prokurimit për mallra, pune, shërbime"

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: znj. E. K., z. E. Sh., z. R. M..

Gjithashtu grupi i auditimi konstatoi se kohëzgjatja e kontratës me nr. 105 prot, datë 17.02.2023 është 60 ditë nga nënshkrimi i saj ose deri me datë 18.04.2023.

- Me procesverbal datë 03.05.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i parë ne vlerën 900,000 lekë dhe mallrat janë mare në dorëzim 15 ditë me vonesë.
4/1000 x *17,728,920 (17,728,920 vlera totale e kontratës)* = 70,916 lekë me TVSh penaliteti ditor.
70,916 lekë me TVSh x 15 ditë = **1,063,735 lekë me TVSh** i cili është penaliteti për 15 ditë vonesë.
Vlera e mbetur e kontratës është 16,828,920 lekë (*17,728,920 vlera totale e kontratës- 900,000 vlerë e mare ne dorëzim nga AK.*

- Me procesverbal datë 10.05.2023 është mare ne dorëzim furnizimi i dytë ne vlerën 8,884,920 lekë dhe mallrat janë mare në dorëzim 22 ditë me vonesë.
4/1000 x 16,828,920 *(*16,828,920 *vlera e mbetur e kontratës)* = 67,316 lekë me TVSh penaliteti ditor.
67,316 lekë me TVSh x 22 ditë = **1,480,945 lekë me TVSh** i cili është penaliteti për 22 ditë vonesë.
Vlera e mbetur e kontratës është 7,944,000 lekë (*17,728,920 vlera totale e kontratës- 900,000- 8,884,920 vlerën e mare ne dorëzim nga AK).*

- Me procesverbal datë 02.06.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i tretë në vlerën 540,000 lekë dhe mallrat janë marëë në dorëzim 45 ditë me vonesë.
4/1000 x 7,944,000 (7,944,000 vlera e mbetur e kontratës) = 31,776 lekë me TVSh penaliteti ditor.
31,776 lekë me TVSh x 45 ditë = **1,429,920 lekë me TVSh** i cili është penaliteti për 45 ditë vonesë.
Vlera e mbetur e kontratës është 7,404,000 lekë *(17,728,920 vlera totale e kontratës- 900,000 - 8,884,920 - 540,000 vlerën e mara në dorëzim nga AK).*
- Me procesverbal datë 09.08.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i katër dhe i fundit në vlerën 7,404,000 lekë dhe mallrat janë mare në dorëzim 113 ditë me vonesë.
4/1000 x 7,404,000 (7,404,000 vlera e mbetur e kontratës) = 29,616 lekë me TVSh penaliteti ditor.
29,616 lekë me TVSh x 113 ditë = **3,346,608 lekë me TVSh** i cili është penaliteti për 113 ditë vonesë.
Në total vlera e penalitetit është **7,321,208** lekë me TVSh.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: ish titullari i komanduar i AK z. P. A., Titullari i AK z. I. A dhe nëpunësi zbatues znj. D. Sh..

2.4.8. Procedura e prokurimit "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës", me fond limit 6,625,000 pa TVSH,

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Procedurë e hapur, : e thjeshtuar, <u>REF-87033-11-09-2023</u></td><td>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 715 prot, datë 13.10.2023
A. I.
D. Sh.
A. V.</td><td>4. KVO
Urdhri nr. 715 prot, datë 13.10.2023
A. P.
E. K.
M. B.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
6,625,000 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
6,500,000 lekë</td><td>7. Dif me FL (pa TVSh)
125,000 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Dt. e pub. të tenderit
10.11.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td rowspan="2">10. OE
a) Pjesëmarrës 1 OE;
1. Fitues "R.-A. shpk me vlerë 6,500,000 Lekë.</td></tr>
<tr><td>8/2 Kohëzgjatja 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim
Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje Ankesës AK
Me shkresë nr. 715/2 prot datë 17.11.2023</td><td>14. Përgjigje Ankesës nga KKP Vendim 1211/2023.</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
nr. 715/6 prot datë 13.12.2023.</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës: Me urdhër nr. 715/9 prot, datë 15.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.</td></tr>
</table>

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.
Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 715 prot, datë 13.10.2023 është ngritur Njësia e prokurimit si më poshtë: A. I., D. Sh., A. V..
Me proces-verbal pa nr. Prot., dhe pa datë, njësia e prokurimit ka hartuar dhe argumentuar kriteret teknike. Me datë 13.11.2023 në SPE është ngarkuar shtojca nr.1 në të cilën specifikon te dhënat teknike.

Një nga kriteret e Kapacitetit teknik.
2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit ***nga data e publikimit të njoftimit të kontratës****, në vlerën* ***jo më te vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.*** *Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme.*
Me shkresë nr. 715/1 prot, datë 15.11.2023 është paraqitur ankesë nga OE " K." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Titullari i AK me shkresë nr. 715/1 prot, datë 16.11.2023 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbëhet nga znj. A. P., znj. E. K. si dhe znj. M. B..

KSHA me shkresë nr. 715/2 prot, datë 17.11.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "K." shpk si dhe ka vendosur në pranimin e saj.
Me shkresë nr. 715/3 prot datë 30.11.2023 **KPP** ka dërguar vendimi me nr. 1211/2023 dhe ka vendosur të mbyllë çështjen për ankesën e OE.

Grupi i Auditimit konstatoi se në procedurën e prokurimit nuk është ngritur komisioni për hartimin e fondit limit në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 76 *"Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit".*
Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit por nuk janë të argumentuara, në *kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.*
Gjithashtu njësia e prokurimit për përvojat e mëparshme ka kërkuar që OE të paraqis dëshmi për një vlerë prej 40% të vlerës se përllogaritur të kontratës, por në kundërshtim me *VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 neni 55 pika 4 shkronja b citon: Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë* ***jo më të madhe se 20%*** *të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Njësia e Prokurimit, znj. A. I., znj. D. Sh., znj. A. V. dhe titullari i AK z. I. A.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Urdhri nr. 715 prot, datë 13.10.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga: znj. A. P., znj. E. K., znj. M. B.
Me procesverbal pa nr. Prot., datë 08.12.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjesë 1 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "R.-A." shpk	6,500,000 lekë.	**Kualifikuar dhe shpallur fitues.**

Grupi i auditimit konstatoi se urdhri për krijimin e KVO-së është njëjtë me urdhrin për Krijimin e Njësisë së Prokurimit. Të dy urdhrat mbajnë numrin 715 prot., datë 13.10.2023, dhe janë regjistruar në librin e protokollit.
Ndërkohe urdhri për ngritjen e KVO-së, me nr. 715 prot, datë 13.10.2023, është firmosur dhe vulosur nga z. I. A, në cilësinë e titullarit të ISUV. Në këtë urdhër, znj. A. P. është emëruar si kryetare e KVO-së, megjithëse marrëdhëniet e saj të punës pranë ISUV kanë filluar më vonë, me urdhër nr. 755 prot., datë 03.11.2023. Si rrjedhojë, urdhri është ngritur 21 ditë përpara fillimit të zyrtare të marrëdhënieve të punës së kryetares së caktuar. (kjo do trajtohet tek protokolli)
Mban përgjegjësi për veprimet dhe mos verimet e tij: Titullari i ISUV z. I. A.
Me proces-verbal pa nr prot datë 11.12.2023 oferta e shpallur fituese(paraprak) është e OE "R.-A." shpk, me ofertën ekonomike në vlerën 6,500,000 lekë pa TVSh ose 7,800,000 lekë me TVSh.
Raporti përmbledhës është hartuar pa nr prot datë 11.12.2023.
Me shkresën nr. 715/5 prot, datë 12.12.2023 janë marrë në dorëzim dokumentacioni i OE.

Grupi i Auditimit konstatoi se KVO nuk ka verifikuar e dokumentacionit e dorëzuar nga OE, por ka përgatitur raportin përmbledhës me datë 11.12.2023 duke shpallur fitues OE. *Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, citon: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Komisioni i vlerësimit të ofertave, znj. A. P.,

znj. E. K., znj. M. B. si dhe titullari i AK z. I. A.

-Lidhja e kontratës.
Kontrata midis AK dhe OE është me nr. 715/6 prot., datë 13.12.2023 dhe afati për shërbimit është 20 dite nga nënshkrimi i kontratës.
Me shkresë nr. 715/7 prot., datë 13.12.2023 është hartuar plani i zbatimit të kontratës.

-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 715/9 prot., datë 15.12.2023 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: znj. B. Ç., znj. S. H., znj. D. Sh. dhe znj. Zh. H..
Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur proces-verbal pa nr. Prot., datë 18.12.2023 ku shprehet se të gjithë mallrat dhe shërbimet e kërkuara nga AK janë realizuar konform specifikimeve nga OE.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 120/2023, datë 15.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 334 datë 28.12.2024 në vlerën 7,800,000 lekë.
Me fletë hyrje nr. 89 datë 18.12.2023 është bërë hyrje në magazinë.

2.4.9. Procedura e prokurimit "Blerje enë dhe materiale laboratorike", me fond limit 20,696,138 pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje enë dhe materiale laboratorike" viti 2023</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Proçedurë e hapur: <u>REF-68234-05-04-2023</u></td><td>2. Grp. i hart. Spec. Tek. dhe FL:
Urdhri nr. 40/1 prot, datë 15.03.2023
J. B.
E. K.
E. M.
V. V.
D. Sh.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 299 prot, datë 28.04.2023
A. I.
R. D.
A. J.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 404/3 prot, datë 26.06.2023 i ndryshuar
F. H.
E. Sh.
A. D.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
20,696,138 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
10,300,000 lekë</td><td>7. Dif. me FL (pa TVSh)
10,396,138 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Dt. e pub. të tenderit
05.05.2023
8/2 Kohëzgjatja e kontratës
MK 12 muaj</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td>10. OE
a) Pjesëmarrës 6 OE;
1. 1 OE të kualifikuar
2. 5 OE të skualifikuar</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje Ankesës AK Me shkresë nr. 299/8 prot, datë 16.05.2023 Me shkresë nr. 299/9 prot, datë 16.05.2023.
Me shkresë nr. 299/10 prot, datë 15.05.2023
Me shkresë nr. 299/11 prot, datë 15.05.2023</td><td>14. Përgjigje Ankesës nga KKP Vendim, 407/2023 datë 23.05.2023,
Vendim 418/2023 datë 24.05.2023,
vendim 408/2023 datë 23.05.2023,
vendimi 410/2023 datë 23.05.2023
vendim 446/2023 datë 31.05.2023
Vendim 499/2023
Vendim 521/2023
Vendim 524/2023.</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
Kontrata me nr. 404/12 prot, datë 19.09.2023</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës:
Me urdhër nr. 640 prot, datë 21.09.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.</td></tr>
</table>

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 40/1 prot, datë 15.03.2023, i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm

të ISUV z. P. A. ka ngritur *Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit*, të përbërë nga J. B., E. K., E. M., V. V. dhe D. Sh.. Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se përllogaritja e fondit limit të kryhet nëpërmjet testimit të tregut dhe ofertat janë marrë paraprakisht.
Nëpërmjet shkresës pa nr. Prot., datë 14.04.2023, përgatitur nga Komisioni i posaçëm i ngritur për përllogaritjen e fondit limit, citohet se ofertat nuk janë marrë nga ky komision por janë përcjellë nga zyra e prokurimit. Në këtë memo, si dhe në PV e të njëjtës datë të Komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 40/1 prot., datë 15.03.2023, dokumentohet se ky komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke nxjerrë thjesht mesataren aritmetike e ofertave të dhëna nga Njësia e prokurimit, në vlerën prej 20,696,138 lekë pa TVSh.
Njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se:
- Në datën 05.01.2023, kur personi përgjegjës për prokurimin A. I. ka dërguar e-mail 4 kompanive, Njësia e posaçme ende nuk kishte hartuar memon me datë 14.04.2023, ku ka përcaktuar specifikimet teknike;
- Neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme.
Specifikimet teknike janë nuk janë të argumentuara, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.
Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:
- Titullari i AK z, P. A. për parregullsitë e konstatuara në veprimet e strukturave të ISUV në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në nenin 21, pika 5 të LPP, i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të RPP;
- J. B., E. K., E. M., V. V. dhe D. Sh., *në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit*, duke mos garantuar ndjekjen e një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit *bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*;
- A. I., për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit.

- Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 299 prot, datë 28.04.2023 është ngritur Njësia e prokurimit me përbërjen: A. I., R. D., A. J.
- Me proces-verbal pa nr prot. dhe pa datë, njësia e prokurimit ka hartuar dhe argumentuar specifiket teknike. Me nr. 299/3 prot, datë 11.05.2023 është paraqitur ankesë nga OE "K." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Në SPE është paraqitur ankesë nga OE "G." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Me nr. 299/5 prot, datë 12.05.2023 është paraqitur ankesë nga OE "I." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Me nr. 299/4 prot, datë 11.05.2023 është paraqitur ankesë nga OE "A." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.
Titullari i AK me shkresë nr. 299/6 prot, datë 11.05.2023 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbehet nga znj. F. H., z. E. Sh. dhe znj. A. D..
KSHA me shkresë nr. 299/9 prot, datë 16.05.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "K." shpk.
KPP ka marrë vendim me nr. 407/2023 datë 23.05.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
KSHA me shkresë nr. 299/11 prot, datë 15.05.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "G." shpk.
KPP ka marrë vendim me nr. 418/2023 datë 24.05.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….

2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit ne themel për pjesën tjetër të ankesës.
KSHA me shkresë nr. 299/8 prot, datë 16.05.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "I." shpk.
KPP ka marrë vendim me nr. 408/2023 datë 23.05.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit ne themel për pjesën tjetër të ankesës.
KSHA me shkresë nr. 299/10 prot, datë 15.05.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "A." shpk.
KPP ka marrë vendim me nr. 410/2023 datë 23.05.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit ne themel për pjesën tjetër të ankesës.
KPP ka marrë vendim me nr. 446/2023 datë 31.05.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1-4. Të pranoj ankesat e paraqitur nga OE.
5. AK të kryej modifikim e DT ne përputhje me konstatimet e KPP
6. AK brenda 5 ditëve te veje ne dijeni KPP mbi zbatimin e këtij vendimi
Me shkresë nr. 299/19 prot, datë 06.06.2023 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 446/2024.
Me shkresë 404 prot pranë AK datë 22.06.2023, **KPP** me vendim nr. 499/2023 nuk ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.
Me shkresë nr. 401/1 prot, datë 22.06.2023 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 499/2023.
Me shkresë 404/2 prot pranë AK datë 29.06.2023, **KPP** me vendim nr. 521/2023 dhe me pas me vendim **524**/2023 ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Urdhri nr. 299/1 prot, datë 28.04.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), i ndryshuar me urdhër 404/3 prot, datë 29.06.2023 të përbërë nga:
Znj. F. H., Kryetare
Z. E. Sh., Anëtarë
Z. A. D., Anëtarë
Me procesverbal pa nr prot, datë 10.07.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjesë 6 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "A." shpk	9,900,000 lekë.	S'kualifikuar.
2	OE "K." shpk	10,300,000 lekë.	Kualifikuar.
3	OE "I." shpk	10,360,479 lekë.	S'kualifikuar.
4	OE "G." shpk	10,900,000 lekë.	S'kualifikuar.
5	OE "M." shpk	12,161,471 lekë.	S'kualifikuar..
6	OE "E." shpk	13,243,335 lekë.	S'kualifikuar..

Në SPE AK i ka kërkuar OE argumentim për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë pasi në ofertat e paraqitura janë anomalisht të ulëta. Me proces-verbal pa nr prot datë 03.08.2023 ka vlerësuar ofertat si me poshtë vijon:
1. OE "A." shpk është **skualifikuar** pasi mbas kërkesës për të shpjeguar arsyen e ofertës anomalisht të ulët:
Referuar argumentimit të ofertës anomalisht të ulët OE në asnjë pikë nuk i referohet përmbushjes së gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomikë të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjithë elementët. Operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë të detajuar analizën e kostos së zërave të punimeve në trajtë analitike, pra të argumentojë me prova dhe fakte dhe si dhe të të justifikojë çmimin e ofertuar për çdo zë. Një parashikim i tillë gjen mbështetje edhe ne Direktivën 24/2014 KE "Për prokurimin publik", ku në nenin 69 të saj, parashikohen edhe kushtet për pranimin e ofertës anomalisht të ulët, në kuadër të zhvillimit të proçedurave të prokurimit publik.

Konkretisht, në nenin 69 të saj parashikohet se: " Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
2. OE "I." shpk është **skualifikuar** pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotesuar kerkesat per specifikime teknike të kërkuara nga AK.
Gjithashtu rezulton se dhe mbas kërkesës sonë për të shpjeguar arsyet për ofertën anomalisht të ulët, ky OE ka dorëzuar si në SPE ashtu edhe në mënyrë shkresore përveç argumentimit të vet në formën e një narrativë ku shpjegon në të gjitha paragrafët e saj se oferta e paraqitur prej tij në këtë tender është plotësisht e realizueshme, në përputhje të plotë me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi ka llogaritur të siguroj një normë fitimi bruto të mjaftueshme, me anë të së cilës të sigurohet fitim neto për kompaninë dhe të mbulohen kostot e tjera si p.sh.: kosto transporti në import dhe shpenzimet administrativ.
3. O.E "G." shpk është **skualifikuar** pasi bazuar në Vendimin Nr. 53 datë 03.08.2023 të APP-së është përjashtuar nga përftimi i kontratave publike për një periudhë kohore prej 8-muaj e 16-ditë.
4. OE "M." shpk është **skualifikuar** pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotesuar kerkesat per specifikime teknike tw kërkuara nga AK.
5. OE "E." shpk është **skualifikuar** pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotësuar kërkesat për specifikime teknike tw kërkuara nga AK.
6. OE "K." shpk pas argumentimit te ofertës së tij anomalisht të ulet, është shpallur **fituese** me ofertën ekonomike në vlerën 10,300,000 lekë pa TVSh ose 12,360,000 Lekë me TVSh.

Nga auditimi konstatohet se:
KVO ka vepruar me 2 standarde, pasi OE K. dhe A. në argumentimet e ofertës së tyre anomalisht të ulët, kanë dhënë të njëjta argumentet për ofertën e tyre, ku kanë paraqitur çmimet e mara nga furnitorët për çdo artikull, kostot e transportit, shpenzimet doganore dhe fitimin e llogaritur (bashkangjitur me dokumentacionin përkatës). Veprime ne kundërshtim me LPP nr. 162/2020 i ndryshuar neni 93 si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82 pika 4.
Për sa më sipër, diferenca prej 400,000 lekësh midis dy operatorëve ekonomikë të vlerësuar nga KVO me ofertë anomalisht të ulët – përkatësisht operatorit të renditur në vend të parë dhe atij të renditur në vend të dytë, i cili është shpallur fitues – do të konsiderohet si përdorim pa ekonomicitet i fondeve, publike.
"**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet:** Komisioni i vlerësimit të ofertave, znj. F. H., z. E. Sh., z. A. D. si dhe titullari i AK z. I. A.

Për sa është trajtuar më sipër në Projekt Raportin auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nga përfaqësues të ISUV-it, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik "A." shpk nga përllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 9,900,000 lekë pa TVSh, rezulton anomalisht e ulët.Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, barra e provës mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulët i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshtë konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit.Në rastin konkret, përvec argumentimit në formën narrative për argumentin e ofertës anomalisht të ulët OE "A." shpk ka paraqitur pasqyrën e kostos së blerjes së produkteve objekt prokurimi te mbështetur në listën e cmimeve të kompanive prodhuese nga të cilat do të furnizohet me këto produkte si dhe vlera e ketyre produkteve nuk do te ndikojë në furnizimin me cilësi të këtyre produkteve sipas specifikimeve teknike të shprehura në katalogët e këtyre kompanive prodhuese të dorezuara në dokumentacionin e ofertës, pra OE nuk ka paraqitur prova shkresore sikurse është e përcaktuar në dispozitën e mësipërme. Nga perllogaritjet e kryera nga KVO-ja ka rezultuar se oferta ekonomike e OE "A." shpk

është 47.8% më e ulët se fondi limit i perllogaritur nga AK ndërsa oferta ekonomike e OE"K." shpk është 49.7% më e ulët se fondi limit, pra oferta e OE "K." shpk është afersisht 50% e fondit limit brenda kufirit ligjor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE rezulton se produktet e ofertuara nga kompanitë I., B., M. B.dhe D., këto kompani kanë cmime më të uleta se cmimet që ka paraqitur OE në oferten e tij ekonomike. Për sa me sipër na le të kuptojm se cilësia e produkteve të ofertuara nga keto kompani për shkak të cmimeve tejet të ulëta na K. bindjen se arktikujt e ofertuara nga OE nuk janë në standardet e kërkuara nga AK.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Referuar observacioneve të ISUV, me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, si dhe arsyetimeve të paraqitura nga subjekti gjatë takimit ballafaqësues të mbajtur më datë 28.07.2025, përfaqësuesit e ISUV argumentuan se produktet e operatorit ekonomik "A." nuk e bindën Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO) lidhur me garantimin e cilësisë së tyre. Sipas ISUV, i takon KVO-së të marrë një vendim në kushtet kur janë dy operatorë ekonomikë me ofertë anomalisht të ulët, mbi bazën e dokumentacionit të kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 82, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe nenit 93 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Pas shqyrtimit të këtyre sqarimeve, grupi i auditimit i KLSH e pranoi pjesërisht observacionin për këtë pikë, duke konsideruar se diferenca prej 400,000 lekësh midis dy operatorëve ekonomikë të vlerësuar me ofertë anomalisht të ulët përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve publike, dhe e reflektoi këtë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

-Lidhja e kontratës.
Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr. 404/12 prot, datë 19.09.2023 dhe afati do te vazhdoj për 12 muaj nga data e nën shkrimit të kontratës.
Me shkresë nr. 404/13 prot datë 19.09.2023 është hartuar plani i zbatimit të kontratës.

-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 640 prot., datë 21.09.2023 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: znj. E. P., z. A. L., znj. S. Dh. dhe znj. Zh. H..

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë:
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 26.10.2023, komisioni shprehet se enët dhe materialet laboratorike rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1716/2023, datë 26.10.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 210 datë 03.11.2023 në vlerën 2,447,490 lekë.
Me fletë hyrje nr. 61 datë 26.10.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 08.11.2023 komisioni shprehet se enët dhe materialet laboratorike rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1774/2023, datë 08.11.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 247 datë 11.12.2023 në vlerën 3,652,656 lekë.
Me fletë hyrje nr. 70 datë 08.11.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 07.12.2023, komisioni shprehet se enët dhe materialet laboratorike rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1972/2023, datë 07.12.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 251 datë 13.12.2023 në vlerën 2,920,602 lekë.
Me fletë hyrje nr. 84 datë 11.12.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 01.02.2024, komisioni shprehet se enët dhe materialet laboratorikë rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 204/2024, datë 01.02.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 56 datë 05.03.2024 në vlerën 1,730,364 lekë.
Me fletë hyrje nr. 9 datë 01.02.2024 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 24.01.2024, komisioni shprehet se enët dhe materialet

laboratorikë rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 128/2024, datë 24.01.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 57 datë 05.03.2024 në vlerën 1,093,884 lekë.
Me fletë hyrje nr. 5 datë 24.01.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Në total në baze të kontratës se sipërcituar janë shpenzuar 11,844,996 lekë.

Nga auditimi konstatohet se:
Komisioni i marrjes në dorëzim nëpërmjet procesverbaleve të sipërcituar, ka përcaktuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar.
Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar dhe a kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe ofertën e pranuar, sa i përket firmës prodhuese si dhe origjinës së produkteve.
Në kundërshtim me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 dhe kontratën me nr. 404/12 prot., datë 19.09.2023, nenin 4. Si dhe Rekomandimi i APP me nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit te zbatimit te kontratave te nënshkruara ne përfundim te procedurave te prokurimit për mallra, pune, shërbime".
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: znj. E. P., z. A. L., znj. S. Dh. dhe znj. Zh. H..

2.4.10. Procedura e prokurimit "Blerje Standarde dhe materiale reference", me fond limit 10,657,826 pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje Standarde dhe materiale reference" viti 2023</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Procedurë e hapur: <u>REF-70620-05-25-2023</u></td><td>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:
Urdhri nr. 40/1 prot, datë 15.03.2023
J. B.
E. K.
E. M.
V. V.
D. Sh.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 346 prot, datë 23.05.2023
A. I.
R. D.
S. K.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 346/1 prot, datë 23.05.2023
B. N.
M. K.
S. B..</td></tr>
<tr><td>5. FL (pa TVSh)
10,657,826 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
5,964,600 lekë</td><td>7. Dif. me FL (pa TVSh)
4,693,226 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Dt. e publikimit
Date 26.05.2023
8/2 Kohëzgjatja e kontratës MK, 12 muaj</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td>10. OE
a) Pjesëmarrës 5 OE;
1. 1 OE të kualifikuar
2. 4 OE të skualifikuar</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim
Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje Ankesës AK
Me shkresë nr. 346/6 prot, datë 05.06.2023
Me shkresë nr. 346/7 dhe 346/8 datë 06.06.2023</td><td>14. Përgjigje Ankesës nga KKP
Vendim, nr. 486/2023 datë 08.06.2023.
Vendim nr. 489/2023 datë 08.06.2023.
Vendim nr. nr. 502/2023 datë 21.06.2023.
Vendim nr. 346/12 datë 27.06.2023.
Vendim nr. nr. 559/2022.</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
Kontrata me nr. 435/4,</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës:
Me urdhër nr. 639 prot., datë 21.09.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe</td></tr>
</table>

datë 12.09.2023.	zbatimin e kontratës.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 40/1 prot, datë 15.03.2023, i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të ISUV z, P. A. ka ngritur *Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit*, të përbërë nga J. B., E. K., E. M., V. V. dhe D. Sh.. Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se përllogaritja e fondit limit të kryhet nëpërmjet testimit të tregut dhe ofertat janë marrë paraprakisht.

Nëpërmjet shkresës pa nr prot, datë 22.05.2023, përgatitur nga Komisioni i posaçëm i ngritur për përllogaritjen e fondit limit, citohet se ofertat nuk janë marrë nga ky komision por janë përcjellë nga zyra e prokurimit. Në këtë memo, si dhe në PV e të njëjtës datë të Komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 41/1 prot, datë 15.03.2023, dokumentohet se ky komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke nxjerrë thjesht mesataren aritmetike e ofertave të dhëna nga Njësia e prokurimit, në vlerën prej 10,657,825.50 lekë pa TVSh.

Njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se:

- Në datën 02.02.2023, kur personi përgjegjës për prokurimin A. I. ka dërguar e-mail 4 kompanive, Njësia e posaçme ende nuk kishte hartuar memon me datë 22.05.2023, ku ka përcaktuar specifikimet teknike;
- Neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme.

Specifikimet teknike janë nuk janë të argumentuara, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.

Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:

- Titullari i AK z. P. A. për parregullsitë e konstatuara në veprimet e strukturave të ISUV në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në nenin 21, pika 5 të LPP, i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të RPP;
- J. B., E. K., E. M., V. V. dhe D. Sh., *në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit*, duke mos garantuar ndjekjen e një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit *bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*;
- A. I., për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit.

- Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 346 prot, datë 23.05.2023 është ngritur Njësia e prokurimit me përbërjen: A. I., R. D., S. K.

Me proces-verbal pa nr prot dhe pa datë, njësia e prokurimit ka hartuar dhe argumentuar specifiket teknike.

Në SPE datë 01.06.2023 është paraqitur ankesë nga OE 1. "G." shpk, 2. "I." dhe 3. "K." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.

Titullari i AK me shkresë nr. 346/5 prot, datë 01.06.2023 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbehet nga znj. B. N., znj. M. K. dhe znj. S. B..

KSHA me shkresë nr. 346/6 prot, datë 05.06.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "G." shpk dhe me shkresë nr. 346/7 dhe 346/8 datë 06.06.2023 ka shqyrtuar ankesën e OE "I." shpk dhe "K." shpk.

KPP ka mare vendim me nr. 486/2023 datë 08.06.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:

1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

KPP ka mare vendim me nr. 489/2023 datë 08.06.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:

1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….

2. Te vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
KPP ka mare vendim me nr. 502/2023 datë 21.06.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1-3. Të pranoj ankesat e paraqitur nga OE.
4. AK të kryej modifikim e DT ne përputhje me konstatimet e KPP…….
5. AK brenda 5 ditëve te veje ne dijeni KPP mbi zbatimin e këtij vendimi…..
Me shkresë nr. 346/12 datë 27.06.2023 AK ka kërkuar saktësimin e vendim nga KPP.
KPP ka mare vendim me nr. 524/2023 datë 26.06.2023 me objekt: Korrigjim vendimi.
Me shkresë nr. 346/14 prot, datë 30.06.2023 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 524/2022.
Me shkresë 435 prot pranë AK datë 07.07.2023, KPP me vendim nr. 559/2022 ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Urdhri nr. 346/1 prot, datë 23.05.2023, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga: znj. B. N., Kryetare, znj. M. K., Anëtarë, znj. S. B. Me procesverbal pa nr prot, datë 17.07.2023 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjesë 5 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/Skualifikuar
1	OE "A." shpk	5,964,600 lekë.	**Kualifikuar dhe shpallur fitues.**
2	OE "K." shpk	4,792,000 lekë.	**Skualifikuar.**
3	OE "I." shpk	6,313,006 lekë.	**Skualifikuar..**
4	OE "G." shpk	5,590,000 lekë.	**Skualifikuar.**
5	OE "M." shpk	8,106,721 lekë.	**Skualifikuar.**

Në SPE AK i ka kërkuar OE "K." shpk argumentim për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë pasi në ofertën e paraqitur janë anomalisht të ulëta.
Me date 11.08.2023 oferta e shpallur fituese(paraprak) është OE "A." shpk si oferta me çmim me te ulet, me ofertën ekonomike në vlerën 5,964,600 lekë pa TVSh ose 7,157,520
Lekë me TVSh.
1. OE "K." shpk është skualifikuar pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotësuar kërkesat për specifikime teknike të kërkuara nga AK.
2. OE "I." sh.p.k është skualifikuar pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotesuar kerkesat per specifikime teknike te kerkuara nga AK.
3. OE "G." shpk skualifikohet bazuar ne Vendimin Nr. 53 datë 03.08.2023 të APP-së është përjashtuar nga përftimi i kontratave publike për një periudhë kohore prej 8-muaj e 16-ditë.
4. OE "M." shpk është skualifikuar pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ky OE nuk ka plotesuar kerkesat per specifikime teknike te kerkuara nga AK.
- Me shkresë nr.435/2 prot, datë 18.08.2023 janë marrë në dorëzim dokumentacioni i OE.
Raporti përmbledhës është hartuar pa nr prot datë 23.08.2023.

-Lidhja e kontratës.
Marrëveshja midis AK dhe OE është lidhur me nr. 435/3 prot, datë 12.09.2023.
Kontrata është lidhur me nr. 435/4, datë 12.09.2023 me afat deri në 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj. Me shkresë me nr. 435/6 prot datë 12.09.2023 është hartuar plani i zbatimit të kontratës.
-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 639 prot, datë 21.09.2023 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: znj. E. Sh., znj. S. H., znj. A. D. dhe znj. Zh. H..

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë:
- Me Proces verbal pa nr prot datë 28.09.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender

janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 2,107,800 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 162/2023, datë 27.09.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 186 datë 23.10.2023 në vlerën 2,107,800 lekë.
Me fletë hyrje nr. 48 datë 28.09.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 19.10.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 364,320 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 173, datë 09.10.2023, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 194 datë 23.10.2023, në vlerën 364,320 lekë.
Me fletë hyrje nr. 52 datë 09.10.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 29.09.2023, dhe 11.10.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 184,800 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 165/2023, datë 29.09.2023, dhe 185/2023 date 11.10.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 209 datë 03.11.2023 në vlerën 184,800 lekë.
Me fletë hyrje nr. 49 datë 29.09.2023 dhe nr. 55 datë 11.10.2023 janë bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 06.11.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 665,280 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 224/2023, datë 06.11.2023, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 246 datë 11.12.2023 në vlerën 665,280 lekë.
Me fletë hyrje nr. 68 datë 06.11.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 17.11.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 867,000 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 253/2023, datë 17.11.2023, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 300 datë 19.12.2023 në vlerën 867,000 lekë.
Me fletë hyrje nr. 74 datë 17.11.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 19.12.2023, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 2,778,120 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 279/2023, datë 18.12.2023, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 323 datë 26.12.2023 në vlerën 2,778,120 lekë.
Me fletë hyrje nr. 88 datë 19.12.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 25.03.2024, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 130,200 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 46/2023, datë 25.03.2024, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 132 datë 13.05.2024, në vlerën 130,200 lekë.
Me fletë hyrje nr. 20 datë 25.03.2024 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 29.07.2024, komisioni shprehet se mallrat të përfshirë në tender janë konform në sasi dhe specifikime me vlerën 60,000 lekë.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 103/2024, datë 29.07.2024, ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 224 datë 22.08.2024, në vlerën 60,000 lekë.
Me fletë hyrje nr. 56 datë 29.07.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Në total në baze të kontratës se sipërcituar janë shpenzuar 7,157,520 lekë.

Nga auditimi konstatohet se:
Komisioni i marrjes në dorëzim nëpërmjet procesverbaleve të sipërcituar, ka verifikuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit.
Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar, dhe se datat e skadencës dhe/ose afatet e përdorimit kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe

ofertën e pranuar, sa i përket afateve të skadencës dhe origjinës së produkteve.
Në kundërshtim me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 dhe kontratën me nr. 123/18 prot, datë 18.09.2024, nenin 4. Si dhe Rekomandimi i APP me nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit te zbatimit te kontratave te nënshkruara ne përfundim te procedurave te prokurimit për mallra, pune, shërbime".
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: znj. E. Sh., znj. S. H., znj. A. D. dhe znj. Zh. H..

2.4.11. Procedura e prokurimit e anuluar

- ISUV më datën 29.07.2022 ka hedhur në SPE procedurën e prokurimit me objekt: **"*Blerje pajisje për ngritjen dhe funksionimin e laboratorëve të mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve*",** REF-37429-07-28-2022, me fond limit 23,500,500 lekë, pa TVSH.
KPP ka mare vendim nr. 785/2022, datë 23.08.2022 për ankesën e paraqitur nga OE mbi dokument e tenderit dhe ka vendosur të shqyrtoj procedurën në themel.
KPP ka mare vendim nr. 836/2022, datë 30.08.2022 ku ka vendosur pranimin e disa prej ankesa te OE, si dhe ka ngarkuar AK te bej modifikimin e dokumenteve të tenderit.
Me vendim 1037/2022, datë 25.10.2022, KPP ka lejuar AK të vazhdoj me hapat e mëtejshëm te procedurës.
Më datën 07.11.2022, është bërë hapja e ofertave nga KVO-ja.
Më datën 09.11.2022 KVO-së ka përfunduar procesin e vlerësimit dhe po në të njëjtën datë ka hedhur në SPE njoftim fituesi.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë 5 (pesë) operatorë ekonomik nga të cilët 1 OE është kualifikuar ndërsa 4 janë skualifikuar për arsye si vijon: 2 OE janë skualifikuar për mangësi në specifikimet teknike ndërsa, 2 OE të tjera nuk e kishin objekt veprimtarie objektin e prokuruar nga AK si dhe për mangësi ne specifikimet teknike.
Raporti përfundimtar është hartuar pa nr. prot me datë 09.11.2022.

Nga auditimi konstatohet se:
KVO nuk ka verifikuar e dokumentacionit e dorëzuar nga OE, por ka përgatitur raportin përmbledhës me datë 09.11.2022 duke shpallur fitues OE. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, citon: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.
Mban përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:
komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhër nr. 643/1 datë 27.07.2022, znj. M. L., z. E. Sh. dhe znj. E. P..
Me e-mail 24.11.2022 është dërguar kontratat nga personi përgjegjës për prokurim OE "M.".
AK me shkresë nr. 936 datë 25.11.2022 i është kërkuar kompanisë "ALBSIG" SHA transferimin e sigurimit të ofertës pasi OE refuzon të nënshkruaj kontratën.
Me shkresë nr. 972 prot, datë 06.12.2022 OE "M." ka paraqitur kthimin e përgjigjes mbi kërkesën e bërë për konfiskimin e sigurimit të ofertës.
Me shkresë nr. 972/1 prot, datë 09.12.2022, AK i ka kthyer përgjigje OE mbi ankesën e tij.
Me datë 30.12.2022 janë transferuar në llogarinë e ISUV-it sigurimi i ofertës.
Në SPE procedura ka kaluar në të gjithë fazat e saj pasi janë ngarkuar si formulari i kontratës së nënshkruar dhe dosja është arkivuar.

Grupi auditimi konstatoi se pavarësisht se procedura është anuluar në sistem ka kaluar të gjithë fazat e saj deri tek arkivimi i dosjes. *Në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 86.*

Mban përgjegjësi: Personi përgjegjës për prokurimet, znj. A. I.
Procedurë e prokurimi u ri hodh me nr. REF-64847-04-04-2023, e cila u anulua me Vendimin Nr. 943/2023 datë 20.09.2023 të KPP-së, mbas zbatimit të Vendimit të KPP-së procedura u ri hodh përsëri me Nr. REF-84856-10-23-2023, për tu kryer por, mbas ankimit të OE-ve dhe tejkalimit të afateve kohore kur ajo duhej të kryhej MBZHR-ja me Shkresën Nr. Prot Hyrës 892 Datë 26.12.2023 "Mbi ndryshimet në planin e buxhetit për shpenzime kapitale, në zbatim të Aktit Normativ Nr.6 datë 14.12.2023" me anë të së cilës ISUV-së i janë shkurtuar fondet buxhetore, saktësisht procedura e prokurimit me Kod produkti 18AJ309 (Ngritje dhe funksionim i laboratorit të mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve (blerje pajisjesh). Procedura është anuluar përsëri.

2.4.12. Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", për vitin 2023, me fond limit 35,339,090 lekë pa TVSh, e ndarë në 4 Lot-e, si më poshtë:
Loti I "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Agilent*", me nr. REF- 69110-05-11-2023, me fond limit 26,439,090 lekë pa TVSh;
Loti II "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Thermofisher*", me nr. REF- 69112-05-11-2023, me fond limit 2,340,000 lekë pa TVSh;
Loti III "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Shimadzu*", me nr. REF- 69114-05-11-2023, me fond limit 5,670,000 lekë pa TVSh;
Loti IV "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Bertin*", me fond limit 890,000 lekë pa TVSh.[1]

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shërbim, riparim, servis kalibrimi" viti 2023</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:
Proçedurë e hapur,</td><td>2. Grp. i hart. Spec. Tek. dhe FL:
Urdhri nr. 40/1 prot, datë 15.03.2023.
J. B.
E. K.
E. M.
V. V.
D. Sh.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 323 prot, datë 11.05.2023
A. I.
S. M.
M. L.</td><td>4. KVO
Urdhri nr. 346/1 prot, datë 11.05.2023
K. C.
L. H.
B. Q.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
L1 26,439,090 lekë
L2 2,340,000 lekë
L3 5,670,000 leke</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
L1 26,438,000 lekë
L2 2,290,000 lekë
L3 5,640,000 lekë</td><td>7. Dif. me FL (pa TVSh)
L1 1,090 lekë
L2 50,000 lekë
L3 30,000 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Data e publikimit të tenderit
12.05.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td rowspan="2">10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender
L1, 1 OE;
L2, 2 OE 1 skualifikuar,
L3, 3 1 OE.</td></tr>
<tr><td>8/2 Kohëzgjatja e kontratës
M.K, 12 muaj</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje nga AK
Me shkresë nr. 323/6 prot, datë 14.06.2023</td><td>14. Përgjigje nga KKP
Nr. 580/2023 datë 21.06.2023</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
L1 Kontrata me nr. 389 prot, datë 19.06.2023.
L2 Kontrata me nr. 390/2, datë 21.06.2023.
L3 Kontrata lidhur me nr. 323/5 prot, datë 14.06.2023</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës:
L1 Me Urdhër nr. 129/1 me nr. 389/4 prot, datë 20.06.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.
L2 Me Urdhër nr. 129 me nr. 390/3 prot, datë 04.12.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.
L3 Me Urdhër nr. 390 prot, datë 14.06.2023 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.</td></tr>
</table>

[1] Është anuluar loti i IV me vendim KPP.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 40/1 prot., datë 15.03.2023, Drejtori i Përgjithshëm i komanduar i ISUV z, P. A. ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit për 9 procedura prokurimi, ndër të tjera për procedurën me objekt "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi*", të përbërë nga znj. J. B., znj. E. K., znj. E. M., znj. V. V. dhe znj. D. Sh..

Komisioni nuk ka në përbërje specialist të fushës (teknik laboratori), për të evidentuar nevojat teknike për shërbimin e mirëmbajtjes/ riparimit të aparaturave.
Nëpërmjet e-mail të datës 09.01.2023, znj. J. B. ka dërguar drejt znj. A. I. (personi përgjegjës për prokurimet) tekstin " *Bashkëlidhur do të gjeni zërin Servis-Kalibrim për ofertë për vitin 2023*".
Nëpërmjet e-mail të datës 10.01.2023, znj. A. I. ka dërguar listën me specifikimet e përcjella drejt për testim tregu 4 OE.
Nëpërmjet Memo pa nr prot, datë 28.04.2023, znj. A. I. kanë dërguar drejt Komisionit për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjes së fondit limit, shkresën ku citohet se "*Po ju dërgojmë ofertat e ardhura nga ana e OE... Ju lutem për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë prokurimi... Oferta 2023 "Shërbim, riparim, servis kalibrimi.*
Nëpërmjet memos pa nr prot, datë 08.05.2023, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit ka hartuar relacionin, ku citohet se "*Lista e finalizuar përmban çmimet nga oferta për Lot P., për lotet Thermofisher, Shimadzu dhe Bertin, të ardhura nga zyra e prokurimit me memon e datës 28.04.2023*", duke përcaktuar fondet limit për lot-et, si dhe zërat specifikë për secilin prej lot-eve.
Studimi i tregut është kryer përpara relacionit përkatës nga Komisioni i posaçëm, rrjedhimisht, ose ky studim nuk është kryer bazuar në specifikimet teknike, ose specifikimet teknike nuk janë hartuar nga Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 40/1 prot., datë 15.03.2023. Nëpërmjet veprimeve të mësipërme, njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit, nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme.

1. Sa i përket Lot-it I, për secilin prej zërave, në kolonën "*Specifikimet teknike*" janë parashikuar jo vetëm veprime që lidhen me servisin (p.sh. servis i pompës, ndërrim i filtrave/ vajit, etj.), por edhe furnizim me artikuj (p.sh. kite, inserte, shiringa, tapa, tuba, filtra membrane, etj.), të cilat janë në sasi më të mëdha se "një (1)" dhe nuk lidhen me pjesë këmbimi për servisin, por me funksionimin dhe operimin e pajisjes në vijimësi. **Specifikimet teknike (përfshirë artikujt dhe sasitë përkatëse të kërkuara, të përfshira në kolonën "*Specifikimet teknike*", për secilën prej pajisjeve) nuk janë të argumentuara**, në kundërshtim me nenin *78, pika 2, të RPP*, aq më tepër duke marrë në konsideratë faktin që kjo procedurë kryhet çdo vit dhe këto artikuj (pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin në vijim të pajisjes) përfshihen në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur, si dhe nuk administrohet një relacion teknik për të argumentuar/ justifikuar nevojën për çdo element të shërbimit, pajisjet pjesë këmbimi, si dhe të gjithë artikujt që janë kërkuar, për secilin prej zërave, specifikime të cilat ndikojnë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike.
Pavarësisht se kjo është një procedurë e përvitshme që kryhet nga ISUV, nga auditimi konstatohet se në specifikimet teknike të përcaktuara, në ndryshim nga procedurat e mëparshme (procedura e vitit 2021-2022), **nuk kërkohen më certifikatat e pjesëve të këmbimit dhe artikujve të furnizuar që shoqërojnë secilin prej zërave**.
Pavarësisht se shërbimi në Lot-in I kërkohet për pajisjet me prodhues "Agilent", duke kërkuar në DST që OE të ketë kontratë të lidhur me inxhinier të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve "Agilent", 2 nga zërat e përfshirë janë me prodhues të ndryshëm nga "Agilent", si "Dialab", "Biosan", nga ISUV nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar lidhjen e kompanisë "Agilent" me 2 kompanitë e tjera që janë përfshirë (nëse kanë marrëdhënie, të tipit "*mother-subsidiary*", "*joint venture*"), apo çdo lloj marrëdhënie tjetër për të argumentuar përfshirjen e këtyre 2 zërave.
Për marrjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve në Lot-in I është përllogaritur fondi limit dhe është kontraktuar vlera, si më poshtë:

2. Sa i përket Lot-it II, në kolonën "Specifikime teknike" për 4 nga 6 zërave të përfshirë, citohet "*Mirëmbajtje e jashtëzakonshme (p.sh. pastrim objektivash dhe okularësh, qendërzimi i dritës, ndërrimi i llampës, etj*.). Në asnjë prej këtyre nuk specifikohen shërbimet që do të kryhen, specifikime të cilat do të duhej të ishin të qarta për të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike.
Pavarësisht se shërbimi në Lot-in II kërkohet për pajisjet me prodhues "Thermofisher", duke kërkuar në DST që OE të ketë kontratë të lidhur me inxhinier të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve "Thermofisher", zërat e përfshirë konsistojnë në pajisje me prodhues të ndryshëm, si "Velp Scientifica", "Carl Zeiss", "Optech", "Optica". Nga ISUV nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar lidhjen e kompanisë "Thermofisher" me kompanitë e tjera për të cilat është kërkuar dhe marrë shërbimi, për të argumentuar përfshirjen e këtyre zërave në këtë procedurë prokurimi.

3. Sa i përket Lot-it III, për secilin prej zërave, në kolonën "*Specifikimet teknike*" janë parashikuar jo vetëm veprime që lidhen me servisin, por edhe furnizim me artikuj (p.sh. set shishe për solventët, kolona, llampa, kapilarë, filtra, etj.), ndër të tjerë edhe artikuj për operimin në vijimësi të pajisjes si viale material qelqi (1000 copë), tapa (2000 copë). **Specifikimet teknike (përfshirë artikujt dhe sasitë përkatëse të kërkuara, të përfshira në kolonën "*Specifikimet teknike*", për secilën prej pajisjeve) nuk janë të argumentuara**, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP, aq më tepër duke marrë në konsideratë faktin që kjo procedurë kryhet çdo vit dhe këto artikuj (pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin në vijim të pajisjes) përfshihen në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur, si dhe nuk administrohet një relacion teknik për të argumentuar/ justifikuar nevojën për çdo element të shërbimit, pajisjet pjesë këmbimi, si dhe të gjithë artikujt që janë kërkuar, për secilin prej zërave, specifikime të cilat ndikojnë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik, që nga studimi i tregut, ofertimi nga operatorët ekonomikë dhe marrja në dorëzim e shërbimit, sipas kërkesave dhe nevojës reale, për të garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike. Pavarësisht se janë zyrtarë të përfshirë në procedurën e prokurimit, anëtarët e komisionit nuk rezulton të kenë nënshkruar Deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenin 73, pika 4 të RPP. Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 323 prot., datë 11.05.2023, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e fondit limit prej 35,339,090 lekë pa TVSh, për realizimin e procedurës me objekt "*Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi*", duke ngritur Njësinë e prokurimit, të përbërë nga znj. A. I., znj. S. M. dhe znj. M. L.. Njësia e prokurimit nuk ka në përbërje specialist të fushës (teknik laboratori).

Procedura e prokurimit
Njësia e prokurimit ka ngarkuar në SPE dokumentet e tenderit dhe PV e argumentimit te ST, ka publikuar procedurat e prokurimit (për secilin Lot) në datën 12.05.2023 dhe ka caktuar afatin e fundit për pranimin e ofertave datën 05.06.2023.
-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 323/1 prot, datë 11.05.2023, Titullari i AK ka ngritur Komisionin për Vlerësimin e Ofertave, të përbërë nga znj. K. C., znj. L. H. dhe znj. B. Q..
KVO ka dokumentuar hapjen e procedurës së prokurimit nëpërmjet PV të datës 05.06.2023. Në procedurat e prokurimit kanë marrë pjesë, si më poshtë:
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSh)	
Lot I "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Agilent"			
1	P.	26,438,000	Kualifikuar
Lot II "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Thermofisher"			
1	K.	2,290,000	Kualifikuar
2	Distributor of devis group	0	Skualifikuar

Lot III "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Shimadzu"			
1	G.	5,640,000	Kualifikuar
Lot IV "Shërbim, servis, kalibrim i pajisjeve Bertin"			
1	A.	690,000	Kualifikuar
1	Distributor of devis group	0	SKualifikuar
1	I.	850,000	Kualifikuar

Nëpërmjet PV të datës 06.06.2023, KVO ka dokumentuar vlerësimin e ofertave të dorëzuara, ku ka rezultuar, si më poshtë:
Për Lot I, shpallet fitues OE "P.", me ofertë ekonomike 26,438,000 lekë pa TVSh dhe 31,725,600 lekë me tvsh;
Për Lot II, shpallet fitues OE "K.", me ofertë ekonomike 2,229,000 lekë pa TVSh dhe 2,674,800 lekë me tvsh, ndërsa OE Distributor of devis group ne SPE ka ngarkuar vetëm ekstraktin e shoqërisë;
Për Lot III, shpallet fitues OE "G.", me ofertë ekonomike 5,640,000 lekë pa TVSh dhe 6,768,000 me tvsh.
Për Lot IV, shpallet fitues OE "A.;", me ofertë ekonomike 690,000 lekë pa TVSh, ndërsa OE Distributor of devis group ne SPE ka ngarkuar vetëm ekstraktin e shoqërisë dhe I. është kualifikuar me ofertë 850,000 lekë;
Më shkresë nr. 323/4 datë 12.06.2023 është paraqitur ankesë nga OE I. për Lotin e IV.
Titullari i AK me shkresë nr. 323/8 datë 12.06.2023 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbehet nga znj. K. C., znj. L. H. dhe znj. B. Q..
KSHA me shkresë nr. 323/6 prot, datë 14.06.2023 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "I." dhe ka vendosur në mos pranimin e saj..
KPP ka mare vendim me nr. 580/2023 datë 21.06.2023 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të pranoj ankesat e paraqitur nga OE.
2. AK të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të KPP
Me shkresë nr. 323/3 datë 08.06.2023 OE K. ka dorëzuar dokumentacionin për Lotin II.
Titullari i AK I. A ka miratuar raportin përfundimtar të procedurës së prokurimit në datën 14.06.2023, i paprotokolluar.

Nga auditimi konstatohet se:
-KVO nuk ka verifikuar e dokumentacionit e dorëzuar nga OE "P." për Lotin e I dhe të OE "G." për lotin e III, pasi nga verifikimi i librit të protokollit nuk evidentohet të jetë dorëzuar dokumentacioni përkatës. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, citon: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet: Komisioni i vlerësimit të ofertave, znj. K. C., znj. L. H. dhe znj. B. Q..

- Titullari i AK ka ngritur KSHA me urdhër nr. 323/8 prot, datë 12.06.2023 për shqyrtimin e ankesës lidhur me shpalljen si fitues të OE "Alemdical" për mos plotësim kriteresh, për lotin e IV. Megjithatë, anëtarët e KSHA janë të njëjtët individë që përbëjnë KVO, të cilët më parë kanë shpallur OE si fitues.. Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 101 pika 1 citon : Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet: Titullari i AK z. P. A..

- Gjithashtu nga verifikimi i librit të protokollit dhe shkresave mbi ngritjen e KSHA dhe kthimit të përgjigjes, vihet re një mospërputhje në renditjen kronologjike. Konkretisht, me numrin e protokollit 323/8, datë 12.06.2023, figuron urdhri për pezullimin e procedurës, ndërsa shqyrtimi i ankesës është regjistruar me numrin 323/6, datë 15.06.2023, sipas protokollit. Megjithatë, në shkresë, data e kthimit të përgjigjes figuron më 14.06.2023. *Veprime në kundërshtim Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë neni 17. Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 ""Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar neni 5*
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet: ish titullari i komanduar i institucionit, z. P. A. dhe znj. N. Z.

-Lidhja e kontratës.
Marrëveshja për lotin e I, midis AK dhe OE "P." me objekt "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Agilent"* është lidhur me nr. 389 prot, datë 19.06.2023.
Kontrata është lidhur me nr. 389/1, datë 19.06.2023 me afat deri në 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj.
Marrëveshja për lotin e II, midis AK dhe OE "K." me objekt "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Thermofisher"* është lidhur me nr. 390/1 prot, datë 21.06.2023.
Kontrata është lidhur me nr., 390/2, datë 21.06.2023 me afat deri në 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj.
Kontrata për lotin e III, midis AK dhe OE "G." me objekt "*Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Shimadzu"* është lidhur me nr., 323/5 prot., datë 14.06.2023 me afat deri në 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj.
Grupi i auditimit konstatoi se nuk janë hartuar planet e zbatimi të kontratës *Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 285, Neni 107 "Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës" pika 4.*
Mban përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Personi përgjegjës për prokurimin znj. A. I.

- Zbatimi i kontratës
- Mbi pajisjet "Agilent" Loti I
Nëpërmjet Urdhrit nr., 129/1 me nr. 389/4 prot, datë 20.06.2023, i firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A është ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga znj. U. R., znj. S. B.dhe znj. M. K..
- Mbi pajisjet "Thermofisher" Loti II
Nëpërmjet Urdhrit nr. 129 me nr. 390/3 prot, datë 04.12.2023, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV I. A ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga znj. A. V., znj. S. H. dhe znj. M. K..
- Mbi pajisjet "Shimadsu" Loti III
Nëpërmjet Urdhrit nr. 86 dhe nr. 390 prot, datë 14.06.2023, Drejtori i Përgjithshëm i komanduar i ISUV z, P. A. ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim, të përbërë nga znj. M. L., znj. E. P. dhe znj. B. G..

Nga auditimi konstatohet se:
Urdhri nr. 129/1 me nr. 389/4 prot, datë 20.06.2023 për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të lotit I mbi pajisjet Agilent nuk është i regjistruar në librin e protokollit.
Ndërkohë, urdhri i datës 20.06.2023 është firmosur nga z. I. A si dhe i vulosur, në cilësinë e titullarit të ISUV. Megjithëse, në këtë periudhë, si titullar i komanduar ka qenë z. P. A..
Z. I. A është emëruar titullar i ISUV më datë 11.07.2023, ndërsa marrëdhëniet financiare kanë filluar më datë 12.07.2023.
Grupi i auditimit kërkoi pranë zyrës së arkiv/protokollit një kopje të urdhrit të sipër cituar ku mund të evidentoj hartuesi dhe miratuesi i urdhrit, por një dokument i tillë nuk na u vu ne dispozicion.
Nga verifikimi i librit të protokollit është vënë re një mospërputhje në renditjen kronologjike. Konkretisht:
- Numri 390/2 i përket datës 21.06.2023.
- Numri i protokollit 390/3 i përket datës 04.12.2023.

- Numri 390/4 i përket datës 29.06.2023.
Njëkohësisht, urdhri i brendshëm për lotin I ka nr. 129/1, datë 20.06.2023, ndërsa urdhri i brendshëm për lotin II ka nr. 129, pa fraksion, por është i datës 04.12.2023, pra urdhri është ngritur 6 muaj me vonë. *Veprime në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë neni 17.*
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: ish titullari i Institucioni z. P. A. dhe Titullari i Institucionit z. I. A.

Marrja në dorëzim
- Mbi pajisjet "Agilent" Loti I
Komision ka hartuar procesverbalin e datës 20.12.2023, ku citohet "*PV i mbajtur sot më datë 20.12.2023... mbi marrjen në dorëzim të shërbimit të prokurimit...*", por në asnjë moment nuk shprehet nëse shërbimi dhe pjesët e këmbimit janë marrë në dorëzim sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar. Pavarësisht se kemi të bëjmë me kontratë miks-e, ku krahas shërbimit do të merren/ furnizohen një numër i konsiderueshëm artikujsh, si pjesë këmbimi dhe artikuj që shërbejnë për operimin në kohë të pajisjes, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nuk ka përfshirë në Komisionin e marrjes në dorëzim personin me përgjegjësi materiale (magazinierin), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". Në Komisionin e marrjes në dorëzim nuk është përfshirë specialist fushe (teknik laboratori), për të garantuar se të gjithë komponentët e kërkuar të shërbimit të servisit janë kryer dhe marrë në dorëzim sipas përcaktimeve në DST.
OE është likuiduar pjesërisht në vlerën totale prej 26,178,000 lekë, si më poshtë:

1. Nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 330, datë 27.12.2023, në vlerën prej 26,178,000 lekë, bazuar në faturën elektronike nr. 4983/2023, datë 20.12.2023. Pavarësisht se për secilin prej këtyre zërave ishin parashikuar edhe pjesë këmbimi dhe artikuj të tjerë, këto nuk janë faturuar në mënyrë të veçantë, por janë përfshirë në zërat e secilës prej pajisjeve.
Komisioni i marrjes në dorëzim në PV e datës 20.12.2023, citohet "*I mbajtur sot... mbi marrjen në dorëzim të shërbimit...*", duke mos cilësuar nëse pjesët e këmbimit dhe artikujt që shoqëronin secilin prej zërave janë marrë në sasinë dhe cilësinë e kërkuar.
Marrja në dorëzim e artikujve të furnizuar, pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.
2. Nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 58, datë 06.03.2024, në vlerën prej 5,547,600 lekë, bazuar në faturën elektronike nr. 836/2024, datë 29.02.2024. Komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar PV e datës 29.02.2024, i paprotokolluar, ku citohet "*I mbajtur sot... mbi marrjen në dorëzim të shërbimit...*", duke mos cilësuar nëse pjesët e këmbimit dhe artikujt që shoqëronin secilin prej zërave janë marrë në sasinë dhe cilësinë e kërkuar.
Marrja në dorëzim e artikujve të furnizuar, pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.
- Në KVK nr. 2.3 është kërkuar që inxhinierët që do të kryejnë servis-kalibrimin duhet të jenë të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve Agilent. Në ofertën e shpallur fituese, OE "P." ka paraqitur dokumentacionin për D. S.. *Pavarësisht sa më sipër, 3 nga raportet e paraqitura, si raporte kualifikimi të operacionit dhe raport shërbimi, janë kryer dhe*

nënshkruar nga E. B., për të cilin nuk ka evidencë nëse është ose jo i trajnuar dhe certifikuar nga kompania prodhuese për servis – kalibrimin e pajisjeve Agilent.
Në asnjë nga dokumentet e sipërcituar, nuk vërtetohet se laboratorët kalibrues plotësojnë kërkesat e SSH ISO/IEC 17025, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*".
Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar **certifikatat e kalibrimit**, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi"*.
Në pikën 6.4.3 të dokumentit të DPA me Kod DA-IN-0011 përcaktohet se, kur laboratori përdor shërbime të një organizate të jashtme për të kalibruar pajisjet matëse dhe testuese, laboratori duhet të plotësojë kërkesat e SSH ISO/IEC 17025. Nëse shërbimet nuk ofrohen nga një laborator kalibrues i akreditуar, laboratori duhet të sigurojë që certifikata e kalibrimit duhet të përmbajë informacionin dhe elementët e përcaktuar në pikën 6.4.4, kur përfshihen pa u kufizuar: titulli "Certifikatë kalibrimi", të dhënat e laboratorik ku janë kryer matjet, identifikimi unik i certifikatës së kalibrimit dhe në çdo faqe një element identifikues që kjo faqe është pjesë e certifikatës, etj. Në pikën 6.8.2 përcaktohet se, kur pajisja është kalibruar ose kur materiali referues është certifikuar nga një organizëm i tretë, laboratori duhet të sigurojë që materiali referues/ pajisja është e përshtatshme për qëllimin që do të përdoret, është e etiketuar dhe ka certifikatën e cila tregon rezultatet e kalibrimit.
Për konfirmimin e shërbimit të marrë, pa marrë në dorëzim certifikatat e kalibrimit për 3 pajisjet, sipas përcaktimit në DST, që do të garantonin se kalibrimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe se pajisjet janë të besueshme dhe mund të përdoren duke siguruar rezultate të sakta dhe të besueshme, ngarkohen me përgjegjësi S. B. dhe znj. M. K., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim.

Mbi pajisjet "Thermofisher"
Komision ka hartuar procesverbalin e datës 04.12.2023, ku citohet "*PV i mbajtur sot më datë 04.12.2023... mbi marrjen në dorëzim të shërbimit të tenderit*...", por në asnjë moment nuk shprehet nëse shërbimi dhe mirëmbajtja janë marrë në dorëzim sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar.
OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 363, datë 22.01.2024, në vlerën prej **2,748,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 1944/2023, datë 04.12.2023.

Grupi i auditimit konstatoi si me poshtë vijon:
- Në KVK nr. 2.3 është kërkuar që inxhinierët që do të kryejnë servis-kalibrimin duhet të jenë të C.tifikuar nga kompania prodhuese e pajisjeve për servis-kalibrimin e pajisjeve Thermofisher. Në ofertën e shpallur fituese, OE "K." ka paraqitur dokumentacionin për F. Z. dhe E. Z.. *Pavarësisht sa më sipër, raporti i paraqitur i servisit te paisjes Velp Scientifica", modeli "UDK 149", nr. serial 399623 është kryer dhe nënshkruar nga M. B., për të cilët nuk ka evidencë nëse janë ose jo të trajnuar dhe C.tifikuar nga kompania prodhuese për servis – kalibrimin e pajisjeve Thermofisher*.
- Në DST është kërkuar **kalibrimi** i artikullit "Real-time PCR", Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar **certifikatën e kalibrimit**, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me Kod DA-IN-0011 "*Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë*" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "*Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi"*.
- Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me urdhrin nr. 390/3 prot., datë 04.12.2023, ka mbajtur procesverbalin pa nr. Prot., datë 04.12.2023, por pa kryer verifikimin paraprak mbi realizimin e shërbimit të servisit, pasi sipas raporteve të serviseve shërbimi është kryer para ngritjes së komisionit.
Në kundërshtim me *Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 36 citon: Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes,*

objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative18. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. A. V., znj. S. H. dhe znj. M. K..

- Mbi pajisjet "Shimadzu"
Komision ka hartuar procesverbale me datë 16.06.2023 dhe 15.09.2023, të paprotokolluar, ku citohet "*Komisioni verifikoi për të marrë në dorëzim të shërbim-riparimit... konfirmoi se shërbimi i marrë është konform*". Pavarësisht se kemi të bëjmë me kontratë mikse, ku krahas shërbimit do të merren/ furnizohen një numër i konsiderueshëm artikujsh, si pjesë këmbimi dhe artikuj që shërbejnë për operimin në kohë të pajisjes,
Drejtori i Përgjithshëm i ISUV nuk ka përfshirë në Komisionin e marrjes në dorëzim personin me përgjegjësi materiale (magazinierin), në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". Në Komisionin e marrjes në dorëzim nuk është përfshirë specialist fushe (teknik laboratori), për të garantuar se të gjithë komponentët e kërkuar të shërbimit të servisit janë kryer dhe marrë në dorëzim sipas përcaktimeve në DST.
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 166, datë 26.06.2023**, në vlerën prej **5,220,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 61/2023, datë 16.06.2023.
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 177, datë 05.10.2023**, në vlerën prej **1,548,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 102/2023, datë 15.09.2023.
Komisioni i marrjes në dorëzim në proces verbalet e mbajtura nuk ka specifikuar shërbimet e marra në dorëzim, por ka cituar se shërbimi i dorëzuar është i përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat.
- Marrja në dorëzim e artikujve të furnizuar, pjesë këmbimi dhe artikuj për operimin e pajisjes, nuk është kryer në prezencë të magazinierit, në kundërshtim me pikën 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", dhe rrjedhimisht këto aktive nuk janë dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, pasi të jetë bërë verifikimi fizik i sasisë, cilësisë dhe çmimit, në kundërshtim me pikën 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

2.4.13. Procedura e prokurimit "Blerje Kite", me fond limit 11,166,900 pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje Kite" viti 2024</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Proçedurë e hapur, : <u>REF-02168-04-22-2024</u></td><td>2. Grp i hart. Spc. Tek. dhe fondit limit:
Urdhri nr. 176/1 prot, datë 27.02.2024
J. B.
V. V.
E. M.
M. K.
D. Sh.</td><td>3. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 123/2 prot, datë 11.04.2024
A. I.
H. M.
E. Sh.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 123/3 prot, datë 11.04.2024
E. K.
P. A.
V. Sh.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
11,166,900 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese (pa TVSh)
8,375,176 lekë</td><td>7. Dif. me FL (pa TVSh)
2,791,724 lekë</td></tr>
<tr><td>8/1 Dt. e pub. 23.04.2024
8/2 Kohëzgjatja MK 12 muaj</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit
Fondet e Buxheti i Shtetit</td><td>10. OE a) Pjesëmarrës 4 OE;
2 OE të kualifikuar; 2 OE të skualifikuar</td></tr>
<tr><td>12. Ankimim
Po</td><td colspan="2">13. Përgjigje Ankesës AK
Me shkresë nr. 123/6 prot, datë 02.05.2024.
Me shkresë nr. 123/12 prot, datë 05.07.2024</td><td>14. Përgjigje nga KKP
V. 473/2024 datë 09.05.2024.
V.1003/2024 datë 06.08.2024.</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</td></tr>
<tr><td>15. Lidhja e kontratës
Nr. 123/8 prot, datë 18.09.2024</td><td colspan="3">Zbatimi i kontratës: Me urdhër nr. 123/20 prot, datë 20.09.2024 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.</td></tr>
</table>

<u>Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.</u>
Nëpërmjet Urdhrit nr. 176/1 prot, datë 27.02.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISUV, z. I. A ka ngritur

Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, të përbërë nga J. B., V. V., E. M., M. K.dhe D. Sh..
Në pikën 4 të Urdhrit përcaktohet se përllogaritja e fondit limit të kryhet nëpërmjet testimit të tregut dhe ofertat janë marrë paraprakisht.
Nëpërmjet shkresës nr. 308 prot., datë 11.03.2024, përgatitur nga Komisioni i posaçëm i ngritur për përllogaritjen e fondit limit, citohet se ofertat nuk janë marrë nga ky komision por janë përcjellë nga zyra e prokurimit. Në këtë memo, si dhe në PV e të njëjtës datë të Komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 176/1 prot, datë 27.02.2024, dokumentohet se ky komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke nxjerrë thjesht çmimin zërat e ofertës së dhëna nga Njësia e prokurimit ne vlerën prej 11,166,900 lekë pa TVSh.
Njësia e posaçme e ngritur për përllogaritjen e fondit limit nuk ka garantuar kryerjen e përllogaritjes së fondit limit *bazuar në specifikime teknike*, sipas përcaktimit të nenit 76 të RPP, duke u bazuar në ofertat e përcjella nga personi përgjegjës për prokurimet, pavarësisht se:
- Në datën 25.01.2024, kur personi përgjegjës për prokurimin A. I. ka dërguar e-mail 4 kompanive, Njësia e posaçme ende nuk kishte hartuar memon me nr 308, prot datë 11.03.2024, ku ka përcaktuar specifikimet teknike;
- Neni 74, pika 4 dhe neni 76, pika 3 e RPP përcaktojnë se hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit kryhet nga anëtari i njësisë së prokurimit ose specialisti i fushës **vetëm në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme**.
Specifikimet teknike janë nuk janë të argumentuara, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP.
Për parregullsitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre:
- Titullari i AK I. A për parregullsitë e konstatuara në veprimet e strukturave të ISUV në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në nenin 21, pika 5 të LPP, i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të RPP;
- J. B., V. V., E. M., M. K., D. Sh., *në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit*, duke mos garantuar ndjekjen e një prej metodave të përcaktuara në nenin 76, pika 1, të RPP, për përllogaritjen e fondit limit *bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*;
- A. I., për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit.

- Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 123/2 prot, datë 11.04.2024 është ngritur Njësia e prokurimit përbërjen: A. I., H. M., E. Sh.
Me proces-verbal pa nr prot. dhe pa datë, njësia e prokurimit ka hartuar dhe argumentuar specifiket teknike.
Me datë 29.04.2024 është paraqitur ankesë nga OE "G." shpk, objekti i ankesës është modifikimi i dokumenteve të tenderit.

Titullari i AK me shkresë nr. 123/5 prot, datë 30.04.2024 ka urdhër pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA) i cili përbehet nga znj. E. K., z. P. A. dhe z. V. Sh..
KSHA me shkresë nr. 123/6 prot, datë 02.05.2024 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "G." shpk si dhe ka vendosur modifikimin e disa nga kriteret ne DT.
KPP ka mare vendim me nr. 473/2024 datë 09.05.2024 dhe ka vendosur si me poshtë vijon:
1. Të mbylle çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së OE për procedurën e prokurimit…….
2. Të pranoje ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "G." SHPK, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme te Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të beje kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik

ankimues "G." SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund te bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë se Prokurimit Publik.
Me shkresë nr. 123/8 prot, datë 15.05.2024 AK ka dërguar pranë KPP informacionin mbi ndryshimet e bëra sipas vendimit 473/2024.
Me shkresë 123/9 prot pranë AK datë 29.05.2024, KPP ka lejuar AK në hapat e mëtejshëm në procedurën e prokurimit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DT dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.
Urdhri nr. 123/3 prot, datë 11.04.2024, Titullari i AK , ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga: znj. E. K., z. P. A., z. V. Sh.
Me procesverbal pa nr prot, datë 06.06.2024 u be hapja e oferta te dorëzuara për procedurën e prokurimit ku mori pjesë 4 OE si me poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	OE "A." shpk	0 lekë.	**S'Kualifikuar.**
2	OE "F." shpk	6,488,600 lekë.	**S'Kualifikuar.**
3	OE "G." shpk	8,700,000 lekë.	**Kualifikuar.**
4	OE "K." shpk	8,375,176 lekë.	**Kualifikuar dhe shpallur fitues.**

Me proces-verbal pa nr prot datë 24.06.2024 ka vlerësuar ofertat si me poshtë vijon dhe shpallur fituese(paraprak).
- OE "K." shpk, është shpallur fituese me ofertën ekonomike në vlerën 8,375,176 lekë pa TVSh ose 10,050,211 Lekë me TVSh.
- OE "A." shpk është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur oferte ekonomike si dhe dokumentacioni tekniko ligjor nuk është sipas kërkesave të AK.
- OE "F." shpk është skualifikuar pasi i mungon objekti i prokurimit ne ison 9001:2015, nuk janë të përkthyer katalogët për artikujt nga zëri 1 deri tek zëri 67, si dhe nuk përmbush specifikimet teknik për artikujt nr 35,36, 52 ku nga AK janë kërkuar antigen ndërsa nga OE janë antitrupa.

OE "G." shpk ka paraqitur ankesë.
Titullari i AK me shkresë nr. 123/11 prot, datë 02.07.2024 ka urdhëruar pezullimin e procedurës si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ankesës (KSHA).
KSHA me shkresë nr. 123/12 prot, datë 05.07.2024 ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga OE "G." shpk si dhe ka vendosur ne mospranim e saj.
Me shkresë nr. 123/13 prot, pranë AK datë 08.08.2024, KKP ka dërguar vendim me nr. 1003/2024 mbi ankesës e OE "G." shpk si dhe ka vendosur ne mos pranim e ankesës si dhe të lejojë AK me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimet.
- APP ka informuar AK me vendim nr. 75 datë 02.08.2024 ku ka vendosur të përjashtoj OE "K." shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike për 12 muaj.
- KVO me proces verbal pa nr prot, datë 13.08.2024 nisur nga shkresa e APP mbi skualifikimin e OE "K." shpk ka shpallur fitues OE e radhës me ofertë me të ulet i cili është OE "G." shpk me vlerë 8,700,000 lekë pa TVSH ose 10,440,000 lekë me TVSH.
Me shkresë nr. 650 prot, 21.08.2024 OE "K." shpk ka dërguar pranë AK vendim e Gjykatës Administrative të shkallës së parë Tiranë e cila ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ nr. 75 datë 02.08.2024 të Agjencisë së Prokurimit Publik deri në përfundim të gjykimit të themelit me vendim të formës se prerë.
- Me shkresë nr. 650/2 datë 22.08.2024 AK i ka kërkuar interpretim APP mbi situatën e procedurës se prokurimit si dhe hapat që do të mare në vazhdimësi.
- APP me shkresë nr. 650/3 prot pranë AK datë 03.09.2024, ka informuar AK se sipas vendimit të gjykatës, APP me vendim nr. 77 datë 22.08.2024 ka pezulluar zbatimin e vendimit nr. 75/2024, duke hequr subjektin në fjalë nga lista e OE të përjashtuar.

- KVO me proces verbal pa nr prot, datë 04.09.2024 ka shpallura fitues OE "K." shpk.

Grupi i Auditimit konstatoi se KVO nuk ka hartuar raportin përmbledhës *veprime në kundërshtim me* LPP Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 99 "Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit" si dhe *VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 73 pika 1 dhe neni 84.*
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Komisioni i vlerësimit të ofertave, znj. E. K., z. P. A., z. V. Sh. dhe titullari i Institucionit z. I. A.

-Lidhja e kontratës.
Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr. 123/18 prot, datë 18.09.2024 dhe afati do te vazhdoj për 12 muaj që nga data e nënshkrimit të kontratës.
Me shkresë nr. 123/9 prot datë 20.09.2024 është hartuar plani i zbatimit të kontratës.

-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 123/20 prot, datë 20.09.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: znj. S. K., znj. B. Q., z. R. M..

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur disa proces-verbal si më poshtë:
- Me Proces verbal pa nr prot datë 25.09.2024, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1362/2024, datë 25.09.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 302 datë 07.11.2024 në vlerën 386,040 lekë.
Me fletë hyrje nr. 71 datë 25.09.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Dalja është bërë me nr. 181 datë 30.08.2024 pas kërkesës së ardhur nga Departamenti i Shëndetit të kafshëve.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 11.10.2024, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1460/2024, datë 11.10.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 303 datë 07.11.2024 në vlerën 2,589,120 lekë.
Me fletë hyrje nr. 74 datë 07.10.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Dalja është bërë me nr. 191 dhe 193 datë 17.10.2024 pas kërkesës se ardhur nga sektori i kontrollit te mikrobiologjik dhe Shëndetit të kafshëve.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 30.10.2024, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1585/2024, datë 30.10.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 304 datë 07.11.2024 në vlerën 3,958,051 lekë.
Me fletë hyrje nr. 82 datë 25.09.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Dalja është bërë me nr. 203, 205, 208 dhe 215 datë 05,06,07,18.11.2024 pas kërkesës se ardhur nga sektori i kontrollit te mikrobiologjik, Shëndetit të kafshëve dhe departamenti i mbrojtjes së bimëve.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 15.11.2024, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1701/2024, datë 15.11.2024 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 319 datë 18.11.2024 në vlerën 1,952,760 lekë.
Me fletë hyrje nr. 89 datë 15.11.2024 është bërë hyrje në magazinë.
Dalja është bërë me nr. 223, 224 dhe 232 datë 21.11.2024 dhe 04.12.2024 pas kërkesës se ardhur nga sektori i kontrollit te mikrobiologjik, Shëndetit të kafshëve dhe departamenti i mbrojtjes së bimëve.
Në total deri në 31.12.2024 në baze të kontratës së sipërcituar janë shpenzuar 8,885,971 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se nëpërmjet procesverbaleve të sipërcituar, komisioni i marrjes në dorëzim ka përcaktuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk

ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit. Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar, dhe se datat e skadencës dhe/ose afatet e përdorimit kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe ofertën e pranuar, sa i përket afateve të skadencës dhe origjinës së produkteve.
Në kundërshtim me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 dhe kontratën me nr. 123/18 prot, datë 18.09.2024, nenin 4. Si dhe Rekomandimi i APP me nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit te zbatimit te kontratave te nënshkruara ne përfundim te procedurave te prokurimit për mallra, pune, shërbime".
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: znj. S. K., znj. B. Q. dhe z. R. M..

Procedura me objekt "Blerje kite për nevoja të ISUV" është realizuar nga MZHBR
Grupi i auditimit te KLSH ka audituar vetëm zbatimine kontratës së kësaj procedure
Me shkresë nr. 480 prot., datë 01.06.2022, ka ardhur autorizimi për lidhje kontratë "Blerje kite për nevoja të ISUV" nga MZHBR si ORGANI qendror i cili zhvilloj procedurën e prokurimit.
1. ISUV ka lidhur kontratën marrëveshje kuadër me nr. 480/1 prot., datë 03.06.2022, me OE "K." me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, me vlerë totale 8,514,760 lekë pa tvsh dhe 10,217,718 lekë me tvsh.
2. ISUV ka lidhur minikontrata e parë me nr., 480/6 prot., datë 30.06.2022, me afat 35 ditë nga nënshkrimi i kontratës se sipërcituar, me vlerë totale 4,200,180 lekë pa tvsh dhe 5,040,216 lekë me tvsh, për 34 artikuj.
3. ISUV ka lidhur minikontrata e dytë me nr. 108 prot, datë 21.02.2023, me afat 35 ditë nga nënshkrimi i kontratës se sipërcituar, me vlerë totale ,310,680 lekë pa tvsh dhe 5,172,816 lekë me tvsh, për 34 artikuj.
-Zbatimi i kontratës.
Me urdhër nr. 587 prot, datë 04.07.2022 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim i përberë nga: z. V. Sh., znj. S. T., znj. E. N..
Komisioni për marrjen në dorëzim për mini kontratën e parë të lidhur me nr. 480/6 prot, datë 30.06.2022, ka mbajtur disa proces-verbal si me poshtë:
- Me Proces verbal pa nr prot datë 04.07.2022, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1033/2022, datë 04.07.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 176 datë 04.08.2022 në vlerën 3,689,976 lekë.
Me fletë hyrje nr. 54 datë 04.07.2022 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr prot datë 26.07.2022, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1125/2022, datë 26.07.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 186 datë 18.08.2022 në vlerën 860,880 lekë.
Me fletë hyrje nr. 56 datë 26.07.2022 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. prot., datë 03.08.2022, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1161/2022, datë 03.08.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 196 datë 07.09.2022 në vlerën 327,360 lekë.
Me fletë hyrje nr. 59 datë 03.08.2022 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. Prot., datë 11.08.2022, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 1198/2022, datë 11.08.2022 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 197 datë 07.09.2022 në vlerën 162,000 lekë.
Me fletë hyrje nr. 64 datë 11.08.2022 është bërë hyrje në magazinë.

Në total deri në 31.12.2024 në baze të kontratës se sipërcituar janë shpenzuar 5,040,216 lekë.

Komisioni për marrjen në dorëzim për mini kontratën e dytë të lidhur me nr. 108 prot., datë 21.02.2023, ka mbajtur dy proces-verbal si me poshtë:
- Me Proces verbal pa nr. prot datë 01.03.2023, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 273/2023, datë 01.03.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 26 datë 17.03.2023 në vlerën 4,703,136 lekë.
Me fletë hyrje nr. 5 datë 01.03.2023 është bërë hyrje në magazinë.
- Me Proces verbal pa nr. prot datë 24.03.2023, komisioni shprehet se kitet rezultuan konform në sasi dhe specifikime teknike.
Fatura tatimore është paraqitur nga OE me nr. 394/2023, datë 24.03.2023 ndërsa likuidimi i faturës është kryer me urdhër shpenzim nr. 60 datë 11.05.2023 në vlerën 469,680 lekë.
Me fletë hyrje nr. 7 datë 24.03.2023 është bërë hyrje në magazinë.
Në total deri në 31.12.2024 në baze të kontratës se sipërcituar janë shpenzuar 5,172,816 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se nëpërmjet procesverbaleve të sipërcituar , komisioni i marrjes në dorëzim ka përcaktuar produktet e marra në dorëzim vetëm në aspektin sasior, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit.
Mos përcaktimi i këtyre të dhënave në procesverbal, nuk ofron garanci që mallrat e furnizuara kanë qenë nga firmat prodhuese sipas ofertës së vlerësuar, dhe se datat e skadencës dhe/ose afatet e përdorimit kanë qenë në përputhje me kërkesat në DST.
Për sa më sipër, nga mungesa e gjurmës së auditimit, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse artikujt e marrë në dorëzim kanë qenë në përputhje ose jo me përcaktimet në DST, kontratë, si dhe ofertën e pranuar, sa i përket afateve të skadencës dhe origjinës së produkteve.
Në kundërshtim me pikën 35, germa b, dhe pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 dhe kontratën nr. 480/1 prot., datë 03.06.2022, nenin 4. Si dhe Rekomandimi i APP me nr. 2106 datë 24.03.2021 "Rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit te zbatimit te kontratave te nënshkruara ne përfundim te procedurave te prokurimit për mallra, pune, shërbime"
Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: z. V. Sh., znj. S. T. dhe znj. E. N..

Në lidhje me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbi procedurat e prokurimit publik mbi kufirin e ulët dhe mbi kufirin e lartë monetar, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit që janë përfshirë në gjetjet nr. 17 dhe nr. 18 në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës administruar në KLSH me nr. 58/7 prot., datë 21.07.2025, subjekti i audituar ka paraqitur observacionin e tij, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: "*Lidhur me gjetjet ku konstatohet se Titullari nuk ka përfshirë specialist të fushës në njësinë e hartimit të specifikimeve teknike dhe komisionet e vlerësimit të ofertave (inxhinier elektronik ose ekuivalent, inxhinier mjedisi ose ekuivalent, etj.), sqarojmë se struktura funksionale e ISUV nuk përfshin punonjës me këtë diplomim. Komisionet e procedurave krijohen me stafin aktual që ne disponojmë*".
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Legjislacioni i prokurimit publik ka parashikuar hapat që autoriteti kontraktor duhet të ndjekë, në rastin e mungesës së personelit, përcaktuar në nenin 74, pika 2 dhe nenin 75, pika 3 të RPP-së. Mungesa e punonjësve specialistë fushe nuk e legjitimon vijimin e procedurave (hartimin e specifikimeve teknike, dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe vlerësimin e ofertave) duke përshtatur punonjës që nuk disponojnë kualifikimet e nevojshme. **Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.**

Auditimi i procedurave te blerjeve te vogla

2.4.14. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Shërbim, riparim krematoriumi"

Titullari i autoritetit kontraktor nëpërmjet Urdhrit Nr. 1, datë 07.02.2022, ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: znj. B. Ç., znj. A. I., znj. F. H.. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit me Nr. 639 Prot., datë 26.07.2022, me objekt "Shërbim, riparim krematoriumi". AK, në datën 02.08.2022 ka bërë njoftimin e fituesit, ku pjesëmarrësi i vetëm OE "H.-G. C." shpk, është shpallur fitues me vlerë 780,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi konstatohet se*:*

1. Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk rezulton të ketë kryer përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
2. Operatori Ekonomik "H.-G. C." është shpallur fitues pa u verifikuar me parë kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë, pasi nuk ka gjurmë auditimi mbi dorëzimin e dokumentacionit të OE. Kjo është në kundërshtim me nenin 2, pika 2, germa j) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", si dhe me pikën 18 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. B. Ç., znj. A. I., znj. F. H., në cilësinë e anëtarëve të grupit të prokurimit.

Marrja në dorëzim:

Titullari i AK ka ngritur komisionin për vlerësimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit/mallit me Urdhër Nr. 639/1 Prot., datë 22.09.2022 i përbërë nga: z. B. N., z. H. M., z. Sh. Rr.

Komisioni ka mbajtur procesverbale të marrjes në dorëzim pa nr. Prot., me datë 31.08.2022, 18.10.2022 dhe 01.12.2022, ku citohet se: "Shërbimi i kërkuar nga ana e ISUV janë konform cilësisë dhe çmimit të kërkuar".

Nga auditimi konstatohet se:

1. Grupi i auditimit konstatoi se Urdhri i Brendshëm me Nr. 639/1 prot., datë 22.09.2022 për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit sipas objektit të prokurimit, nuk është i regjistruar në librin e protokollit.

Në librin e protokollit me këtë numër protokolli, por me datë të ndryshme është regjistruar ftesa për ofertë. Këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" dhe me Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17.

2.4.15. Procedura e prokurimit me vlerë te vogël me objekt: "Blerje kite emergjence"

Në datën 25.03.2022 është ngritur Urdhri i Prokurimi Nr. 112, datë 25.03.2022, për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për procedurën me objekt: "Blerje kite", me përbërje: znj. M. L., znj. A. I., znj. B. Ç..

Nga auditimi konstatohet se:

- Përllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike nuk janë hartuar nga grupi i komisionit për blerjet e vogla ose nga një strukturë e posaçme e ngritur me urdhër për të kryer këtë veprim.

Znj. J. B., në cilësinë e përgjegjësit të departamentit të shëndetit të kafshëve dhe znj. V. V., në cilësinë e përgjegjësit të departamentit të PMB-ve dhe Mbrojtjes së Bimëve, kanë hartuar memo pa numër protokolli dhe pa datë drejtuar komisionit për blerjet e vogla të ngritur për këtë prokurim me lëndë "Përllogaritja e fondit limit".

- Nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, si dhe nuk është mbajtur një procesverbal i administrimit të ofertave të marra ose të treguesve të çmimeve, në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit

Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: M. L., A. I. dhe B. Ç., në cilësinë e anëtarëve të komisionit për procedurën me objekt: "Blerje Kite (emergjence)."

Vlerësimi i ofertave
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur Urdhrin e Prokurimit me Nr. 272 Prot., datë 25.03.2022, për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: "Blerje kite (emergjence)"
Komisioni i Prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël ka hartuar ftesën për ofertë, e cila është protokolluar më Nr. 272/1 Prot., datë 28.03.2022.
OE fitues "K." shpk ka dorëzuar pranë ISUV me Nr. 272/2 Prot., datë 30.03.2022, dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Marrja në dorëzim:
- Punonjësit pranë ISUV: L. H., E. P., B. Q., kanë hartuar procesverbal pa numër protokolli, me datë 08.04.2022, për marrjen në dorëzim të mallit të kërkuar në urdhrin e prokurimit dhe ftesës për ofertë, bazuar në faturën e OE "K." nr. 564/2022 datë 08.04.2022.
AK ka bërë likuidim me urdhër shpenzim nr. 86 datë 17.05.2022 me vlerën 164,400 lekë me TVSH.
- Punonjësit pranë ISUV: L. H., E. P., B. Q., kanë hartuar procesverbal pa numër protokolli, me datë 11.04.2022, për marrjen në dorëzim të mallit të kërkuar në urdhrin e prokurimit dhe ftesës për ofertë, bazuar në faturën e OE "K." nr. 577/2022 datë 08.04.2022.
AK ka bërë likuidim me urdhër shpenzim nr. 85 datë 17.05.2022 me vlerën 723,600 lekë me TVSH.

Nga auditimi konstatohet se:
1. Titullari i AK nuk rezulton të ketë ngritur një urdhër për marrjen në dorëzim të objektit të prokurimit. Gjithashtu punonjësit: L. H., E. P., B. Q., kanë marrë në dorëzim mallin e objektit të prokurimit, pa u bazuar mbi një urdhër për marrjen në dorëzim të mallit. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit 30 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. A. R., në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. L. H., E. P., B. Q., në cilësinë e nëpunësve që kanë firmosur në procesverbalin e marrjes në dorëzim.

2.4.16. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Shërbim, riparim krematoriumi".
Titullari i autoritetit kontraktues ka ngritur Urdhrin me Nr. 37 Prot., datë 17.01.2023 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël" me përbërje: znj. B. Ç.., znj. A. I., znj. D. Sh..

Nga auditimi konstatohet se*:*
1. Anëtari i KBVV D. Sh. është njëkohësisht edhe nëpunës zbatues pranë ISUV. Rrjedhimisht nuk duhet të ishte përfshirë si anëtare komisioni, pasi pamundëson objektivisht realizimin e hallkës së kontrollit lidhur me ligjshmërinë, rregullueshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficencës dhe efektivitetit sipas përcaktimeve në nenin 12 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. P. A., në cilësinë e titullarit të AK.

- Titullari i AK ka ngritur Urdhrin e Prokurimit me Nr. 531 Prot., datë 10.08.2023 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: "Shërbim, riparim krematoriumi".
Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël ka hartuar ftesën për ofertë me Nr. 531/1 prot., datë 14.08.2023.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE nga ku dy operatorë ekonomikë janë kualifikuar dhe 1 është s'kualifikuar.

Në datën 16.08.2023 është bërë njoftim për fituesin, i cili është OE "C." shpk. OE ka dorëzuar dokumentacionin pranë AK me Nr. 531/1 Prot., datë 18.08.2023.

Nga auditimi konstatohet se:
- Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka kryer përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
- KBVV nuk ka hartuar dhe nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, dhe me nenin 2, pika 2, germa c) të VKM-së 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar. Gjithashtu KBVV nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
- Operatori Ekonomik fitues nuk e ka në objekt veprimtarinë "Shërbim, riparim (servis)" për krematoriumin, në kundërshtim me pikën 15, germa a) të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Për sa më sipër KBVV duhet ta kishte evidentuar këtë parregullsi dhe ky operator duhet të ishte s'kualifikuar.
- Në ftesën për ofertë është vendosur kriter që OE te jetë regjistruar në QKB për projektim zbatim të impianteve të gazit dhe enëve nën presion. OE fitues "C." sh.p.k ka si veprimtari vetëm projektim, zbatim të projekteve të impianteve të gazeve. Mosplotësimi i këtij kriteri, është në kundërshtim me kërkesat e vendosura në ftesën për ofertë.
- OE "C." është shpallur fitues pa u verifikuar me parë të gjitha kriteret e kërkuara ne ftesën për ofertë, pasi në dokumentacionin e dorëzuar pranë AK nuk rezulton të jetë dorëzuar dëshmi për punët e ngjashme (për 3 vitet e fundit).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. A. I., znj. D. Sh., znj. B. Ç., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit.

*Marrja në dorëzim***:**
Me urdhrin Nr. 531/3 Prot., datë, 21.08.2023 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga: z. B. N., z. H. M., z. B. J..
Komisioni i marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbal pa numër protokolli, me datë 13.12.2023 mbi marrjen në dorëzim "Shërbim, riparim krematoriumi", bazuar në faturën tatimore të lëshuar nga OE "C.".

Nga auditimi konstatohet se:
- Ftesa për ofertë me Nr. 531/1 Prot., datë 14.08.2023 për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, nuk është regjistruar në librin e protokollit.
Në librin e protokollit me këtë numër protokolli, por me datë të ndryshme 18.08.2023 është regjistruar dorëzimi i dokumentacionit të OE fitues.
Këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe me Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17.

2.4.17. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Kontrolli i mjeteve matëse"
Titullari i autoritetit kontraktues ka ngritur urdhrin me Nr. 118/1 Prot., për ndryshimin e urdhrit Nr. 118 Prot., datë 12.02.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël" me përbërje: znj. A. I., znj. D. Sh., znj. E. K..

Nga auditimi konstatohet se*:*
1. Anëtari i KBVV D. Sh.është njëkohësisht edhe nëpunës zbatues pranë ISUV. Rrjedhimisht nuk duhet të ishte përfshirë si anëtare komisioni, pasi pamundëson objektivisht realizimin e hallkës së kontrollit lidhur me ligjshmërinë, rregullueshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficencës dhe efektivitetit sipas përcaktimeve në nenin 12 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. I. A, në cilësinë e titullarit të institucionit të Autoritetit Kontraktor.

-Titullari i AK ka ngritur Urdhrin e Prokurimit me Nr. 579 Prot., datë 24.07.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: "Kontrolli i mjeteve matëse".
KBVV ka hartuar ftesën për ofertë me Nr. 579/1 prot., datë 24.07.2024.
Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE nga ku dy operatorë ekonomikë janë kualifikuar dhe 1 është skualifikuar.
Në datën 26.07.2024 është bërë njoftim i fituesin, i cili është OE i parë ofertues "A." shpk, me vlerë 880,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi konstatohet se:
- KBVV nuk ka përllogaritur fondin limit në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
- KBVV nuk ka hartuar dhe nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 78, pika 2 dhe nenin 2, pika 2, germa c) të VKM-së 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Gjithashtu KBVV nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".
- OE "A." është shpallur fitues pa u verifikuar me parë kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë pasi në dokumentacionin e dorëzuar pranë ISUV janë konstatuar mangësitë si më poshtë:
a) OE fitues nuk e ka në objekt veprimtarinë "Kontrollin (kalibrimin) e mjeteve matëse", në kundërshtim me pikën 15, germa a) të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021"Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Për sa më sipër, KBVV duhet ta kishte evidentuar këtë parregullsi dhe ky operator duhet të ishte skualifikuar.
b) Certifikata e akreditimit Nr.. 426-6 e dorëzuar në dokumente, ka qenë e vlefshme deri në datën 06.05.2024, ndërkohë që procedura e prokurimit është hapur në datën 25.07.2024 dhe njoftimi për fituesin është bërë në datën 26.07.2024. OE ka dorëzuar dokumentacionin pranë AK në datën 29.07.2024. Pra, ky operator ekonomik nuk ka qenë i licencuar për të kryer kalibrimin për këtë periudhë.
c) Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se certifikata e lëshuar nga laboratori kalibrues nuk është i akredituar nga një organizëm akreditues, i cili është nënshkrues i EA-MLA në fushën e kalibrimit, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021"Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 18.
ç) OE ka dorëzuar në dokumentacion certifikatën e akreditimit Nr. 426-6 të operatorit "Total Q Calibration Labortaries S.A", por nuk ka gjurmë auditimi për një kontratë mes OE fitues dhe këtij laboratori për të kryer shërbimin e kërkuar nga ana e ISUV.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. A. I. në cilësine e kryetares së komisionit, znj. D. Sh. në cilësinë e anëtarit, znj. E. K. në cilësinë e anëtarit.

Marrja në dorëzim:
Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin me Nr. 579/3 Prot., datë, 29.10.2024 për komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga: znj. S. H., znj. E. Sh., znj. A. V., z. L. Z., znj. Zh. H..

Komisioni ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim pa numër Protokolli, me datë 29.10.2024 ku ndër të tjera citohet se: "Artikujt me nr. serial: 040914003 (zëri 4), 15409227 (zëri 5), 17203108 (zëri 5), 16205936 (zëri 5) nuk e kanë kaluar shërbimin e kërkuar (kalibrim). Artikujt shoqërohen me certifikatë".

Nga auditimi konstatohet se:
1. Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me urdhrin Nr. 579/3 Prot., datë, 29.10.2024, ka mbajtur procesverbalin pa numër prot., me datë 29.10.2024, por pa kryer verifikimin paraprak mbi realizimin e shërbimit të servisit, pasi sipas certifikatave të kalibrimit, shërbimi është kryer para ngritjes së komisionit. Kjo është në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzim-it nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*
2. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim thuhet se është marrë në dorëzim zëri 6 i kërkesës për ofertë me specifikime: shpërndarës për shishe qelqi MMV, fusha e përdorimit 5-50 ml, Nr. Serial 17303692, Firma "Kartell Dosi Jet". Servis dhe Kalibrim, por ndërkohë nga certifikatat e kalibrimit dorëzuar grupit të auditimit rezulton se është bërë kalibrim për një artikull i cili nuk është pjesë e ftesës për ofertë me specifikim: Shpërndarës për shishe qelqi_MMV, fusha e përdorimit 5-60 ml, Nr. Serial 17303692, Firma I., në kundërshtim me specifikimet teknike të Urdhrit të Prokurimit dhe ftesës për ofertë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. S. H., znj. E. Sh., znj. A. V., z. L. Z., ne cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

- Në procesverbalin e marrjes në dorëzim është cituar se: "Artikujt me nr. Serial 040914003 (zëri 4), 15409227 (zëri 5), 17203108 (zëri 5), 16205936 (zëri 5) nuk e kanë kaluar shërbimin e kërkuar (kalibrim). Artikujt shoqërohen me certifikatë".
Në urdhër shpenzimin me nr. 303, datë 23.12.2024, me vlerë 1,056,000 lekë me TVSH, është likuiduar fatura me vlerën totale, duke përfshirë dhe 4 artikujt e sipërcituar për të cilët komisioni i marrjes në dorëzim është shprehur se nuk e kanë kaluar shërbimin e kërkuar (kalibrimin). Vlen të theksohet se *tek specifikimet teknike në ftesën për ofertë për artikujt me nr. serial të sipërcituar është kërkuar kalibrimi dhe jo kontrolli i tyre.*
- Për zërin nr. 6 "Shpërndarës për shishe qelqi" të Urdhrit të Prokurimit, me përcaktimet: fusha e përdorimit 5-50 ml, Nr. Serial 17303692, Firma "Kartell Dosi Jet", sipas kërkesës për ofertë, nuk është bërë servis dhe kalibrim.
- Në urdhër shpenzimin me nr. 303, datë 23.12.2024, me vlerë 1,056,000 lekë me TVSH, është likuiduar fatura totale, duke është përfshirë dhe këtë artikull, për të cilin nuk është bërë kalibrimi, sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë.
Autoriteti kontraktor ka likuiduar faturën totale duke përfshirë dhe 4 artikujt e sipërcituar të cilët nuk kanë kaluar shërbimin e kërkuar (kalibrimin) në vlerë prej 115,200 lekë me TVSH si dhe për 1 artikull për të cilin nuk është bërë kalibrimi sipas specifikimeve teknike në ftesën për ofertë me vlerën prej 28,800 lekë me TVSH.
Për sa më sipër likuidimi i vlerës totale prej 144,000 lekë me TVSH, pa u kryer kalibrimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Urdhrin e Prokurimit dhe Ftesës për Ofertë përbën dëm ekonomik.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
J. B., në cilësinë e nëpunësit autorizues, D. Sh., në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4.18. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Shërbim, riparim, blerje pjese këmbimi për aparaturat Bertin".

Titullari i autoritetit kontraktues ka ngritur Urdhrin me Nr. 118/1 Prot., për ndryshimin e Urdhrit nr. 118 Prot., datë 12.02.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël" me përbërje: znj. A. I., znj. D. Sh., znj. E. K..

Nga auditimi konstatohet se*:*
1. Anëtari i KBVV D. Sh. është njëkohësisht edhe nëpunës zbatues pranë ISUV. Rrjedhimisht nuk duhet të ishte përfshirë si anëtare komisioni, pasi pamundëson objektivisht realizimin e hallkës së kontrollit lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficencës dhe efektivitetit sipas përcaktimeve në nenin 12 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. I. A, në cilësinë e titullarit të institucionit të Autoritetit Kontraktor.

- Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit me Nr. 746 Prot., datë 25.09.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për aparaturat Bertin".
KBVV ka hartuar ftesën për ofertë me Nr. 746/1 Prot., datë 25.09.2024.
Në datën 27.09.2024 është bërë njoftim i fituesit, i cili është OE i parë dhe i vetëm ofertues "I." sh.p.k me vlerë 989000 lekë pa TVSH.
Nga auditimi konstatohet se:
1. KBVV nuk ka përllogaritur fondin limit në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
2. KBVV nuk ka hartuar dhe nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të vecanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 78, pika 2dhe nenin 2, pika 2, gërma c) të VKM-së 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar. Gjithashtu KBVV nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
3. KBVV nuk ka argumentuar kriteret e vendosura në ftesën për ofertë në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 78, pika 2.
4. OE "I." është shpallur fitues pa u verifikuar me parë kriteret e kërkuara ne ftesën për ofertë, pasi nuk ka gjurmë auditimi mbi dorëzimin e dokumentacionit të OE. Kjo është në kundërshtim me nenin 2, pika 2, germa j) të VKM-së 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar si dhe me pikën 18 të Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021"*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. A. I. në cilësine e kryetares së komisionit, znj. D. Sh.në cilësinë e anëtarit, znj. E. K. në cilësinë e anëtarit.

Marrja në dorëzim:
Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin me Nr. 746/2 Prot., datë, 24.12.2024, ku është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga: znj. E. Sh., znj. B. Q., znj. G. N..
Komisioni ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim pa numër Prot., datë 24.12.2024 ku citohet se: "Servisi dhe shërbimi i kërkuar u realizua i plotë, sipas akt-dorëzimit të OE të datës 24.12.2024" Operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore me nr. fature 184/2024, datë 24.12.2024. AK ka kryer likuidimin e faturës me Urdhër Shpenzimin nr. 390 datë 27.12.2024 në vlerën 1,186,800 lekë me TVSH.

Nga auditimi konstatohet se:
1. Titullari i AK ka ngritur Urdhrin e Brendshëm me Nr. 746/2 Prot., datë 24.12.2024 "Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të prokurimit me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për

aparaturat Bertin". Ky urdhër është ngritur *78 ditë kalendarike më vonë* nga shpallja e OE fitues, por në ftesën për ofertë citohet se: "Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë 10 ditë nga momenti i shpalljes fitues" ose deri në datën 07.10.2024.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. I. A në cilësinë e titullarit (deri në datën 31.10.2024), znj. J. B., në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor (01.11.2024-në vazhdim).
2. Bazuar në akt dorëzimin e lëshuar nga OE dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim konstatohet se nuk janë marrë të gjitha mallrat në dorëzim pasi për mallin e parë *"Tuba bosh pa sfera sasia 15 ml" janë kërkuar **5 pako***, ndërkohë në akt dorëzim dhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim është dorëzuar ***1 pako***. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e këtij objekti prokurimi, bazuar në ftesën për ofertë dhe urdhrin e prokurimit.
3. Bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim të datës 24.12.2024 citohet se: "Servisi dhe shërbimi i kërkuar u realizua i plotë".
Nuk kemi një dokument, procesverbal, certifikatë kalibrimi që vërteton se është kryer riparim, servis kalibrimi për aparaturat Bertin.
Nga kontrolli në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), OE nuk ka licencë për kalibrim dhe për rrjedhojë nuk ka lëshuar një certifikatë për kalibrimin e aparaturave Bertin pas përfundimit të shërbimit. Kjo është në kundërshtim me objektin e kësaj procedure prokurimi si dhe me dokumentin e publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë "Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, Interpretimi dhe Përdorimi.
4. Në ftesën për ofertë citohet se: "Afati i lëvrimit të mallit/shërbimit/punës do të jetë 10 ditë nga momenti i paraqitjes në ISUV dhe pranimit të dokumentacionit të rregullt, ndërsa mirëmbajtja do të kryhet deri në fund te vitit 2024".
Operatori ekonomik është shpallur fitues në datën 26.07.2024, ndërkohë lëvrimi i mallit është bërë në datën 24.12.2024. Ky shërbim është bërë 78 ditë me vonesë, në kundërshtim me kërkesat e ftesës për ofertë.
5. Për mallrat e marra në dorëzim nuk është bërë hyrje në magazinë, në kundërshtim me pikën 44 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. E. Sh., znj. B. Q., znj. G. N., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

2.5. Mbi Vlerësimin e Funksionimit të Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
Në kuadër të auditimit, është vlerësuar funksionimi i Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në ISUV. Ky sistem përbëhet nga pesë komponentë thelbësorë sipas përcaktimeve ligjore dhe udhëzimeve të MF. Analiza synon të evidentojë nivelin e zbatimit të secilit komponent dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator. Gjetjet janë mbështetur në dokumentacionin zyrtar dhe verifikimet në terren. Vlerësimi i 5 komponentëve të MFK në ISUV paraqitet sa më poshtë vijon:

1.Mjedisi i kontrollit, i cili përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale, ku menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit.
Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep struktura drejtuese e ISUV.

Nga auditimi konstatohet se:
- Mungon plani strategjik afatshkurtër/afatmesëm, me objektiva të qarta dhe të matshme, sipas kërkesave të nenit 9, pika 4, germa "a", e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.
- Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), si strukturë përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e objektivave strategjikë.

- Mungon rregullorja e brendshme për funksionimin e institucionit, përfshirë përshkrimet e punës, strukturën organike dhe marrëdhëniet ndërsektoriale, etj., veprim ky në kundërshtim me Manualin e MFK-së, pika 3.3.
- Ka probleme në administrimin e dokumentacionit dhe arkivit, përfshirë mospërputhje në protokollim, mungesë firmash dhe shkelje të ligjit për arkivat, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", si dhe nenin 12 dhe 13 të Normave Tekniko - Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen, sipas parashikimeve të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se:

- Nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, si në nivel qendror, ashtu edhe në drejtori, në kundërshtim me piken 2, neni 21 të ligjit nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar dhe në udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*", pika 3.2.1dhe 3.2.2
- Mungon regjistri i riskut, dhe nuk bëhet identifikimi i riskut të lartë financiar, ligjor dhe operacional, sikurse parashikohet në nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.
- Nuk është përgatitur regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky i parashikuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar pika 2 neni 11.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

Nga auditimi konstatohet se:

-ISUV nuk ka miratuar gjurmën e auditit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit, siç përcaktohet në pikat nr. 2 dhe 3, të nenit 16, "*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit*", dhe në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.
-evidentohen parregullesi gjate fazës se miratimit te fondit limit dhe mënyrës se marrjes se ofertave nga OE në fazën e përllogaritjes së fondit limit.

4. Informacioni dhe komunikimi

Informacioni dhe Komunikimi përbëjnë një komponent thelbësor për funksionimin efektiv të sistemit të MFK-së. Institucionet publike duhet të sigurojnë që informacioni të jetë i saktë, i plotë, i përshtatshëm dhe i shpërndarë në kohë, për të mundësuar marrjen e vendimeve ne përputhje me bazën ligjore te zbatuar.

Nga auditimi u konstatua se:

Komunikimi ligjor dhe administrativ brenda institucionit paraqitet i fragmentuar, duke munguar një sistem i strukturuar për informimin e njësive mbi ndryshimet ligjore në fuqi.
Në disa raste, aktet administrative mbështeten në baza ligjore tashmë të shfuqizuara, duke treguar mungesën e një mekanizmi formal për përditësimin dhe kontrollin e legjislacionit në përdorim.

Gjithashtu, procesi me shumë hallka për përcaktimin e fondit limit dhe të specifikimeve teknike ka krijuar paqartësi, për shkak për shkak të mungesës së një procedure të unifikuar për koordinimin ndërmjet sektorëve dhe njësisë së prokurimit.

5. Monitorimi
Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.
Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Nga auditimi konstatohet se:
ISUV nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, siç parashikohet në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.
Në lidhje me strukturën e auditit të brendshëm, ISUV nuk ka një njësi të auditit të brendshëm në organikën e vet institucionale, pasi është një institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe kontrollohet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë kësaj ministrie.
Për periudhën objekt auditimi, Njësia e Auditit të Brendshëm ka hartuar raportin e auditimit nr. 704/5 Prot., datë 31.01.2022, me protokoll hyrës në ISUV nr. 140/4 Prot., datë 04.05.2022.

Konkluzion:
Për sa më lart, MFK në institucionin Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare për 5 (pesë) komponentët integral, konstatohet se:
1.Mjedisi i kontrollit për periudhën objekt auditimi, është jo efektiv.
2. Nuk funksionon një sistem efektiv për menaxhimin e riskut.
3.Institucioni ka mangësi në aktivitetet e kontrollit dhe nuk eshte efektiv
4.Nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.
5.Mungon sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Në përfundim sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën objekt auditimi në institucionin Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, konstatohet se është jo efektiv.
Këto mangësi cenojnë cilësinë e menaxhimit dhe integritetin financiar të institucionit dhe kërkojnë masa të menjëhershme për ndërtimin e një sistemi funksional të MFK-së
Me veprimet apo mosveprimet brenda periudhës së ushtrimit të detyrës së titullarit të institucionit të ISUV, duke mos siguruar dhe ngritur një sistem efektiv të kontrollit dhe menaxhimit financiar, ngarkohen me përgjegjësi: z. A. R., z. P. A., z. I. A dhe znj. J. B., dhe njëkohësisht nëpunësit e autorizuar: znj. N. Z. në cilësinë e Arkivist/Protokollist dhe znj. B. Ç. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, duke vepruar në mospërputhje me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë të hartuar në zbatim të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat".

2.6. Të tjera, mbi aktivitetin e ISUV, si institucion përgjegjës për gjurmimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe shpendëve, si dhe çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.
2.6.1. Informacion i përgjithshëm mbi shpërndarjen e përcaktimeve analitike të akredituara, në përputhje me plotësimin e standardit ISO/IEC 17025 nga ISUV.

ISUV është një institucion publik, i specializuar në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit veterinar dhe kontrollit të produkteve me origjinë shtazore dhe bimore, i cili luan një rol thelbësor në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit dhe në garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian. Akreditimi përbën një proces të rëndësishëm

që siguron njohjen zyrtare të kompetencës teknike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara nga ISUV. ISUV është akreditуar nga DPA, në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, i cili përcakton kërkesat për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit. Në funksion të misionit të tij, për forcimin e sigurisë ushqimore dhe veterinare, ISUV realizon një gamë të gjerë analizash laboratorike të akredituara. Deri në fund të vitit 2024, ISUV në total është i akreditуar për kryerjen e 1,909 analizave, të cilat janë të ndara sipas departamenteve dhe sektorëve, siç paraqitet në tabelën nr.1.

Tabela nr. 1. Numri i përcaktimeve të akreditуar sipas departamenteve/sektorëve (viti 2024)

Departamenti	Sektori	Akreditime
Dep. Shëndetit të Kafshëve	Sek. Serologji	13
	Sek. Diag. Kafshë & Shpendë	6
	Sek. Patologji&Terbimit	2
	Totali	**21**
Dep. Mikrob. & Monitorimi Ujërave & Cilësisë	Sek. Prod. Peshkut & Monitorim Molusqe	5
	Sek. Kontroll.Mikrobiologjik i Produkteve	80
	Sek. Vleresimi të Cilësisë së Ushqimeve	4
	Totali	**89**
Dep. Monitorimit të Mbetjeve, Kontrollit të Barnave Veterinare dhe Toksikologjisë	Sek. Mbetjeve Veterinare dhe Kontaminantëve	21
	Sektori I Kontrollit të Barnave Veterinare	0
	Totali	**21**
Dep. Mbrojtjes së Bimëve	Sek. Anal. PMB & Monitorim i Mbetje Bimë	1778
	Sek. i Diagnostikimit të Dëmtuesve të Bimëve	0
	Totali	**1778**
Totali ISUV		**1,909**

Burimi: ISUV, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

- Procesi i akreditimit të ISUV, sipas standardit ISO/IEC 17025 ka nisur në vitin 2011, me mbikëqyrje nga DPA.
- Në vitin 2012, ISUV mori akreditim nga ACCREDIA, pasi DPA në këtë periudhë nuk ishte pjesë e EA-MLA.[13]
- Duke filluar nga viti 2016 e në vazhdim, ISUV mban akreditime vetëm nga DPA, pasi kjo e fundit u bë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare të njohjes reciproke (EA-MLA dhe ILAC-MRA[14]).
- Në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr.2 pasqyrohen numri i analizave të akredituara

Tabela nr.2. Shpërndarja e përcaktimeve "Akreditуar" - 2024

Departamenti	Përcaktime	% e Totalit
Dep. Mbrojtjes së Bimëve	1,778	93.1%
Dep. Mikrobiologjisë & Monitorimit të Ujërave	89	4.7%
Dep. Monitorimit të Mbetjeve	21	1.1%
Dep. Shëndetit të Kafshëve	21	1.1%
Total	**1,909**	**100%**

Burimi: ISUV, përpunimi nga grupi i auditimit te KLSH

Nga auditimi konstatohet se:

- ISUV ka gjithsej 41 laboratorë (përfshirë 3 laboratorë që kryejnë vetëm shërbime të brendshme: Lab. Metrologjisë, Preparatori Speciale, Vivarium), nga të cilët **19 Laborator kanë teste të akredituara në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, pra rreth 50% e laboratorëve (pa përfshirë 3 laboratorët për shërbime të brendshme) janë të pa akreditуar.**
- Pjesa dërrmuese e analizave të akredituara, përkatësisht 1,778 ose 93.1% e totalit, janë të përqendruara në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve.

[13] European co-operation for Accreditation-Multilateral Agreement
[14] International Laboratory Accreditation Cooperation-Mutual Recognition Arrangement

- Ndërkohë, që departamente të tjera me funksione kyçe për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve, si Departamenti i Mikrobiologjisë dhe Monitorimit të Ujërave (4.7%), Departamenti i Monitorimit të Mbetjeve (1.1%) dhe Departamenti i Shëndetit të Kafshëve (1.1%), përfaqësojnë një përqindje minimale të analizave të akredituara.
- Sektori i kontrollit të barnave veterinare dhe sektori i diagnostikimit të dëmtuesve të bimëve, **nuk kanë asnjë përcaktim/test analitik të akredituar**.

Konkluzion:
Niveli i ulët i mbulimit analitik të akreditimeve në disa sektorë, tregon se:
Në planin e zhvillimit strategjik, ISUV nuk ka zhvilluar dhe investuar mjaftueshëm në rritjen e kapaciteteve në fushat që mbulojnë këta sektorë jetik për sigurinë ushqimore dhe veterinare, siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027, mbi forcimin e kapaciteteve laboratorike për të garantuar sigurinë ushqimore dhe për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian në këtë drejtim

2.6.2. Realizimi i planeve kombëtare të kontrolleve
Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku, të miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ISUV luan një rol kyç në realizimin e analizave laboratorike për kampionet e mbledhura nga AKU dhe AKMBV. Ky plan, i hartuar sipas një metodologjie të vlerësimit të riskut të operatorëve të biznesit, synon të garantojë sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik në vend
Në zbatim të PKKZBR për vitet 2022, 2023 dhe 2024, veprimtaria e departamenteve të ISUV në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

1. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, ofron shërbime të specializuara laboratorike në fushat e analizave kimike, mikrobiologjike dhe biologjike, me fokus në mbrojtjen e bimëve dhe garantimin e sigurisë ushqimore të produkteve me origjinë bimore.
Veprimtaria e këtij departamenti për periudhën 2022–2024 është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në Tabelën nr. 3, Aneksi 2.6.2**.** dhe në vijim në tabelën nr.4 paraqiten rastet alerte/pozitive

Tabela nr. 4. Analiza të kryera për periudhën 2022-2024 nga DMB

Viti	Kampione të Ardhura	Kampione të Analizuara	Analiza të Kryera	Raste Pozitive/Alert	% Pozitiviteti (mbi kamp. analizuara)
2022	1,022	539	110,552	69	**12.8%**
2023	1,531	1,531	429,356	135	**8.8%**
2024	1,638	1,638	419,502	105	**6.4%**

Burimi: ISUV, përpunimi nga grupi i auditimit.

Nga auditimi konstatohet se:
Si rezultat i analizave të kampionëve, të ardhura nga AKU dhe AKMBV sipas planeve kombëtare të kontrollit, veprimtaria e këtij departamenti, ka pasur një rritje të ndjeshme të kampioneve të analizuara në vitet 2023 dhe 2024, krahasuar me vitin 2022.
Po ashtu, në bazë të rezultateve të testeve të kryera për këto kampione, konstatohet një rënie e rasteve alert/pozitiv nga 12.8% në 6.4%.
- Monitorimi i mbetjeve të pesticideve, në kuadër të këtyre planeve kombëtare, ka treguar se në vitin 2022 janë regjistruar 69 raste alert/pozitive, në vitin 2023 janë regjistruar 135 raste pozitive dhe në vitin 2024 janë identifikuar 105 raste pozitive.

2. Departamentit të Monitorimit të Mbetjeve, Kontrollit të Barnave Veterinare dhe Toksikologjisë, veprimtaria e tij, është e orientuar drejt sigurimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore përmes analizave laboratorike të produkteve me origjinë shtazore dhe bimore.
Ky departament kryen analiza të mbetjeve të substancave të ndaluara dhe të paautorizuara, si dhe të barnave veterinare në kafshët e gjalla dhe produktet e tyre, e cila përfshin monitorimin e mbetjeve

të pesticideve dhe metaleve të rënda në produkte ushqimore me origjinë shtazore dhe bimore, si dhe kontrollin e cilësisë së barnave veterinare të përdorura në trajtimin e kafshëve.
Veprimtaria e këtij departamenti për periudhën 2022–2024 është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në Tabelën nr. 5, Aneksi 2.6.2.

3. Departamentit i Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë, veprimtaria e tij bazohet në planet e monitorimit për zonat e ndryshme të bregdetit shqiptar si:
Laguna e Butrintit, Gjiri i Butrintit, Karavasta, Gjiri Durrësit, Shëngjin -Velipojë, Kepi i Rodonit.
Në planin me bazë risku të AKU për kontrollit e produkteve shtazore dhe jo shtazore në vend, planin e monitorimit të peshkut si dha analiza autokontrolli për eksport.
Akreditimet përfshijnë një game të madhe të matricave ushqimore që i përkasin kategorive si mish e nënprodukte, qumësht e nënprodukte, produkte peshkore të freskëta dhe të përpunuara, molusqe, vaj ulliri dhe vajra vegjetalë, ujë i kripur dhe i ëmbël.
Veprimtaria e këtij departamenti për periudhën 2022–2024 paraqitet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën nr. 6, Aneksi 2.6.2.

4.**Departamenti i Shëndetit të Kafshëve** ka si aktivitet bazë përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose ngordhshmërisë së specieve të ndryshme të kafshëve dhe e mbështet punën mbi Ligjin 10465 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë".
Në kuadër të Planeve kombëtare të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve detyrimisht të raportueshme si dhe zbatimin e strategjive lidhur me minimizimin e prevalencës së sëmundjeve zonotike të cilat kanë impakt në shëndet publik, janë analizuar kampionet siç paraqiten në tabelën nr.7 Aneksi 2.6.2.

2.6.3. Autokontrolli në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinare

Autokontrolli është një praktikë e ndërmarrë me iniciativë të vetë operatorëve të biznesit ushqimor dhe fermerëve, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së produkteve me kërkesat ligjore në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe bimëve.
Ky mekanizëm vlerësohet si një mjet thelbësor për rritjen e sigurisë së prodhimeve dhe për mbrojtjen e shëndetit publik, duke përmirësuar gjithashtu kushtet për tregtimin dhe eksportin e produkteve agro-ushqimore.
Kryerja e analizave laboratorike në institucione të akredituara, përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sistemit të vetëkontrollit të zbatueshëm nga bizneset.
Analizat e autokontrollit, nuk bëjnë pjesë në planin kombëtar të monitorimit me bazë risku, por realizohen jashtë këtij plani, me kërkesë të drejtpërdrejtë të vetë subjekteve private.
Përmes këtij mekanizmi, bizneset ushqimore kërkojnë të sigurohen mbi cilësinë dhe sigurinë e produkteve të tyre, duke rritur besueshmërinë në treg dhe duke përmbushur kërkesat e standardeve ndërkombëtare.
Për periudhën 2022-2024, ISUV ka realizuar gjithsej 11,954 analiza laboratorike të autokontrollit.
ISUV, zbaton të njëjtat procedura të menaxhimit të cilësisë si për analizat e kryera në kuadër të PKKZBR, ashtu edhe për analizat që realizohen me iniciativë të vetë subjekteve private në kuadër të autokontrollit. Ky proces përfshin të gjithë ciklin e trajtimit të kampionit, që nga marrja dhe regjistrimi i tij, e deri te raportimi i rezultatit përfundimtar të analizës, në përputhje me kërkesat e standardeve të akreditimit dhe legjislacionit në fuqi.
ISUV ofron shërbime laboratorike për operatorët e biznesit ushqimor dhe fermerët në bazë të një liste tarifash të miratuar, për të cilat të ardhurat që gjenerohen nuk administrohen nga ISUV, por derdhen si të ardhura për MBZHR.
Në tabelën nr.8 paraqiten në mënyrë analitike numri i analizave të kryera gjatë periudhës objekt auditimi dhe të ardhurat e siguruara nga kjo veprimtari, në funksion të autokontrollit dhe ofrimit të shërbimeve laboratorike për palët e treta.

Tabela nr.8. Të ardhura nga analizat e autokontrollit

Nr.	Viti	Nr. Analizave me Auto Kontroll	Vlera në lekë
1	2022	6,804	9,776,500
2	2023	3,151	3,849,926
3	2024	1,999	3,662,472
Total		**11,954**	**17,288,898**

Burimi: ISUV përpunimi nga grupi i auditimit te KLSH

Nga auditimi konstatohet se:
Gjatë viteve 2023 dhe 2024, është vërejtur një tendencë në rënie e numrit të analizave të kërkuara nga subjektet private pranë ISUV, çka ka sjellë gjithashtu ulje të të ardhurave dytësore të gjeneruara nga ofrimi i këtyre shërbimeve laboratorike. Megjithëse analizimi i shkaqeve konkrete nuk bën pjesë në objektin e drejtpërdrejtë të auditimit nga ana e KLSH, si faktorë të mundshëm ndikues mund të përmenden:
- Ulja e aktivitetit eksportues të disa operatorëve privatë në sektorin ushqimor dhe veterinar.
- Orientimi i subjekteve drejt laboratorëve të tjerë privatë që ofrojnë shërbime të ngjashme.
- Kohëzgjatja e proceseve të analizës dhe e dhënies së përgjigjeve nga ISUV krahasuar me laboratorë të tjerë.
- Si dhe niveli i tarifave të aplikuara nga ISUV, nëse rezultojnë më të larta sesa ofertat në treg.
Këto elementë përbëjnë supozime të mbështetura në analizë kontekstuale, për këtë arsye mbi shkaqet e rënies së kërkesave për kryerjen e analizave të autokontrollit, duhet të bëhet nga vetë ISUV.

2.6.4. Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në ISUV
ISUV, zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë në përputhje me standardin ISO/IEC 17025:2017, që përfshin të gjitha hallkat e procesit nga pranimi i kampionit deri në lëshimin e raportit analitik.
Ky sistem siguron integritetin e procesit laboratorik dhe kompetencën teknike të laboratorëve, duke përmbushur kërkesat e DPA-së dhe standardeve ndërkombëtare për laboratorët testues dhe kalibrues.

Menaxhimi i Kampioneve dhe Fluksi i Punës
Procesi përfshin disa hapa të strukturuar:

1. Pranimi i Kampioneve
Kampionet dorëzohen në ZPK, ku verifikohet përmbushja e kritereve teknike sipas dokumentit mod. 40-SU-007, kontrollohet pesha, temperatura dhe gjendja fizike e ambalazhit.
Dokumentacioni shoqërues (Fleta e Shoqërimit mod. 40-SU-004) regjistrohet në sistemin LIMS dhe në Regjistrin e Pranimit (mod. 40-SU-001).
2. Identifikimi dhe Etiketimi
Çdo kampion identifikohet me një kod unik (p.sh. kampioni Nr. U0034/25), i cili vendoset në të gjitha dokumentet përkatëse për të garanton gjurmueshmërin.
Shënim: Nr. U0034/25 tregon që ky kampion është regjistruar në ZPK me nr. 34 Prot.; numri 25 tregon vitin 2025, dhe shkronja U tregon që analiza do të bëhet për sigurinë ushqimore. Pra, vendosja e kodit unik në ISUV ndjek gjithmonë këtë rregull.
3. Dërgimi në Laborator
Kampioni dorëzohet në laborator në paketimin origjinal dhe pa u hapur.
Laboratori konfirmon marrjen dhe dokumenton shpërndarjen me Fletën përkatëse (40-SU-005).
Nëse kampioni qëndron në pritje, ai ruhet në kushte frigoriferike.
4. Analizimi dhe Dokumentimi
Kampioni regjistrohet në Rregjistrin e Laboratorit (mod.40-SU-003).
Analizat kryhen sipas skedave operative të miratuara.
Raporti i Provës përmban rezultatet analitike dhe nënshkruhet nga analisti, përgjegjësi i departamentit dhe drejtori për raportet që dalin jashtë ISUV.
5. Ruajtja dhe Asgjësimi i Kampioneve

Kampionet ruhen sipas kushteve specifike të përcaktuara për secilin analizë.
Temperatura e ruajtjes monitorohet dhe regjistrohet në "Skedën e Kontrollit të Temperaturës".
Pas analizave, kampionet asgjësohen ose ruhen për një periudhë të caktuar për qëllime verifikimi.

6. Tërheqja e Raporteve nga Klientët

Raportet tërhiqen në ZPK nga klientët, duke firmosur në Regjistrin mod.40-SU-00

7. Afatet e Shërbimit

Afatet për marrjen e rezultateve të analizave përcaktohen në listën zyrtare të shërbimeve të ISUV.

Nga auditimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, u konstatua se:

a. Megjithëse ISUV ka të implementuar sistemin informatik LIMS për regjistrimin dhe menaxhimin e kampioneve laboratorike, procesi aktual nuk është tërësisht i automatizuar dhe informatizuar në të gjitha hallkat e tij, më konkretisht:

- Identifikimi dhe gjurmueshmëria e kampioneve realizohet përmes kodeve manuale, ndërsa në çdo fazë të ciklit laboratorik nuk përdoren sisteme barkodimi apo skanime elektronike;
- Dokumentacioni dhe komunikimi ndërdepartamental në disa raste vazhdon të mbështetet në procedura manuale ose të pjesshme, të mbështetura vetëm në mënyrë të kufizuar nga LIMS-i, gjë që shton kohën e përpunimit dhe rrit mundësinë për gabime njerëzore;
- Proceset e ruajtjes, transferimit dhe asgjësimit të kampioneve, si dhe arkivimi i rezultateve analitike, nuk janë të integruara në mënyrë të automatizuar në një sistem gjurmues që mundëson kontroll dhe akses në kohë reale mbi të gjithë zinxhirin laboratorik.

b. ISUV, nuk ka të informatizuar tërësisht zinxhirin e pandërprerë të menaxhimit të cilësisë, siç është praktika e aplikuar gjerësisht në laboratorët referentë të sigurisë ushqimore dhe veterinare në vendet e BE, të cilët përdorin platforma të integruara LIMS të shoqëruara me sisteme barkodimi dhe monitorim automatik në çdo hap të procesit analitik, duke garantuar gjurmueshmëri, transparencë dhe një cilësi të standardizuar në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17025.

2.6.5. Administrimi i kiteve, reagentëve dhe materialeve laboratorike.

Në lidhje me administrimin e kiteve, reagenteve dhe materialeve laboratorike në ISUV, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Përgjigjet zyrtare të strukturave përgjegjëse të ISUV, në lidhje me pyetësorin e hartuar nga grupi i auditimit të KLSH-së, kryesisht mbi administrimin e bazës materiale të nevojshme për laboratorët, siç janë kitet dhe reagentët, etj.

2. Gjetjet në lidhje me procesin e marrjes në dorëzim të materialeve laboratorike, të evidentuara nga grupi i auditimit të KLSH-së gjatë auditimit të zbatimit të kontratave, kryesisht për artikujt si kitet dhe reagentët, për periudhën objekt auditimi.

3. Libri i magazinës dhe dokumentacioni fizik për hyrjet dhe daljet e artikujve: kite, reagentë, standarde dhe terrene. (Për artikujt "kite", të dhënat janë pasqyruar në tabelën nr. 9, Aneksi 2.6.5).

- Grupi i auditimit të KLSH, ndoqi një qasje të bazuar në vlerësimin e riskut, duke u mbështetur në konstatimet e arritura gjatë auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit.

Kjo qasje kishte për qëllim të siguronte një kuptim të plotë të proceseve, rolit të strukturave përgjegjëse dhe mekanizmave të brendshëm të kontrollit, si dhe të ndihmonte grupin e auditimit në identifikimin e fushave me risk të lartë.[15].

Gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit zhvilloi intervista gjysmë të strukturuara me personelin përgjegjës dhe shqyrtoi dokumentacionin rregullator të ISUV.

Më tej, për të strukturuar informacionin, iu drejtuam institucionit me pyetësorë gjysëm të strukturuar, dhe për çdo përgjigje të dhënë u kërkuan dokumente mbështetëse, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kuadrin rregullator të zbatueshëm.

[15] ISSAI 100 – Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik, parimi 37: "Një analizë e mjedisit të kontrollit dhe strukturës organizative të subjektit të audituar është e domosdoshme për të kuptuar kontekstin dhe për të orientuar auditimin drejt fushave me rëndësi më të madhe."

Qëllimi i auditimit mbi administrimin e materialeve laboratorike, është të vlerësojë përputhshmërinë e procedurave të ndjekura me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke filluar nga:
- Planifikimi i nevojave të tyre që gjatë fazës së hartimit të PBA;
- Marrja në dorëzim në drejtim të respektimit të afateve të skadencës dhe kohës së përdorimit të tyre, si dhe të kushteve të ruajtjes në kushtet e respektimit të zinxhirit në të ftohtë, duke përfshirë dhe shelf life[16];
- Regjistrimi i tyre në librin e magazinës nga sektori i financës;
- Koha e qëndrimit të tyre në ambientet e magazinës qendrore;
- Shpërndarja e tyre nga magazina qendrore në departamente;
- Dokumentimi i përdorimit të tyre nga strukturat përgjegjëse të laboratorëve/ departamenteve/ sektorëve;
- Inventarizimi nga strukturat përgjegjëse gjatë inventarizimit periodik të sasive gjendje të kiteve dhe reagentëve në laboratorët e ISUV.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, konstatohet se:

- Referuar gjetjeve të auditimit të procedurave të prokurimeve publike, të evidentuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, në lidhje me procesin e marrjes në dorëzim të kiteve dhe reagentëve (faza e zbatimit të kontratës), është konstatuar se procesverbalet e hartuara nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme për sigurinë dhe gjurmueshmërinë e produkteve, si: emri i prodhuesit, numri i lotit, data e skadencës dhe afati i përdorimit.
- Në lidhje me artikujt kryesisht kite reagent, të përfituara nëpërmjet donacionit, strukturat përgjegjëse të ISUV nuk kanë hartuar një akt administrativ të posaçëm që të rregullojë procedurën e marrjes në dorëzim të donacioneve të mundshme, të cilat në shumë raste janë me afate të afërta skadencë, duke rritur kostot e ISUV për asgjësimin e tyre.
- Për periudhën e auditimit, ISUV është furnizuar me "Kite" përmes kontratave me një vlerë totale prej 19,987,243 lekë. (siç pasqyrohet në tabelën nr.9, aneksi 2.6.5.)
  Sasia totale e këtyre kiteve për periudhën 2022-2024 është shpërndarë e gjitha nga magazina qendrore drejt departamenteve direkt pasi është marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim, pra nëse i referohemi vetëm artikujve "kite dhe reagent" i gjithë furnizimi i kontraktuar nga ISUV, nuk ka qëndruar asnjë ditë në magazinën qendrore, por ka kaluar në laboratorët e departamenteve të ISUV.
- Përdorimi i artikujve, kryesisht kite dhe reagentë, pasi janë transferuar nga magazina në laboratorë, nuk administrohet dhe nuk dokumentohen në përputhje me ndonjë procedurë të miratuar nga drejtuesit e ISUV, sipas së cilës çdo artikull i përdorur duhet të dokumentohet përmes një fletë kërkese të paraqitur nga përdoruesi dhe të miratuar nga drejtuesi i laboratorit/departamentit/sektorit përkatës.
- Mungon një sistem formal për monitorimin e datave të skadencës gjatë kohës së qëndrimit të këtyre artikujve në laboratorët përkatës sipas departamenteve respektive.
  Strukturat përgjegjëse në ISUV nuk kanë hartuar dhe miratuar ndonjë akt administrativ për këtë qëllim.
- Për artikujt kite dhe reagentë, mungon një sistem informatik për sinjalizimin në prag të skadencës, që do të lejonte përdorimin në kohë ose transferimin e tyre në laboratorë të tjerë shtetërorë që kanë nevojë për përdorimin e tyre.
  Në mungesë të një sistemi të informatizuar (module shtesë të LIMS), administrimi i këtyre produkteve bëhet në mënyrë manuale dhe jo të standardizuar, duke pamundësuar kontrollin sasior dhe cilësor të tyre, duke rritur rrezikun që produktet të skadojnë gjatë kohës që qëndrojnë në laborator, edhe nëse në momentin e dorëzimit ato përputhen me kriteret e vlefshmërisë.
- Gjatë procesit të inventarizimit vjetor në laboratorët sipas departamenteve, komisionet përkatëse të ngritura për këtë qëllim, në procesverbalet e mbajtura dhe të miratuara nga titullari i

[16] Shelf life (në shqip: afati i ruajtjes) është periudha kohore gjatë së cilës një produkt mbetet i sigurt, i përdorshëm dhe ruan cilësitë e tij të deklaruara**,** kur ruhet në kushte të përcaktuara të temperaturës.

institucionit nuk pasqyrohen sasitë në gjendje të kiteve, reagentëve, si dhe afatet e skadencës apo koha e përdorimit të tyre.

- Gjatë hartimit të PBA-së për nevojat e institucionit, kryesisht për materialet si kite, reagentë, standarde dhe terrene, për periudhën objekt auditimi, drejtuesit e ISUV nuk ka ngritur grup pune për konsolidimin e kërkesave sipas departamenteve dhe sektorëve përbërës të institucionit.
  Si pasojë, nuk është ndjekur një metodologji e qartë për parashikimin e nevojave, bazuar në gjendjen e stokut, qarkullimin e viteve të fundit (2–3 vite) dhe objektivat e akreditimit për rritjen e analizave dhe percaktimeve analitike të akreditura.
- Gjatë proceseve laboratorike, krijohen mbetje laboratorike nga përdorimi i kiteve dhe reagentëve, nga ku konstatohet se këto mbetje nuk regjistrohen në regjistra të veçantë apo në sisteme informatike.
  Mbetjet laboratorike të krijuara nuk ruhen në ambiente të dedikuara, por vendosen në vende të improvizuara nga përdoruesit në laborator.
- Magazina qendrore nuk plotëson kushtet teknike për ruajtjen e materialeve që kërkojnë zinxhir në të ftohtë, për shkak të mungesës së investimeve në frigoriferë specifikë të përshtatshëm për këtë qëllim.

Për sa më sipër, z. A. R., z. P. A., z. I. A dhe znj. J. B., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të institucionit gjatë periudhës përkatëse të ushtrimit të detyrës brenda periudhës objekt auditimi, ngarkohen me përgjegjësi, pasi me veprimet ose mosveprimet e tyre nuk kanë krijuar, përmes akteve administrative dhe mbi bazën e kuadrit ligjor rregullator në fuqi, një sistem të kontrollit të menaxhimit financiar dhe kontrollit një sistem efektiv, sipas parashikimeve të nenit 8, 9, 16 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, përkatësisht pikave 26, 28, 18, 38, 41, 54, 57, 79 dhe 116.

2.6.6. Laboratorët e Autorizuar jashtë vendit.

Referuar pasqyrave financiare për realizimin e buxhetit për vitet 2022, 2023 dhe 2024, periudhë objekt auditimi, konstatohet se zëri *"Analiza konfirmatore"* përbën zërin më të lartë të shpenzimeve të llogarisë 602. Në mënyrë të përmbledhur, shpenzimet paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Totali paga, sig. (600, 601) (1)	Totali shp korrente (602) (2)	Shpenz.anal. konfer.Llog. (6021002) (3)	Totali F. vecant (606) (4)	Investime kapitale (230, 231) (5)	Total Buxheti (6=1+2+4+5)	% Total. Analiza. Kon.ndaj Tot.Shp.op (7=3/2)	% Total. Anal..Kon. ndaj T..Buxhet. (8=3/6)
2022	95,121,453	167,806,333	61,240,771	1,394,000	42,191,000	306,510,006	**36%**	**20%**
2023	133,391,393	170,158,372	978,884	308,500	51,947,535	355,805,800	**34%**	**16%**
2024	15,8041,339	255,878,090	102,250,438	861,938	82,309,485	497,090,852	**40%**	**21%**

Pra, nga të dhënat e përmbledhura të realizimit të buxhetit, konstatohet se zëri shpenzime për analiza konfirmatore (ose nënkontraktim) përbën zërin më të lartë të shpenzimeve, konkretisht:

- Për vitin 2022, shpenzimet për realizimin e analizave me laboratorët jashtë vendit (analiza konfirmatore/nënkontraktim) përbëjnë 36% të totalit të shpenzimeve korrente dhe 20% të totalit të buxhetit.
- Për vitin 2023, shpenzimet për realizimin e analizave me laboratorët jashtë vendit përbëjnë 34% të totalit të shpenzimeve korrente dhe 16 % të totalit të buxhetit.
- Për vitin 2024, shpenzimet për realizimin e analizave me laboratorët jashtë vendit përbëjnë 40% të totalit të shpenzimeve korrente dhe 21% të totalit të buxhetit.

Grupi i auditimit e klasifikoi zërin "Analiza konfirmatore" si një shpenzim me risk të lartë financiar dhe ligjor, duke audituar:

a. Mënyrën e përzgjedhjes së laboratorëve referentë për analizimin e mostrave, sipas PKKZBR për ato analiza, ku ISUV nuk është i akreditуar;
b. Procedurat e ndjekura për dhënien e autorizimit për laboratorët jashtë vendit;
c. Studimin paraprak të ofertave financiare për realizimin e analizave në laboratorë të akredituar të BE-së, me qëllim optimizimin e shpenzimeve;
d. Hartimin e kontratave, dhe kushteve të pagesës së faturave tatimore për shërbimin e ofruar nga laboratorë jashtë vendit, si dhe likuidimi i faturave tatimore, në përputhje me bazën ligjore në fuqi për përjashtimin nga TVSH-ja.

ISUV për realizimin e planeve të monitorimit, në kuadër të kontrolleve zyrtare, si:
- Planin e Monitorimit të mbetjeve në kafshë të gjalla dhe në produktet me origjinë shtazore,
- Planin e Monitorimit të produkteve të Peshkimit dhe planin e Monitorimit të molusqeve Bival në zonat e rritjes dhe bankat natyrale.

Për testet laboratorike që, ISUV nuk i kryen dhe për ato për të cilat nuk është i akreditуar, ISUV i dërgon në disa laboratorë të BE-së, të cilët duhet të autorizohen nga ministri përgjegjës për ushqimin. Referuar nenit 44 (laboratorët e autorizuar te kontrollit), pika 4 e Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar ku parashikohet se:

Lista e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, ku përcaktohet tipi i laboratorit dhe analizat, që janë të autorizuar të kryejnë, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ushqimin dhe ***botohet në Fletoren Zyrtare një herë në vit.***

Planet kombëtare të monitorimit janë vjetore dhe miratohen nga MBZHR, dhe dërgohen në ISUV, AKVMB dhe AKU.
Mostrat e analizave përcillen në laboratorin e ISUV nga AKVMB dhe AKU, kryesisht për produkte me origjinë shtazore.
Mostrat merren nga fermat blegtorale të regjistruara në sistemin Ruda, në thertore dhe stabilimente të përpunimit të mishit.
Pas paraqitjes së mostrave nga këto dy institucione në ISUV, i cili zbaton protokollet e pranimit mbi sigurinë e mostrës, ato përgatiten përmes ekstraktimit dhe dërgohen nëpërmjet termo-boxeve me akull të thatë, në laboratorët e autorizuar nga ministri përgjegjës i ushqimit, jashtë vendit.

Nga auditimi mbi përzgjedhjen e laboratorëve të autorizuar të kontrollit dhe tipin e analizave, që janë autorizuar të kryejnë, u konstatuan se:
-Procesi i përzgjedhjes së laboratorëve për kryerjen e analizave, në zbatim të PKKZBR, të cilat realizohen në një nga vendet e BE-së, është kryer pa urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës për ushqimin, në kundërshtim me nenin 44, pika 4, neni 45, neni 46 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" (i ndryshuar), si dhe me nenin 81, 120, 121, 122, 123, 124 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

-Drejtori i Përgjithshëm, z. A. R., me shkresën nr. 339 Prot., datë 15.04.2022, me objekt "Kërkesë për autorizim për nënkontraktim testesh laboratorike për përmbushjen e kërkesave të Planit Kombëtar të Monitorimit të mbetjeve", i është drejtuar z. I. T., Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, dhe për dijeni z. O. M., Sekretar i Përgjithshëm.

Në këtë shkresë, ISUV thekson se: "Analizat laboratorike të mostrave të marra për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit bëhen në laboratorët e autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe lista e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, ku përcaktohet tipi i laboratorit dhe analizat që janë të autorizuar të kryejnë, miratohet me urdhër të Ministrit të MBZHR."

Në vijim të kësaj shkrese, ISUV kërkon/propozon që laboratorët për testet laboratorike, bashkëlidhur (Aneksi 1) shkresës, të autorizohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për të vazhduar procedurat e nënkontraktimeve.
Nga auditimi i regjistrave të protokollit rezultoi se: MBZH nuk është përgjigjur kërkesës së ISUV në lidhje me çështjet e trajtuara në shkresën e sipërpërmendur.

Lidhja e kontratave
- Drejtori i Përgjithshëm, z. P. A., ka nënshkruar kontratën nr. 580, datë 30.06.2022, me Wageningen Food Safety Research (WFSR), në shumën 46,047 euro pa TVSH, në të cilën mungon firma e kontraktuesit (WFSR), si dhe dokumentacioni mbështetës në lidhje me zgjedhjen e këtij laboratori dhe ofertat ekonomike nga laboratorë të tjerë të akredituar për përzgjedhjen e tij, lidhur me çmimin e ofruar.
- Drejtori i Përgjithshëm, z. P. A., ka nënshkruar kontratën nr. 222, datë 24.03.2023, me Ëageningen Food Safety Research (WFSR), në shumën 55,371 euro pa TVSH, në të cilën mungon firma e përfaqësuesit të kontraktuesit, si dhe dokumentacioni mbështetës në lidhje me zgjedhjen e këtij laboratori dhe ofertat ekonomike nga laboratorë të tjerë të akredituar për përzgjedhjen e tij lidhur me çmimin e ofruar.
- Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të MBZHR nr. 1, datë 15.01.2024, për miratimin e "Planit Kombëtar të Kontrollit Zyrtar me Bazë Risku dhe të Marrjes në Mostra për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe Inputet Bujqësore, si dhe Planit të Marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2024", lidhur me "Planin e Monitorimit të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024", përgjegjësja e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, znj. V. V., përmes memo-s nr. 211 prot., datë 06.03.2024, me objekt "Draft-kontrata e dërguar nga Wageningen Food Safety Research (WFSR), Holandë, lidhur me Planin e Monitorimit të PMB-ve 2024 (analiza e substancave aktive në 36 produkte për mbrojtjen e bimëve)", i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ISUV, z. I. A, i cili e ka miratuar draft-kontratën.
Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me përzgjedhjen e këtij laboratori, siç pohon dhe vet përgjegjësja e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, nuk janë marrë oferta financiare nga laborator të tjerë alternativ të akredituar për kryerjen e këtyre analizave të sipërcituar, por vetëm lista e çmimeve të laboratorit Wageningen Food Safety Research (WFSR), në fund të memos znj. V. V. shprehet se, e citoj:
... prandaj, alternativa e vetme që kemi gjetur është ky laborator.
Drejtori i Përgjithshëm, z. I. A, pas miratimit të draft-kontratës me Wageningen Food Safety Research (WFSR), të propozuar nga përgjegjësja e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, znj. V. V., ka nënshkruar kontratën me laboratorin e sipërpërmendur, nr. 211/1, datë 15.03.2024, në shumën prej 33,124 euro pa TVSH.

Pagesa për laboratorët referentë jashtë vendit:
Për periudhën objekt auditimi, gjithë aktivitetin e nënkontraktimeve ISUV e ka realizuar me dy laboratorë, respektivisht me laboratorin Wageningen (Holandë) dhe laboratorin C. Group (Belgjikë).

1. ***Për pagesat e kryera ndaj laboratorit Wageningen (Holandë), u konstatua se:***

Me urdhër-shpenzimi (U.SH) nr. 145, datë 20.05.2024 dhe U.SH nr. 333, datë 25.11.2024, ISUV ka kryer pagesën për këtë laborator në shumën totale 33,124 euro, respektivisht për:
faturën nr. 7224120170, datë 24.04.2024, në shumën 6,624.80 euro, shumë që përfaqëson 20% të totalit të shërbimit të kryer nga ky laborator.
Nga auditimi i praktikës së pagesës së faturës së mësipërme, konstatohet se mungon urdhri i brendshëm i titullarit për autorizimin e pagesës së saj. Ndërkohë, nga zyra e financës është hartuar urdhër-shpenzimi U.SH nr. 145, datë 20.05.2024 dhe është kryer pagesa për këtë faturë në llogari të laboratorit Wageningen.
Ndërkohë, në praktikën e administruar dhe audituar nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me U.SH nr. 333, datë 25.11.2024, për kryerjen e vlerës së mbetur prej 80% të faturës nr. 7224120504, datë

20.11.2024, në vlerën totale 26,499.20 euro (e konvertuar sipas kursit ditor të bankës), nëpunësi zbatues ka ekzekutuar pagesën mbi bazën e urdhrit të brendshëm nr. 123 prot., datë 21.11.2024 të titullarit të institucionit, ku urdhërohet sektori i financës për ekzekutimin e pagesës për:
"Analizat të dërguara me nënkontraktim me laboratorin Wageningen".
Nga auditimi i ditarit të bankës në lidhje me pagesat e kryera nga ISUV për llogari të laboratorit Wageningen, konstatohet se ky laborator nuk ka përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, duke respektuar parimin e vendndodhjes së porositësit dhe përfituesit të shërbimit, i cili ndodhet jashtë territorit të vendit ku kryhet shërbimi (analizat), në përputhje me parimin B2B, të parashikuar në legjislacionin e BE-së.
-Në marrëveshjen tip të bashkëpunimit me laboratorin Wageningen, është përcaktuar qartë te zëri *Rate(s) and Invoice, se: VAT will not be charged.*
Pra, që në marrëveshjen e bashkëpunimit është përcaktuar mos përfshirja e VAT dhe të gjitha faturat për shërbimin e ofruar gjatë periudhës objekt auditimi nuk kanë përfshirë VAT-in

2. ***<u>Për pagesat e kryera ndaj laboratorit C. Group (Belgjikë), u konstatua se:</u>***

Laboratori C. Group, për periudhën 2022–2024, në faturat e shërbimit të kryera për llogari të ISUV ka përfshirë vlerën e TVA (21%), sipas legjislacionit të Shtetit Belg, ndërkohë që për të njëjtën periudhë, laboratori Wageningen nuk ka përfshirë vlerën e VAT, në faturat e shërbimit kundrejt ISUV.
-Në marrëveshjen tip të bashkëpunimit të ISUV me laboratorin C. Group (Belgjikë), nuk është përcaktuar përfshirja ose jo e TVA-së.

Grupit të auditimit të KLSH, krahas dokumentacionit të kërkuar në lidhje me pagesat e kryera nga ISUV për Laboratorin C. Group, iu vu në dispozicion edhe fatura përpara periudhës së auditimit, ku konstatohet se nuk është përfshirë TVA, pra Laboratori C. Group në këto raste ka respektuar parashikimet e nenit 21, pika 2 të Kodit të TVSH-së të shtetit Belg, për parimin "Reverse Charge", një prej faturave ku TVA është zero paraqitet në aneksin 2.6.6, për më tepër që në këtë faturë është vendosur dhe NIPT i ISUV, fakt që tregon që Laboratori C. Group është i informuar që subjekti ISUV është person i klasifikuar i tatueshëm.

Nga auditimi konstatohet se:
Të gjitha faturat e C. Group, për periudhën 2022-2024 ku është përfshirë TVA dhe atyre ku TVA është zero janë firmosur nga Dr. N. G., Drejtori i Laboratorit të analizave të C. Group.
Në Aneksin 2.6.6 gjenden fax-similet nr. 1 dhe nr. 2 të dy faturave (njëra me TVA dhe tjetra me TVA zero), të nënshkruara nga i njëjti person i sipërcituar, Dr. N. G., Drejtori i Laboratorit të analizave të C. Group.
Shpenzimet totale për "*Analizat konfirmatore" të kryera në laboratorët jashtë vendit, paraqiten n*ë tabelën nr.10.
Për periudhën objekt auditimi, shpenzimet totale në lidhje me pagesat për analizat dhe shërbimet mbështetëse arrijnë afërsisht në 1,880,000 euro, duke përfshirë edhe shpenzimet e tjera të pasqyruara në tabelën nr. 11, nga ku rezulton se ISUV ka një shpenzim mesatar vjetor prej rreth 627,000 euro për llogari të laboratorëve jashtë vendit.

Tabela nr.10. Shpenzimet për shërbimet me laboratorët jashtë vendit.

Viti	**Pagesat për C. GROUP**			
	Total pa TVSH	Vlera TVSH	Total	Urdh.Shpenzim Nr. Datë
2022	€ 458,304.13	€ 96,243.87	€ 554,548	U.SH 135 dt. 29.06.2022; U.SH 168 dt. 27.07.2022; U.SH 190 dt. 24.08.2022; U.SH 284 dt. 22.11.2022; U.SH 327 dt. 23.12.2022; U.SH 342 dt. 30.12.2022; U.SH 43 dt. 18.04.2023; U.SH 86 dt. 13.06.2023; U.SH 138 dt. 24.08.2023;
2023	€ 532,470.25	€ 111,818.75	€ 644,289	U.SH 97 dt. 12.04.2024; U.SH 138 dt. 24.08.2023; U.SH 148 dt. 20.05.2024; U.SH 148 dt. 20.05.2024;

				U.SH 169 dt. 20.06.2024; U.SH 207 dt. 01.11.2023; U.SH 367 dt. 31.12.2023;
2024	€ 427,198.35	€ 89,711.65	€ 516,910	U.SH 232 dt. 26.08.2024; U.SH 233 dt. 26.08.2024; U.SH 234 dt. 26.08.2024; U.SH 330 dt. 25.11.2024; U.SH 331 dt. 25.11.2024; U.SH 332 dt. 25.11.2024; U.SH 373 dt. 24.12.2024; U.SH 374 dt. 24.12 .2024; U.SH 375 dt. 24.12 .2024; U.SH 376 dt. 24.12 .2024; U.SH 377 dt. 24.12 .2024; U.SH 416 dt. 31.12 .2024;
Shuma 1	**€ 1,417,972.73**	**€ 297,774.27**	**€ 1,715,747**	
Viti	**Pagesat për Wageningen**			
	Total pa TVSH	Vlera TVSH	Total	Urdh.Shpenzim Nr. Date
2022	€ 46,047.00	$0.00	€ 46,047.00	U.SH 191 dt. 25.08 .2022; U.SH 326 dt. 23.12 .2022;
2023	€ 55,371.00	$0.00	€ 55,371.00	U.SH 87 dt. 13.06 .2023; U.SH 366 dt. 31.12 .2023;
2024	€ 33,124.00	$0.00	€ 33,124.00	U.SH 145dt. 20.05 .2024; U.SH 333 dt. 25.11 .2024;
Shuma 2	**€ 134,542.00**	**$0.00**	**€ 134,542**	
Total	**€ 1,552,514.73**	**€ 297,774.27**	**€ 1,850,289**	

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.11. Shpenzime dytësore të analizave me nënkontraktim në laboratorët referentë

Viti	Përshkrimi I shpenzimit	Vlera në lekë
2022	Transport analiza konfermatore	653,460
	Akull i thate	94,500
	Totali	**747,960**
2023	Transport analiza konfermatore	907,984
	Akull I thate	219,240
	Kuti termobox	1,137,600
	Totali	**2,264,824**
2024	Transport analiza konfermatore	1,958,235
	Akull i thate	1,001,082
	Kuti termobox	-
	Totali	**2,959,317**

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër, ashtu siç trajtohet gjerësisht në pikën 2.6.6, konstatohet se procesi i përzgjedhjes së laboratorëve për kryerjen e analizave, në zbatim të PKKZBR, të cilat realizohen në një nga vendet e BE-së, është kryer pa urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës së ushqimit, në kundërshtim me nenin 44, pika 4 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" (i ndryshuar), si dhe me nenin 121 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Gjithashtu, propozimet për përzgjedhjen e laboratorëve referentë në vendet e BE-së, të bëra nga strukturat përgjegjëse pranë ISUV-it, nuk janë mbështetur në një studim të mirëfilltë për laboratorët e akreditуar, duke rritur riskun financiar të marrjes së të njëjtit shërbim me kosto më të lartë.

Po ashtu, gjatë periudhës objekt auditimi, titullarët e institucionit nuk kanë hartuar dhe miratuar ndonjë akt administrativ/udhëzim të qartë për mënyrën e përzgjedhjes së laboratorëve që duhet t'i propozohen ministrit përgjegjës së ushqimit për dhënien e autorizimit vjetor, në rastet kur analizat nuk realizohen nga ISUV.

Nga ana e zyrës së financës, nuk janë evidentuar parregullsitë, lidhur me faturat e lëshuara nga kompania C. Group me seli në Belgjikë mbi përfshirjen e TVA-së.

Pas konfirmimit nga nëpunësi zbatues, në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur pranë zyrës së financës, nga ana e nëpunësit zbatues është përgatitur urdhër shpenzimi për kryerjen e pagesës së shërbimeve të përfituara jashtë vendit, duke lejuar kështu ekzekutimin e faturave të dërguara nga laboratori "C. Group", pavarësisht se në to përfshihej edhe vlera e TVA-së.

Për periudhën objekt auditimi, përfshirja e TVA-së në faturat e "C. Group" ka rezultuar në një kosto shtesë prej ***297,774.27 euro***[17] *ose* ***32,576,505 lekë****, shumë e cila nga grupi i auditimit të KLSH do të konsiderohet si përdorim i fondeve buxhetore pa ekonomicitet.*

Gjithashtu, drejtuesit përkatës gjatë periudhës objekt auditimi, z. I. A dhe z. P. A., në cilësinë e titullarëve të institucionit për periudhat përkatëse të ushtrimit të detyrës si drejtorë të përgjithshëm dhe nënshkrues të kontratave me laboratorë jashtë vendit, kanë lidhur kontrata në mungesë të urdhrit të ministrit përgjegjës të ushqimit për autorizimin e laboratorëve dhe të llojeve përkatëse të analizave. Në dy raste është konstatuar se kontratat janë firmosur vetëm nga titullari i ISUV-it, pa firmën e kontraktuesit.

Konkluzion:
Duke qenë se ISUV është i pajisur me NIPT dhe, në kuptim të nenit 23 pika b të Ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", konsiderohet si person i tatueshëm, dhe për rrjedhojë vendi i furnizimit të shërbimit laboratorik sipas nenit 24 pika 1 shkronja a të ligjit të sipërcituar është Shqipëria, përfshirja dhe pagesa e TVA-së 21% nga ana e ISUV në vendin e huaj (Belgjikë) është kryer në kundërshtim me parimin e vendit të furnizimit.
Për më tepër, në zbatim të nenit 51 pika o, të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" shërbimet veterinare janë të përjashtuara nga TVSH në Shqipëri. Pagesa e TVA-së për llogari të laboratorit C. Group me vendodhje ne Belgjikë përbën një kosto shtesë dhe në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit.

Për sa është konstatuar më lart, me veprimet apo mosveprimet e tyre, ngarkohen me përgjegjësi për periudhën përkatëse të ushtrimit të detyrës si Drejtorë të Përgjithshëm të ISUV, z. I. A dhe z. P. A., pasi kanë nënshkruar kontrata në mungesë të autorizimit nga ministri përgjegjës për ushqimin për autorizimin e këtyre laboratorëve dhe të llojeve përkatëse të analizave dhe në dy raste, është konstatuar se kontratat nuk janë firmosur nga kontraktuesit, por vetëm nga titullari i ISUV-it dhe znj. D. Sh., në cilësinë e nëpunësit zbatues ka vepruar në kundërshtim me pikën 3, shkronja "a", të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenin 23 pika b, dhe neni 24 pika 1, germa a, neni1 51 pika o, të Ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", duke ekzekutuar pagesa për laboratorin C. Group duke përfshirë TVA, në kundërshtim me parashikimet ligjore të vendit ku kryhet shërbimi, në rastet kur vendndodhja e porositësit dhe marrësit të shërbimit nuk ndodhen në të njëjtin shtet, ndryshe nga sa është vepruar në mënyrë të drejtë me pagesat ndaj laboratorit Wageningen (Holandë), ku në asnjë rast nuk është përfshirë VAT, si dhe për një rast të kryerjes së pagesës së shërbimit ndaj laboratorit Wageningen (Holandë) për vitin 2024, pa autorizimin paraprak të nëpunësit autorizues.

2.6.7. Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve
Menaxhimi i integruar i mbetjeve, në kuptim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, i ndryshuar, nënkupton grumbullimin, transportimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe mbikëqyrjen e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e agjentit. Mbetje, sipas përkufizimit në këtë akt, do të konsiderohet çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndërmend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.
Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin.
Nga ISUV bëhet me dije se, nga proceset e përditshme të punës në laborator, gjenerohen disa lloje mbetjesh, si mbetje kimike të lëngshme, mbetje kimike të ngurta, mbetje të karkasave joinfekte dhe infektive, mbetje biologjike, mbetje infektive nga kulturat laboratorike, mbetje organike të prodhuara nga analizimi i kampioneve, mbetje nga kulturat e prodhuara nga laboratori gjatë proceseve të punës

[17] Kursi mesatar i euro për vitin 2022-2024, është 109.4 lekë referuar Bankës së Shqipërisë

(si doreza, maja pipetash plastike, filtra të ndryshëm, pipeta plastike, etj.), mbetjet e kampioneve të analizuar pas mbarimit të afatit të ruajtjes në laborator, mbetje kimike të prodhuara gjatë punës, mbetje solvente (metanol, acetonitril, ujë + amonium format + acid formic, etj.), ndër të tjera të dëmshme për shëndetin, të ndezshme, korrozive.
Nisur nga sa më sipër, ISUV ka hartuar Udhëzuesin 25-IV-004 "*Praktika të mira të punës dhe biosiguria në laborator*", kapitulli 8 i së cilit trajton mbetjet nga aktivitetet laboratorike.
Në këtë udhëzues përcaktohen procedura të përgjithshme lidhur me mbetjet kimike (të lëngshme dhe të ngurta) dhe kontejnerët e trajtuar, duke u fokusuar kryesisht në procesin e grumbullimit të mbetjeve në laboratorët përkatës dhe në transportimin e tyre në ruajtje të përkohshme. ISUV ka hartuar gjithashtu Udhëzuesin 40-LD-013 mbi Trajtimin e Mbetjeve të *Departamentit të Shëndetit të Kafshëve*, paraqitur në hartë skematike, në aneksin 2.6.7 figura 1:

Kategorizimi i mbetjeve të gjeneruara nga ky departament dhe mënyra e trajtimit të tyre paraqitet, si më poshtë:

Nr.	Kategoria	Mënyra e trajtimit
1	Mbetje të lëngëta biologjikisht të kontaminuara	Duhet të futen në qese të përshtatshme "Biohazard". Sipas ngarkesës lajmërohet punonjësi i shërbimit për tërheqjen e tyre për t'u eliminuar në krematorium.
2	Mbetje të ngurta biologjikisht të kontaminuara	Duhet të futen në qese të përshtatshme "Biohazard". Sipas ngarkesës lajmërohet punonjësi i shërbimit për tërheqjen e tyre për t'u eliminuar në krematorium.
3	Materialet e destinuara për krematorium (karkasa)	Operatorët teknikë i vendosin në qese të përshtatshme "Biohazard" dhe ruhen në -20 gradë celcius në laboratorin e Nekropsisë. Sipas ngarkesës lajmërohet punonjësi i shërbimit për tërheqjen e tyre për t'u eliminuar në krematorium.
4	Materialet e riciklueshme të kontaminuara	Në qese të përshtatshme "Biohazard"/ në bikse të mbyllura për të evituar rrjedhjet ose në kontenitorë të qendrueshëm ndaj çarjes-shpimit, dërgohen në dhomën e Autoklavizimit nga operatorët teknikë. Pas Autoklavizimit kalojnë në lavanteri për procesin e larjes dhe sterilizimit. Pas kësaj mund të trajtohen si material joinfektiv.
5	Objektet e mprehtë të infektuar (prehës-shpues: lama, ciflat e qelqit)	Duhet të mblidhen gjithmonë në kontenitorë të qëndrueshëm ndaj çarjes-shpimit, të pajisur me kapakë dhe trajtohen si mbetje infektive (dërgohen në dhomën e Autoklavizimit nga operatorët teknikë dhe më pas në mbetjet urbane).
6	Mbeturina joinfekte	Eliminohen si mbetje urbane.

Në dokument përcaktohet se mbetjet kimike nuk autoklavizohen, pasi kjo mund të çojë në situata të rrezikshme, sepse mund të krijojnë mjedis shpërthyes/ gërryes dhe toksik në autoklavë.

1. Mbi grumbullimin/ ruajtjen e mbetjeve

Grumbullimi i mbetjeve është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve, për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve. Nga ISUV bëhet me dije se mbetjet e gjeneruara lihen në ruajtje në ambientet e përcaktuara nga ISUV deri në asgjësim, si dhe se mbetjet e rrezikshme kimike grumbullohen të etiketuara në dhomën e grumbullimit të mbetjeve (ambient i posaçëm për grumbullimin e tyre jashtë laboratorit), siç paraqitet edhe më poshtë në figurën 2.
Sipas pikës 5.10.a dhe b të Shtojcës 1 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", *stacioni transferimi për mbetje të rrezikshme/ jo të rrezikshme* që nuk përmenden në pika të tjera, kërkojnë pajisjen me Leje mjedisore të tipit B. Kjo leje përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se përmbushen kërkesat e Ligjit "*Për lejet e mjedisit*" dhe legjislacionit në fuqi. Nga auditimi nuk rezulton që ISUV të jetë i pajisur me Leje mjedisore të tipit B për grumbullimin/ ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme/ jo të rrezikshme, sipas kategorive përkatëse.
Gjatë vitit 2024, ISUV ka kryer një procedurë prokurimi me objekt grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e një sasie mbetjesh të rrezikshme, që sikurse cituar në relacionet përkatëse, kanë qenë në grumbullim/ ruajtje në ambientet e ISUV prej shumë vitesh. Edhe pas realizimit të procedurës së

prokurimit, ISUV vijon të ketë të grumbulluar një sasi të konsiderueshme mbetjesh të llojeve të ndryshme, pasqyruar në relacionin e datës 16.10.2024 (i paprotokolluar), me një numër prej 1983 artikujsh, me data skadencë më të largëtat në vitin 2008, si dhe një sasi mbetjesh të ndara sipas paketimeve (e pamundur të përcaktohet sasia totale, pasi referohen në njësi matëse të ndryshme). Ndër të tjera, sikurse cituar në relacionet përkatës dhe në përgjigjet e pyetësorëve, përpos mbetjeve kimike e fizike, administrohen dhe mbetje që konsiderohen të dëmshme për shëndetin, të ndezshme e korrozive.
Kjo situatë, përpos riskut mjedisor që paraqet, është një rrezik i vazhdueshëm për shëndetin dhe/ ose sigurinë minimalisht të punonjësve të ISUV, aq më tepër kur nuk ka personel të specializuar për çështje mjedisore, si dhe nuk ka një vlerësim të specializuar nga institucionet përgjegjëse/ kompetente nëse ambienti është i përshtatshëm për të magazinuar këto mbetje, nëse magazinimi është i tillë që parandalon kontaminimin apo rreziqe të tjera për zonën, nëse mbetjet po ruhen/ magazinohen si duhet (të ndara, etj.), nëse aksesi është i kufizuar për personel specifik dhe mbahet në masa të caktuara sigurie, etj., të pasqyruar në aneksin 2.6.6 figura nr.2

2. Mbi asgjësimin e mbetjeve

Nga ISUV bëhet me dije se materialet me risk të lartë mikrobiologjik kalohen paraprakisht në autoklavizim (figura 3) dhe më pas transportohen në krematorium nga personi përgjegjës (figura 4). Krematoriumi gjithashtu përdoret për mbetjet biologjike (mostra: peshk, muskul, dhjamë), karkasa të kafshëve dhe shpendëve, organe nga karkasat e kafshëve dhe nga ISUV bëhet me dije se në krematorium nuk digjen mbetje kimike. Në rregulloren e brendshme të ISUV sa i përket operimit të krematoriumit përcaktohet vetëm te detyrat e punëtorëve të mirëmbajtjes, të cilët ndër të tjera kanë si detyrë të mbajnë në gatishmëri aparatin e krematoriumit. Gjithashtu, sa i përket operimit të autoklavizimit, në rregulloren e brendshme citohet se: Të gjitha kulturat, materialet e përdorura përpara se të hidhen duhet të dekontaminohen nëpërmjet metodave të përshtatshme për dekontaminim e tyre si p.sh. autoklavizimi, të pasqyruara në aneksin 2.6.7. figura nr.3
Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të regjistrit për depozitimin e mbetjeve për asgjësim në krematorium, por nga ISUV është bërë me dije se nuk administrohet një regjistër i tillë. Procesi i largimit të mbetjeve nga laboratorët/ ambientet ku prodhohen këto mbetje dokumentohet në memo specifike, ku pas mbarimit të afatit të ruajtjes në laborator, mbetjet e kampioneve të analizuar grumbullohen, peshohen dhe nëpërmjet memo-s informohet për asgjësimin e tyre financa dhe drejtoria mbështetëse (pasi duhet të aprovojë përdorimin e lëndës djegëse naftë).
Pas miratimit të memo-s, një punonjës i mirëmbajtjes i ngarkuar me këtë detyrë tërheq mbetjet për t'i asgjësuar më tej në krematorium. Nga korrespondenca përkatëse me sektorin e financës, sa i përket procedurave të asgjësimit në krematorium për vitin 2024, ka rezultuar se në krematorium kryesisht janë asgjësuar nëpërmjet djegies (i) mbetje shtazore, si mostra peshku, dhjami, karkasa, të brendshme, (ii) si dhe mbetje të tjera të grumbulluara nga lavanderia, nga nekropsia, nga konxhelatorët, nga autoklava, nga laboratori, mostra plastike (maja, shiringa, doreza), të pasqyruara në Aneksin 2.6.7/1. Gjithashtu, nga ISUV nuk është vënë në dispozicion dokumentacion mbi depozitimin dhe trajtimin e hirit të gjeneruar nga procesi i djegies në krematorium. Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të Lejes mjedisore përkatëse për operimin e krematoriumit, por nga ISUV është bërë me dije se krematoriumi ka funksionuar në institucion shumë më herët se të hynte në fuqi kërkesa për marrje leje mjedisore për të, prandaj nuk e ka një të tillë. Në nenin 20, pika 1 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, përcaktohet se pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, ndërkohë që në nenin 3, pika 10, përcaktohet se do të konsiderohet "instalim i ri" edhe një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar. Leje mjedisi e tipit B i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit përkatës dhe përmban të shkruara kushtet e nevojshme ***për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e Ligjit "Për lejet e mjedisit" dhe legjislacionit në fuqi***.
Sipas pikës 5.1.c të Shtojcës 1 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", *incenerimi i mbetjeve*, duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incenerimi, përveç mbetjeve të

rrezikshme, klasifikohet në Leje mjedisore e tipit B nëse përdoret ose është dizenjuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë ose më të vogël se 1 ton/ orë, ndërkohë që për intensitet më të lartë do të duhej Leje mjedisore e tipit A.
Gjendja e krematoriumit paraqitet në aneksin 2.6.7 figura nr.4

Konkluzion:
ISUV, përgjatë viteve periudhë auditimi 2022-2024, ka zhvilluar veprimtari të tilla si grumbullimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme dhe/ ose të parrezikshme, subjekte të lejeve mjedisore sipas Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "*Për lejet e mjedisit*", i ndryshuar, pa dokumentuar në asnjë rast korrespondenca me institucionet përgjegjëse në fushën e mjedisit, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
Për veprimet e mësipërme, duke mos ndërmarrë hapat e nevojshme për të mitiguar riskun mjedisor që paraqesin këto veprimtari, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, si dhe për të garantuar se këto veprimtari kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngarkohen me përgjegjësi titullarët e ISUV për periudhat takuese, respektivisht z. A. R., z. P. A., znj. J. B. dhe z. I. A.

2.6.8. Çështje të tjera të evidentuara gjatë auditimit – Verifikim i rregullshmërisë së mbajtjes së librit të protokollit.
Në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe në përputhje me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor të sigurojnë administrimin korrekt të dokumentacionit, duke përfshirë protokollimin e saktë, të plotë dhe në kohë të çdo akti zyrtar. Këto norma përcaktojnë qartë përgjegjësitë për regjistrimin, ruajtjen dhe përdorimin e dokumenteve, me qëllim garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë institucionale. Në vijim paraqiten gjetjet e auditimit në lidhje me zbatimin e këtyre kërkesave në ISUV.
I. Nga auditimi i procedurës së blerjeve të vogla me objekt "Servis, Mirëmbajtje Krematoriumi" për vitet 2022 dhe 2023, në lidhje me parregullsitë në drejtim të mbajtjes së librit të protokollit, u hartua Akt Verifikimi nr. 1, me nr. 72/2 Prot., datë 18.04.2025.

Nga auditimi konstatohet se:
a. Për procedurën e blerjes me vlerë të vogël me objekt "Servis, Mirëmbajtje Krematoriumi" për vitin 2022, me urdhrin e prokurimit nr. 639 Prot., datë 01.08.2022, dhe ftesën për ofertë me numrin 639/1 Prot., datë 01.08.2022, ndërsa urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim dhe kolaudimit për këtë blerje mban të njëjtin numër 639/1 Prot., datë 22.09.2022.
Nga verifikimi i librit të protokollit rezulton se numri 639/1 i përket vetëm ftesës për ofertë të përmendur më sipër, ndërsa urdhri i brendshëm për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim dhe kolaudimit nuk figuron i regjistruar në libër, megjithëse në verifikimin fizik ky dokument gjendet në dosje, mban numrin 639/1, datën 01.08.2022, vulën e institucionit dhe firmën e titullarit.
b. Nga auditimi i procedurës së blerjes me vlerë të vogël për "Servis, Mirëmbajtje Krematoriumi" për vitin 2023, rezulton se urdhri i prokurimit për këtë procedurë është nr. 531 Prot., datë 10.08.2023, ftesa për ofertë mban nr. 531/1 Prot., datë 14.08.2023, ndërsa dokumentacioni i operatorit ekonomik mban nr. 531/1 Prot., datë 18.08.2023.
Nga verifikimi i librit të protokollit konstatohet se numri 531/1 i protokollit i përket dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues, ndërsa ftesa për ofertë me nr. 531/1 Prot., datë 14.08.2023, nuk është regjistruar në libër.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", si dhe me nenet 12 dhe 13 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

II. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës", me fond limit 6,625,000 lekë pa TVSH, u konstatua se operatori ekonomik R.-A., i vetmi pjesëmarrës në garë, u kualifikua dhe u shpall fitues

nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me ofertën prej 6,500,000 lekë pa TVSH. Vendimi i KVO u miratua më pas nga titullari i autoritetit kontraktor, z. I. A, në Raportin Përmbledhës të datës 11.12.2023 (pa numër protokolli). Kjo situatë është trajtuar në mënyrë të detajuar në pikën 2.4.8 të Projekt-Raportit të Auditimit, si dhe në Akt-Konstatimin nr. 6, datë 05.05.2025, të grupit të auditimit të KLSH.

Nga auditimi u konstatua se:
Titullari i AK-së, z. I. A me urdhrin brendshëm nr. 715 Prot., datë 13.10.2023, ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga: znj. A. P. (kryetare), znj. E. K. dhe znj. M. B..
I njëjti numër protokolli dhe e njëjta datë janë përdorur edhe për urdhrin e ngritjes së Njësisë së Prokurimit.
Të dy urdhrat mbajnë nr. 715 Prot., datë 13.10.2023, dhe janë regjistruar në librin e protokollit.
Ndërkohë, urdhri për ngritjen e KVO-së, i nënshkruar nga z. I. A dhe i vulosur nga zyra e protokoll arkivit, ka caktuar si kryetare të KVO-së znj. A. P., megjithëse marrëdhëniet e saj të punës pranë ISUV kanë filluar 21 ditë më vonë, me urdhrin nr. 755 Prot., datë 03.11.2023, të lëshuar nga titullari i ISUV.
Në këtë mënyrë, znj. A. P. ka ushtruar funksionin e kryetares së KVO-së, edhe pse në atë periudhë nuk ishte ende pjesë e strukturës së institucionit.

Konkluzion:
Titullari i ISUV ka nxjerrë urdhrin e brendshëm për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), duke caktuar si kryetar një person që në momentin e nxjerrjes së aktit nuk kishte marrëdhënie pune me institucionin, i cili filloi punë 21 ditë më vonë. Kjo shkelje përbën mosrespektim të nenit 75, pika 1 dhe 3 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të nenit 108, pika 1(a)(i-iii) të Kodit të Procedurës Administrative, që parashikon pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ në rast shkeljeje të kompetencës, procedurës apo formës.

III. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim, riparim, servis kalibrimi”, për vitin 2023, me fond limit 35,339,090 lekë pa TVSh, e ndarë në 4 (katër) Lot-e, për sa është trajtuar gjerësisht në pikën 2.4.12 të këtij Projekt-Raporti të Auditimit, krahas të tjerave, u konstatuan problematika në lidhje me funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe zbatimin efektiv të MFK.

Nga auditimi konstatohet se:
Drejtori i përgjithshëm z. I. A ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023 për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim, për të finalizuar kontratën nr. 389 Prot., datë 19.06.2023, me objekt “Loti I - Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Agilent”.
Në pikëpamje formale, urdhri i sipërcituar është i firmosur nga titullari i institucionit dhe mban vulën e institucionit ISUV, çka tregon se pas hartimit të urdhrit të brendshëm, marrjes së numrit të protokollit dhe firmosjes nga titullari, kur plotësohen këto kushte dhe ato formale të stemës së Republikës dhe të emërtimit të institucionit, struktura përgjegjëse në zyrën e protokollit vendos vulën e institucionit mbi firmën e titullarit, mban një kopje në arkiv dhe e regjistron në librin e protokollit.
Nga verifikimi i librit të protokollit, urdhri i sipërcituar nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023, nuk është i regjistruar dhe nuk ekziston asnjë regjistrim në librin e protokollit me nr. 129/1 ose 389/4 në datë 20.06.2023.
Nga auditimi i strukturës së ISUV në datën 19.06.2023, kur është nxjerrë ky urdhër i brendshëm, titullar i komanduar ka qenë z. P. A., dhe jo z. I. A, i cili ka firmosur urdhrin e sipërcituar.
Z. I. A është emëruar titullar i ISUV më datë 11.07.2023, ndërsa marrëdhëniet financiare kanë filluar më datë 12.07.2023. Grupi i auditimit kërkoi pranë zyrës së arkiv/protokollit një kopje të urdhrit të brendshëm nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023, që të evidentonte hartuesin dhe miratuesin e urdhrit, por një dokument i tillë nuk na u vu në dispozicion.
Urdhri nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023, për të cilin po i referohemi, ishte pjesë e dosjes së auditimit të shërbimit të pajisjes Agilent.

Urdhri i brendshëm nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023 për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim për të finalizuar kontratën nr. 389 Prot., datë 19.06.2023 me objekt "Loti I - Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Agilent", ndërkohë që urdhri i brendshëm nr. 129 me nr. 390/3 Prot., datë 04.12.2023 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për të finalizuar kontratën nr. 390/1 Prot., datë 21.06.2023 me objekt "Loti II - Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturën Thermofisher", i firmosur nga z. I. A në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm, tregon që urdhri 129/1 datë 20.06.2023 është nxjerrë 6 muaj para urdhrit nr. 129 me nr. 390/3 Prot., datë 04.12.2023.
Veprime në kundërshtim me nenin 109, pika "b", nenit 108, pika 1(a)(i-iii), neni 110 pika 2, e Kodit të Procedurës Administrative, *ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17, ngarkojnë me Z. I. A ne cilësinë e titullarit te Institucionit*

Për sa është trajtuar më sipër në Projekt Raportin auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nga përfaqësues të ISUV-it, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Përsa ju keni konstatuar, në lidhje me protokollimin dhe administrimin e dokumentacionit nga zyra e protokoll – arkivit bazuar në rekomandimin e lënë nga ju për forcimin e kontrollit mbi procesin e protokollimit të dokumenteve duke garantuar që çdo veprim administrativ të regjistrohet në kohë sipas rendit kronologjik dhe me Nr. Unik në përputhje me legjislacionin për arkivat, nga ana e ISUV ka nisur marrja e masave për rishikimin e praktikave aktuale dhe zbatimin e një mekanizmi mbikëqyrje në mënyrë të menjëhershme.
Lidhur gjejen, në të cilën konstatohet se: Titullari i institucionit ka nënshkruar një urdhër më datë 20.06.2023, ndërkohë që emërimi dhe fillimi i detyrës është bërë me datë 11.07.2024. Pas verifikimeve përkatëse, rezulton që ky është një lapsus teknik. Duke qenë se është një lapsus kërkojmë nga ana juaj që kjo gjetje të rishikohet dhe të përjashtohet nga raporti final i auditit.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura shkresën nr. 506/3 prot., datë 18.07.2025, nuk u sollën arsyetime apo dokumente shtesë vërtetues prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

IV. Problematika të tjera të konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, konkretisht:
Nga verifikimi i librit të protokollit është vërejtur një mospërputhje në renditjen kronologjike, si më poshtë:

- Numri 390/2 i përket datës 21.06.2023
- Numri 390/3 i përket datës 04.12.2023
- Numri 390/4 i përket datës 29.06.2023

Gjithashtu, nr. i protokollit 105/2, datë 14.04.2023 "Kthim përgjigje shkresës…" nuk është evidentuar në përputhje me rregullat dhe formatin standard të librit të protokollit, pasi është shtuar në fundin e faqes, në një hapësirë pa vijëzim, duke shënuar numrin e përditësuar

Konkluzion:
Nga auditimi i kryer në ISUV janë konstatuar raste të përsëritura të mosregjistrimit të dokumenteve në librin e protokollit, pavarësisht se këto dokumente ishin firmosur nga titullari i institucionit dhe mbanin vulën zyrtare të institucionit. Dokumentet në fjalë janë pjesë e dosjeve të prokurimit. Gjithashtu, janë konstatuar raste kur i njëjti numër protokolli është përdorur për dokumente të ndryshme, duke krijuar paqartësi dhe mangësi në gjurmueshmërinë e dokumentacionit.
Në disa raste, janë nxjerrë urdhra për ngritjen e komisioneve ose për përfshirjen e punonjësve në komisione prokurimesh, para se marrëdhënia e tyre e punës me institucionin të ishte formalizuar ligjërisht. Në një rast të veçantë, është lëshuar urdhër i brendshëm për komisionin e marrjes në dorëzim nga një person që në atë moment nuk kishte statusin e titullarit të institucionit.

Një problem tjetër i konstatuar është mospërputhja kronologjike e regjistrimeve në librin e protokollit. Të gjitha këto shkelje tregojnë për mosfunksionim të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të dokumentacionit zyrtar

Për sa më sipër, është konstatuar se, duke vepruar në mospërputhje me nenin 109, pika "b", nenin 108, pika 1, germa "a", nënndarjet (i)-(iii) dhe nenin 110, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative, Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", nenet 12, 13 dhe 17 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit", me veprime apo mosveprime ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. I. A, në cilësinë e Titullarit të ISUV, për nxjerrjen dhe miratimin e akteve të brendshme në kushtet e mosligjshmërisë, lejimin e ushtrimit të funksioneve nga persona jashtë strukturës, si dhe për mungesën e zbatimit efektiv të sistemit të MFK dhe kontrollit të brendshëm;
- Znj. B. Ç., në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme;
- Znj.A. I., në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkiv/Protokoll;
- Znj. N. Z., në cilësinë e Arkivist/Protokolliste;

për mospasqyrimin e dokumentacionit zyrtar në librin e protokollit, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor, për moszbatimin e detyrimeve mbikëqyrëse dhe mungesën e masave parandaluese në administrimin e dokumentacionit, për lejimin e përfshirjes në komision të një personi të paemëruar zyrtarisht, si dhe për mungesën e kontrollit mbi njësitë vartëse, përfshirë Zyrën e Prokurimeve dhe Arkivit, veprimtaria e të cilave është audituar dhe pasqyruar në këtë Projekt Raport Auditimi dhe Akt verifikimi të mbajtur në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në librin e protokollit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIMIE:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë me kuadrin ligjor në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, rezultoi se ISUV nuk ka hartuar raportet periodike të monitorimit me qëllim vlerësimin e ecurisë së realizimit të buxhetit vjetor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Kapitulli VI "Raportet e monitorimit". Po ashtu, gjatë periudhës 2022–2024 u konstatua një numër i lartë i rishikimeve buxhetore: konkretisht, në vitin 2024 janë kryer 16 ndryshime buxhetore; në vitin 2023 janë kryer 9 ndryshime buxhetore; dhe për vitin 2022 gjithashtu 9 ndryshime.
Njëkohësisht, evidentohet një nivel i ulët i realizimit të investimeve të parashikuara dhe i të ardhurave. Mangësitë e mësipërme tregojnë për një planifikim fillestar të pasaktë buxhetor, si dhe mungesë të monitorimit dhe kontrollit efektiv gjatë zbatimit të buxhetit.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-28 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) të marrë masa për hartimin dhe dorëzimin në kohë të raporteve periodike të monitorimit të realizimit të buxhetit vjetor. Këto raporte duhet të përmbajnë analiza mbi realizimin e shpenzimeve, krahasimin me planifikimet, identifikimin e devijimeve dhe shkaqet përkatëse, si dhe rekomandime për përmirësime të mundshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive vjetore, rezultoi se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon akt rakordimi të llogarisë 520, në kundërshtim me pikën 50 e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, sipas të cilit Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet).
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-35 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e aktit të rakordimit për llogarinë 520 "Disponibilitete në thesar", i cili duhet të përmbajë strukturimin e saktë të tepricave sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara dhe t'i bashkëlidhet pasqyrave vjetore financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive vjetore mbi procedurën e inventarizimit të vitit 2024 dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, nuk është realizuar procesi i inventarizimit. Gjithashtu, në llogaria kontabël 214 "Aktive të tjera afatgjata materiale" dhe 218 "Aktive të tjera afatgjata jomateriale" rezultojnë të mbartura aktive që prej vitit 1996.
Nga analiza e të dhënave kontabël rezultoi se vlera e mbetur kontabël e këtyre aktiveve është më e vogël se 10% e vlerës fillestare të tyre. Koha e largët e regjistrimit fillestar të këtyre aktiveve dhe vlera e ulët me të cilën ato figurojnë të regjistruara mbart risk në lidhje me gjendjen funksionale dhe vlefshmërinë e tyre ekonomike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se, ISUV disponon një regjistër të aktiveve, i cili aktualisht paraqitet i paplotë dhe ka nevojë për përmirësim në drejtim të përmbajtjes së të dhënave që pasqyrohen në të, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, kapitulli III, pika 30. Regjistri duhet të përmbajë informacion të detajuar në funksion të klasifikimit të aktiveve, duke përfshirë, ndër të tjera: përshkrimin përkatës, datën e daljes nga përdorimi, afatin e skadencës, vlerën e investimeve pasuese që ndikojnë në rritjen e vlerës, vendndodhjen fizike të aktivës, personin përgjegjës për administrimin e saj, vlerën e akumuluar të amortizimit, periudhat dhe natyrën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e shpenzimeve të mirëmbajtjes si dhe datën e daljes nga pronësia.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-35 të Raportit të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Nga ana strukturave përgjegjëse të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të merren masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve në përputhje kuadrin ligjor. Procesi i inventarizimit duhet të mbështetet me dokumentacion përkatës dhe të përfshijë verifikimin fizik dhe kontabël të aseteve, me qëllim garantimin e saktësisë së të dhënave financiare, si dhe të merren masa për të përditësuar regjistrin e aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive vjetore u konstatua se, ISUV mban në llogarinë 468 "Debitorë të Ndryshëm" dhe në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)", detyrime që ish-punonjësit kanë ndaj institucionit në vlerë 727,073 lekë, të cilat datojnë që nga viti 2014. Gjatë kësaj periudhe, ISUV nuk ka ndërmarrë masa ligjore apo administrative për të arkëtuar këto të drejta nga debitorët, në kundërshtim me germat "g" dhe "gj", të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-36 të Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Nga ana strukturave përgjegjëse të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të ri-verifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive vjetore rezultoi se ISUV ka debituar në llogarinë 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata", TVSH e projekteve IPA të viteve 2012 dhe 2013, në vlerën 125,883,224 lekë. Sipas UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, seksioni 2.1 "*Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2*", pika "f", llogaria 28 debitohet vetëm në rastet kur një institucion i transferon një aktiv një institucioni tjetër të varësisë ose institucioneve të tjera. Derisa aktivi të jetë në përdorim nga institucioni përfitues, ai regjistrohet si një caktim, ku llogaria 28 shërben si një llogari kalimtare për caktime ndërinstitucionale. ISUV ka klasifikuar TVSH-në e projekteve IPA si një aktiv të caktuar, ndonëse nuk ka dokumentacion mbështetës për të verifikuar origjinën e kësaj vlere, investimit të cilit i korrespondon dhe nëse ky investim është kryer për llogari të ISUV apo një institucion tjetër, - Klasifikimi i gabuar i TVSH-së së projekteve IPA në llogarinë 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata" ka ndikim edhe për llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme", duke e mbivlerwsuar vlerën e kësaj llogarie.
-Në vitin 2024, vlera e llogarisë 28 është pakësuar me 23,979,396 lekë për shkak të amortizimit në masën 15%, një trajtim i pasaktë kontabël, pasi llogaria 28 nuk i nënshtrohet procesit të amortizimit. Sipas përcaktimeve të UMFE nr. 5, llogaria 28 "*Caktime të Aktiveve Afatgjata*" nuk duhet të përfshijë amortizim, pasi ajo funksionon si një llogari kalimtare për transferime ndërinstitucionale të aktiveve. Veprimet e mësipërme tregojnë për një pasqyrim të gabuar të vlerës së aktiveve dhe pasaktësi në hartimin e pasqyrave financiare.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-38 të Raportit të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës së ISUV të sigurojë dokumentacionin e plotë për investimet e projektit IPA për vitet 2012 dhe 2013, ku vlera e TVSH-së është 125,883,224 lekë, dhe në cilësinë e institucionit përfitues të këtij investimi të kryejë rishikimet dhe sistemimet përkatëse kontabël, në përputhje me rregullat e kontabilitetit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të marrë masa për sistemimin e regjistrimeve kontabël që lidhen me zbritjen e vlerës së llogarisë 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata", në shumën prej 23,979,396 lekë, si rezultat i amortizimit. Institucioni të marrë masa të rishikojë të gjitha regjistrimet përkatëse dhe të sigurojë që pasqyrimi i tyre të jetë në përputhje me rregullat e kontabilitetit publik, duke reflektuar saktësisht natyrën kalimtare të kësaj llogarie.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave te prokurimit u konstatua se (i) personi i angazhuar në studimin e tregut dhe (ii) anëtarët e Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit në asnjë rast nuk kanë nënshkruar këtë deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, veprime në kundërshtim me nenin 73, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. (*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-55 të Raportit të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Titullari i AK dhe personi përgjegjës për prokurimin të marrë masat për garantimin e dokumentimit të nënshkrimit të deklaratave të konfliktit të interesit nga çdo punonjës që përfshihet në procedurat e prokurimit publik, si një nga masat për të parandaluar konfliktin e interesit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit mbi kufirin e ulët monetar dhe mbi kufirin e lartë monetar, u konstatua se:

a. Pavarësisht se Titullari i AK ka ngritur komisionin për hartimin e specifikimeve teknike, sa i përket procedurave të prokurimit:

1. "*Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes"* viti 2022
2. *"Blerje enë dhe materiale laboratorike"* viti 2023
3. "*Blerje Standarde dhe materiale reference*" viti 2023

4-5."*Shërbim, servis kalibrimi*" për vitit 2023-2024

6."*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" vitin 2024

7. *"Blerje Kite"* viti 2024

8. *"Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve"*

Komisionet respektive të këtyre procedurave nuk janë angazhuar në hartimin e specifikimeve teknike, por i kanë marrë nga përgjegjësit e departamenteve.

- Në procedurat e prokurimit "*Shërbim, servis kalibrimi*" për vitit 2023-2024, "*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" për vitin 2024, nuk është përfshirë një specialist fushe inxhinier elektronik, teknik laboratori, pavarësisht se objektet e prokurimit përfshinin specifikime të detajuara teknike të pajisjeve laboratorike dhe të nevojave teknike për servis.

b. Komisioni i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, në asnjë rast në procedurat e prokurimit të audituara, nuk ka argumentuar specifikimet teknike të artikujve të kërkuar. Mos argumentimi i specifikimeve teknike, përveç faktit se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, që nga studimi i tregut, ofertimi nga OE dhe marrja në dorëzim e mallit/ shërbimit të kërkuar, por nuk garanton përdorimin me eficiencë të fondeve publike, nuk nxit pjesëmarrjen e OE-ve në procedurat e prokurimit, si dhe kufizon ndjeshëm konkurrencën ndërmjet tyre.

c. Specifikimet teknike, sa i përket procedurave të prokurimit me objekt "*Shërbim servis kalibrimi*" për vitet 2023-2024, "*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV*" për vitin 2024, "*Pajisje për*

fuqizimin e laboratorëve në ISUV" për vitin 2023, "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve*" për vitin 2024, nuk janë hartuar nga specialistë të fushës, duke mos garantuar se të gjithë elementët e përfshirë në specifikimet teknike, në sasinë e kërkuar, janë të nevojshme për përmbushjen e objektit të kontratës.
d. Në procedurat e prokurimit me objekt "*Shërbim servis kalibrimi*" për vitet 2023 dhe 2024, pavarësisht se ndarja në Lot-e është bërë nisur nga kompania prodhuese e pajisjeve, në lot-in I dhe lot-in II janë përfshirë pajisje të firmave prodhuese të ndryshme dhe artikuj të tjerë, të cilat nuk kanë lidhje me kompaninë prodhuese përkatëse ("Agilent", "Thermofisher"). Përfshirja e tyre e paargumentuar në një procedurë që nuk ka konkurrencë, pasi janë operatorë specifikë që disponojnë autorizimin e prodhuesit, ndikon drejtpërdrejt në fondin limit të përllogaritur e në vlerën totale të kontratës, duke mos garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë.
e. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sa i përket procedurës së prokurimit me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve*" për vitin 2024, nuk janë hartuar nga specialistë të fushës. Kjo ka sjellë që të vendosen kritere për kualifikim, të paargumentuara, që nuk lidhen me objektin e kontratës dhe që nuk janë në proporcion me objektin e kontratës. Gjithashtu, Njësia e prokurimit ka kërkuar që OE të disponojë Leje mjedisore të Tipit A, pa specifikuar kategorinë e mbetjeve objekt i prokurimit. Kjo ka sjellë që KVO të neglizhojë në kryerjen e verifikimeve të nevojshme mbi kategoritë e mbetjeve që BOE ofertues ishte i licencuar, duke u mjaftuar me Lejen mjedisore të Tipit A të paraqitur, rrjedhimisht duke kualifikuar një ofertues që nuk plotësonte kriteret e nevojshme për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 55-57 të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, të marrë masat për krijimin e një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv, për të garantuar hartimin dhe argumentimin e kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga ISUV, në mënyrë të tillë që të garantohet transparenca, trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar, mos diskriminim dhe konkurrencë, duke siguruar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë.

Në vijimësi

8. Gjetj nga auditimi: a. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim i mbetjeve*" u konstatua se Titullari i AK nuk ka përfshirë në Komisionin e Vlerësimit të Ofertës specialist të fushës (inxhinier mjedisi ose ekuivalent), në kundërshtim me nenin 75 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Në KVK-në nr. 2.3.2 është kërkuar disponimi i Lejes mjedisore Tipi A (Kodi III.1.C) për të njëjtin objekt prokurimi. KVO ka kualifikuar BOE "G. C." ShPK & "B. A." SHPK, pavarësisht se nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi që të jenë të pajisur me Leje mjedisore Tipi A (Kodi III.1.C), por jo për të njëjtin objekt prokurimi, pasi në kategoritë e mbetjeve e listuara në Aktin e Miratimit bashkëlidhur, nuk përfshihen kategoritë e mbetjeve objekt prokurimi. Mungesa e specialistit të fushës ka sjellë kualifikimin nga ana e KVO-së të BOE "G. C." SHPK & "B. A." SHPK, pa konfirmuar kategoritë e mbetjeve për të cilët disponohej Leja mjedisore Tipi A (Kodi III.1.C), për të verifikuar nëse ato përkonin me objektin e prokurimit. Pavarësisht parregullsive të mësipërme, Titullari i AK ka miratuar Raportin përmbledhës të procedurës së prokurimit, për të vijuar më tej me lidhjen e kontratës.
b. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës*", u konstatua se KVO, ka përgatitur raportin përmbledhës me datë 11.12.2023 duke shpallur fitues OE "R.-A." shpk, por pa verifikuar dokumentacionit e dorëzuar nga OE me datë 12.12.2023, në kundërshtim me nenin 26 pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021;
c. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes*", u konstatua se KVO, me datë 09.12.2022 ka bërë vlerësimin e ofertave

duke shpallur fitues OE "K." shpk, por pa verifikuar dokumentacionit e dorëzuar nga OE me datë 13.12.2022.

d. Nga auditimi procedurës se prokurimit me objekt: "*Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve*", OE "G." shpk nuk ka dorëzuar vërtetim për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, por ka dorëzuar vetëm vërtetimin për pagimin e taksave dhe tatimeve.

Për sa me sipër KVO, nuk ka respektuar kërkesat e vendosura në DT, siç janë Kriteret e pwrgjithshme, Veprimet në kundërshtim me LPP nr. 162, datë23.12.2020,"Për prokurimin publik" neni 76, pika 2, neni 92, pika 3, 4 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 26, pika 2 gërma "dh", pika 2. (*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-68 të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, t'i kushtojë vëmendje të shtuar procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit, përpara nënshkrimit të Raportit Përmbledhës të procedurës së prokurimit, për të garantuar përputhshmërinë e plotë me kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "*Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike*", për vitin 2024, Titullari i AK nuk ka përfshirë specialist të fushës (inxhinier mjedisi ose ekuivalent) në komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në kundërshtim me pikën 43 të UMF nr. 30, datë 27.11.2011. Komisioni i marrjes në dorëzim ka konfirmuar marrjen në dorëzim të shërbimit, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur si "Dokumentet e transportit për mbetje të rrezikshme" dhe "Dokumenti i dorëzimit për mbetje të rrezikshme" nuk përcaktojnë saktë përshkrimin e mbetjes dhe kodin sipas katalogut të mbetjeve, duke përfshirë të gjitha mbetjet e asgjësuara në kodin 15 01 10*, që i referohet *mbetjeve të ambalazhit* që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme. Sipas pikës 8 të VKM-së nr. 798, datë 29.09.2010 "*Për administrimin e mbetjeve spitalore*", çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve deri tek asgjësimi i tyre.

-*Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt* "*Shërbim, servis kalibrimi*", ndarë në 3 lot-e, për vitet 2022 – 2024, janë konstatuar parregullsitë, si më poshtë:

-Titullari i AK nuk ka përfshirë specialist të fushës (teknik laboratori, inxhinier elektronik, ose ekuivalent) në komisionin e marrjes në dorëzim, si dhe nuk ka përfshirë personin me përgjegjësi materiale (magazinierin), pavarësisht se kontratat e lot-it 1 (për të tre vitet) dhe në kontratat e lot-it 3 (për vitin 2023, 2024) kanë qenë kontrata mikse, ku përpos marrjes së shërbimit të servisit, janë marrë në dorëzim edhe pjesë këmbimi dhe pjesë për operimin e pajisjeve (pra jo pjesë që ndërrohen direkt me marrjen e shërbimit), veprime në kundërshtim me pikën 43, të UMF nr. 30, datë 27.11.2011.

Si pasojë, nuk është kryer verifikimi fizik i sasisë së tyre nga magazinieri për efekt të regjistrimit në magazinë, në kundërshtim me pikën 37 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.11.2011.

-Pavarësisht se në dokumentet e tenderit është kërkuar që OE të paraqesin vërtetime që kanë inxhinierë të trajnuar dhe të certifikuar nga kompanitë prodhuese për të kryer shërbimin e servisit, Komisionet e marrjes në dorëzim nuk kanë kryer verifikimet e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratave. Kjo ka sjellë që, shërbimi për lot-in I dhe lot-in II të jetë kryer nga persona të ndryshëm nga stafi i paraqitur dhe i pranuar në ofertën fituese, për të cilët ISUV nuk administron dokumentacion nëse janë ose jo të trajnuar dhe të certifikuar nga kompanitë prodhuese për ofrimin e këtij shërbimi.

-Pavarësisht se është kërkuar ndër të tjera kalibrimi i pajisjeve në secilin prej lot-eve, komisioni i marrjes në dorëzim ka konfirmuar marrjen e shërbimit pa administruar certifikatat e kalibrimit, si dokument vërtetues për kalibrimin e pajisjeve, sipas përcaktimit në pikën 6.4.3, 6.4.4 dhe 6.8.2 të Dokumentit të DPA-së me Kod DA-IN-0011 "Udhëzues në lidhje me kalibrimin dhe gjurmueshmërinë" dhe dokumentit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë "Guidë për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit: Analiza, interpretimi dhe Përdorimi".

-*Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt*
1. "*Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes*" viti 2022
2. "*Blerje enë dhe materiale laboratorike*" viti 2023
3. "*Blerje enë dhe materiale laboratorike*" viti 2023
4. "*Blerje Standarde dhe materiale reference*" viti 2023
5. "*Blerje Kite*" viti 2024
6. "*Blerje kite për nevoja të ISUV*" viti 2022 (procedurë e kryer nga MBZHR, zbatuar nga ISUV)
7. *"Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve"*

u konstatua se komisionet e marrjes në dorëzim kanë dokumentuar në procesverbal vetëm verifikimin sasior të artikujve të marrë në dorëzim, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar firmën prodhuese të mallrave të furnizuar, si dhe nuk ka përcaktuar origjinën dhe datën e skadencës apo afatin e përdorimit, sipas rastit, për të mundësuar gjurmën e auditimit mbi marrjen në dorëzim të artikujve në përputhje me kontratën, DST, si dhe ofertën fituese.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 69-75 të Raportit të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/ shërbimeve/ punëve, të ngritura nga Titullari i Institucionit, të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuar në ftesën për ofertë, kontratës së lidhur dhe ofertës së pranuar të OE, si dhe të administrojnë të gjithë dokumentacionin shoqërues të nevojshëm, me qëllim evidentimin dhe mundësimin e gjurmës së auditimit mbi realizimin e furnizimit me mallra, shërbime e punë sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar, me qëllim garantimin e përdorimit të fondeve publike me eficiencë dhe efektivitet.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 (pesë) procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se:
-Në asnjë procedurë Komisioni i Blerjeve me Vlere të Vogël, nuk ka kryer përllogaritjen e fondit limit, duke vepruar në mospërputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenin 2, pika 2, germa ç) dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe me pikën 7, të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".
-Në 3 procedura prokurimi, KBVV nuk ka hartuar procesverbalin e argumentimit të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 78, pika 2 dhe nenin 2, pika 2, germa c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar. Gjithashtu, KBVV nuk ka ngarkuar në SPE procesverbalin përkatës, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021.
- Në 3 procedura prokurimi, anëtari i KBVV është njëkohësisht dhe nëpunës zbatues pranë ISUV, në mospërputhje me parashikimet e nenit 12, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- Nga auditimi mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave u konstatua se:
Në procedurat "Shërbim, riparim krematoriumi" (2022) dhe "Shërbim, riparim, blerje pjese këmbimi për aparaturat Bertin" (2024), operatorët ekonomikë janë shpallur fitues pa u verifikuar më parë kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë, pasi nuk ka gjurmë auditimi mbi dorëzimin e dokumentacionit pranë AK, në kundërshtim me nenin 2, pika 2, germa j) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 dhe me pikën 18, të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021.
Në procedurat "Shërbim, riparim krematoriumi" (2023) dhe "Kontrolli i mjeteve matëse" (2024), OE fitues nuk e kanë në objekt veprimtarinë objekt prokurimi, në kundërshtim me pikën 15, germa a) të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021. Për këtë arsye, KBVV duhej ta kishte evidentuar parregullsinë dhe të kishte skualifikuar operatorin.
Në procedurën "Kontrolli i mjeteve matëse" (2024), OE është shpallur fitues pa u verifikuar kriteret e ftesës për ofertë. Dokumentacioni i dorëzuar ka pasur mangësi:

a) Certifikata e akreditimit Nr. 426-6 ishte e vlefshme deri më 06.05.2024, ndërkohë që procedura u hap më 25.07.2024 dhe dokumentet u dorëzuan më 29.07.2024 – periudhë kur OE nuk ishte i licencuar.
b) Certifikata e lëshuar nga laboratori nuk është nga një organizëm akreditues nënshkrues i EA-MLA, i njohur nga Republika e Shqipërisë, në kundërshtim me pikën 18, të Udhëzimit nr. 5.
c) Nuk ka gjurmë auditimi për një kontratë mes OE dhe laboratorit "Total Q Calibration Laboratories S.A", që mbështet dorëzimin e dokumentacionit për këtë shërbim.
- Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave u konstatua:
Në procedurën "Blerje kite (emergjencë)", titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit. Malli është marrë në dorëzim nga punonjës të ISUV pa urdhër të veçantë, në kundërshtim me pikën 42, të Udhëzimit nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Në procedurën "Kontrolli i mjeteve matëse", komisioni i ngritur me urdhrin Nr. 579/3 Prot., datë 29.10.2024, ka mbajtur procesverbal pa kryer verifikim paraprak të shërbimit, pasi kalibrimi ishte kryer përpara ngritjes së komisionit, në kundërshtim me pikën 36, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Nga auditimi i zbatimit të kontratës për blerjet e vogla, procedurë e vitit 2024 "Shërbim, riparim, blerje pjese këmbimi për aparaturat Bertin", nëpërmjet akt dorëzimit dhe procecverbalit të komisionit, është dokumentuar marrja në dorëzim e një nga pesë mallrave të kërkuar, ndërkohë nuk ka gjurmë auditimi mbi marrjen në dorëzim të katër pakove të tubave të kërkuar, në kundërshtim më pikën pikën 42 e 47, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Për sa më sipër, duke qenë se fatura nuk ka qenë e ndarë me zëra, është e pamundur të përllogaritet vlera për katër zërat që nuk është dokumentuar marrja në dorëzim. Në të njëjtën procedurë, procesverbali i datës 24.12.2024 pohon se "shërbimi u realizua i plotë", por nuk ka asnjë dokument (procesverbal, certifikate kalibrimi) që vërteton realizimin e riparimit apo kalibrimit për aparaturat Bertin, në kundërshtim me objektin e prokurimit dhe me "Guidën për metrologjinë – Certifikatat e kalibrimit" të DPM.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 113-115 të Raportit të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa që, Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël të hartoj dhe të ngarkoj në Sistemin Elektronik të Prokurimit, procesverbalin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike dhe në asnjë rast të mos përfshijnë nëpunësin zbatues pjesë të këtij komisioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:
Për periudhën objekt auditimi ISUV nuk ka hartuar planin strategjik dhe planet e veprimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9, pika 4, germa "a".
-Titullari i institucionit nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b" dhe nenin 27, Manualin e MFK-së, pika 2.2.6, si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".*
- Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-ve të hartuara gjatë periudhës së auditimit, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit. Mosveprimet e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit si përgjegjës për realizimin e detyrave teknike si dhe zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore janë në kundërshtim me pikën 2.6 të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*".
- ISUV nuk ka rregullore të brendshme të miratuar, veprim ky në kundërshtim me Manualin e MFK-së, pika 3.3
-Strukturat përgjegjëse të ISUV, nuk kanë hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, siç parashikohet në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, pika 2, neni 21 si dhe në udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë*

dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3.2.1
- Nuk është hartuar regjistri i riskut në nivel institucional sikurse parashikohet në nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, dhe nuk është përgatitur regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 11.
- ISUV nuk ka miratuar gjurmën e auditit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit, siç përcaktohet në nenin 16, pikat nr. 2, 3, në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.5, faqe 122-125 të Raportit të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Titullari i ISUV, në bashkëpunim me strukturave përgjegjëse, të marrë masa konkrete për krijimin dhe funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), duke:
-Hartuar dhe miratuar planin strategjik afatmesëm me objektiva të matshme dhe të arritshme.
-Ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS);
-Bashkëpunuar me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme;
-Hartuar strategjinë dhe regjistrat e riskut në nivel departamentesh/drejtori/sektor, dhe të ndërtojë mekanizma për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e riskut;
-Miratuar procedurat e kontrollit të brendshëm dhe dokumentin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: ISUV ka gjithsej 41 laboratorë (përfshirë 3 laboratorë që kryejnë vetëm shërbime të brendshme: Lab. Metrologjisë, Preparatori Speciale, Vivarium), nga të cilët 19 Laborator kanë teste të akredituara në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve, dhe rreth 50% e laboratorëve (pa përfshirë 3 laboratorët për shërbime të brendshme) janë të pa akredituar. Pjesa dërrmuese e analizave të akredituara, përkatësisht 1778 ose 93.1% e totalit, janë të përqendruara në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve. Ndërkohë, që departamente të tjera me funksione kyçe për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve, si Departamenti i Mikrobiologjisë dhe Monitorimit të Ujërave (4.7%), Departamenti i Monitorimit të Mbetjeve (1.1%) dhe Departamenti i Shëndetit të Kafshëve (1.1%), përfaqësojnë një përqindje minimale të analizave të akredituara. Sektori i kontrollit të barnave veterinare dhe sektori i diagnostikimit të dëmtuesve të bimëve, nuk kanë asnjë përcaktim/test analitik të akredituar. Për periudhën objekt auditimi, shpenzimet vetëm për kryerjen e analizave nga ISUV jashtë vendit pranë laboratorëve referent në BE, shkojnë në shumën 1,880,000 euro ose 205,672,000 lekë.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.1 faqe 111-112 të Raportit të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISUV, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për rritjen e numrit të analizave të akredituara në sektorët ku niveli i akreditimit rezulton i ulët, duke hartuar dhe zbatuar një plan veprimi konkret, të matshëm, për zgjerimin e fushës së akreditimit në sektorët prioritarë, si dhe duke garantuar mbështetjen teknike, financiare dhe njerëzore të nevojshme, në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025 dhe objektivat strategjikë të politikave kombëtare për sigurinë ushqimore dhe veterinarisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, u konstatua se:
a. Megjithëse ISUV ka të implementuar sistemin informatik LIMS, për regjistrimin dhe menaxhimin e kampioneve laboratorike, procesi aktual nuk është tërësisht i automatizuar dhe informatizuar në të gjitha hallkat e tij, më konkretisht:
- Identifikimi dhe gjurmueshmëria e kampioneve realizohet përmes kodeve manuale, ndërsa në çdo fazë të ciklit laboratorik nuk përdoren sisteme barkodimi apo skanime elektronike;
- Dokumentacioni dhe komunikimi ndër departamental në disa raste vazhdon të mbështetet në procedura manuale ose të pjesshme, të mbështetura vetëm në mënyrë të kufizuar nga LIMS-i, gjë që shton kohën e përpunimit dhe rrit mundësinë për gabime njerëzore;
- Proceset e ruajtjes, transferimit dhe asgjësimit të kampioneve, si dhe arkivimi i rezultateve analitike, nuk janë të integruara në mënyrë të automatizuar në një sistem gjurmues, që mundëson kontroll dhe akses në kohë reale mbi të gjithë zinxhirin laboratorik.
b. ISUV, nuk ka të informatizuar tërësisht zinxhirin e pandërprerë të menaxhimit të cilësisë, siç është praktika e aplikuar gjerësisht në laboratorët referentë të sigurisë ushqimore dhe veterinare në vendet e BE, të cilët përdorin platforma të integruara LIMS të shoqëruara me sisteme barkodimi dhe monitorim automatik në çdo hap të procesit analitik, duke garantuar gjurmueshmëri, transparencë dhe një cilësi të standardizuar në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17025.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.4 faqe 115-116 të Raportit të Auditimit)*

<u>13.1 Rekomandimi</u>: Drejtori i Përgjithshëm i ISUV, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë laboratorike, nëpërmjet informatizimit të plotë dhe automatizimit të proceseve kyçe që lidhen me menaxhimin e kampioneve dhe të dhënave analitike.
Në mënyrë të veçantë, duhet të synohet integrimi i plotë i sistemit LIMS me komponentë shtesë teknologjikë si barkodimi, skanimi elektronik dhe monitorimi në kohë reale, për të siguruar gjurmueshmëri të pandërprerë, reduktim të ndërhyrjeve manuale dhe rritje të transparencës në çdo hallkë të ciklit laboratorik, në linjë me praktikat e laboratorëve referentë të vendeve të Bashkimit Europian.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e kiteve, reagentëve dhe materialeve laboratorike, u konstatua:
- Për periudhën e auditimit, ISUV është furnizuar me "Kite" përmes kontratave me një vlerë totale prej 19,987,243 lekë. Sasia totale e këtyre kiteve për periudhën 2022–2024 është shpërndarë menjëherë nga magazina qendrore drejt departamenteve, pa qëndruar në magazinë dhe pa ndjekur ndonjë procedurë të miratuar për administrimin e mëtejshëm të tyre.
- Nuk dokumentohet përdorimi i artikujve në laboratorë përmes fletë-kërkesash të miratuara nga drejtuesit përkatës të laboratorëve/departamenteve.
- Mungon një sistem formal dhe i miratuar për monitorimin e afateve të skadencës së kiteve dhe reagentëve pas kalimit të tyre në laboratorë.
- Strukturat përgjegjëse nuk kanë hartuar apo miratuar ndonjë akt administrativ për këtë qëllim.
- Mungon një sistem informatik (p.sh. module shtesë të LIMS) për sinjalizimin e skadencës së afërt të produkteve.
- Administrimi bëhet në mënyrë manuale dhe jo të standardizuar, duke pamundësuar kontrollin sasior dhe cilësor të tyre.
- Gjatë hartimit të PBA-së për materialet laboratorike, ISUV nuk ka ngritur komision të posaçëm për konsolidimin e kërkesave sipas strukturave.
- Nuk është ndjekur ndonjë metodologji e qartë për planifikimin e nevojave bazuar në gjendjen e stokut, historikun e qarkullimit dhe objektivat e akreditimit.
- Mbetjet laboratorike nga përdorimi i kiteve dhe reagentëve nuk regjistrohen në regjistra të veçantë ose sisteme informatike.
- Nuk ruhen në ambiente të dedikuara, por vendosen në vende të improvizuara nga përdoruesit.

- Magazina qendrore nuk përmbush kushtet teknike për ruajtjen e materialeve që kërkojnë zinxhir të ftohtë, për shkak të mungesës së investimeve në frigoriferë të specializuar.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.5, faqe 116-118 të Raportit të Auditimit)*

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISUV - të marrë masa për përmirësimin dhe standardizimin e administrimit të kiteve, reagentëve dhe materialeve të tjera laboratorike në të gjitha hallkat e përdorimit të tyre, duke:
- Hartuar akte administrative për përdorimin, dokumentimin dhe kontrollin e çdo artikulli laboratorik (kit, reagent, etj.);
- Informatizuar monitorimin e afateve të skadencës dhe gjendjes së stokut, përmes zgjerimit të platformës LIMS me module shtesë për administrimin e inventarit;
- Ngritur një komision Ad Hoc për analizimin e kërkesave të departamenteve dhe sektorëve dhe konsolidimin e tyre në kuadër të hartimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, bazuar në gjendjen aktuale të stokut, qarkullimin e materialeve gjatë 2–3 viteve të fundit dhe objektivat e akreditimit për zgjerimin e analizave të akredituara;
- Përmirësuar dhe plotësuar kushtet e ruajtjes në magazinën qendrore për materialet që kërkojnë zinxhir të ftohtë, përmes investimeve në pajisje frigoriferike të përshtatshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: ISUV, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, prodhon mbetje të rrezikshme dhe/ose mbetje jo të rrezikshme, si dhe ushtron veprimtari të tilla si grumbullimi, ruajtja, trajtimi dhe asgjësimi i këtyre mbetjeve. Këto veprimtari përfshihen ndër ato që, sipas përcaktimeve ligjore kërkojnë pajisjen me leje mjedisore Tipi A/B, në varësi të kategorisë së mbetjeve, kapacitetit dhe llojit të procesit të trajtimit.
Nga auditimi rezulton se, ISUV nuk është i pajisur me leje mjedisore për ushtrimin e këtyre aktiviteteve si: grumbullim/ ruajtje apo trajtim/asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe/ose jo të rrezikshme, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.7, faqe 123-126 të Raportit të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare të marrë masa për fillimin e procedurave për pajisjen me lejet mjedisore përkatëse për të gjitha proceset/ aktivitetet që ISUV kryen lidhur me grumbullimin, trajtimin, asgjësimin e mbetjeve, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve/publikut, si dhe të sigurohet që çdo aktivitet kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve si dhe me standardet mjedisore.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2 Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare të marrë masa për planifikimin dhe kryerjen e procedurave të prokurimit publik lidhur me largimin dhe asgjësimin e mbetjeve që grumbullohen/ruhen në ambientet e ISUV, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve të ISUV.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi "*Çështje të tjera të evidentuara gjatë auditimit – Verifikim i rregullshmërisë së mbajtjes së librit të protokollit",* u konstatuan disa shkelje në lidhje me protokollimin dhe administrimin e dokumentacionit nga Zyra e Protokoll/Arkivit.
Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës", me fond limit 6,625,000 lekë pa TVSH, u konstatua se operatori ekonomik R.-A., i vetmi pjesëmarrës në garë, u kualifikua dhe u shpall fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me ofertën 6,500,000 lekë pa TVSH. Vendimi i KVO u miratua më pas nga titullari i autoritetit kontraktor, në Raportin Përmbledhës të datës 11.12.2023 (pa numër protokolli). (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6.8 të Projekt-Raportit të Auditimit*).

Nga auditimi u konstatua se titullari i AK-së, z. I.A, me urdhrin e brendshëm nr. 715 Prot., datë 13.10.2023, ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), ku i njëjti numër protokolli dhe e njëjta datë janë përdorur edhe për urdhrin e ngritjes së Njësisë së Prokurimit. Të dy urdhrat mbajnë nr. 715 Prot., datë 13.10.2023, dhe janë regjistruar në librin e protokollit. Ndërkohë, urdhri për ngritjen e KVO-së, i nënshkruar nga Titullari i Autorittit Kontraktor dhe i vulosur nga Zyra e Protokoll/Arkivit, ka caktuar si kryetare të KVO-së znj. A. P, megjithëse marrëdhëniet e saj të punës pranë ISUV kanë filluar 21 ditë më vonë, me urdhrin nr. 755 Prot., datë 03.11.2023, të lëshuar nga titullari i ISUV, duke ushtruar në këtë mënyrë funksionin e kryetares së KVO-së, edhe pse në atë periudhë nuk ishte ende pjesë e strukturës së institucionit.
Nga auditimi i procedurës "Loti I – Shërbim, riparim, blerje pjesë këmbimi për aparaturat Agilent", u konstatua se Drejtori i Përgjithshëm, ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 129/1 me nr. 389/4 Prot., datë 20.06.2023, për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim, për kontratën nr. 389 Prot., datë 19.06.2023, por nga auditimi i strukturës së ISUV rezulton se më datë 19.06.2023, datë që përkon me urdhrin e brendshëm, titullar i institucionit ka qenë z. P. A., dhe jo z. I. A., i cili ka firmosur urdhrin e sipërcituar. Z. I. A. është emëruar titullar i ISUV më datë 11.07.2023, ndërsa marrëdhëniet financiare i kanë filluar më datë 12.07.2023.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.8, faqe 140-142 të Raportit të Auditimit)*

16.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare - të marrë masa për forcimin e kontrollit mbi procesin e protokollimit të dokumenteve, duke garantuar që çdo akt administrativ të regjistrohet në kohë, sipas rendit kronologjik dhe me numër unik, në përputhje me legjislacionin për arkivat, me qëllim parandalimin e regjistrimeve të pasakta, të dyfishta apo të paregjistruara, të cilat cenojnë gjurmueshmërinë dhe vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit zyrtar. Gjithashtu Titullari i Institutit të marrë masa për të rishikuar praktikat aktuale të protokollimit, të trajnohet stafi përgjegjës dhe të vendoset një mekanizëm mbikëqyrës efektiv.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, germat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike ISUV, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **7,465,208 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedura e prokurimit me objekt "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave te tyre te rritjes". Kontrata midis AK dhe OE është lidhur me nr. 105 prot, datë 17.02.2023 dhe afati për shërbimin është 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës ose deri me datë 18.04.2023, u konstatua se:
Me procesverbalin e datës 03.05.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i parë dhe mallrat janë marrë në dorëzim 15 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,063,735 lekë me TVSh.
Me procesverbalin e datës 10.05.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i dytë dhe mallrat janë marrë në dorëzim 22 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,480,945 lekë me TVSh.
Me procesverbalin e datës 02.06.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i tretë dhe mallrat janë marrë në dorëzim 45 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 1,429,920 lekë me TVSh.
Me procesverbalin e datës 09.08.2023 është marrë në dorëzim furnizimi i katër dhe i fundit dhe mallrat janë marrë në dorëzim 122 ditë me vonesë dhe penaliteti është në vlerën 3,346,608 lekë me

TVSh, Në total penaliteti është 1,063,735 lekë + 1,480,945 lekë + 1,429,920 lekë + 3,346,608 lekë = **7,321,208** lekë me TVSh.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4.7, faqe 81-82 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor ISUV, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **7,321,208 lekë** nga kontraktori "K." shpk, si kamatëvonesa për tejkalim të afatit të dorëzimit të mallrave**.**

Brenda datës 31.12.2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël "Kontrolli i mjeteve matëse", në procesverbalin e marrjes në dorëzim konstatohet se: 1 artikull për zërin 4 dhe 3 artikuj në zërin 5 të specifikimeve teknike, nuk e kanë kaluar shërbimin e kërkuar (Kalibrim). Vlen të theksohet se *tek* specifikimet teknike në ftesën për ofertë për këto artikuj është kërkuar kalibrimi dhe jo kontroll/testim i tyre. Gjithashtu nuk është bërë servis dhe kalibrim për zërin 6 me specifikimet teknike sipas ftesës për ofertë. Autoriteti Kontraktor ka likuiduar faturën totale, duke përfshirë 4 artikujt e sipërcituar të cilët nuk kanë kaluar shërbimin e kërkuar (kalibrimin) në vlerë prej 115,200 lekë me TVSH, si dhe 1 artikull për të cilin nuk është bërë kalibrimi sipas specifikimeve teknike në ftesën për ofertë me vlerën prej 28,800 lekë me TVSH. Për sa më sipër likuidimi i vlerës totale prej 144,000 lekë me TVSH, pa u kryer kalibrimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Urdhrin e Prokurimit dhe Ftesës për Ofertë përbën dëm ekonomik.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 89-89 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 144,000 lekë nga kontraktori "A." shpk, në cilësinë e OE fitues në procedurën me objekt "Kontrolli i mjeteve matëse", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si pasojë e likuidimit të shërbimit të kërkuar (kalibrim) të pakryer.

Brenda datës 31.12.2025

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Sipas Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", kreu III, pika 2, germa "ç", citohet:
"Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, (mund të caktojnë pagë) në masën deri në 110,000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj." Gjatë periudhës 2023–2024 janë lidhur gjithsej 17 kontrata me këshilltarë të jashtëm. Numri i kontratave tejkalon numrin e këshilltarëve të përfshirë, pasi disa prej tyre janë angazhuar më shumë se një herë, përmes rinovimit ose lidhjes së kontratave të njëpasnjëshme.
Nga auditimi rezulton se, në vitin 2023 ISUV ka lidhur 8 kontrata me këshilltarë të jashtëm, ndërsa në vitin 2024 ka lidhur 9 kontrata, përfshirë kontratat e reja dhe ato të rinovuara nga viti paraardhës. Në total, për vitet 2023 dhe 2024, rezultojnë të lidhura 17 kontrata në vlerën totale prej 3,769,363 lekë për 13 këshilltar të jashtëm.
Përzgjedhja dhe kontraktimi i tyre nga strukturat përgjegjëse të ISUV nuk është realizuar nëpërmjet procedurës së prokurimit për shërbime konsulence, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 1, pika 2 dhe neni 3 pika 2.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-32 të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të shtetit në vlerë totale **3,769,363 lekë** mbi pagesën e 13 këshilltarëve të jashtëm, pa u zhvilluar procedura prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje enë dhe materiale laboratorike", u konstatua se:Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka konstatuar se operatorët ekonomikë "K." dhe "A." kanë paraqitur oferta anomalisht të ulëta. KVO ka kërkuar nga OE "K." shpk dhe OE "A." argumentimin e ofertave të tyre anomalisht të ulëta dhe, pas shqyrtimit të argumentimeve të sjella nga të dy operatorët, ka vendosur të skualifikojë OE "A.".Grupi i auditimit konstatoi se KVO ka vepruar me standard të dyfishtë, pasi si OE "K.", ashtu edhe OE "A.", në argumentimet e ofertave të tyre anomalisht të ulëta, kanë dhënë të njëjtat justifikime, duke paraqitur çmimet e marra nga furnitorët për çdo artikull, kostot e transportit, shpenzimet doganore dhe fitimin e llogaritur (të mbështetura me dokumentacionin përkatës). Ky veprim bie ndesh me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 93, si dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82, pika 4. Për sa më sipër, diferenca midis dy operatorëve ekonomikë me ofertë anomalisht të ulët dhe atij të renditur në vendin e dytë dhe shpallur fitues, dhe operatorit të skualifikuar të renditur në vendin e parë, do të konsiderohet si përdorim pa ekonomicitet i fondeve publike, në vlerën prej 400,000 lekësh.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 82-83 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim evidentimin e shkaqeve që kanë çuar në përdorimin pa ekonomicitet të fondeve publike, në vlerën 400,000 lekë, në procedurën "Blerje enë dhe materiale laboratorike, viti 2023".

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se është ekzekutuar vendimi gjyqësor për një ish-punonjës, në vlerën totale prej 6,906,437 lekë. Vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga ISUV, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë , veprime në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenin 130, nenin 451/a dhe nenin 510/a, duke paguar tarifa përmbarimore në vlerën totale prej 512,820 lekë.
(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-32 të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare të merren masa për analizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën prej **6,906,437 lekë**.
Vendimet gjyqësore kanë rezultuar në pagesa që nuk përputhen me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin e ISUV-it. Për këtë arsye, është e rëndësishme të ndërmerren hapa për parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikës së kryerjes së analizave jashtë vendit për ato analiza që nuk mund të realizohen në ISUV, lidhur me pagesat e kryera ndaj laboratorit C. Group (Belgjikë), u konstatua se:
Laboratori C. Group (Belgjikë), për periudhën 2022–2024, në faturat e shërbimit të kryera për llogari të ISUV ka përfshirë vlerën e TVA[18] / TVSH-së, ndërkohë që për të njëjtën periudhë, laboratori tjetër

[18] Norma e TVA-së (TVSH-së) në Belgjikë është 21% - Norma standarde

i kontraktuar, Wageningen (Holandë), nuk ka përfshirë vlerën e TVSH-së në faturat e shërbimit kundrejt ISUV.
- Në marrëveshjen tip të bashkëpunimit të ISUV me laboratorin C. Group (Belgjikë), nuk është përcaktuar mos përfshirja e TVA / TVSH-ja, për analizat që do të kryejë për llogari të ISUV, por ky fakt nuk do te thotë që e lejon Laboratorin C. Group me seli në Belgjikë të përfshijë vlerën e TVA në faturat e shërbimit, në rastet kur vendndodhja e porositësit dhe marrësit të shërbimit nuk ndodhen në të njëjtin shtet, ndryshe nga sa është vepruar në mënyrë të drejtë me pagesat ndaj laboratorit Wageningen (Holandë), ku në asnjë rast nuk është përfshirë VAT.
- Grupit të auditimit të KLSH, krahas dokumentacionit të kërkuar në lidhje me pagesat e kryera nga ISUV për laboratorin C. Group, iu vunë në dispozicion edhe fatura për periudha para auditimit, ku konstatohet se në këto raste nuk është përfshirë TVA. Kjo tregon se laboratori C. Group në këto raste ka respektuar parashikimet e nenit 21, pika 2 të Kodit të TVSH-së, së shtetit Belg, për parimin "Reverse Charge".
- Të gjitha faturat e C. Group, për periudhën 2022-2024, ku është përfshirë TVA, dhe ato ku TVA është zero, janë firmosur nga Dr. N. Gillard, drejtori i laboratorit të analizave të C. Group.
- Për periudhën objekt auditimi, shpenzimet totale për kryerjen e analizave me nënkontraktim për llogari të ISUV arrijnë afërsisht në 1,880,000 euro, me një shpenzim mesatar vjetor prej rreth 627,000 euro.
- Procesi i përzgjedhjes së laboratorëve për kryerjen e analizave, në zbatim të PKKZBR, të cilat realizohen në një nga vendet e BE-së, është kryer pa urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës për ushqimin, në kundërshtim me nenin 44, pika 4, neni 45, neni 46, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar, si dhe me nenin 81, 120, 121, 122, 123, 124 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Gjithashtu, propozimet për përzgjedhjen e laboratorëve referentë në vendet e BE-së, të bëra nga strukturat përgjegjëse pranë ISUV-it, nuk janë mbështetur në një studim të mirëfilltë për laboratorët e akreditуar, duke rritur riskun financiar të marrjes së të njëjtit shërbim me kosto më të lartë.
-Nga ana e zyrës së financës së nuk janë evidentuar parregullsi lidhur me faturat e lëshuara nga kompania C. Group me seli në Belgjikë, ku është përfshirë TVA në masën 21%.
-Pas konfirmimit nga nëpunësi zbatues në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur pranë zyrës së financës, është përgatitur urdhër shpenzimi për kryerjen e pagesës së shërbimeve të përfituara jashtë vendit, duke lejuar kështu ekzekutimin e faturave të dërguara nga laboratori C. Group, pavarësisht përfshirjes së vlerës së TVA-së.

Për periudhën objekt auditimi, përfshirja e TVA-së në faturat e C. Group ka rezultuar në një kosto shtesë prej 297,774.27 euro, ose 32,576,505 lekë, shumë e cila nga KLSH do të konsiderohet si përdorim i fondeve buxhetore pa ekonomicitet.

(*Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.6.6, faqe 118-123 të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për analizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në shumën prej **32,576,505 lekë**.
Përfshirja dhe kryerja e pagesës së TVSH-së për laboratorin C. Group, nuk përputhet me parimin e përdorimit të fondeve publike me ekonomicitet, duke sjellë një kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Për këtë arsye, është e nevojshme të ndërmerren masa për parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE
D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, shkronja (c), si dhe në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 58, "Llojet e masave disiplinore", VKM nr. 115,

datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i **rekomandojmë** Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga "Vërejtje", deri në "Largim nga shërbimi civil", (në proporcion me shkeljen e kryer), për z. I. A, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i ISUV, për parregullsitë e konstatuara në të gjitha fazat e procedurave të prokurimit, për parregullsitë lidhur me krijimin e njësive të prokurimit dhe komisioneve për specifikimet teknike, vlerësimin e ofertave, marrjen në dorëzim, mosgarantimin e përdorimit të fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë, bazuar në nenin 21, pika 5/1, të Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, nenin 73, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, dhe nenin 8, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

D.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Titullari i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masat për ngritjen e Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 59, pika 4, germa b, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", për të vlerësuar nivelin e përgjegjësisë individuale të punonjësve në shkeljet e konstatuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit dhe caktimin e masave disiplinore përkatëse, sipas përcaktimit në nenin 57, pika 1, të këtij Ligji, në masat nga "*vërejtje*" deri në "*pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet*", sipas përcaktimit në nenin 58, germat a, b, c, të këtij Ligji, si më poshtë:

1.Znj. J. B., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit me objekt: "Inkubator për rritjen e Mykobakterieve"; "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat kryesore të veprimtarisë analitike: siguria ushqimore, shëndeti i kafshëve dhe i bimëve"; "Grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i mbetjeve laboratorike"; "Shërbim, riparim dhe servis kalibrimi për vitin 2024"; Zbatimi i Planit Kombëtar për molusqet dhe zonat e tyre të rritjes; "Blerje enësh dhe materialesh laboratorike"; "Blerje standardesh dhe materialesh referencë"; "Shërbim, riparim dhe servis kalibrimi"; "Blerje kite".

2. Z. P. A., në cilësinë e ish-titullarit të institucionit, për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me të njëjtët anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3.Znj. E. M., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit me objekt: "Inkubator për rritjen e Mykobakterieve"; "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për vitin 2024"; "Blerje enë dhe materiale laboratorike"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi"; "Blerje kite"; si dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike".

4.Znj. A. I., në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për parregullsitë në administrimin e procesit të prokurimit; në cilësinë e personit të angazhuar me studimin e tregut, për kryerjen e studimit të tregut para hartimit të specifikimeve teknike të objektit që prokurohet nga komisioni i posaçëm, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetje laboratorike"; për kryerjen e veprimeve të paautorizuara lidhur me studimin e tregut për përllogaritjen e fondit limit në procedurat "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes"; "Blerje standarde dhe materiale referencë"; dhe në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për procedurën "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës"; dhe për mos hartimin e planeve të zbatimit të kontratës "Shërbim, riparim, servis kalibrimi".

5.Znj. E. B., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit me objekt: "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet

analitik: siguria ushqimore, shëndeti i kafshëve dhe bimëve"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për vitin 2024"; "Blerje kite"; si dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, në procedurën e prokurimit me objekt: "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike"; "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes". Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes"; "Blerje enë dhe materiale laboratorike"; "Blerje standarde dhe materiale reference"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi".

6.Znj. S. K., në cilësinë e anëtares së Komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes", dhe në procedurën "Blerje kite"; në cilësinë e anëtares së Komisionit të marrjes në dorëzim.

7.Znj. V. V., në cilësinë e anëtares së Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit me objekt: "Inkubator për rritjen e Mykobakterieve"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për vitin 2024"; "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes"; "Blerje enë dhe materiale laboratorike"; "Blerje standarde dhe materiale referencë"; "Shërbim, riparim, servis kalibrimi"; dhe "Blerje kite".

8.Znj. D. T., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit "Inkubator për rritjen e Mykobakterieve"; "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes".

9. Znj. D. Sh., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit me objekt "Inkubator për rritjen e Mykobakterieve" dhe "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes", si dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, nuk ka përcaktuar dhe mbajtur penalitetin e zbatimit të kontratës së kësaj procedure në vlerën 7,321,208 lekë; dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për "Mobilim, arredim dhe vënien në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës".

10.Znj.E. N., në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes"; në cilësinë e anëtares së Komisionit për përllogaritjen e fondit limit, në procedurën "Blerje standarde dhe materiale referencë"; dhe në cilësinë e anëtares së Komisionit të marrjes në dorëzim, në procedurën e prokurimit "Blerje kite për nevoja të ISUV", e zhvilluar nga MZHBR.

11.Znj.A. Ç., në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes".

12. Znj. F. H., Znj. A. D., Z. E. Sh., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit "Blerje enë dhe materiale laboratorike" viti 2023 dhe **z. E. Sh.** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim, në procedurën e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes" dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit me objekt "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh".

13.Z. R. M., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim, në procedurat e prokurimit "Implementimi i planit kombëtar të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes" dhe "Blerje kite".

14.Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit me objekt (i) "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh", (ii) "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike", (iii) "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për vitin 2024"; "Blerje kite"; në cilësinë e anëtares së Komisionit të marrjes në dorëzim për "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", Loti II.

15.Znj. D. Sh., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit me objekt (i) "Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në tre fushat ku ushtron aktivitetin e vet analitik, siguri ushqimore, shëndet

kafshësh dhe bimësh", (ii) "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike", (iii) "Shërbim, riparim, servis kalibrimi për vitin 2024".
16.Znj. M. L., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike", dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, në procedurat e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike" dhe "Shërbim, riparim, servis kalibrimi" për vitet 2022 dhe 2024.
17.Znj. S. M., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike" dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratave me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi" për vitet 2022 dhe 2024, sipas përcaktimit në nenin 107, pika 7, të RPP-së.
18.Znj. E. P., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike".
19.Z. H. M., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, në procedurën e prokurimit me objekt "Grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh laboratorike".
20.Znj.A. D., Znj.S. T., Znj.A. J., Znj.S. Dh., Znj.E. Sh., Znj.E. Sh., Znj.K. C., Znj.E. B., Znj.U. R., Znj.S. B., Znj.A. V., Z.A. L., Znj.S. H., në cilësinë e anëtarëve të komisioneve të marrjes në dorëzim të shërbimit, me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi", për lot-et përkatëse, për vitet 2022 dhe 2024 dhe "Blerje enë dhe materiale laboratorike"; "Blerje standarde dhe materiale referencë".
21.Znj.E. K., në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit "Mobilim, arredim dhe vënie në funksion të sallës së konferencave dhe zyrave të administratës".
22.Znj.K. C., Z. L. H., Znj.B. Q., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim, riparim, servis kalibrimi".
23.Z.V. Sh., Znj.B. Q., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim, në procedurën e prokurimit "Blerje kite", nuk është dokumentuar plotësisht përmbushja e të gjitha specifikimeve teknike të artikujve.

D.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, apo me statute të parashikuar në ligje të veçanta.

1. N. Z., në cilësinë e Arkivist/Protokolliste; për mospasqyrimin e dokumentacionit zyrtar në librin e protokollit, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor

D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.
1. Për **z. A. R.** me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës me shkresën nr. Shkresa Nr. 2888 Prot., datë 24.05.2022.

D.3. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

V. ANEKSE

Aneksi 2.6.2. *Realizimi i planeve kombëtare të kontrolleve*

Tabela nr.3. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB)

Viti	Aktiviteti	Kampione të Ardhura	Kamp. të Analizuara	Analiza të Kryera	R. Pozitive Alerte
2022	Monitorimi i Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore (Qershor 2021 - Prill 2022)	885	403	100,750	61
	Kontroll Zyrtar të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore	18	18	4,500	0
	Kontroll Zyrtar me Pagesë (AKU) të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore	0	0	0	-
	Autokontroll	21	21	5,250	8
	Përcaktimi i Nitrateve në Produktet me Origjinë Bimore	12	12	12	0
	Vlerësimi i Dosjeve të PMB-ve	45	45	-	-
	PMB (Analizë L.A.)	41	40	40	-
	Sektori i Diagnostikimit të Dëmtuesve	-	-	-	-
Total		**1,022**	**539**	**110,552**	**69**
2023	Monitorimi i Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore	1,196	1,196	418,600	134
	Kontroll Zyrtar të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore	30	30	10,500	1
	Kontroll Zyrtar me pagesë (AKU) të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore	0	0	0	0
	Autokontroll	0	0	0	0
	Përcaktimi i Nitrateve në Produktet me Origjinë Bimore	30	30	30	-
	Vlerësimi i Dosjeve të PMB-ve	49	49	-	-
	PMB (Analizë L.A.)	49	49	49	-
	Sektori i Diagnostikimit të Dëmtuesve	177	177	177	0
Total		**1,531**	**1,531**	**429,356**	**135**
2024	Monitorimi i mbetjeve të pesticideve	1,080	1,080	378,000	89
	Kontroll Zyrtar i mbetjeve të pesticideve	114	30	39,900	16
	Kontroll Zyrtar me pagesë (AKU)	3	3	1,050	0
	Përcaktimi i nitrateve	23	23	23	0
	Autokontroll	-	-	-	0
	Vlerësimi i dosjeve të PMB-ve	50	50	-	-
	PMB (analiza L.a)	28	28	28	-
	Plani i monitorimit të dëmtuesve	390	390	501	-
Total		**1,638**	**1,638**	**419,502**	**105**

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.5. Dep. i Monitorimit të Mbetjeve, Kontrollit të Barnave Veterinare dhe Toksikologjisë

Aktiviteti	2022	2023	2024
Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me Origjinë Shtazore - Kampione	1968	1696	1577
Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve - Analiza	4974	1696	1577
Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve - Parametra analitikë	138	138	138
Plani i Molusqeve - Kampione	16	-	-

Plani i Molusqeve (plumb, kadmium dhe mërkur) - Analiza	19		
Plani i Molusqeve - Parametra analitikë	48	-	-
Plani i Peshkut - Kampione	131	94	26
Plani i Peshkut - Analiza	131	94	26
Plani i Peshkut - Parametra analitikë	3406	6	6
Kontrolli zyrtar (AKU) - Kampione	84	162	211
Kontrolli zyrtar (AKU) - Analiza	156	179	211
Kontrolli zyrtar (AKU) - Parametra analitikë	290	-	-
Analiza për qëllim eksporti - Kampione	16	1	10
Analiza për qëllim eksporti - Analiza	32	1	10
Analiza për qëllim eksporti - Parametra analitikë	48	-	-
PMV Aplikime online - Aplikime gjithsej	115	207	98
PMV - Regjistrime	61	61	42
PMV - Riregjistrime	29	112	28
PMV - Variacione	25	34	28
Teste për PMV - Teste fiziko-kimike	319	546	331
Teste për PMV - Teste mikrobiologjike	60	177	39
Teste për PMV - PMV të testuar	90	-	-

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.6. Departamentit i Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë (DMMUC)

Viti	Burimi / Programi	Ardhur (Kampione)	Realizuar (Kampione)	Realizuar (Analiza)
2022	PKM Molusqe	1,049	1,049	1,310
	AKU Zyrtare	1,628	1,628	8,856
	Autokontroll	1,269	1,269	6,521
	Totali	**3,946**	**3,946**	**16,687**
2023	PKM Molusqe	931	931	1,051
	AKU Zyrtare	1,980	1,980	10,568
	Autokontroll	774	774	2,442
	Totali	3,685	3,685	14,061
2024	PKM Molusqe	1,020	1,020	1,524
	AKU Zyrtare	2,192	2,192	11,664
	Autokontroll	457	457	2,206
	Plan Peshku	36	36	36
	Totali	**3,669**	**3,669**	**15,394**

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.7. Departamenti i Shëndetit të Kafshëve

Viti	Sëmundja / Aktiviteti	Nr. Kampioneve	Nr. Analizave	Raste Pozitive
2022	Bruceloza në Gjedh (TUQ)	4705 ferma	4705	8 ferma
	Bruceloza në Gjedh (individual)	263	548	36 krerë
	REV 1 në të imta	1121	1121	-
	Afta Epizotike	472	472	-
	Tërbimi në dhelprat e kuqe	267	801	-
	Influenca Aviare(Monitorim serologjik)	1177	1577	10
	Gjuhës Blu	841	708	55
	Tuberkuloz	2	2	2
	Anthrax	65	65	20
	Anisakis spp në peshk	60	60	0

	Bruceloza Shëndetësim	957	1715	12 ferma
	Influence aviare (konf. me Rt-PCR)	292	292	75
	MAED Visna	341	348	0
	Murtaja klasike e derrit	58	58	0
	Diagnoze ne kafshe dhe shpendë	624	863	
2023	Bruceloza në Gjedh (ferma)	6724	6724	25
	Bruceloza në Gjedh (individual)	1264	2528	236
	REV 1 në të imta	1685	1685	-
	Tërbimi në dhelprat e kuqe	170	510	-
	Afta Epizotike	350	350	-
	Gjuhës Blu	294	294	-
	Influenca Aviare	910	910	-
	Afrikan Sëine Fever	0	0	-
	Anthrax	50	150	36
	TBC	2	4	-
	Anisakis spp në peshk	7	7	-
	Diagnozë kafshë/shpendë/akuakulturë	1339	2674	-
2024	Bruceloza në Gjedh (ferma)	6990	6990	9 ferma
	Bruceloza në Gjedh (individual)	1631	1662	31 krere
	REV 1 në të imta	309	309	-
	Tërbimi në dhelprat e kuqe	125	375	-
	Afta Epizotike	501	501	0
	Gjuhës Blu	355	355	0
	Influenca Aviare	977	977	9
	Afrikan Sëine Fever	7	7	7
	Anthrax	78	78	27
	TBC	5	9	1
	Anisakis spp në peshk	86	86	2
	Bruceloze shëndetësim	1628	1936	
	PPR	25	25	
	Diagnozë kafshë/shpendë/akuakulturë	13332	13671	

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Aneksi 2.6.5. *Administrimi i kiteve, reagentëve dhe materialeve laboratorike në ISUV.*

Tabela nr.9. Administrimi i Kiteve për periudhën 2022-2024

Viti	Nr.	Kontrata	Kontraktues	Nr. FH	date Hyrje	Shuma (leke)	Nr. FD.	Data e daljes	Shuma (leke)	Dite qendrimi ne magazine	Personi qe ka terhequr	Departamenti
2022-2023	1	"Blerje Kite" me negocim 2022	Krijon	23	8-Apr-22	164,400	50	8-Apr-22	164,400	0	Lulzime Haxha	DSHK
				24	11-Apr-22	723,600	52	12-Apr-22	723,600	1	Elidona Piroli	PMB
			888,000			**888,000**			**888,000**	-		
	2	"Blerje Kite" kontrata 480/1 dt 03.06.2022	Krijon	54	4-Jul-22	3,689,976	103	5-Jul-22	1,543,512	1	Erga Shkodra	DSHK
					4-Jul-22		104	6-Jul-22	43,584	2	Eglantina Prenga	DMUMUC/SCMU
					4-Jul-22		105	7-Jul-22	281,280	3	Krisida Ciko	STM
					4-Jul-22		106	7-Jul-22	1,821,600	3	Adriana Tuta	PMB
						3,689,976			**3,689,976**	-		
				56	26-Jul-22	860,880	109	28-Jul-22	190,080	2	Marsela Bregu	DMUMUC/SKMU
					26-Jul-22		112	3-Aug-22	670,800	8	Erga Shkodra	DSHK
				59	3-Aug-22	327,600	112	3-Aug-22	327,600	0	Erga Shkodra	DSHK
				64	11-Aug-22	162,000	124	11-Aug-22	162,000	0	Erga Shkodra	DSHK
						1,350,480			**1,350,480**	-		
				5	1-Mar-23	4,703,136	13	1-Mar-23	122,784	0	Ermelinda Nexhipi	DMUMUC/SKMU
					1-Mar-23		14	1-Mar-23	1,821,600	0	Adriana Tuta	PMB
					1-Mar-23		15	1-Mar-23	2,618,112	0	Erga Shkodra	DSHK
					1-Mar-23		16	7-Mar-23	140,640	6	Manuela Kupi	STM
						4,703,136			**4,703,136**	-		
				7	24-Mar-23	469,680	18	24-Mar-23	327,120	-	Erga Shkodra	DSHK
					24-Mar-23		19	27-Mar-23	142,560	3	Eglantina Prenga	DMUMUC/SKMU
						469,680			**469,680**	-		
			10,217,712			**10,213,272**	-	-	**10,213,272**			
2024	3	"Blerje Kite" kontrata 123/18 dt 18.09.2024	Krijon	71	25-Sep-24	386,040	181	30-Sep-24	386,040	5	Erga Shkodra	DSHK
				74	11-Oct-24	2,589,120	191	17-Oct-24	114,000	6	Ivanela Simoni	dmumUC/SKMU
					11-Oct-24		193	17-Oct-24	2,475,120	6	Erga Shkodra	DSHK
				82	30-Oct-24	3,958,051	203	5-Nov-24	40,920	6	Eglantina Prenga	DMUMUC/SKMU
					30-Oct-24		205	6-Nov-24	97,800	7	Sheqere Roci	PMB/SDD
					30-Oct-24		208	7-Nov-24	102,960	8	Sheqere Roci	PMB/SDD
					30-Oct-24		215	18-Nov-24	3,716,371	19	Brixhilda Qyra	DSHK
				89	15-Nov-24	1,952,760	219	19-Nov-24	60,120	4	Erga Shkodra	DSHK
					15-Nov-24		223	21-Nov-24	727,800	6	Renata Disha	TM
					15-Nov-24		224	21-Nov-24	921,600	6	Matilda Likaj	PMB
					15-Nov-24		232	4-Dec-24	243,240	19	Fatime Hyraj	PMB/SDD
			10,050,211			**8,885,971**			**8,885,971**	-		
					Total hyrje	**19,987,243**	-	**Total dalje**	**19,987,243**	**4**		
Deprartamenti I Mbrojtjes se Bimeve												
Departamenti I Shendetit te Kafsheve												
Departamenti I Mikrobioligjise Ushqimore dhe Monitorimi te Ujrave edhe te cilesise												
Sektori I Kontrollit Mikrobiologjik te produkteve												
Sektori Toksikologjia mbetje												
Sektori I diagmnostikimit te demtuesve ne bime												

Burimi: ISUV, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Aneksi 2.6.6.

Faks simile nr. 1. Fature tatimore e C. Group pa TVSH



CER Groupe

Facture

Adresse de livraison
FSVI: Food Safety and Veterinary Institute
St. Aleksander Moisiu no. 82
TIRANE, 1001
Albania

Adresse de facturation
FSVI: Food Safety and Veterinary Institute
St. Aleksander Moisiu no. 82
TIRANE, 1001
Albania

Contact	Mme Caroline CHARLIER	A mentionner à chaque communication		
N° tél. contact	+32 (0)84/658.095	Code client	N° document	Date
Votre N° TVA		C00925	VEN-19-0842	20/05/19

N° article	Désignation	Unité	Qté	P.U.	Montant	% TVA
RESI-0047	MS: Stéroïdes (urine) Rapport d'essai N° 19/1652 Echantillons analysés au mois de mai 2019 Samples analysed in May 2019 Y/Ref: 416 Prot Prestation de service B2B Principe de localisation du service art. 21 §2 du Code TVA belge "Autoliquidation" - N° identification fiscale: 3 61828040 C Supply of services B2B Principle of location of the service art. 21 §2 of the Belgian VAT Code "Reverse charge" - Tax ID Nr: 3 61828040 C	U	2,000	200,00	400,00	

Dr N. GILLARD
Head of Analytical Laboratory
CER Groupe
Rue du Point du Jour 8
BE-6900 MARLOIE (BELGIUM)
Tel. +32 (0)84 65 80 80
n.gillard@cergroupe.be

Pour nos conditions générales de vente, consultez notre site http://www.cergroupe.be

	0%				
ase	400,00				
VA	0,00				

Sous-total	400,00
TVA	0,00
Total	400,00
A payer	**EUR 400,00**
Date d'échéance	**19/06/19**

yable à 30 jours date de facture
ELFIUS IBAN : BE 06 0682 4372 1722 BIC : GKCCBEBB
NP PARIBAS FORTIS IBAN : BE 78 0014 8431 2366 BIC : GEBABEBB

t Groupe | Fondation d'utilité publique
ails Science Park • Rue de la Science 8 • BE-6900 Aye (Belgique)
+32 (0)84 22 02 11 • F +32 (0)84 22 02 12

info@cergroupe.be
www.cergroupe.be
TVA BE 0420 654 158 RPM Marche-en-Famenn

Faks simile nr. 2. Fature tatimore e C. Group me TVSH (faqe 1 dhe 5)



CER Groupe

Invoice

Delivery address
FSVI: FOOD SAFETY AND VETERINARY INSTITUTE
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
2020 Rruga Aleksandër Moisiu Nr.82
TIRANE, 1001
Albania

Invoicing address
FSVI: FOOD SAFETY AND VETERINARY INSTITUTE
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
2020 Rruga Aleksandër Moisiu Nr.82
TIRANE, 1001
Albania

Contact	Mme Caroline CHARLIER	*To mention on every communication*		
Contact phone no.	+32 (0)84/658.090	Cust. Code	Document no.	Date
Your VAT no.		C00925	VEN-24-1607	31/07/24

Item no.	Description	Unit	Qty	U.P.	Amount	VAT %
RESI-0150	MS: Tranquilisants, Bêta-bloquants (rein)	U	1,000	175,00	175,00	21
	Report of assay N° 24/3213 - 502/Prot					
RESI-0393	MS: Stéroïdes, Corticostéroïdes (urine)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3241 - 502/Prot					
RESI-0156	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (muscle)	U	1,000	383,00	383,00	21
	Report of assay N° 24/3261 - 502/Prot					
RESI-0177	MS: Aminoglycosides (muscle)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0156	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (muscle)	U	1,000	383,00	383,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0177	MS: Aminoglycosides (muscle)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0156	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (muscle)	U	1,000	383,00	383,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0177	MS: Aminoglycosides (muscle)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0156	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (muscle)	U	1,000	383,00	383,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0177	MS: Aminoglycosides (muscle)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0156	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (muscle)	U	1,000	383,00	383,00	21
	Report of assay N° 24/3262 - 502/Prot					
RESI-0177	MS: Aminoglycosides (muscle)	U	1,000	218,00	218,00	21
	Report of assay N° 24/3263 - 502/Prot					

Dr. N. GILLARD
Head of Analytical Laboratory
CER Groupe
Rue du Point du Jour 8
BE-6900 MARLOIE (BELGIUM)
Tel. +32 (0)84 65 80 90
n.gillard@cergroupe.be

Page 1 of 5

CER Groupe

Invoice

Item no.	Description	Unit	Qty	U.P.	Amount	VAT %
RESI-0342	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (miel) Report of assay N° 24/3478 - 502/Prot	U	1,000	383,00	383,00	21
RESI-0316	MS: Aminoglycosides (miel) Report of assay N° 24/3479 - 502/Prot	U	1,000	218,00	218,00	21
RESI-0342	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (miel) Report of assay N° 24/3479 - 502/Prot	U	1,000	383,00	383,00	21
RESI-0302	MS: Macrolides, Lincosamides, Pleuromutilines Report of assay N° 24/3544 - 502/Prot	U	1,000	218,00	218,00	21
RESI-0316	MS: Aminoglycosides (miel) Report of assay N° 24/3544 - 502/Prot	U	1,000	218,00	218,00	21
RESI-0342	MS: Dépistage médicaments vétérinaires (miel) Report of assay N° 24/3544 - 502/Prot	U	1,000	383,00	383,00	21
03	Samples carried out in july 2024					
REV. CH.	« Reverse charge » Supply of services Principle of location of the service art. 21 §2 of the Belgian VAT Code					

Dr. N. GILLARD
Head of Analytical Laboratory
CER Groupe
Rue du Point du Jour 8
BE-6900 MARLOIE (BELGIUM)
Tél. +32 (0)84 65 80 90
n.gillard@cergroupe.be

For our general conditions of sale, visit our website http://www.cergroupe.be

	21%			
Base	18.387,00			
VAT	3.861,27			

Subtotal	18.387,00
VAT	3.861,27
Total	22.248,27
To pay	**EUR 22.248,27**
Due date	**30/08/24**

PAYMENT DUE 30 DAYS FROM INVOICE DATE
BELFIUS IBAN : BE 06 0682 4372 1722 BIC : GKCCBEBB
BNP PARIBAS FORTIS IBAN : BE 78 0014 8431 2386 BIC : GEBABEBB

CER Groupe | Fondation d'utilité publique
Novalis Science Park • Rue de la Science 8 • BE-6900 Aye (Belgique)
T : +32 (0)84 22 02 11 • F : +32 (0)84 22 02 12

info@cergroupe.be
www.cergroupe.be
TVA BE 0420 654 158 RPM Marche-en-Famenne

Aneksi 2.6.7.

Figura 1: Eliminimi i mbetjeve – diagrama e fluksit



Burimi: Udhëzuesi 40-LD-013, ISUV

Figura ***2:*** Vendgrumbullimi i mbetjeve kimike brenda ambienteve të ISUV

Burimi: Fotografuar nga grupi i auditimit në ambientet e ISUV

Figura 3: Trajtimi me autoklavizim në ambientet e ISUV

Figura 4: Krematoriumi në ambientet e ISUV

ANEKS 2.6.7/1 "*Asgjësimet e kryera në krematorium, evidentuar nga korrespondenca me sektorin e financës*"[19]

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Data	Dept.
1	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	28	11.01.2024	DTMM[20]
2	Mostra dhjami në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	5	11.01.2024	DTMM
3	Mbeturina të grumbulluara nga autoklava	Paketuar në qese plehrash	Qese	80	17.01.2024	DMMUC[21]
4	Mbeturina të grumbulluara nga kontrollet zyrtare (karkasa)	Analiza në kuadër të kontrolleve zyrtare për diagnozën në kafshë	Kg	250	31.01.2024	DSHK[22]
5	Mbeturina të grumbulluara nga autoklava	Paketuar në qese plehrash	Qese	80	01.02.2024	DMMUC
6	Mostra të grumbulluara nga konxhelatorët	Paketuar në qese plehrash	Qese	150	02.02.2024	DMMUC
7	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha plehrash	Kosh	80	23.02.2024	DMMUC
8	Mostra në ruajtje SPPMM	Qese plastike	3	30	28.02.2024	DMMUC
9	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	28	29.02.2024	DTMM
10	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	28	29.02.2024	DTMM
11	Mostra grurë ruajtje që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	17	29.02.2024	DTMM
12	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	05.03.2024	DMMUC
13	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë	Kg	200	06.03.2024	DSHK
14	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	6	25.03.2024	DTMM
15	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	20	25.03.2024	DTMM
16	Mostra grurë ruajtje që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	4	25.03.2024	DTMM
17	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	140	08.04.2024	DMMUC
18	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë	Kg	400	12.04.2024	DSHK

[19] Pasqyruar nw Akt Konstatimin nr. 10, datw 05.05.2025, pwr tw cilin nuk wshtw paraqitur observacion nga subjekti i audituar.
[20] Departamenti i Toksikologjisë dhe Monitorimit të Mbetjeve
[21] Departamenti i Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë
[22] Departamenti i Shëndetit të Kafshëve

19	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	23	29.04.2024	DTMM
20	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	13.2	29.04.2024	DTMM
21	Mostra grurë ruajtje që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	6.2	29.04.2024	DTMM
22	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	07.05.2024	DMMUC
23	Mostra të grumbulluara nga konxhelatorët	Paketuar në qese dhe kosha	Kosh	150	07.05.2024	DMMUC
24	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë	Kg	400	20.05.2024	DSHK
25	Mostra në ruajtje SPPMM	Paketuar në qese plastike	5	60	22.05.2024	DMMUC
26	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	11	28.06.2024	DTMM
27	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	13	28.060.2024	DTMM
28	Mbeturina të grumbulluara nga laboratori	Materialet e provave (kultura, pjata të inkubuara, 2materiale një perdorimshe)	Kg	8	03.07.2024	DSHMB[23]
29	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	05.07.2024	DMMUC
30	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	20	08.07.2024	DTMM
31	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	10	08.07.2024	DTMM
32	Mostra plastike (maja, shiringa, doreza)	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	2	08.07.2024	DTMM
33	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë	Kg	400	16.07.2024	DSHK
34	Mostra në ruajtje SPPMM	Paketuar në qese plastike	6	70	25.07.2024	DMMUC
35	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë, kampione qumështi nga m,onitorimi i brucelozës	Kg	400	12.08.2024	DSHK
36	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	9	14.08.2024	DTMM
37	Mostra muskul, mëlçi në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	29	14.08.2024	DTMM
38	Mostra dhjam, në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar	Kg	113	14.08.2024	DTMM

[23] Departamenti i PMB-ve, Shëndetit dhe Mbrojtjes së Bimëve

	kaluar afati i qëndrimit në laborator	paraprakisht, paketuar në thasë				
39	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	15.08.2024	DMMUC
40	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	16.09.2024	DMMUC
41	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	26	17.09.2024	DTMM
42	Mostra muskul, mëlçi në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	36	17.09.2024	DTMM
43	Mbeturina të grumbulluara nga laboratori	Materialet e provave (kultura, pjata të inkubuara, materiale një përdorimshe)	Kg	8	24.09.2024	DSHMB
44	Mostra në ruajtje SPPMM	Paketuar në qese plastike	7	80	25.09.2024	DMMUC
45	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	7	14.10.2024	DTMM
46	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	15	14.10.2024	DTMM
47	Mostra dhjam, në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	8	14.10.2024	DTMM
48	Mbeturina të grumbulluara nga nekropsia	Organe shpendë dhe kafshë	Kg	400	15.10.2024	DSHK
49	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	28.10.2024	DMMUC
50	Mbeturina të grumbulluara nga laboratori	Kampione të rezultuar pozitiv, materialet e provave (kultura, pjata të inkubuara, materiale një përdorimshe)	Kg	10	04.11.2024	DSHMB
51	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	35	06.11.2024	DTMM
52	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	10	06.11.2024	DTMM
53	Mostra dhjam, në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	5	06.11.2024	DTMM
54	Mbeturina të grumbulluara nga laboratori	Kampione të rezultuar pozitiv (fidanë), materialet e provave (kultura, pjata të inkubuara, materiale një përdorimshe)	Kg	10	04.12.2024	DSHMB
55	Mostra peshku në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka kaluar afati i qëndrimit në laborator	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar paraprakisht, paketuar në thasë	Kg	22	13.12.2024	DTMM
56	Mostra muskul, melci në ruajtje (frigorifer, konxhelator) që i ka	Mostra të hapura në paketim origjinal, trajtuar	Kg	36	13.12.2024	DTMM

	kaluar afati i qëndrimit në laborator	paraprakisht, paketuar në thasë				
57	Mostra të grumbulluara nga lavanderia	Paketuar në kosha me qese biohazardi	Kosh	100	17.12.2024	DMMUC

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.